



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 04/L-210

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES FINANCIARE NË MES TË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE ASOCIACIONIT
NDËRKOMBËTAR PËR ZHVILLIM – FINANCIMI I DYTË SHITESË
PËR PROJEKTIN E PASTRIMIT TË SEKTORIT TË ENERGIJISË
DHE TË BONIFIKIMIT TË TOKAVE - CLRP**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES FINANCIARE NË
MES TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE ASOCIACIONIT
NDËRKOMBËTAR PËR ZHVILLIM – FINANCIMI I DYTË SHITESË
PËR PROJEKTIN E PASTRIMIT TË SEKTORIT TË ENERGIJISË
DHE TË BONIFIKIMIT TË TOKAVE - CLRP**

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Ky ligj ka për qëllim që të ratifikojë marrëveshjen financiare e nënshkruar në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim lidhur me Financimin e Dytë Shtesë për Projektin e Pastrimit të Sektorit të Energjisë dhe të Bonifikimit të Tokave – CLRP.

Neni 2

Ratifikimi i marrëveshjes

Ratifikohet Marrëveshja Financiare (Financimi i Dytë Shtesë për Projektin e Pastrimit të Sektorit të Energjisë dhe të Bonifikimit të Tokave) e lidhur në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim, më 15 Maj 2013, në Prishtinë.

Neni 3

Dokumentet e bashkëngjitura

1. Në aneksin nr. 1 të këtij ligji është bashkëngjitur “Marrëveshja Financiare (Financimi i Dytë Shtesë për Projektin e Pastrimit të Sektorit të Energjisë dhe të Bonifikimit të Tokave), e lidhur në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim.
2. Në aneksin nr. 2 është bashkëngjitur “Kushtet e Përgjithshme për Kredi dhe Grante” të Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim.
3. Në aneksin nr. 3 është bashkëngjitur “Udhëzimet për prokurimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve, përveç shërbimeve të konsultencës, të huave të marra nga BNRZH-ja dhe kredive dhe granteve të marra ANZH-së, nga huamarrësit e Bankës Botërore”
4. Në aneksin nr. 4 është bashkëngjitur “Udhëzime për përzgjedhjen dhe punësimin e konsulentëve në kuadër të kredive të BB-së dhe granteve të ANZH-së.
5. Në aneksin nr. 5 është bashkëngjitur “Udhëzime për parandalimin dhe luftimin e mashtrimeve dhe të korrupsionit në projektet e financuara nga huat e BNRZH-së dhe nga kreditit dhe grantet e ANZH-së”
6. Në aneksin nr. 6 është bashkëngjitur “Marrëveshja për projekt” e lidhur në mes të Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim dhe Korporatës Energjetike të Kosovës, e nënshkruar më 15 Maj 2013, në Prishtinë.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/ L-210
31 korrik 2013

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI

Marrëveshja për financim

(Financimi i dytë shtesë për Projektin e pastrimit
dhe rikthimit të tokës në Sektorin e Energjetikës)

ndërmjet

REPUBLIKËS SË KOSOVËS

dhe

ASOCIACIONIT NDËRKOMBËTAR PËR ZHVILLIM

Datë 15 maj 2013

MARRËVESHJA PËR FINANCIM

Marrëveshja e datës 15 maj, 2013, e lidhur ndërmjet REPUBLIKËS SË KOSOVËS (“Pranuesi”) dhe ASOCIACIONIT NDËRKOMBËTAR PËR ZHVILLIM (“Asociacioni”) me qëllim të ofrimit të financimit shtesë për aktivitetet e ndërlidhura me Projektin ESCLR (i definuar me Aneksin e kësaj Marrëveshjeje). Pranuesi dhe Asociacioni me këtë pajtohen si në vijim:

NENI 1 – KUSHTET E PËRGJITHSHME, PËRKUFIZIMET

- 1.01. Kushtet e përgjithshme (ashtu siç definoohen në Aneksin e kësaj Marrëveshjeje) janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.
- 1.02. Përveç nëse kërkohet ndryshe nga konteksti, shprehjet me shkronja të shtypura, të përdorura në këtë Marrëveshje kanë kuptimet të cilat janë paraparë me Kushtet e përgjithshme apo me Aneksin e kësaj Marrëveshjeje.

NENI II - FINANCIMI

- 2.01. Asociacioni pajtohet t’i ofrojë Pranuesit, sipas afateve dhe kushteve të parapara këtu apo të përmendura në këtë Marrëveshje, një kredi në shumën e barabartë me dy milionë e tetëqind mijë të Drejta Speciale të Tërheqjes (SDR 2,800,000) (“Financimi”) për të ndihmuar me financimin e projektit të përshkruar në Shtojcën 1 të kësaj Marrëveshjeje (“Projekti”).
- 2.02. Pranuesi mund të tërheq mjetet e Financimit në përputhje me Seksionin IV të Shtojcës 2 të kësaj Marrëveshjeje.
- 2.03. Norma Maksimale e Pagesës për Zotim të cilën e paguan Pranuesi për Bilancin e Patërhequr të Financimit është gjysmë përqind (1/2 e 1%) në vit.
- 2.04. Pagesa për Shërbim të cilën e paguan Pranuesi për Bilancin e Tërhequr të Kredisë është tre të katërtat e përqindjes (3/4 e 1%) në vit.
- 2.05. Pagesa e Interesit të cilën e paguan Pranuesi për Bilancin e Tërhequr të Kredisë është një pikë njëzetë e pesë përqind (1.25%) në vit.
- 2.06. Datat për pagesë janë 15 janar dhe 15 korrik të çdo viti.
- 2.07. Valuta e pagesës është Euro.

NENI III - PROJEKTI

- 3.01 Pranuesi deklaron përkushtimin e vet ndaj pikësnyimeve të Projektit. Për këtë qëllim, Pranuesi zbaton Projektin përmes MMPH-së dhe KEK-ut, në përputhje me dispozitat e Nenit IV të Kushteve të Përgjithshme.
- 3.02 Pa kufizuar dispozitat e Seksionit 3.01 të kësaj Marrëveshjeje, dhe përveç nëse Pranuesi dhe Asociacioni pajtohen ndryshe, Pranuesi kujdeset që Projektin të zbatohet në përputhje me dispozitat e Shtojcës 2 të kësaj Marrëveshjeje.

NENI IV – MJETET LIGJORE TË ASOCIACIONIT

- 4.01. Ngjarjet Shtesë të Suspendimit janë si në vijim:
- (a) Pranuesi ka ndërmarrë apo ka lejuar ndërmarrjen e masave të cilat parandalojnë apo pengojnë kryerjen e obligimeve të KEK-ut sipas Marrëveshjes së projektit.
 - (b) KEK-u nuk ka përmbushur ndonjë obligim nga Marrëveshja e projektit.
 - (c) Asociacioni ka suspenduar disbursimin sipas Marrëveshjes mbi grantin ndërmjet Pranuesit dhe Asociacionit të datës 10 janar 2013 apo sipas ndonjë Marrëveshjeje paraprake financiare ndërmjet Pranuesit dhe Asociacionit për Projektin ESCLR.
 - (d) Asociacioni ka deklaruar se KEK-u nuk ka përmbushur kushtet për të pranuar mjetet nga çfarëdo financimi të ofruar nga Asociacioni, apo të merr pjesë në përgatitjen dhe implementimin e ndonjë projekti të financuar tërësisht apo pjesërisht nga Asociacioni (përfshirë në cilësinë e administratorit të mjeteve të ofruar nga një financues tjetër), si rezultat i: (i) konstatimit nga Asociacioni se KEK-u është përfshirë në praktika mashtruese, të korruptuara, detyruese apo të fshehta përkitazi me përdorimin e mjeteve të financimit të ofruara nga Asociacioni; dhe/ose (ii) deklarin nga ndonjë financues tjetër se KEK-u nuk i përmbush kushtet për të pranuar mjetet e financimit nga një financues i tillë apo të merr pjesë në përgatitjen apo implementimin e ndonjë projekti të financuar tërësisht apo pjesërisht nga financuesi i tillë si rezultat i konstatimit nga financuesi i tillë se KEK-u është përfshirë në praktika mashtruese, të korruptuara, të detyrimit apo të fshehta në lidhje me shfrytëzimin e mjeteve të tilla të financimit nga financuesi i tillë.

NENI V – HYRJA NË FUQI; NDËRPRERJA

- 5.01. Kushtet shtesë të hyrjes në fuqi janë si në vijim:
- (a) Pranuesi i ofron Asociacionit dëshmi të kënaqshme për Asociacionin se Njësia për menaxhim të projektit e MMPH-së është themeluar në përbërje, burime dhe terma të referencës që janë të kënaqshme për Asociacionin; dhe

(b) Marrëveshja e vartësisë është nënshkruar nga Pranuesi dhe KEK-u, në mënyrën e kënaqshme për Asociacionin.

- 5.02. Çështjet Ligjore Shtesë janë si në vijim: që Marrëveshja e vartësisë dhe Marrëveshja mbi Projektin të jenë autorizuar apo ratifikuar nga Pranuesi dhe KEK-u, gjegjësisht të jenë nënshkruar dhe zbatuar në emër të tyre, dhe se të jetë ligjërisht obligativ për Pranuesin dhe KEK-un në përputhje me kushtet e parapara me to.
- 5.03. Afati për hyrje në fuqi është data pas kalimit të nëntëdhjetë (90) ditëve nga data e kësaj Marrëveshjeje.
- 5.04. Për qëllime të Nenit 8.05(b) të Kushteve të Përgjithshme, data në të cilën pushojnë obligimet e Pranuesit sipas kësaj Marrëveshjeje (përveç atyre të cilët rregullojnë obligimet për pagesë) është njëzet (20) vite pas datës së kësaj Marrëveshjeje.

ENI VI – PËRFAQËSUESI; ADRESA

6.01 Përfaqësuesi i Pranuesit është Ministria e Financave.

6.02. Adresa e Pranuesit është:

Ministria e Financave
Rruga Nëna Terezë
10000, Prishtinë
Republika e Kosovës

Faksi:
+381 38 213 113

6.03 Adresa e Asociacionit është:

International Development Association
1818 H Street, N. W.
Washington, D. C. 20433
United States of America

Kabllogram:

Telex:

Facsimile:

INDEVAS
Washington, D.C.

248423 (MCI)

1-202-477-6391

Dakorduar në Prishtinë, Republika e Kosovës, në ditën dhe datën e shkruar më lartë.

REPUBLIKA E KOSOVËS

Nga

Përfaqësuesi i Autorizuar

Emri: _____

Titulli: _____

INTERNATIONAL DEVELOPMENT ASSOCIATION

Nga

Përfaqësuesi i Autorizuar

Emri: _____

Titulli: _____

SHTOJCA 1

Përshkrimi i projektit

Pikësypnimet e Projektit janë: (i) të shtjellojë çështjet e trashëguara mjedisor lidhur me hedhjen e hapur të hirit në tokë nga termocentrali i KEK-ut Kosova A, (ii) t'i mundësohet KEK-ut të lirojë tokën për qëllime të zhvillimit të komunitetit aktualisht e zënë nga materiali i stërngarkuar dhe t'i mundësohet KEK-ut të rregullojë deponinë e hirit të Kosova A; (iii) të mbështetet KEK-u dhe MMPH për të zbatuar operacionet e vazhdueshme të spastrimit dhe praktikave të mira mjedisore në sektorin e minierave dhe të energjetikës.

Pjesa A: Përgatitja e Minierës së hapur të Mirashit për Menaxhim të Hirit

Përgatitja e minierës së Mirashit, përfshirë instalimin e linjës bazë dhe ndërtimin e strukturave anësore të pendës, për të zhvilluar kushtet e duhura për deponim të sigurt dhe të qëndrueshëm të hirit dhe materialeve të mbingarkuara të grumbulluara nga termocentralet Kosova A dhe Kosova B, si dhe nga zhvillimi i mihjes së linjës, me kryerjen e punëve.

Pjesa B: Rregullimi mjedisor i deponive të hirit Kosova A

Deponia ekzistuese e hirit nga Kosova A dhe material i mbingarkuar nga minierat ekzistuese të linjës do të rregullohen në mënyrë që të zbutet ndikimi mjedisor, në veçanti, emetimet e pluhurit, dhe të mënjanojnë jostabilitetet gjeoteknike të materialeve të hedhura të cilat krijojnë rreziqe për shtëpitë përreth, përmes dhënies së ndihmës teknike, pajisjeve dhe punëve.

Pjesa C: Rikthimi i Zonave të mbingarkuara të deponisë

Rikthimi, reformimi dhe rikultivimi i deponisë së mbingarkuar të Fushës Jugore të KEK-ut si dhe deponisë së mbingarkuar perëndimore të minierës së KEK-ut Bardh për lirim të 6.5 kilometrave katrorë të tokës për qëllime të zhvillimit të komunitetit, përfshirë (i) ndërtimin e rrugëve, (ii) sistemin e kanalizimit sipërfaqësor, dhe (iii) mbjelljen e druve dhe vegjetacionit të përzier, me prokurimin e ndihmës teknike, mallrave dhe punëve.

Pjesa D: Menaxhimi i Projektit

Ofrimi i ndihmës teknike KEK-ut dhe MMPH-së për qëllime të implementimit të Projektit, përfshirë financimin e Trajnimit dhe Kostot Inkrementale (të shkallëzuara) Operative siç janë Menaxhimi i projektit, ekspertët afatshkurtër, pajisjet e zyrës për MMPH-në dhe auditimi.

Pjesa E: Pastrimi i kimikateve të rrezikshme në Lokacionin e Gazifikimit të Kosovës A

- (i) Largimi dhe eliminimi i depozitave të katranit dhe llumit të katranit nga lokacioni i gazifikimit të Kosovës A;
- (ii) Monitorimi i implementimit të depozitave të katranit dhe largimin dhe eliminimin e llumit të katranit nga lokacioni i gazifikimit të Kosovës A.

Pjesa F: Monitorimi mjedisor dhe Menaxhimi nga MMPH

Përmirësimi i funksionimit të ekzaminimit dhe të monitorimit në MMPH përkizati me ndikimet mjedisore dhe shoqërore të projekteve të mëdha të termocentraleve, përmes ofrimit të mallrave, punëve dhe ndihmës teknike, përfshirë:

- (i) Pajisjet për monitorim të ajrit për të matur të dhënat elementare mbi cilësinë e ajrit;
- (ii) Monitorimin e dheut dhe ujit për të mbledhur të dhëna mbi të dhënat elementare mbi ndotjen aktuale,
- (iii) Përgatitjen e Vlerësimit të ndikimit mjedisor dhe shoqëror (VNMSH) për Projektin e propozuar të Termocentralit në Kosovë;
- (iv) Monitorimi i implementimit të RAP-it ekzistues;
- (v) Panelet e ekspertëve të themeluara për të këshilluar Pranuesin mbi përgatitjen e VNMSH-së dhe implementimit të RAP-it; dhe
- (vi) Hartimin e strategjisë energjetike për rritjen e ulët të karbonit.

SHTOJCA 2

Ekzekutimi i projektit

Seksioni I. Përgatitjet për implementim

A. Përgatitjet institucionale

1. Pranuesi zbaton Pjesën F të Projektit përmes Njesisë së MMPH-së për menaxhim të projektit (NJPM) dhe kujdeset që KEK-ut të zbatojë Pjesën C dhe E të Projektit. Pranuesi zbaton aktivitete të menaxhimit të projektit të parapara me Pjesën D të Projektit: aktivitetet e menaxhimit të projektit për Pjesën F kryhen përmes MMPH-së ndërsa aktivitetet e menaxhimit të Projektit për Pjesët C dhe E kryhen nga KEK-u.
2. Gjatë tërë kohëzgjatjes së implementimit të Projektit, Pranuesi i furnizon NJMP-së së MMPH-së fonde, stabilimente, shërbime dhe burime të tjera adekuate si dhe me staf të kualifikuar dhe atë në numra të mjaftueshëm.
3. Jo më vonë se 31 tetor, 2013, Pranuesi, përmes NJPM-së së MMPH-së, themelon panelet e ekspertëve, në përbërje dhe me terma të referencës që janë të kënaqshme për Asociacionin, për kryerjen e aktiviteteve të Pjesës F të Projektit.
4. Jo më vonë se 31 tetor, 2013, dhe gjatë ekzekutimit të Projektit, Pranuesi themelon dhe mirëmban Komitetin e hisedarëve për rishqyrtim dhe monitorim për të mbikëqyrur përparimin dhe rezultatet e Komponentës F të Projektit. Komiteti kryesohet nga përfaqësuesi i MMPH-së dhe përbëhet nga përfaqësuesit e Ministrisë për zhvillim ekonomik, Ministrisë për financa, KEK-ut dhe komunës së Obiliqit.
5. Jo më vonë se 31 tetor 2013, Pranuesi, përmes MMPH-së, kujdeset për themelimin e qendrës informative në komunën e Obiliqit në mënyrë që VNMSH-ja dhe dokumentet tjera relevante t'i shpalosen publikut.

B. Marrëveshja e vartësisë

1. Për të lehtësuar zbatimin e Projektit, Pranuesi lidh Marrëveshjen e vartësisë me KEK-un, dhe atë me afate dhe kushte që janë të kënaqshme për Asociacionin, në bazë të së cilës Pranuesi pajtohet t'i jep mjetet relevante të Financimit KEK-ut.
2. Pranuesi ushtron të drejtat e tij sipas Marrëveshjes së vartësisë në mënyrën e cila mbron interesat e Pranuesit dhe Asociacionit dhe përmbushen qëllimet e Financimit. Përveç nëse pajtohet Asociacioni, Pranuesi nuk mund të caktojë, ndryshojë, shkurtojë apo të zhvleftësojë Marrëveshjen e vartësisë apo ndonjë dispozitë të saj.
3. Përmes Marrëveshjes së vartësisë, Pranuesi kujdeset që Bordi i Drejtorëve i KEK-ut të takohet të paktën njëherë në tremujorin kalendarik gjatë implementimit të Projektit, apo më shpesh, sipas nevojës:

- (a) Për të shqyrtuar përparimin në zbatimin e Projektit;
- (b) Për të shqyrtuar Raportet tremujore të progresit nga NJPM e MMPH-së; dhe
- (c) Për t'i ofruar NJPM-së së KEK-ut çfarëdo këshilla apo rekomandime të cilat i konsideron si të duhura apo të domosdoshme në rrethana të caktuara.

4. Përmes Marrëveshjes së vartësisë, Pranuesi kujdeset që NJPM e KEK-ut:

- (a) Gjatë tërë kohëzgjatjes së projektit të furnizohet me fonde, stabilimente, shërbime dhe burime të tjera adekuata, dhe me staf të kualifikuar në numër të mjaftueshëm;
- (b) I raporton Bordit të Drejtorëve të KEK-ut, përmes Shërbimeve Korporative të KEK-ut, në mënyrë të plotë, të rregullt dhe kohë, përfshirë, pa kufizim, ofrimin e raporteve tremujore mbi progresin e Projektit;
- (c) Është përgjegjëse për Zbatimin dhe menaxhimin ditor të Pjesëve C dhe E të projektit, si dhe për aktivitete të menaxhimit të projektit për Pjesët C dhe E, të kryera sipas Pjesës D, përfshirë, pa kufizim, menaxhimin e mbrojtjes mjedisore dhe shoqërore, menaxhimin financiar, prokurimin, dhe monitorimin dhe vlerësimin si dhe raportimin mbi përparimin dhe raportimin financiar, hartimin e përshkrimit të përgjegjësive për konsulentët që financohen nga Projektit dhe shqyrtimin e raporteve të konsulentëve, monitoron punën e konsulentëve të tillë dhe rregullon konsultimet publike, sipas nevojës;
- (d) Përgatit raportet tremujore të progresit të Projektit për Bordin e Drejtorëve të KEK-ut; dhe
- (e) Ushtron funksione të tjera dhe merr përgjegjësi të tjera të cilat i caktohen kohë pas kohe me Doracakun e Operacioneve.

C. Udhëzuesi kundër korrupsionit

Pranuesi kujdeset që Projekti të kryhet në përputhje me dispozitat e Udhëzuesve kundër korrupsionit.

D. Masat mbrojtëse

1. Pranuesi, përmes Marrëveshjes së vartësisë, kujdeset që KEK-u, përmes NJPM-së së KEK-ut, të zbatojë aktivitetet e Pjesës C dhe E në përputhje me Planet për menaxhim mjedisor dhe Doracakun e Operacioneve e në përputhje me kushtet e tyre përkatëse, si dhe aplikon dhe zbaton, varësisht prej rastit, politikat procedurat dhe marrëveshjet e parapara në to.

2. Pranuesi, përmes Marrëveshjes së vartësisë, kujdeset që KEK-u, përmes NJPM-së së KEK-ut, të mos ndryshojë, suspendojë, anulojë, ndërpresë apo të zhvleftësojë apo të lejojë ndryshimin, suspendimin, anulimin, ndërprerjen apo zhvleftësimin e Planeve për menaxhim mjedisor apo Doracakut të operacioneve, apo ndonjë dispozitë të cilës do prej tyre, përveç me miratimin paraprak me shkrim të Asociacionit.
3. Pa pëlqimin paraprak të Asociacionit, Pranuesi nuk ndërmerr veprime vijuese dhe as i lejon KEK-ut t'i bëjë ato:
 - (a) Marrjen e ndonjë vendimi përfundimtar në lidhje me tokën e rikthyer në përputhje me Pjesën C të Projektit; ose
 - (b) Shitjen, transferin, dhënien me qira apo tjetërsimin e tërësishëm apo të pjesërishëm të tokës së tillë.

përveç nëse dhe deri në hartimin e një plani për shfrytëzim të tokës, të kënaqshëm për Asociacionin, në përputhje me legjislacionin për planifikim hapësinor në Kosovë dhe në mënyrë pjesëmarrëse të pranueshme për Asociacionin.
4. Pranuesi, përmes MMPH-së, është përgjegjës për zbatimin e Planit e veprimit për rihvendosje dhe kujdeset që zhvendosja në lidhje me LPTAP për lagjen Shala të fshatit Hade të kryhet në përputhje me dispozitat dhe procedurat e parapara me RAP dhe kujdeset që të ofrohen të gjitha informatat relevante personave të prekur, dhe personave që kanë gjasa të preken, dhe atë me kohë dhe në mënyrë adekuate.
5. Pranuesi nuk ndryshon, suspendon, anulon, ndërprejë apo zhvleftëson apo lejon ndryshimin, suspendimin, anulimin, ndërprerjen apo zhvleftësimin e RAP-it apo ndonjë dispozitë të saj, përveç me lejen paraprake me shkrim të Asociacionit.
6. Pranuesi, përmes MMPH-së, (a) përgatit vlerësimin e Ndikimit Mjedisor dhe Shoqëror të KPP-së së propozuar dhe atë në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Asociacionin; dhe (b) shpalosjen e VNMSH-së në mënyrën e cila është e kënaqshme për Asociacionin.

Seksioni II. Monitorimi, raportimi dhe vlerësimi i projektit

A. Raportet e projektit

Pranuesi monitoron dhe vlerëson, si dhe sigurohet që KEK-u monitoron dhe vlerëson, progresin e Projektit dhe harton Raportet e Projektit në përputhje me dispozitat e Nenit 4.08 të Kushteve të përgjithshme dhe mbi bazë të treguesve të dakorduar me Asociacionin. Çdo Raport i Projektit mbulon periudhën e një tremujori kalendarik dhe i dorëzohet Asociacionit jo më vonë se katër dhjetë e pesë (45) ditë pas përfundimit të periudhës së mbuluar nga ky raport.

B. Menaxhimi financiar, raportet dhe auditet financiare

1. Pranuesi mirëmban apo siguron mirëmbajtjen e një sistemi të menaxhimi financiar në përputhje me dispozitat e Nenit 4.09 të Kushteve të përgjithshme.
2. Pranuesi përgatit dhe i dorëzon Asociacionit si pjesë e Raportit të Projektit jo më vonë se katër dhjetë e pesë (45) ditë pas përfundimit të çdo tremujori kalendarik, raportet e përkohshme të pa audituara financiare për Projektin për tremujor, dhe atë në formë dhe përmbajtje e cila është e kënaqshme për Asociacionin. Pranuesi sigurohet që NJPM-ja e KEK-ut parashtron deklaratat e konsoliduara financiare të projektit deri sa aktivitetet e ndërlidhura me largimin e kimikateve të rrezikshme nga lokacioni i gazifikacionit të kenë përfunduar dhe të jenë raportuar, pas së cilës gjë parashtrihen deklaratat e konsoliduara financiare nga NJPM e MMPH-së.
3. Pranuesi auditon Deklaratat financiare në përputhje me dispozitat e Nenit 4.09(b) të Kushteve të përgjithshme. Çdo auditim i Deklaratave Financiare mbulon periudhën prej një viti financiar të Pranuesit. Deklaratat e audituara financiare për çdo periudhë të tillë i dorëzohen Asociacionit jo më vonë se gjashtë muaj pas përfundimit të periudhe të tillë.

Seksioni III. Prokurimi

A. Të përgjithshmet

1. **Mallrat, punët dhe shërbimet jo-konsulente.** Të gjitha mallrat, punët dhe shërbimet jo-konsulente të nevojshme për Projektin dhe të cilat duhet të financohen nga mjetet e Financimit furnizohen në përputhje me kushtet e parapara apo të referuara në Seksionin I të Udhëzimeve për prokurim, dhe me dispozitat e këtij Seksioni.
2. **Shërbimet e konsulentëve.** Të gjitha shërbimet e konsulentëve të nevojshme për Projektin dhe të cilat duhet të financohen nga mjetet e Financimit furnizohen në përputhje me kushtet e parapara në Seksionin I dhe IV të Udhëzimeve për konsulentë, dhe me dispozitat e këtij Seksioni.
3. **Përkufizimet.** Shprehjet me shkronjën e parë të madhe të përdorura në këtë Seksion në vijim për të përshkruar metodat të caktuara të prokurimit apo metoda të rishqyrtimit të kontratave të caktuara nga Asociacioni, iu referohen metodave gjegjëse të përshkruara në Udhëzimet për prokurim, apo në Udhëzimet për konsulentë, varësisht prej rastit.

B. Metodatat e caktuara të prokurimit të mallrave, punëve dhe shërbimeve jo-konsulente

1. **Ofertimi konkurrues ndërkombëtar.** Përveç nëse ndryshe parashihet në paragrafin 2 në vijim, mallrat, punët dhe shërbimet jo-konsulente furnizohen sipas kontratave të dhënë në bazë të Ofertimit konkurrues ndërkombëtar.
2. **Metodat tjera të prokurimit të mallrave, punëve dhe shërbimeve jo-konsulente.** Tabela vijuese përcakton metodat tjera të prokurimit, përveç Ofertimit konkurrues ndërkombëtar, të cilat mund të aplikohen për mallra, punë dhe shërbime jo-konsulente. Plani i prokurimit përcakton rrethanat në kuadër të të cilëve mund të aplikohen këto metoda:

Metoda e prokurimit

- (a) Ofertimi konkurrues ndërkombëtar, i bazuar në dispozitat e Aneksit të kësaj Shtojce 2
- (b) Blerja e thjeshtë (shoppingu)
- (c) Kontraktimi direkt

C. Metodatat e veçanta të prokurimit të shërbimeve konsulente

1. **Përzgjedhja e bazuar në cilësi dhe kosto.** Përveç nëse parashihet ndryshe në paragrafin 2 në vijim, shërbimet konsulentë sigurohen me kontratat që jepen sipas përzgjedhjes të bazuar në cilësi dhe kosto.
2. **Metodat tjera të prokurimit të shërbimeve konsulente.** Tabela në vijim përcakton metodat e prokurimit, përveç Përzgjedhjes së bazuar në cilësi dhe kosto, të cilat mund të aplikohen për shërbimet konsulentë. Plani i prokurimit përcakton rrethanat në kuadër të të cilëve mund të aplikohen metodat e tilla.

Metoda e aplikimit

- (a) Përzgjedhja me kosto më të ulët
- (b) Përzgjedhja e bazuar në Kualifikimet e konsulentëve
- (c) Përzgjedhja një-burimore
- (d) Përzgjedhja e konsulentëve individual

D. Shqyrtimi i Vendimeve të prokurimit nga ana e Asociacionit

Plani i prokurimit përcakton kontratat të cilat i nënshtrohen Shqyrtimit Paraprak të Asociacionit. Të gjitha kontratat e tjera i nënshtrohen Shqyrtimit pasues (post-shqyrtimit) nga Asociacioni.

Seksioni IV. Tërheqja e mjeteve të Financimit

A. Të përgjithshmet

1. Pranuesi mund të tërheq mjetet e Financimit në përputhje me dispozitat e Nenit II të Kushteve të Përgjithshme, këtij Seksioni, dhe udhëzimeve të tjera shtesë të cilat i përcakton Asociacioni e për të cilat njofton Pranuesin (përfshirë “Udhëzimet e Bankës Botërore për Disbursime për Projekte” të datës maj 2006, me ndryshime periodike nga Asociacioni e të cilat vlejnjë për këtë Marrëveshje në përputhje me udhëzimet e tilla), për financimin e Shpenzimeve të pranueshme, ashtu siç është paraparë në tabelën në paragrafin 2 në vijim.
2. Tabela vijuese përcakton kategoritë e Shpenzimeve të pranueshme të cilat mund të financohen me mjetet e Financimit (“Kategoria”), alokimin e shumës së Kredisë për çdo Kategori, si dhe përqindjen e shpenzimeve e cila do të financohet për Shpenzimet e pranueshme në çdo Kategori:

Kategoria	Shuma e Financimit të alokuar (e shprehur në SDR)	Përqindja e shpenzimeve që do të financohen (përfshirë tatimet)
(1) Mallrat, punët, shërbimet jo-konsulente si dhe shërbimet konsulentë për Pjesët C (iii) dhe E të Projektit	1,200,000	100%
(2) Mallrat, punët, shërbimet jo-konsulente dhe shërbimet konsulentë për Pjesën F të Projektit	1,521,000	100%
(3) Mallrat, punët, shërbimet jo-konsulente dhe Kostot e përshkallëzuara operative për Pjesën D të Projektit		
(a) KEK	15,000	100%
(b) MMPH	64,000	100%
SHUMA E PËRGJITHSHME	2,800,000	

B. Kushtet e tërheqjes; periudha e tërheqjes

1. Pavarësisht dispozitave të Pjesës A të këtij Seksioni, nuk bëhet asnjë tërheqje për pagesat para datës së kësaj Marrëveshjeje, përveç tërheqjeve në shumën e përgjithshme e cila nuk tejkalon pesëqind e gjashtë dhjetë mijë të Drejta Speciale të Tërheqjes (SDR 560,000) për pagesat që janë para kësaj date por më apo para datës 1 qershor 2012, dhe atë për Shpenzimet e pranueshme.
2. Data e mbylljes është 31 dhjetor 2014.

**ANEKSI
PËR
SHTOJCËN 2**

OFERTIMI KOMBËTAR KONKURRUES – NDRYSHIMET

1. Procedura e prokurimit që duhet të aplikohen për Ofertimin kombëtar konkurrues është Procedura për tenderim të hapur, e paraparë me Ligjin Kosovar për prokurimin publik nr. 04/L-042, të datës 29 gusht, 2011 (“LPP”), me kusht që procedurat e tilla t’i nënshtrohen dispozitave të Pjesës I dhe paragrafëve 3.3 dhe 3.4 të “Udhëzimeve për prokurim të mallrave, punëve dhe shërbimeve jo-konsulente për Kreditë e IBRD-së si dhe Grantet e Kreditë të IDA-së nga Huamarrësit e Bankës Botërore” (janar 2011) (“Udhëzimet për prokurim”) si dhe dispozitave vijuese shtesë:

Kushtet për pjesëmarrje

2. E drejta për pjesëmarrje në procesin e prokurimit dhe për dhënie të kontratës të financuar nga Asociacioni definohet me Pjesën I të Udhëzimeve për prokurim; rrjedhimisht, asnjë ofertues apo ofertues i mundshëm nuk mund të shpallet si jo i përgjegjshëm për kontratat e financuara nga Asociacioni për çfarëdo arsye, përveç atyre të parapara me Pjesën I të Udhëzimeve për prokurim.

Regjistrimi i kontraktuesve dhe furnitorëve

3. Regjistrimi nuk mund të përdoret për të vlerësuar kualifikimet e ofertuesve.
4. Operatorit të huaj ekonomik nuk do t’i kërkohet që të regjistrohet për parashtrimin e ofertës, ndërsa ofertuesit të huaj të rekomanduar për dhënie të kontratës i jepet mundësi e arsyeshme për t’u regjistruar, me bashkëpunimin e arsyeshëm të Huamarrësit, para nënshkrimit të kontratës.

Dokumentet e ofertimit

5. Përdoren dokumentet e ofertimit të pranueshme për Asociacionin, të cilat përgatiten në një mënyrë e cila siguron ekonomi, efikasitet, transparencë dhe përputhje të gjerë me dispozitat e Pjesës I të Udhëzimeve të prokurimit.

Kualifikimi

6. Kriteret për kualifikim përcaktohen qartazi në dokumentet e ofertimit. Të gjitha kriteret e përcaktuara në këtë mënyrë, dhe vetëm këto kriteret, përdoren për të përcaktuar nëse një ofertues është i kualifikuar. Kualifikohet vlerësohen mbi bazën “kalon ose nuk kalon”, dhe nuk përdoren pikat për meritë. Vlerësimi i tillë bazohet ekskluzivisht mbi aftësinë dhe resurset e ofertuesit apo ofertuesit të mundshëm që të ekzekutojë kontratën në mënyrë efektive, duke marrë parasysh faktorët objektivë dhe të matshëm, përfshirë: (i) përvojën relevante të përgjithshme dhe specifike, si dhe punët paraprake të kënaqshme dhe përfundimin e suksesshëm të kontratave të ngjashme gjatë periudhës së dhënë; (ii) pozita financiare; dhe aty ku është relevante (iii) aftësia për ndërtim dhe/ose stabilimentet prodhuese.

7. Procedurat dhe dokumentet e parakualifikimit të pranueshme për Asociacionin përdoren për punë të mëdha, komplekse, dhe/ose të specializuara. Verifikimi i informatave në bazë të të cilave është parakualifikuar ofertuesi, përfshirë zotimet aktuale, kryhet në kohën e dhënies së kontratës, krahas vlerësimit të kapaciteteve të ofertuesit përkitazi me personelin dhe pajisjet.
8. Për prokurimin e mallrave dhe punëve ku nuk aplikohet para-kualifikimi, kualifikimi i ofertuesit i cili rekomandohet për dhënie të kontratës vlerësohet me pas-kualifikim, ku aplikohen kriteret e kualifikimit të cekura në dokumentet e ofertimit.

Vlerësimi i kostos

9. Vlerësimet e hollësishme të kostos janë konfidenciale dhe nuk iu shpalosen ofertuesve të mundshëm. Asnjë ofertë nuk refuzohet në bazë të krahasimit me vlerësimet e kostos pa pëlqimin paraprak me shkrim nga Asociacioni.

Vlerësimi i kostos

10. Ofertuesve të mundshëm u jepen së paku tridhjetë (30) ditë nga dita e publikimit të ftesës për ofertim apo datës së disponueshmërisë së dokumenteve të ofertimit, cila do që të paraqitet më vonë, për të përgatitur dhe parashtruar ofertat. Ofertat hapen publikisht, menjëherë pas afatit për parashtrim të ofertave. Ofertat e pranura pas afatit për parashtrim të ofertave refuzohen dhe iu kthehen ofertuesve të pahapura. Kopja e procesverbalit nga hapja e ofertave iu jepet të gjithë ofertuesve të cilët kanë paraqitur oferta, si dhe Asociacionit në lidhje me kontratat të cilat i nënshtrohen shqyrtimit paraprak të Asociacionit.

Vlerësimi i ofertave

11. Vlerësimi i ofertave bëhet në përputhje të plotë me kriteret për vlerësim të parapara në dokumentet e ofertimit. Kriteret tjera të vlerësimit, përveç çmimeve, vlerësohen nga aspekti monetar. Gjatë vlerësimit të ofertës, nuk aplikohen pikat për meritë, dhe as nuk jepen pikat minimale apo vlera në përqindje për rëndësinë e çmimit.
12. Gjatë vlerësimit të ofertave, nuk shfaqet preferencë për ofertuesit në bazë të kombësisë së tyre, origjinës së mallit dhe shërbimeve, dhe/ose programeve preferenciale. Kontratat i jepen ofertuesit të kualifikuar, oferta e të cilit është konstatuar: (i) të jetë e përgjegjshme me dokumentet ofertuese, (ii) të ketë ofruar çmimin më të ulët të vlerësuar. Nuk lejohen negociatat. Si kusht për dhënie të kontratës, ofertuesit nuk i kërkohet që të ndërmer obligime të cilat nuk janë përcaktuar në dokumentet ofertuese apo të ndryshojnë në ndonjë mënyrë tjetër ofertën pas parashtrimit fillestar. Ofertuesi nuk eliminohet nga vlerësimi i detajshëm në bazë të devijimeve të vogla, jo-thelbësore.

Refuzimi i të gjitha ofertave dhe ri-ofertimi

13. Ofertat (ose edhe një ofertë e vetme nëse vetëm një e tillë pranohet) nuk refuzohen, procesi i prokurimit nuk anulohet dhe ofertat e reja nuk kërkohen pa pëlqimin paraprak me shkrim nga Asociacioni.

Vlefshmëria e ofertave

14. Periudha e vlefshmërisë së ofertave e kërkuar me dokumentet ofertuese duhet të jenë të mjaftueshme të mbulojnë çfarëdo periudhë e cila mund të jetë e nevojshme për aprovimin dhe regjistrimin e kontratës, ashtu siç parashihet me LPP. Nëse arsyetohet me rrethana të jashtëzakonshme, të gjithë ofertuesit mund të kërkojnë zgjatje të vlefshmërisë së ofertës para skadimit të datës fillestare të vlefshmërisë, me kusht që zgjatja e tillë të mbulojë jo vetëm periudhën minimale të nevojshme për të kryer vlerësimin, dhënien e kontratës, dhe/ose përfundimin e procesit të regjistrimit; në raste të tilla, kërkohet një zgjatje gjegjëse e garancës së ofertës. Ofertuesi mund të refuzojë kërkesën për zgjatje të vlefshmërisë së ofertës pa humbur garancën e ofertës së tij. Zgjatjet e tjera nuk kërkohen pa pëlqimin paraprak me shkrim të Asociacionit.

Garancat

15. Garancat jepen në formatin e dhënë në dokumentet ofertues. Siguria e ofertës duhet të jetë e vlefshme për njëzet e tetë (28) ditë pas periudhës fillestare të vlefshmërisë së ofertës, ose përtej çfarëdo periudhe të vazhdimit, nëse është kërkuar. Pagesat në avans nuk bëhen pa garancën paraprake të përshtatshme të pagesës.

Mashtrimi dhe korrupsioni

16. Dokumentet e ofertimit dhe të kontratës, të cilat janë të pranueshme për Asociacionin, përfshijnë dispozitat ku ceket politika e Bankës për të dënuar firmat apo individët, për të cilët është konstatuar se janë përfshirë në mashtrim dhe korrupsion, ashtu siç definuar në Udhëzimet për prokurim.

Inspektimi dhe të drejtat për auditim

17. Në përputhje me Udhëzimet për prokurim, çdo dokument i ofertimit dhe kontrata e financuar me mjetet e Financimit sigurojnë që ofertuesit, furnizuesit dhe kontraktuesit, si dhe nënkontraktuesit, përfaqësuesit, personeli, konsulentët, ofruesit e shërbimeve, apo furnitorët e tyre t'i lejojnë Asociacionit të inspektojë të gjitha llogaritë, shënimet dhe dokumentet tjera të ndërlidhura me parashtrimin e ofertave apo me ekzekutimin e kontratës, si dhe auditimin e tyre nga auditorët e emëruar nga Asociacioni. Aktet që kanë për synim pengimin e ushtrimit të inspektimit nga Asociacioni dhe të drejtave për auditim, të parapara me Udhëzimet për prokurim, përbëjnë praktikë penguese, të cilat definojnë në Udhëzime.

Ndryshimet në kontratë

18. Përkitazi me kontratat të cilat i nënshtrohen shqyrtimit paraprak të Asociacionit, Huamarrësi merr pëlqimin e Asociacionit para se të pajtohet për: (a) zgjatjen materiale të kohës së paraparë për ekzekutim të kontratës; (b) ndryshimet thelbësore të fushëveprimit të shërbimeve apo ndryshimet tjera domethënëse të afateve dhe kushteve të kontratës; (c) çfarëdo urdhëri për ndryshim apo devijim (përveç në rastet e

emergjencës ekstreme) të cilat, qoftë ndaras apo së bashku me urdhrat apo ndryshimet tjera paraprahe, e rrisin shumë fillestare të kontratës për më shumë se 15 përqind; ose (d) ndërprerjen e propozuar të kontratës. Asociacionit i dorëzohen kopjet e të gjitha ndryshimeve të kontratës.

SHTOJCA 3

Orari i pagesës

Data e pagesës	Kryegjëja e kredisë për pagesë (e shprehur me përqindje)
Çdo 15 janar dhe 15 korrik:	
Fillon më 15 korrik 2018 e deri më 15 janar 2028, duke përfshirë edhe këtë datë	1.65%
Fillon më 15 korrik 2028 e deri më 15 janar 2038, duke përfshirë edhe këtë datë	3.35%

ANEKSI

Pjesa I. Përkufizimet

1. “Udhëzimet kundër korrupsionit” nënkuptojnë “Udhëzimet për parandalimin dhe luftimin e mashtrimit dhe korrupsionit në Projektet e financuar me Huatë e IBRD-së dhe Kreditë dhe Grantet e IDA-së.”, të datës 15 tetor 2006, të ndryshuar në janar 2011.
2. “Kategoria” nënkupton kategorinë e paraparë në tabelën në Pjesën VI të Shtojcës 2 të kësaj Marrëveshjeje;
3. “Udhëzimet për konsulentë” nënkuptojnë “Udhëzimet: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve në kuadër të Huave të IBRD-së dhe Kredive dhe Granteve të IDA-së nga Huamarrësit e Bankës Botërore”, të publikuar në janar 2011;
4. “Ndikimi i vlerësimit mjedisor dhe shoqëror” apo “NVMSH” nënkupton vlerësimin mjedisor dhe shoqëror, i cili do të përgatitet nga Pranuesi për Projektin e Propozuar Energjetik të Kosovës, dhe i cili përfshin (i) identifikimin dhe vlerësimin e mjedisit të mundshëm dhe ndikimit shoqëror të Projektit të propozuar energjetik të Kosovës, (ii) vlerësimin e masave alternative, dhe (iii) Planin për menaxhim të mjedisit ku ceken masat zbutëse, të monitorimit, institucionale dhe menaxheriale që janë të domosdoshme për zbatimin e PEK-ut, për të informuar procesin e vendim-marrjes të investimeve të propozuara dhe për të rritur kapacitetin monitorues dhe menaxheriale të MMPH-së.
5. “Plani për menaxhim të mjedisit” apo “PMM” nënkupton një plan për menaxhim të mjedisit, i cili është i kënaqshëm për Asociacionin, për të eliminuar, baraspeshuar, apo për të ulur aspektet e dëmshme mjedisor apo shoqërore të aktiviteteve të Projektit në nivele të pranueshme, përfshirë veprimet e nevojshme për të implementuar masat zbutëse, monitoruese dhe institucionale të cilat duhet të ndërmerren gjatë zbatimit dhe kohëzgjatjes së Projektit, përfshirë:
 - (a) Plani për menaxhim të mjedisit, i përgatitur për KEK-un i datës 2 maj 2006 për Projektin ESCLR; dhe
 - (b) Plani për menaxhim të mjedisit, i përgatitur për KEK-un i datës 10 shkurt 2010 për Projektin ESCLR.
6. “Projekti ESCLR” nënkupton Projektin për pastrim të sektorit energjetik dhe rikthim të tokës, të përshkruar me Marrëveshjen për financim ndërmjet Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim, të datës 13 dhjetor 2006, të ndryshuar me Marrëveshjen për financim për Financimin Shtesë të Projektit për pastrim të sektorit energjetik dhe rikthim të tokës, ndërmjet palëve të njëjta, i datës 5 nëntor 2007 si dhe Amendamentin e Marrëveshjeve për financim të datës 4 qershor 2009, të nënshkruar më 12 qershor 2009;
7. “Kushtet e përgjithshme” nënkuptojnë “Kushtet e përgjithshme për kredi dhe grante të Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim”, të datës 31 korrik 2010;

8. “Rregullimi i materialeve të rrezikshme” nënkupton masat për mënjanim, trajtim dhe kontroll të cilat duhet të zbatohen në përputhje me dizajnin e detajshëm dhe PMM-në e Projektit dhe atë në mënyrën e cila ul rrezikun mjedisor dhe shëndetësor lidhur me materialet që ruhen në lokacionin për gazifikim;
9. “Kostot e përshkallëzuara (inkrementale) operative” nënkuptojnë shpenzimet e arsyeshme dhe të domosdoshme të përshkallëzuara, të cilat aprovoen nga Asociacionin në bazë të buxheteve të pranueshme për Asociacionin, të shkaktuara nga Njësitë për menaxhim të projektit për mbështetje teknike për Projektin, si dhe për implementim, lehtësim, koordinim, monitorim dhe vlerësim, të cilat nuk financohen në mënyra të tjera në kuadër të Projektit ECSLR, përfshirë honorarë për konsulentë (të cilat nuk financohen nga shërbimet për konsulentë), furnizime të harxhueshme për zyre, mirëmbajtja dhe riparimi i pajisjeve për zyre, puna dhe riparimi i automjeteve (përfshirë karburantin), komunikimin, përkthimin dhe interpretimin, hartimin e dokumenteve, shpalljen e reklamave dhe njoftimeve për prokurim, shpenzimet e udhëtimit, përfshirë biletat ajrore, transportin lokal, vizitat studimore, punëtori, konferenca, konsultime publike, pagesat për hotel dhe mëditje, si dhe shpenzime të tjera të ndryshme të cilat dakordohen me Asociacionin, por ku përjashtohen pagat dhe honorarët e zyrtarëve dhe nëpunësve të Pranuesit;
10. “KEK” nënkupton Korporata Energjetike e Kosovës sh.a., e inkuorporuar sipas ligjeve të Kosovës më 22 dhjetor 2005 dhe e regjistruar në Regjistrin Kosovar të Organizatave Afariste dhe Emrave Tregtare me numër 70325399, apo çfarëdo pasuesi apo pasuesit e tij;
11. “NJPM e KEK-ut” nënkupton Njësia për menaxhim të projektit në kuadër të KEK-ut për qëllime të implementimit të pjesëve të caktuara të Projektit.
12. “Kosova A” nënkupton stabilimentin ekzistuese për prodhim të energjisë elektrike me linjit, me kapacitet prej 370 MW (neto) e cila gjendet në Obiliq, Kosovë.
13. “Projekti Energjetik i Kosovës” apo “PEK” nënkupton projektin e pavarur të propozuar të energjisë elektrike i cili do të përbëhej nga: (i) impiant i ri prodhimit me bazë të linjtit, të quajtur Termocentrali Kosova e Re (KRPP-TCKR) i cili do të vendoset në një lokacion ngjitur me termocentralin ekzistues Kosova B, përfshirë dy njësi me nga 339 MW çdonjëri, dhe me infrastrukturë përcjellëse, siç janë rrugë për qasje, furnizim me ujë përmes kanalit Ibër – Lepenc, deponinë e hirit, si dhe sistemet bartëse për thëngjill dhe hi, dhe (ii) Miniera e linjtit në Sibocin jugor e cila do të furnizojë linjit TCKR-së, si dhe termocentraleve Kosova A dhe Kosova B, dhe infrastruktura përcjellëse, siç janë rrugët për qasje, sistemet bartëse për transportimin e linjtit në impiante, sistemet e ujësjellësit, dhe deponitë e mbingarkuara.
14. “Projekti i ndihmës teknike për energji elektrike me linjit” apo “LPTAP” nënkupton projektin e përshkruar në Marrëveshjen për financim ndërmjet Administratës së përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe Asociacionit ndërkombëtar për zhvillim, të datës 13 dhjetor 2006.
15. “MMPH” nënkupton Ministrinë e mjedisit dhe planifikimit hapësinor të Pranuesit, apo cildo pasues apo pasuesit e saj;

16. “NJPM e MMPH-së” nënkupton Njësinë për menaxhim të projektit të themeluar në kuadër të MMPH-së për qëllime të implementimit të pjesëve të caktuara të Projektit.
17. “Doracaku i operacioneve” nënkupton Doracakun e operacioneve të paraparë me Marrëveshjen për financim për Projektin ESCLR, i cili mund të jetë ndryshuar apo mund të ndryshohet kohë pas kohe me miratimin paraprak me shkrim nga Asociacioni;
18. “Udhëzimet për prokurim” nënkuptojnë “Udhëzime: prokurimi i mallrave, punëve dhe shërbime jo-konsulente për Kreditë e IBRD-së dhe Kreditë dhe Grantet e IDA-së nga Huamarrësit e Bankës Botërore”, të botuar në janar të vitit 2011;
19. “Plani i prokurimit” nënkupton planin e prokurimit për Planin, të datës 21 mars 2013, të miratuar nga KEK-u dhe MMPH-ja dhe të miratuar nga Pranuesi, i cekur në paragrafin 1.16 të Udhëzimeve për prokurim dhe në paragrafin 1.24 të Udhëzimeve për konsulentë, i cili mund të azhurnohet kohë pas kohe në përputhje me dispozitat në këto paragrafë.
20. “Njësitë për menaxhim të projektit” apo “NJPM-të” nënkuptojnë NJPM-në e KEK-ut dhe NJPM-në e MMPH-së;
21. “Plani i veprimit për zhvendosje” apo “RAP” nënkupton planin e veprimit për rizhvendosje për lagjen Shala të fshatit Hade, i dhjetorit të vitit 2011, të përgatitur për MMPH-në me financimin nga LPTAP.
22. “Korniza e politikës së rizhvendosje” nënkupton Kornizën e politikës për rizhvendosje për Sigurimin e tokës për Zonën e re të mihjes të përgatit për MMPH-në në kuadër të LPTAP-së dhe e miratuar nga Pranuesi më 6 korrik 2011.

REPUBLIKA E KOSOVËS

15 maj, 2013

International Development Association
1818 H Street, N. W.
Washintong, D. C. 20433
United States of America

Lënda: Kredia e IDA-së 5240-XK
(Financimi i dytë shtesë për Projektin e spastrimit dhe rikthimit të tokës në sektorin energjetik)
Seksioni 5.01 e Kushteve të përgjithshme
Të dhënat financiare dhe ekonomike

Të nderuar zotërinj dhe zonja:

Lidhur me Marrëveshjen për financim (Marrëveshja për financim) të kësaj date ndërmjet Republikës së Kosovës (Shteti anëtar) dhe Asociacionit ndërkombëtar për zhvillim (Asociacioni) me të cilin parashihet financimi (Financimi) për projektin e lartpërmendur, si dhe me Kushtet e përgjithshme (Kushtet e përgjithshme) që vlejné për Marrëveshjen për financim, ju shkruaj në emër të Shtetit anëtar për të t'ju vënë në pah si në vijim:

1. E kuptojmë dhe pajtohem që, për qëllime të Seksionit 5.01 të Kushteve të përgjithshme, Shteti anëtar obligohet nga Asociacioni që të raportojë lidhur me “borxhin e jashtëm afatgjatë” (ashtu siç definohet në Doracakun e Bankës Botërore mbi Sistemin e raportimit të debitorëve, të janarit të vitit 2000 (DRSM)), në përputhje me DRSM, dhe në veçanti, të njoftojë Asociacionin mbi “Zotimet e reja kreditore” (ashtu siç definohen me DRSM) jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të tremujorit në të cilin është shkaktuar borxhi, dhe të njoftojë Asociacionin lidhur me “transaksionet e parapara me kredinë e tillë” (ashtu siç definohet me DRSM) një herë në vit, jo më vonë se 31 mars të vitit pas vitit i cili shtjellohet me raport.
2. Deklarojmë se nuk ka shuma të papaguara lidhur me ndonjë borxh të tillë të jashtëm (siç definohet me DRSM). Na është bërë me dije se, gjatë Financimit, Asociacioni mund të bazohet në deklaratimet e dhëna në këtë letër ose të cilave iu referohet kjo letër.
3. Luteni të konfirmoni pajtimin tuaj lidhur me pikat e lartpërmendura ashtu që një përfaqësues i autorizuar i Asociacionit të nënshkruajë në hapësirën e paraparë në vijim.

Sinqerisht i juaji

REPUBLIKA E KOSOVËS

Nga:

Përfaqësuesi i autorizuar

DAKORDUAR:

ASOCIACIONI NDËRKOMBËTAR PËR ZHVILLIM

Nga: _____
Përfaqësuesi i autorizuar

Banka botërore
Banka ndërkombëtare për rindërtim dhe
zhvillim
Asociacioni ndërkombëtar për zhvillim

1818 H Street N. W.
Washington D. C. 20433
U.S.A.

(202) 477-1234
Cable address: INTBAFRAD
Cable address: INDEVAS

15 maj 2013

Z. Ramadan Avdiu
Ushtrues i detyrës së Ministrit për financa
10000 Prishtinë
Republika e Kosovës

Marrëveshja për financim nr. 5240-XK
(Projekti për pastrim dhe rikthim të tokës në Sektorin e energjetikës)

Shkëlqesi:

Bashkëngjitur janë dokumentet vijuese lidhur me Projektin e titulluar si më lartë, të cilat ju dorëzohen Juve si përfaqësues i autorizuar i Republikës së Kosovës.

1. Një origjinal i nënshkruar i Marrëveshjes për financim i datës së cekur në të, i lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës (Pranuesit) dhe Asociacionit ndërkombëtar për zhvillim (Asociacioni).
2. Një origjinal i nënshkruar i Marrëveshjes së projektit i datës së cekur në të ndërmjet Republikës së Kosovës (Pranuesit) dhe Asociacionit ndërkombëtar për zhvillim (Asociacioni).
3. Një origjinal i nënshkruar i Letrës plotësuese nr. 1, Lënda: të dhënat financiare dhe ekonomike.
4. Një kopje e konformuar e Letrës shtesë nr. 2, Lënda: treguesit e monitorimit të performancës.
5. Një origjinal i nënshkruar i Letrës së disbursimit me shtojca.
6. Një kopje e Kushteve të përgjithshme të Asociacionit ndërkombëtar për zhvillim për kredi dhe grante, të datës 31, 2010.
7. Një kopje të Udhëzimeve: prokurimi i mallrave, punëve dhe shërbimeve jo-konsulente me Huatë e IBRD-së dhe Kreditë dhe Grantet e IDA-së nga Huamarrësit e Bankës Botërore, të datës 2011.
8. Një kopje e Udhëzimeve: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve në kuadër të Huave të IBRD-së dhe Kredive dhe Granteve të IDA-së, të datës 15 tetor, 2006, të ndryshuar në janar të vitit 2011.

Në përputhje me dispozitat e Nenit 5.03 të Marrëveshjes për financim, 13 gushti i vitit 2013, është data përfundimtare për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes për financim.

Luteni të konfirmoni në emër të Pranuesit pranimin e dokumenteve të lartcekura duke nënshkruar kopjen e bashkëngjitur të kësaj letre.

Sinqerisht i juaji

Jan-Peter Olters
Menaxher shteti, Kosovë

Shtojcat

Banka botërore
Banka ndërkombëtare për rindërtim dhe
zhvillim
Asociacioni ndërkombëtar për zhvillim

1818 H Street N. W.
Washington D. C. 20433
U.S.A.

(202) 477-1234
Cable address: INTBAFRAD
Cable address: INDEVAS

15 maj 2013

Z. Ramadan Avdiu
Ushtues i detyrës së Ministrit për financa
10000 Prishtinë
Republika e Kosovës

Shkëlqesi:

Lënda: Financimi i IDA-së 5240-XK (Kosovë – Financimi i dytë shtesë për Projektin për pastrim dhe rikthim të tokës në Sektorin e energjetikës), Udhëzimet shtesë: disbursimi

I referohem Marrëveshjes për financim ndërmjet Asociacionit ndërkombëtar për zhvillim (“Asociacioni” ose “IDA”) dhe Republikës së Kosovës (“Pranuesi”) lidhur me projektin e lartpërmendur, të datës 15 maj 2013. Marrëveshja parasheh që Asociacioni mund të lëshojë udhëzime shtesë lidhur me tërheqjen e mjeteve të Financimit nga IDA 5240-XK (“Financimi”). Kjo letër (“Letër e disbursimit”), e rishqyrtuar periodikisht, përbën udhëzime shtesë.

Udhëzimet e bashkëngjitura të Bankës botërore për disbursim, të datës 1 maj 2006, (“Udhëzimet për disbursim”) (Shtojca 1), janë një pjesë përbërëse e Letrës së disbursimit. Mënyra se si dispozitat e Udhëzimeve për disbursim vlejné për Financimit ceket në vijim. Seksionet dhe nën-seksionet në kllapa në vijim iu referohen seksioneve dhe nën-seksioneve relevante në Udhëzimet për disbursim dhe, përveç nëse ndryshe parashihet me letër, shprehjet me shkronjë të parë të madhe kanë kuptime të cilat iu caktohen në Udhëzimet për disbursim.

I. Arrazhmanet për disbursim

- (i) **Metodat e disbursimit (seksioni 2).** Për Financimin mund të aplikohen metodat vijuese të disbursimit:
- Rimbursimi
 - Pagesa direkte
- (ii) **Kushtet e disbursimit (nën-seksioni 3.8).** Luteni t’iu referoheni Kushteve të disbursimit në Marrëveshjen për financim.

II. Tërheqja e mjeteve për financim

(i) **Nënshkrimet e autorizuara (nën-seksioni 3.1).**

Letra mbi nënshkruesin e autorizuar në Formularin e bashkëngjitur (Shtojca 2) duhet t’i dorëzohet Asociacionit në adresën e cekur më poshtë ku ofrohet emri (emrat) dhe mostra e nënshkrimit (apo nënshkrimeve) të zyrtarëve të autorizuar për të nënshkruar Kërkesat:

The World Bank
1818 H Street, NW
Washington, DC 20433
Attention: Country Director

- (ii) **Kërkesat (nën-seksionet 3.2-3.3).** Luteni të ofron kërkesa për tërheqje të plotësuara dhe të nënshkruara (a), së bashku me dokumentet mbështetëse, në adresën e cekur më lartë:

The World Bank
Radnicka cesta 80, 9 floor
Zagreb, HR – 10000,
Croatia
Attention. Loan Department

- (iii) **Parashtrimi elektronik (nën-seksioni 3.4).** Asociacioni mund t'i lejojë Pranuesit që t'i parashtrojë Asociacionit kërkesën në mënyrë elektronike (me dokumente mbështetëse) përmes Lidhjes së Asociacionit për Klientë, portal të bazuar në ueb. Opsioni për t'i parashtruar kërkesën Asociacionit me mjete elektronike mund të kryhet nëse: (a) Pranuesi ka emëruar me shkrim, në përputhje me nën-paragrafin (i) të këtij Seksioni, zyrtarët e tij të cilët janë të autorizuar të nënshkruajnë dhe të parashtrojnë Kërkesat dhe për të pranuar aparate të sigurta identifikimi ("Tokenë") nga Asociacioni për qëllime të parashtrimit të kërkesave të tilla përmes mjeteve elektronike; dhe (b) të gjithë zyrtarët e tillë të emëruar nga Pranuesi të jenë regjistruar si shfrytëzues të Lidhjes për klientë. Nëse Asociacioni pajtohet, Asociacioni i siguron Pranuesit Tokenë për zyrtarë të emëruar. Pas kësaj, zyrtarët e emëruar mund t'i dorëzojnë kërkesat në mënyrë elektronike duke plotësuar Formularin 2380, të cilit mund t'i qaset përmes Lidhjes për klientë (<https://clientconnection.worldbank.org>). Pranuesi mund të vazhdojë të ushtrojë mundësinë e përgatitjes dhe parashtrimit të kërkesës në formë të letrës. Asociacioni rezervon të drejtën dhe, në diskrecion të tij, pjesërisht apo përgjithnjë të ndalojë parashtrimin elektronik të Aplikacioneve nga Pranuesi.
- (iv) **Termet dhe kushtet për shfrytëzimin e tokenëve për përpunim të kërkesave.** Me emërtimin e zyrtarëve për të pranuar Tokenët dhe duke vendosur t'i parashtrojnë Kërkesat në mënyrë elektronike, Pranuesi konfirmon përmes letrës për nënshkruar të autorizuar pëlqimin e vet si në vijim: (a) t'iu përmbahet *Termave dhe kushteve mbi përdorimin e aparateve të sigurta për identifikim në lidhje me Shfrytëzimin e mjeteve elektronike për përpunimin e kërkesave dhe dokumenteve mbështetëse* ("Termet dhe kushtet për shfrytëzimin e tokenëve") të dhënë në Shtojcën 5; dhe (b) t'i dorëzojë Termet dhe Kushtet e Shfrytëzimit të Tokenëve çdo zyrtari të tillë dhe të sigurohet që ata t'iu përmbahen termave dhe kushteve të tilla.
- (v) **Vlera minimale e kërkesave (nën-seksioni 3.5).** Vlera minimale e kërkesave është 100,000 USD

III. Raportimi mbi Shfrytëzimin e mjeteve të financimit

- (i) **Dokumentacioni mbështetës (seksioni 4).** Dokumentacioni mbështetës ofrohet krahas çdo kërkesë për tërheqje si në vijim:

- **Për kërkesat për rimbursim:**
 - Lista e pagesave sipas kontratave të cilat i nënshtrohen shqyrtimit paraprak të Asociacionit, në formularin e bashkëngjitur (Shtojca 4)
 - Shënimet – “*Deklaratat e shpenzimeve me dokumentacionin mbështetës*” (Shtojca 3A) – evidentimi i shpenzimeve të pranueshme (p.sh. kopjet e dëftesave, faturat e furnitorëve) në vlerë prej US\$100,000 për mallra dhe punë; US\$50,000 për shërbime dhe firma konsulentë dhe US\$25,000 për shërbimet e konsulentëve individual;
 - “*Deklarata e shpenzimeve pa dokumentacion mbështetës*” (Shtojca 3B) për pagesat e bëra për të gjitha kontratat tjera, përfshirë edhe Kostot e përshkallëzuara operative.
- **Për kërkesat për Pagesat direkte:** shënimet me të cilat dëshmohen shpenzimet e pranueshme, p.sh., kopjet e dëftesave, faturat e furnitorëve

IV. Informatat tjera të rëndësishme

Për informata shtesë lidhur me arranzhmanet për disbursim, luteni t’iu referoheni Doracakut për disbursim, i cili mund të gjendet në ueb faqen publike të Asociacionit në <https://www.worldbank.org> dhe në ueb faqen “Kyçja për klientë” në <https://clientconnection.worldbank.org>. Kopjet e shtypura vihen në dispozicion me kërkesë.

Nga ueb faqja lidhja për klientë (Client Connection), do të mund të përgatisni dhe të parashtroni kërkesat, të monitoroni statusin në kohë reale të Financimit, dhe të marrin politikën e ndërlidhur, informata financiare dhe të prokurimit.

Nëse tashmë nuk e keni bërë këtë, Asociacioni rekomandon që të regjistroheni si shfrytëzues në ueb faqen Lidhja për klientë (<https://clientconnection.worldbank.org>). Nga kjo ueb faqe do të mund të përgatisni dhe të parashtroni kërkesat, të monitoroni statusin në kohë reale të Financimit, dhe të marrin politikën e ndërlidhur, informata financiare dhe të prokurimit. Të gjithë zyrtarët e Pranuesit të autorizuar për të nënshkruar dhe për të dorëzuar Kërkesat me mjetet elektronike duhet të regjistrohen në Lidhja për klientë para se të mund të kryhet parashtrimi elektronik. Për më shumë informata, për ueb faqen dhe për përgatitjet për regjistrim, luteni të kontaktoni Asociacionin me email në clientconnection@worldbank.org.

Nëse keni ndonjë pyetje lidhur çështjet më lartë, luteni të kontaktoni Jose Janeiro, Zyrtarin e lartë financiar në adresën jjaneiro@worldbank.org, duke cekur numrin referues të cekur më lartë.

Sinqerisht juaji,

Jan-Peter Oiters,
Menaxher shteti, Kosovë

Shtojcat:

1. Shtojca 1 – *Udhëzimet e Bankës botërore për disbursim për Projekte, të datës 1 maj 2006,*
2. Shtojca 2 – Formulari për nënshkrimet e autorizuara,
3. Shtojca 3A – *“Deklarata e shpenzimeve me dokumentacionin mbështetës” dhe Shtojca 3B – “Deklarata e shpenzimeve pa dokumentacionin mbështetës”*
4. Shtojca 4 – Formulari i pagesave për kontrata që i nënshtrohen shqyrtimit paraprak të Bankës,
5. Shtojca 5 – *Termet dhe kushtet mbi shfrytëzimin e mjeteve të sigurta të identifikimit në lidhje me shfrytëzimin e mjeteve elektronike për të përpunuar kërkesat dhe dokumentacionin mbështetës, të datës 20 janar 2010*

Përgatitur nga: Jose Janeiro, CTRLA

Miraturar nga dhe cc: Adam Shayne, jurist shteti
Katelijan Van der Berg, Udhëheqësi i ekipit

Cc me kopje: [Subjekti për implementim të projektit 1]
[adresa]
[qyteti], [shteti]
[adresa e emailit]

[Subjekti për implementim të projektit 2]
[adresa]
[qyteti], [shteti]
[adresa e emailit]

Formulari i Letrës së nënshkruesit të autorizuar

[stema]

Ministria e financave

[adresa]

DATE

Banka Botërore
Rruga 1818 H, N.W.
Uashington, D.C. 20433
Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Për: [drejtor shteti]

Lënda: Financimi Nr. _____ - _____ (Projekti _____)

Iu referohem Marrëveshjes për financim (“Marrëveshja”) ndërmjet Asociacionit ndërkombëtar për zhvillim (“Asociacioni”) dhe [emri i Pranuesit] (Pranuesi), të datës _____, lidhur me Financimin në fjalë. Për qëllime të Nenit 2.03 të Kushteve të përgjithshme të definuara me Marrëveshjen, cili do¹ [njëri] nga personat nënshkrimi i vërtetuar i të cilëve paraqitet në vijim është i autorizuar që në emër të Pranuesit të nënshkruajë kërkesa për tërheqje [dhe kërkesa për zotim të veçantë] sipas këtij Financimi.

Për qëllime të dorëzimit të Kërkesave Asociacionit², [çdo] person, mostra e vërtetuar e nënshkrimit e të cilit është dhënë në vijim, është i autorizuar që në emër të Pranuesit, duke vepruar³ [individualisht], [së bashku]⁴, për të dorëzuar Kërkesa, si dhe dëshmitë në mbështetje të kësaj në termat dhe kushtet e parapara nga Asociacioni.

⁵[Kjo konfirmon se Pranuesi autorizon persona të tillë që të pranojnë Tokenë dhe t’i dorëzojnë Kërkesën Asociacionit dhe dokumentet mbështetëse me mjete elektronike. Duke pranuar se Asociacioni mbështetet në deklaratat dhe garanca të tilla, përfshirë, pa kufizim, deklaratat dhe garancat të cilat ceken në *Termt dhe kushtet për shfrytëzimin e Aparateve të sigurta identifikuese në lidhje me Shfrytëzimin e mjeteve elektronike për të përpunuar kërkesa dhe dokumentacion mbështetës* (“Termt dhe kushtet për shfrytëzimin e Tokenëve”),

¹ Udhëzime Pranuesit: Këtu cekni nëse më shumë se një person duhet të nënshkruajë Kërkesën, sa prej tyre apo në cilat pozita, dhe nëse vlen ndonjë kufizim. *Luteni të fshini këtë fusnotë në letrën përfundimtare që i dërgohet Asociacionit.*

² Udhëzime Pranuesit: Këtu parashihni nëse më shumë se një person duhet të nënshkruajë Kërkesën, nëse po, luteni të tregoni numrin e vërtetë. *Luteni ta fshini këtë fusnotë në letrën përfundimtare e cila i dërgohet Asociacionit.*

³ Udhëzime Pranuesit: Përdorni këtë kllapë katrore nëse qoftë edhe një nga personat e autorizuar mund të nënshkruajë; nëse kjo nuk vlen, atëherë luteni të fshini. *Luteni të fshini këtë fusnotë në letrën përfundimtare e cila i dërgohet Asociacionit.*

⁴ Udhëzime Pranuesit: Përdorni këtë kllapë katrore vetëm nëse disa individë duhet të nënshkruajnë bashkërisht Kërkesën; nëse kjo nuk vlen, luteni të fshini. *Luteni të fshini këtë fusnotë në letrën përfundimtare e cila i dërgohet Asociacionit.*

⁵ Udhëzimet Pranuesit: Luteni të shtoni këtë paragraf nëse Pranuesi dëshiron të autorizojë personat e cekur për të pranuar Tokenët dhe për të parashtruar Kërkesën me mjete elektronike; nëse kjo nuk vlen, luteni të fshini paragrafin. *Luteni të fshini këtë fusnotë në letrën përfundimtare e cila i dërgohet Asociacionit.*

Pranuesi deklaron dhe i garanton Asociacionit se do t'i dorëzojë çdo personi kopjen e Termave dhe kushteve të shfrytëzimit të tokenëve dhe bën që personat e tillë t'iu përmbahen termave dhe kushteve.]

Ky Autorizim zëvendëson dhe zhvleftëson çfarëdo Autorizimi që gjendet aktualisht në shënimet e Asociacionit përkitazi me këtë Marrëveshje.

[Emri], [pozita] Mostra e nënshkrimit: _____

[Emri], [pozita] Mostra e nënshkrimit: _____

[Emri], [pozita] Mostra e nënshkrimit: _____

Sinqerisht juaji,

/nënshkruar/

[pozita]

**Termet dhe Kushtet e Shfrytëzimit të Mjeteve të Sigurta të Identifikimit
në lidhje me Shfrytëzimin e mjeteve elektronike për të
përpunuar kërkesat
dhe dokumentacionin përcjellës**

20 janar, 2010

Banka Botërore (Banka)¹ siguron aparate të sigurta për identifikim (Tokenë) për t'i lejuar Huamarrësit² të parashtrojë kërkesa për tërheqje dhe kërkesa për zotime të veçanta sipas Marrëveshjes (apo Marrëveshjeve) dhe dokumentacionin mbështetës (kërkesat dhe dokumentacioni i tillë mbështetës kolektivisht të quajtur Kërkesa në këto Terma dhe Kushte) Bankës në mënyrë elektronike, dhe atë me terma dhe kushtet të parapara këtu.

A. Identifikimi i shfrytëzuesve

1. Huamarrësit i kërkohet të identifikojë, në Letrën e plotësuar të nënshkruesve të autorizuar (LNA) të dorëzuar në dhe të pranuar nga Banka, çdo person i cili është i autorizuar të parashtrojë Kërkesa. Banka siguron Tokenë për çdo person të identifikuar në LNA (nënshkrues), ashtu siç parashihet më poshtë. Huamarrësi gjithashtu njofton Bankë menjëherë nëse ndonjë Nënshkrues nuk është më i autorizuar nga Huamarrësi që të veprojnë si Nënshkrues.
2. Çdo nënshkrues duhet të regjistrohet si shfrytëzues në uebfaqen e Lidhjes së Bankës për klientë (CC) (<https://clientsconnection.worldbank.org>) para dorëzimit të Tokenëve. Regjistrimi në CC kërkon që Nënshkruesi të krijojë një fjalëkalim (fjalimi për CC). Nënshkruesi nuk ia shpalos askujt fjalëkalimin e tij/saj apo të ruajë apo të regjistrojë fjalëkalimin për CC në ndonjë formë të shkruar apo formë tjetër. Pas regjistrimit i shfrytëzues i CC, Nënshkruesit i caktohet emri unik identifikues i llogarisë.

B. Shpërndarja, inicimi dhe kthimi i tokenëve

1. Banka i dorëzon fizikisht Tokeni çdo Nënshkruesi në mënyrën e cila përcaktohet nga Banka dhe e cila është e kënaqshme për të.
2. Në kohën e dorëzimit të tokenit një Nënshkruesi, Nënshkruesi merr kopjen e këtyre Termave dhe Kushteve të Shfrytëzimit për qëllime të inicimit të Tokenit.
3. Banka verifikon nëse janë dorëzuar dhe pranuar si duhet nga Shfrytëzuesi i CC-së Tokeni, Fjalëkalimi i përkohshëm dhe Termet dhe kushtet e Shfrytëzimit.
4. Menjëherë pas pranimit të Tokenit dhe të Termave dhe Kushteve të Shfrytëzimit, Nënshkruesi iu qaset CC-së duke përdorur emrin e tij/saj të llogarisë dhe Fjalëkalimin e CC-së dhe regjistron Tokenin e tij/saj si dhe numrin personal të identifikimit (PIN) i

¹ “Banka” nënkupton IBRD-në dhe IDA-në.

² “Huamarrësi” nënkupton huamarrësin e një huaje të IBRD-së, kredinë e IDA-së, apo avancin për Përgatitjen e projektit si dhe pranuesin e grantit.

cili do të përdoret krahas shfrytëzimit të Tokenit të tij/saj, pas që cilës Tokeni iniciohet për përdorim nga Nënshkruesi ekskluzivisht për qëllime të parashtrimit të Kërkesave. Pas inicimit të Tokenit, Nënshkruesi është “Shfrytëzues i Tokenit”. Në bazën e vet të të dhënave, Banka ruan llogarinë e shfrytëzuesit (Llogaria) për çdo Shfrytëzues të Tokenit për qëllime të menaxhimit të Tokenit dhe Shfrytëzuesit të Tokenit. As Huamarrësi dhe as Shfrytëzuesi i Tokenit nuk kanë qasje në Llogari.

5. Para përdorimit të parë të Tokenit nga Shfrytëzuesi i Tokenit për parashtrim të Kërkesës, Huamarrësi sigurohet që Shfrytëzuesi i Tokenit të ketë pranuar materialet e trajnimit të sigluara nga Banka përkitazi me shfrytëzimin e Tokenit.
6. Tokenët i kthehen pa vonesë Bankës me kërkesë të Bankës.

C. Menaxhimi i tokenëve

1. Tokenët mbesin pronë e Bankës.
2. Përdorimi i Tokenëve është i kufizuar në mënyrë rigoroze për përdorim në parashtrimin e Kërkesave nga Përdoruesi i Tokenit në mënyrën e përcaktuar nga Banka në Marrëveshje(t) dhe me këto Terma dhe kushte. Çdo përdorim tjetër i Tokenit është i ndaluar.
3. Banka nuk merr asnjë përgjegjësi për çfarëdo obligimi apo keqpërdorimi të Tokenit nga përdoruesi i Tokenit, nga përfaqësues të tjerë të Huamarrësit, ose nga palët e treta.
4. Huamarrësi merr përsipër të sigurojë, dhe deklaron e i garanton Bankës (ku deklaratat dhe garancat e tilla merren parasysh shprehimisht nga Banka gjatë dorëzimit të Tokenit çdo përdoruesi) që çdo përdoruesi të Tokenit janë dhënë, i kupton dhe i përmbahet Termat dhe kushtet e përdorimit, duke përfshirë pa kufizim, si në vijim:

Siguria

- 4.1 Shfrytëzuesi i Tokenit nuk ia shpalos askujt PIN-in e tij/saj dhe as ruan apo regjistron PIN-in e vet në formë të shkruar apo në ndonjë formë tjetër.
- 4.2 Shfrytëuesi i Tokenit nuk i lejon askujt që të shfrytëzojë Tokenin për t’i parashtruar Bankës kërkesën.
- 4.3 Shfrytëzuesi i Tokenit gjithnjë çregjistrohet nga CC kur nuk është duke e përdorur sistemin. Mos çregjistrimi i duhur mund të krijojë shteg për në sistem, i cili është i pambrojtur.
- 4.4 Nëse Shfrytëzuesi i Tokenit beson se një palë e tretë ka mësuar PIN-in e tij/saj apo ka humbur Tokenin e tij/saj, ai menjëherë njofton clientconnection@worldbank.org.
- 4.5 Huamarrësi menjëherë njofton Bankë në clientconnection@worldbank.org për çfarëdo Tokenë të humbur, të vjedhur apo të rrezikuar dhe ndërmerr hapa të tjera të arsyeshme për t’u siguruar që Tokenët e tillë të deaktivizohen menjëherë.

Kujdesi për Tokenët

- 4.6 Tokenët përmbajnë instrumente delikate dhe të sofistikuar dhe prandaj duhet të përdoren me kujdes, të mos zhyten në lëngje, të mos iu ekspozohen temperaturave ekstreme, të mos thërmohen apo të lakohen. Gjithashtu, Tokenët duhet të mbahen më shumë se pesë (5) cm larg aparateve të cilat krijojnë rrezatim elektromagnetik (EMR), siç janë telefonat mobilë, PDA-të me telefona, telefona të mençur dhe aparate të tjera të ngjashme. Tokenët duhet të barten dhe të ruhen ndaras nga ndonjë aparat EMR. Në afërsi (më pak se 5 cm), këto aparate kanë nivel të lartë të emetimit të EMR të cilat mund të pengojnë punën e duhur të pajisjeve elektronike, përfshirë punën e Tokenit.
- 4.7 Pa devijuar nga këto Terma dhe Kushte të Përdorimit, udhëzimet tjera teknike mbi përdorimin dhe kujdesin e duhur të Tokenëve mund të gjenden në <http://www.rsa.com>.

5. *Zëvendësimi*

- 5.1 Tokenët e humbur, të dëmtuar, të rrezikuar apo të shkatërruar (në kuptim të nenit 4.5 më lartë), zëvendësohen me shpenzim të Huamarrësit.
- 5.2 Banka rezervon të drejtën, me diskrecion të vet, që të mos zëvendësojë ndonjë Token në rast të keqpërdorimit, apo të mos riaktivizojë Llogarinë e Përdoruesit të Tokenit.

6. *Rezervimi i të drejtës për të deaktivizuar Tokenin*

- 6.1 Huamarrësi rezervon të drejtën që të tërheq autorizimin e Shfrytëzuesit të Tokenit për të përdorur Tokenin për çfarëdo qoftë arsye.
- 6.2 Banka rezervon të drejtën, me diskrecion të vet, për të deaktivizuar përkohësisht apo për gjithnjë, një Token, të deaktivizojë Llogarinë e Shfrytëzuesit të Tokenit apo t'i bëjë të dyja këto.

Shtojca 4

Pagesat e bëra gjatë Periudhës së raportimit për kontrata të cilat iu nënshtrohen Shqyrtimit paraprak të Asociacionit

Numri i kontratës	Furnizuesi	Data e kontratës	Shuma e kontratës	Data e mos kundërshtimit të BB-së për kontratën	Shuma e paguar Furnitorit gjatë periudhës	Pjesa e BB-nga shuma e paguar Furnitorit gjatë periudhës
-------------------	------------	------------------	-------------------	---	---	--

|

DEKLARATA E SHPENZIMEVE (DESH), SHTOJCA 3A

Pagesat e bëra gjatë periudhës prej _____ deri _____

Për: Shpenzimet tjera përveç atyre sipas kontratave nën pragun e dokumentacionit të DESH – luteni t’iu referoheni Disbursimit për Pragjet e DESH

Dokumentacioni mbështetës i nevojshëm – faturat, dëftesat për të gjitha pagesat sipas kontratave mbi pragjet e DESH

Data

Nr. i apl.

**Kredia e IDA-së/Nr. gr.
DESH nr. i tabelës**

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
Nr. i art.	Nr. i kategorisë	Emri i furnitorit, kontraktuesit apo konsulentit, nr. ref. i kontr., data	Shuma e përgjithshme e kontratës (të përfshihen të gjitha valutat)	Përshkrimi i shkurtër i mallrave, punëve apo shërbimeve	Kategoria e shërbimeve	Shuma e përgjithshme e faturës e mbuluar nga kjo kërkesë (net mbetja)	% e financimit të pranueshëm	Valuta dhe shuma e pranueshme e paguar (7) dhe (8)	Barazvlera në US\$ e paguar nga Llogaritë e Caktuara**	Data e pagesës	Norma e shkëmbimit*	Vërejtje

GJITHSEJ

Shënim: (*) zëret duhet të grupohen sipas kategorisë; ose përndryshe, për çdo kategori, mund të përdoret një DESH e veçantë.

(**) nëse kërkesa nuk është për rimbushjen e Llogarisë së Caktuar, leni shtyllat 10 dhe 12 të zbrazëta.

DEKLARATA E SHPENZIMEVE (DESH), SHTOJCA 3B

Pagesat e bëra gjatë periudhës prej _____ deri _____

Për: Shpenzimet tjera përveç atyre sipas kontratave nën pragun e dokumentacionit të DESH – luteni t’iu referoheni Disbursimit për Pragjet e DESH

Dokumentacioni mbështetës i nevojshëm – faturat, dëftesat për të gjitha pagesat sipas kontratave mbi pragjet e DESH

Data

Nr. i apl.

**Kredia e IDA-së/Nr. gr.
DESH nr. i tabelës**

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
Nr. i art.	Nr. i kategorisë	Emri i furnitorit, kontraktuesit apo konsulentit, nr. ref. i kontr., data	Shuma e përgjithshme e kontratës (të përfshihen të gjitha valutat)	Përshkrimi i shkurtër i mallrave, punëve apo shërbimeve	Kategoria e shërbimeve	Shuma e përgjithshme e faturës e mbuluar nga kjo kërkesë (net mbetja)	% e financimit të pranueshëm	Valuta dhe shuma e pranueshme e paguar (7) dhe (8)	Barazvlera në US\$ e paguar nga Llogaritë e Caktuara**	Data e pagesës	Norma e shkëmbimit*	Vërejtje

GJITHSEJ

Dokumentet mbështetëse për këtë DESH ruhen në: _____

Shënim: (*) zëret duhet të grupohen sipas kategorisë; ose përndryshe, për çdo kategori, mund të përdoret një DESH e veçantë.
(**) nëse kërkesa nuk është për rimbushjen e Llogarisë së Caktuar, leni shtyllat 10 dhe 12 të zbrazëta.

KOPJA E KONFORMUAR

Letra plotësuese Nr. 2

REPUBLIKA E KOSOVËS

15 maj 2013

Asociacioni ndërkombëtar për zhvillim
Rruga 1818 H, N. W.
Uashington, D. C. 20433
Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Lënda: Kredia e IDA-së 5240-XK
 (Financimi i dytë shtesë për Projektin e Pastrimit dhe Rikthimit të
 tokës në Sektorin energjetik)
 Treguesit e monitorimit të performancës

Të nderuar zotërinj dhe zonja:

Kjo letër i referohet paragrafit A të Seksionit II të Shtojcës 2 të Marrëveshjes për financim ndërmjet Republikës së Kosovës (Pranuesit) dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim (Asociacioni) lidhur me projektin në fjalë. Pranuesi me këtë i konfirmon Asociacionit se treguesit e cekur në shtojcën e kësaj letre shërbejnë si bazë që Pranuesi të monitorojë dhe të vlerësojë progresin e Projektit si dhe përmbushjen e pikësnyimeve të Projektit.

Sinqerisht i juaji,

REPUBLIKA E KOSOVËS

Nga /s/ Ramadan Avdiu
Përfaqësues i autorizuar

Shtojca

Kredia e IDA-së 5240-XK
(Financimi i dytë shtesë për Projektin e pastrimit dhe rikthimit të tokës në Sektorin e energjetikës)

Treguesit e monitorimit të performancës

Emërtimi i treguesit	Thelbi	Njësia matëse	Pikënisja 2007 (Fillimi i projektit)	Pikënisja (përparimi deri më sot) 2012	Vlerat kumulative cak			Shpeshtësia	Burimi i të dhënave / metodologjia	Përgjegjësia për mbledhje të të dhënave
					2013	2014	Caku përfundimtar			
1. Përqindja e hirit të hedhur i cili është në përputhje me praktikat e mira mjedisore dhe devijohet nga deponia e hapur në Deponinë e Hirit të Kosova A në minierën e Mirashit.		Përqindja	0%	0%	100%		100%	Tremujore	Raportet tremujore	NJPM-KEK
2. Toka e kontaminuar e menaxhuar apo deponitë (industriale) të mbyllura sipas Projektit	C	Hektarë	0	156 ¹			156			Treguesi tashmë është përmbushur.
3. Rregullimi i deponisë së hirit të Kosova A duke eliminuar problemet e hirit dhe infiltrimin e ndotjes nga hirit në ujërat nëntokësore ²		Përqindja	0%	55%			55%			Treguesi tashmë është përmbushur.
4. Toka e rikthyer për vendbanime natyrore, bujqësi apo përdorime të tjera në zonat e mbingarkuara të KEK-ut.		Hektarë	0	603			526			Treguesi tashmë është përmbushur, përtej caktimit të arritur.
5. Toka e rikthyer për vendbanime natyrore, bujqësi apo për shfrytëzim të tokës në zonat e mbingarkuara të KEK-ut.		Përqindja	0%	63%			55%			Treguesi tashmë është përmbushur, përtej caktimit të arritur.
6. Të rriten		Hektarë	0	69	69	127	127	Tremujore	Raportet	NJPM-KEK

¹ Treguesi fillestar për Projektin është 55% e zonës së deponisë të jetë rehabilituar, që është 156 hektarë, shih gjithashtu PDO treguesin 3.

² Ky është treguesi aktual i projektit fillestar i cili mbahet për arsye të konsistencës së Projektit, Treguesi Thelbësor i Sektorit i shtohet Kornizës së Rezultateve.

kapacitetet e KEK-ut për operacione të vazhdueshme të pastrimit, të matura me numrin e hektarëve të rregulluar dhe të rikthyer me burimet e vet KEK-ut 7. Të rriten kapacitetet e MMPH-së për zbatimin e praktikave të mira mjedisore në sektorin e mihjeve dhe të energjisë

tremujore

	Teksti			Nuk është përgatitur ESIA për KPP.	Rizhvendosja e lagjes Shala të fshatit Hade të kryhet në përputhje me RAP-in e apvuar	ESIA për KPP përgatitur dhe shpërndarë në përputhje me politikën e Bankës lidhur me OP4.01	ESIA për KPP përgatitur dhe shpërndarë në përputhje me politikën e Bankës dhe praktikën e mira ndërkombëtare.	Tremujore	Raportet tremujore	NJPM-MMPH
8.	Të gjitha substancat e gjetura të rrezikshme në lokacionin e gazifikimit të largohet dhe trajtohet/mënjahet (katranet, benzeni, fenolët, metanoli, përbërësit e vajit).	Tonë	0	19,316	21,783		Rizhvendosja e lagjes Shala kryer në përputhje me RAP-in e apvuar 21,783	Tremujore	Raportet nga inxhinieri mbikëqyrës	NJPM-KEK
	Përfituesit Përfituesit e projektit	C	Numër	0	21,500		21,500			Përfituesit e projektit vlerësohen në mënyrë përafërsisht si popullata e komunës Obiliq.
	Prej të cilëve (përfituese) femra	C	Numër	0	10,600		10,600			

Asociacioni ndërkombëtar për zhvillim

**Kushtet e përgjithshme
për
Kredi dhe Grante**

Data 31 korrik, 2010

NENI I

Dispozitat hyrëse

Seksioni 1.01. Zbatimi i Kushteve të Përgjithshme

Këto kushte të përgjithshme përcaktojnë disa terma dhe kushte përgjithësisht të zbatueshme për Marrëveshjen e Financimit dhe për çdo marrëveshje tjetër Ligjore. Ato zbatohen deri në masën ku ofron Marrëveshja Ligjore. Nëse nuk ka Marrëveshje e Projektit ndërmjet Shoqatës dhe Entit Zbatues të Projektit, referencat në këto kushte të përgjithshme për Entin Zbatues të Projektit dhe Marrëveshjes së Projektit nuk do të merren parasysh.

Seksioni 1.02. Papajtueshmëria me Marrëveshjet Ligjore

Nëse ndonjë dispozitë e cilësdo Marrëveshje Ligjore është në kundërshtim me ndonjë dispozitë të këtyre Kushteve të Përgjithshme, dispozita e Marrëveshjes Ligjore do të udhëheqë.

Seksioni 1.03. Përkufizimet

Kurdo që përdoren në këto Kushtet e Përgjithshme ose në Marrëveshjet Ligjore (përveç kur parashikohet ndryshe në Marrëveshjet Ligjore), kushtet e përcaktuara në shtojcën kanë kuptimet që u jepen atyre në Shtojcën.

Seksioni 1.04. Referencat, Titujt

Referencat në këto Kushtet e Përgjithshme të Neneve, Seksioneve dhe Shtojcave janë për Nenet dhe Seksionet e, dhe Shtojca për, këto Kushte të përgjithshme. Titujt e Neneve, Seksioneve dhe Shtojcave, dhe Tabela e Përmbajtjes janë futur në këto Kushtet e Përgjithshme vetëm për referencë dhe nuk do të merren parasysh në interpretimin e këtyre Kushteve të Përgjithshme.

NENI II

Tërheqjet

Seksioni 2.01. Llogaria e Financimit, Tërheqjet në Përgjithësi, Valuta e Tërheqjeve

(a) Shoqata e krediton shumën e financimit në llogarinë e Financimit me të Drejtat Speciale për Tërheqje.

(b) Kohë mas kohe, Përfituesi mund të kërkojë tërheqjen e shumave të financimit nga Llogaria e Financimit në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Financimit dhe këto Kushte të Përgjithshme.

(c) Çdo Tërheqje e shumës së financimit nga Llogaria e Financimit do të bëhet në Valutën ose Valutat e tillë si në mënyrë të arsyeshme do të kërkojë Përfituesi për të përmbushur pagesat për Shpenzime të Pranueshme. Shuma e secilës tërheqje nga Llogaria e Financimit do të llogaritet si ekuivalent në kushtet e të Drejtave Speciale të Tërheqjes (siç përcaktohet nga data e tërheqjes) të valutës apo valutave të kërkuara në atë mënyrë.

Seksioni 2.02. Angazhimi i Veçantë nga Shoqata

Me kërkesë të Përfituesit dhe në termat dhe kushtet e tilla kur Përfituesi dhe Shoqata do të bien dakord, Shoqata mund të hyjë në angazhime të veçanta me shkrim të paguajë shumat për Shpenzime të Pranueshme pavarësisht nga çfarëdo pezullimi ose anulimi i mëvonshëm nga ana e Shoqatës apo Përfituesit ("Angazhimi i veçantë").

Seksioni 2.03. *Aplikime për Tërheqje apo për Angazhim të Veçantë*

(a) Kur Përfituesi dëshiron të kërkojë një tërheqje nga Llogaria e Financimit ose të kërkojë nga Shoqata për të hyrë në një Angazhim të Veçantë, Përfituesi do t'i dorëzojë Shoqatës një kërkesë me shkrim në formë dhe përmbajtje të tillë si Shoqata në mënyrë të arsyeshme do të kërkojë. Aplikimet për tërheqje, duke përfshirë edhe dokumentacionin e kërkuar në bazë të këtij neni, do të bëhen menjëherë në lidhje me Shpenzimet e Pranueshme.

(b) Përfituesi do t'i paraqesë Shoqatës provat e kënaqshme të autoritetit të Shoqatës për personin ose personave të autorizuar për të nënshkruar aplikime të tilla dhe nënshkrimin e ekzemplarit të vërtetuar të çdo personi të tillë.

(c) Përfituesi do t'i paraqesë Shoqatës ato dokumente dhe evidenca të tjera në mbështetje të çdo aplikimi të tillë si Shoqata në mënyrë të arsyeshme do të kërkojë, qoftë para ose pasi Shoqata e ka lejuar ndonjë tërheqje të kërkuar në aplikim.

(d) Çdo kërkesë e tillë dhe dokumentet shoqëruese dhe provat e tjera duhet të jenë të mjaftueshme në formë dhe përmbajtje për të kënaqur Shoqatën që Përfituesi të ketë të drejtë të tërheqë shumën e aplikuar nga Llogaria e Financimit dhe se shumat që do të tërhiqet nga Llogaria e Financimit do të përdoret vetëm për qëllimet e specifikuar në Marrëveshjen e Financimit.

(e) Shoqata do të paguajë shumat e tërhequra nga ana e Përfituesit nga Llogaria e Financimit vetëm për, ose me urdhër të, Përfituesit.

Seksioni 2.04. *Llogaritë e Përcaktuara*

(a) Përfituesi mund të hapë dhe mbajë një ose më shumë llogaritë e përcaktuara në të cilën Shoqata mund, sipas kërkesës së Përfituesit, të deponojë shumat e tërhequra nga Llogaria e Financimit si parapagimet për nevojat e Projektit. Të gjitha llogaritë e përcaktuara do të hapen në një institucion financiar të pranueshëm për Shoqatën, dhe mbi termat dhe kushtet e pranueshme për Shoqatën.

(b) Deponimet në, dhe pagesat jashtë, çdo llogarie të tillë të përcaktuar do të bëhet në përputhje me Marrëveshjen e Financimit dhe këtyre Kushteve të Përgjithshme dhe udhëzimeve shtesë që Shoqata mund të përcaktojë kohë pas kohe me njoftim për Përfituesin. Shoqata mundet që, në përputhje me Marrëveshjen e Financimit dhe udhëzimeve të tilla, të pushojë deponimin në ndonjë llogari të tillë pas një njoftimi për Përfituesin. Në rast të tillë, Shoqata do të njoftojë Përfituesin për procedurat që do të përdoren për tërheqje të mëvonshme nga Llogaria e Financimit.

Seksioni 2.05. *Shpenzimet e Pranueshme*

Përfituesi dhe Enti Zbatues i Projektit do të përdorin të ardhurat e financimit ekskluzivisht për të financuar shpenzimet të cilat, përveç kur parashikohet ndryshe në Marrëveshjen e Financimit, të përmbushin kërkesat e mëposhtme ("Shpenzimet e Pranueshme"):

(a) pagesa është për financimin e kostos së arsyeshme të mallrave, punimeve apo shërbimeve që kërkohen për Projektin, që do të financohen nga të ardhurat e financimit dhe të

prokurimit, të gjitha në përputhje me dispozitat e Marrëveshjeve Ligjore;

(b) pagesa nuk është e ndaluar me vendimin e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të marrë sipas kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara; dhe

(c) pagesa është bërë në apo pas datës së përcaktuar në Marrëveshjen e Financimit, dhe përveç kur Shoqata mund të bien dakord ndryshe, është për shpenzimet e ndodhura para Datës së Mbylljes.

Seksioni 2.06. *Tatimet e Financimit*

Përdorimi i cilës do shume të financimit për të paguar për tatimet e vendosura nga, ose në territorin e, Përfituesit mbi ose në lidhje me Shpenzimet e Pranueshme, ose në importimin, prodhimin, prokurimin ose furnizimin e tyre, nëse lejohet nga Marrëveshja e Financimit, është subjekt i politikës së Shoqatës së ekonomisë së detyruar dhe efikasitet në përdorimin e fondeve të kredive dhe granteve të saj. Për këtë qëllim, në qoftë se Shoqata në cilën do kohë përcakton se shuma e tatimit të tillë është e tepruar, apo se Tatimi i tillë është diskriminues ose ndryshe i paarsyeshëm, Shoqata mundet, me anë të një njoftimi drejtuar Përfituesit, të rregullojë përqindjen e Shpenzimeve të tilla të Pranueshme që do të financohen nga shuma e Financimit e specifikuar në Marrëveshjen e Financimit, siç kërkohet për të siguruar konsistencë me politikën e tillë të Shoqatës.

Seksioni 2.07. *Rifinancimi i Parapagimit të Përgatitjes*

Nëse Marrëveshja e financimit parashikon shlyerjen nga të ardhurat e financimit të një parapagimi të bërë nga Banka ose Shoqata ("Parapagimi i Përgatitjes"), Shoqata, në emër të Përfituesit, do të tërheqë nga Llogaria e Financimit në ose pas datës efektive shumë që kërkohet për të shlyer bilancin e tërhequr dhe të paguar të parapagimit sipas datës së tërheqjes së tillë nga Llogaria e Financimit dhe të paguajë të gjitha pagesat e papaguara dhe të mbledhura, nëse ka ndonjë, paraprakisht nga ajo datë. Shoqata do të paguajë atë shumë të tërhequr në vetvete ose në bankë, siç mund të jetë rasti, dhe do të anulojë shumën e mbetur të patërhequr paraprakisht.

Seksioni 2.08. *Rialokimi*

Pavarësisht nga ndonjë alokim i një shume të financimit për një kategori të shpenzimeve sipas Marrëveshjes së Financimit, në qoftë se Shoqata në mënyrë të arsyeshme vendos në çfarë do kohë që shuma e tillë do të jetë e pamjaftueshme për të financuar shpenzimet e tilla, ajo mundet, me anë të një njoftimi për Përfituesin:

(a) të rialokojë ndonjë shumë tjetër të Financimit e cila sipas mendimit të Shoqatës nuk është e nevojshme për qëllimin për të cilin ajo ka qenë e caktuar sipas Marrëveshjes Financiare, deri në masën e nevojshme për të plotësuar mangësitë e vlerësuara; dhe

(b) nëse rialokimi i tillë nuk do të përmbushë plotësisht mungesën e vlerësuar, të zvogëlojë përqindjen e shpenzimeve të tilla që do të financohen nga shuma e Financimit, në mënyrë që tërheqjet e mëtejshme për shpenzime të tilla mund të vazhdojnë deri sa të gjitha këto shpenzime të përfundojnë.

NENI III

Kushtet e Financimit

Seksioni 3.01. *Pagesa e Angazhimit*

(a) Përfituesi do t'i paguajë Shoqatës një pagesë angazhimi mbi Bilancin e Patërhequr të Financimit në normën e përcaktuar nga Shoqata më 30 qershor të çdo viti ("Pagesa e Angazhimit"), e cila nuk duhet të tejkalojë normën e specifikuar në Marrëveshjen e Financimit ("Pagesa Maksimale e Angazhimit").

(b) Pagesa e Angazhimit do të rritet nga një datë gjashtëdhjetë ditë pas datës së Marrëveshjes së Financimit deri në datat përkatëse në të cilat shumat janë tërhequr nga ana e Përfituesit nga Llogaria e Financimit apo është anuluar. Pagesa e Angazhimit do të rritet në shkallën e caktuar më 30 qershor menjëherë para datës së interesit dhe me atë normë tjetër siç mund të përcaktohet nga koha në kohë në përputhje me këtë Seksion. Përqindja e vendosur më 30 qershor në çdo vit do të zbatohet nga data e pagesës së ardhshme në atë vit. Pagesa e Angazhimit do të jetë e pagueshme çdo gjashtë muaj në borxh në çdo datë pagese. Pagesa e Angazhimit do të llogaritet mbi bazën e vitit 360-ditor të dymbëdhjetë muajve 30 ditor.

(c) Shoqata do të njoftojë Përfituesin për Pagesën e aplikueshme të Angazhimit menjëherë pas përcaktimit të saj.

Seksioni 3.02. *Pagesa e Shërbimit*

Përfituesi do t'i paguajë Shoqatës një pagesë shërbimi në bilancin e tërhequr të kredisë në normën e përcaktuar në Marrëveshjen e Financimit. Pagesa e shërbimit do të mblidhet nga datat përkatëse në të cilat shumat e kredisë janë tërhequr dhe do të paguhet në baza gjashtë mujore në borxh në çdo datë pagese. Pagesa e Shërbimit do të llogaritet mbi bazën e vitit 360-ditor të dymbëdhjetë muajve 30 ditor.

Seksioni 3.03. *Kthimi i Kredisë*

(a) Kthimi përgjithësisht. Në bazë të dispozitave të paragrafit (b) të këtij Seksioni, Përfituesi do t'i paguajë Asociacionit Bilancin e Tërhequr të Kredisë në këste, siç parashikohet në Marrëveshjen e Financimit.

(b) *Kthimi i përshpejtuar.*

(i) Shoqata mund të modifikojë pagesën e kësteve të Bilancit të Kredisë së Tërhequr siç është paraparë në Marrëveshjen e Financimit në përputhje me nënparagrafin (ii) ose (iii) të këtij paragrafi kurdo që të gjitha ngjarjet e mëposhtme kanë ndodhur: (A) të ardhurat kombëtare bruto të Përfituesit për kokë banori, siç është përcaktuar nga Shoqata, e ka tejkaluar për tre vite rresht nivelin vjetor të caktuar nga Shoqata për përcaktimin e të drejtës për qasje të burimeve të Shoqatës; (B) Banka e konsideron Përfituesin si të besueshëm për kreditim Bankar; dhe (C) pas shqyrtimit të duhur të zhvillimit të ekonomisë së Përfituesit, Drejtorët Ekzekutivë të Shoqatës e kanë shqyrtuar dhe miratuar modifikimin e tillë.

- (ii) Shoqata, pas shfaqjes së ngjarjeve të përmendura në paragrafin (b) (i) të këtij Seksioni, do të: (A) kërkojë nga Përfituesi të paguajë shumën e dyfishtë të çdo kësti të Bilancit të Kredisë së Tërhequr të pa skaduar ende derisa sa kredia të shlyhet plotësisht; dhe (B) kërkojë nga Përfituesi të fillojë kthimin e tillë qysh nga gjashtë mujori i parë i Datës së Pagesës së Kryegjësë duke rënë gjashtë muaj ose më shumë pas datës në të cilën Shoqata e njofton Përfituesin se ngjarja e tillë ka ndodhur; sidoqoftë, me kusht që do të ketë një grejs periudhë prej minimum pesë vjeçare mbi këtë shlyerje.
- (iii) Përndryshe, nëse kërkohet nga Përfituesi, Shoqata mund të rishikojë kushtet e specifikuar në nënparagrafin (ii) të këtij paragrafi të përfshijë, në vend të disa ose të gjitha rritjeve në shumat e kësteve të tilla, pagesën e interesit në një normë vjetore të rënë dakord me Shoqatën mbi Shumën Kapitale të Kredisë së Tërhequr; me kusht që, në gjykimin e Shoqatës, një rishikim i tillë nuk do të ndryshojë elementin e grantit të dhënë nën kushte të tilla.
- (iv) Në qoftë se, në çdo kohë pasi kushtet e kthimit janë modifikuar në pajtim me nën-paragrafin (i) të këtij Seksioni, Shoqata përcakton se gjendja ekonomike e Përfituesit është keqësuar dukshëm, Shoqata mundet, nëse kërkohet nga Përfituesi, më tej të rishikojë kushtet e kthimit të Bilancit të Kredisë së Tërhequr dhe për të qenë konform planit të kësteve të parashikuara fillimisht në Marrëveshjen e Financimit, duke marrë parasysh çdo Pagesë tashmë të bërë nga Përfituesi.

Seksioni 3.04. *Parapagimi*

Përfituesi mund t'i paguajë Asociacionit shumën e tërë apo ndonjë pjese të shumës kryesore para maturimit të shumës kryesore të një ose më shumë maturimeve të Kredisë të Specifikuar nga Përfituesi.

Seksioni 3.05. *Pagesa e pjesërishme*

Nëse Shoqata ndonjëherë pranon më pak se shumën e plotë të ndonjë Pagese të Financimit përpos pagesës së duhur, ajo do të ketë të drejtë të ndajë dhe të aplikojnë shumën e pranuar në çdo mënyrë dhe për qëllime të tilla sipas Marrëveshjes së Financimit siç përcakton në diskrecionin e saj të vetëm.

Seksioni 3.06. *Vendi i Pagesës*

Të gjitha Pagesat e Financimit do të paguhen në ato vende që Shoqata në mënyrë të arsyeshme do të kërkojë.

Seksioni 3.07. *Valuta e Pagesës*

(a) Përfituesi do t'i paguajë të gjitha Pagesat e Financimit në Valutën e specifikuar në Marrëveshjen e Financimit ("Valuta e Pagesës").

(b) Nëse Përfituesi do të kërkojë, Shoqata, duke vepruar si agjent i Përfituesit, dhe në terma dhe kushte të tilla siç do t'i përcaktojë Shoqata, do të blejë valutën e pagesës me qëllim të pagimit të Pagesës së Financimit mbi pagesën në kohë nga Përfituesi me fonde të mjaftueshme për këtë qëllim në valutë ose valutat e pranueshme për Shoqatën; me kusht që, sidoqoftë, Pagesa e Financimit do të konsiderohet se ka qenë e paguar vetëm kur dhe në atë masë që Shoqata ka pranuar pagesën e tillë në Valutën e Pagesës.

Seksioni 3.08. *Shuma e Pagesës*

Bilanci i pagueshëm i Kredisë së Tërhequr do të jetë ekuivalent (siç përcaktohet nga data, ose datat përkatëse, të pagesës) të vlerës së valutës apo valutave të tërhequra nga Llogaria e Kredisë të shprehura në termat e të Drejtave të Tërheqjes Speciale sipas datave përkatëse të tërheqjes.

Seksioni 3.09. *Vlerësimi i Valutave*

Sa herë që bëhet e nevojshme për qëllime të ndonjë marrëveshje ligjore, për të përcaktuar vlerën e një valute në drejtim të një tjetër, vlera të tilla do të përcaktohen si të arsyeshme nga Shoqata.

Seksioni 3.10. *Mënyra e Pagesës*

(a) Çdo Pagesë Financimi që kërkohet t'i paguhet Shoqatës në Valutën e ndonjë vendi do të paguhet në mënyrë të tillë, dhe në Valutën e fituar në mënyrë të tillë, si do të lejohet sipas ligjeve të atij vendi me qëllim për të bërë pagesa të tilla dhe të ndikojnë në depozitën e Valutës së tillë në llogarinë e Shoqatës me një depozitues të Shoqatës të autorizuar për të pranuar depozita në valutën e tillë.

(b) Të gjitha Pagesat e Financimit do të paguhet pa kufizime të çfarëdo lloji të vendosura nga, ose në territorin e Përfituesit, dhe pa zbritje për, dhe të lirë nga çfarëdo Takse të vënë nga, ose në territorin e, Përfituesit.

(c) Marrëveshjet ligjore do të jenë të lirë nga çfarëdo Takse të vënë nga, ose në territorin e Përfituesit, ose në lidhje me përmbarimin, dorëzimin ose regjistrimin e tyre.

NENI IV

Ekzekutimi i Projektit

Seksioni 4.01. *Ekzekutimi i Projektit Përgjithësisht*

Përfituesi dhe Enti Zbatues i Projektit do të kryejnë pjesët e tyre përkatëse të Projektit:

- (a) me kujdes të duhur dhe efikasitet;
- (b) në përputhje me standardet dhe praktiket e duhura administrative, teknike, financiare, ekonomike, mjedisore dhe sociale; dhe
- (c) në përputhje me dispozitat e Marrëveshjeve Ligjore dhe këto Kushte të Përgjithshme.

Seksioni 4.02. *Performanca sipas Marrëveshjes së Projektit*

Përfituesi do të: (a) ndikojë në Entin Zbatues të Projektit t'i kryejë të gjitha detyrimet e Entit Zbatues të Projektit të përcaktuara në Marrëveshjen e Projektit në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Projektit; dhe (b) nuk merr ose lejon të merret asnjë veprim që do të parandalojë ose ndërhyjë me punën e tillë

Seksioni 4.03. Sigurimi i fondeve dhe burimeve të tjera

Përfituesi do të sigurojë ose dikojë që të sigurohen, menjëherë sipas nevojës, fondet, objektet, shërbimet dhe burime të tjera: (a) që nevojiten për Projektin; dhe (b) të nevojshme ose të përshtatshme për të mundësuar Entin Zbatues të Projektit për të kryer obligimet e veta sipas Marrëveshjes së Projektit.

Seksioni 4.04. Sigurimi

Përfituesi dhe Enti Zbatues i Projektit do të marrin masa adekuate për sigurimin e secilit mall të nevojitur për Pjesët e tyre Përkatëse të Projektit dhe që do të financohen nga shuma e Financimit, kundër rreziqeve të incidentit të transportit, blerjes dhe shpërndarjes së mallrave në vendin e përdorimit ose instalimit të tyre. Çdo dëmshpërblim për sigurimin e tillë do të jetë i pagueshëm në një Valutë lirisht të përdorshme për të zëvendësuar ose riparuar këto mallra.

Seksioni 4.05. Blerja e Tokës

Përfituesi dhe Enti Zbatues i Projektit do të marrin (ose do të ndikojnë që të merren) të gjitha veprimet për të blerë, si dhe kur është e nevojshme e gjithë tokën dhe të drejtat në lidhje me tokën, si do të jetë e nevojshme për kryerjen e Pjesëve të tyre Përkatëse të Projektit dhe menjëherë do t'i dorëzojnë Shoqatës, me kërkesën e saj, prova të kënaqshme për Shoqatën se toka në fjalë dhe të drejtat në lidhje me atë tokë janë në dispozicion për qëllime që lidhen me Projektin

Seksioni 4.06. Përdorimi i Mallrave, Punimeve dhe Shërbimeve; Mirëmbajtja e Objekteve

(a) Përveçse kur Shoqata bie dakord ndryshe, Përfituesi dhe Enti Zbatues i Projektit do të sigurojë që të gjitha mallrat, punimet dhe shërbimet e financuara nga të ardhurat e Financimit janë përdorur ekskluzivisht për qëllime të Projektit.

(b) Përfituesi dhe Enti Zbatues i Projektit do të sigurojnë që të gjitha objektet me rëndësi të Pjesëve të tyre Përkatëse të Projektit në çdo kohë duhet të operohen dhe mirëmbahen siç duhet dhe se të gjitha riparimet e nevojshme dhe ripërtëritja e objekteve të tilla do të bëhet menjëherë sipas nevojës.

Seksioni 4.07. Planet; Dokumentet; Shënimet

(a) Përfituesi dhe Enti Zbatues i Projektit do t'i dorëzojnë Shoqatës të gjitha planet, oraret, specifikimet, raportet dhe dokumentet kontraktuese për Pjesët e tyre Përkatëse të Projektit, dhe çdo modifikim material i ose shtesa të këtyre dokumenteve, menjëherë pas përgatitjes së tyre dhe në detaje të tilla si Shoqata në mënyrë të arsyeshme do të kërkojë.

Përfituesi dhe Enti Zbatues i Projektit do të mbajnë shënime adekuate për të regjistruar progresin e Pjesëve të tyre Përkatëse të Projektit (duke përfshirë koston dhe përfitimet që do të rrjedhin prej saj), për identifikimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve të financuara nga shuma e Financimit dhe të zbulojë përdorimin e tyre në Projekt, dhe do t'i dorëzojë të dhënat e tilla Shoqatës me kërkesën e tij.

(c) Përfituesi dhe Enti Zbatues i Projektit do t'i mbajnë të gjitha shënimet (kontratat, urdhrat, faturat, fletëpagesat, vërtetimet dhe dokumente të tjera) duke evidentuar shpenzimet nën Pjesët e tyre Përkatese të Projektit jo më vonë se: (i) një vit pasi Shoqata ka pranuar Pasqyrat e audituara Financiare që mbulojnë periudhën gjatë së cilës është bërë tërheqja e fundit nga Llogaria e Financimit; dhe (ii) dy vjet pas Datës së Mbylljes. Përfituesi dhe Enti Zbatues i Projektit do t'i mundësojnë përfaqësuesve të Shoqatës për të shqyrtuar të dhënat e tilla.

Seksioni 4.08. *Monitorimi dhe Vlerësimi i Projektit*

(a) Përfituesi do të mbajë ose të ndikojë që të mbahen politikat dhe procedurat adekuate për t'i mundësuar monitorimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të progresit të projektit dhe arritjen e objektivave të tij, në përputhje me tregues të pranueshëm për Shoqatën.

(b) Përfituesi do të përgatisë apo do të ndikojë në përgatitjen e raporteve periodike ("Raporti i Projektit"), në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Shoqatën, duke integruar rezultatet e aktiviteteve të monitorimit dhe vlerësimit dhe të përcaktohen masat e rekomanduara për të siguruar ekzekutimin e vazhdueshëm efikas dhe efektiv të Projektit, dhe për të arritur objektivat e Projektit. Përfituesi do të dorëzojë ose do të ndikojë në dorëzimin e çdo Raporti të Projektit për Shoqatën menjëherë pas përgatitjes së tij, mundësojë Shoqatës një mundësi të arsyeshme për të shkëmbyer pikëpamjet me Përfituesin dhe Entin Zbatues të Projektit mbi një raport të tillë, dhe më pas të zbatojnë masat e rekomanduara të tilla, duke marrë parasysh këndvështrimet e Shoqatës mbi këtë çështje.

(c) Përfituesi do të përgatisë, ose të ndikojë në përgatitjen, dhe do t'i dorëzojë Shoqatës jo më vonë se gjashtë muaj pas Datës së Mbylljes, ose atë datë të mëhershme, siç mund të specifikohet për këtë qëllim në Marrëveshjen e Financimit: (i) një raport, i fushëveprimit të tillë dhe në detaje të tilla si Shoqata në mënyrë të arsyeshme do të kërkojë, për ekzekutimin e Projektit, performancës nga ana e Përfituesit, Entiteti Zbatues i Projektit dhe Shoqata, të detyrimeve të tyre përkatese sipas Marrëveshjeve Ligjore dhe realizimi i qëllimit të Financimit; dhe (ii) një plan i projektuar për të siguruar qëndrueshmërinë e arritjeve të Projektit.

Seksioni 4.09. *Menaxhimi financiar, Pasqyrat Financiare, Auditimet*

(a) Përfituesi do të mbajë ose do të ndikojë që të mbahet një sistem i menaxhimit financiar dhe të përgatis pasqyrat financiare ("Pasqyrat Financiare") në përputhje me standardet e kontabilitetit të aplikuara në mënyrë konstante të pranueshme për Shoqatën, të dyja në një mënyrë të përshtatshme për të reflektuar operacionet, burimet dhe shpenzimet që lidhen me Projektin.

(b) Përfituesi do të:

- (i) ketë Pasqyrat audituara Financiare në mënyrë periodike, në përputhje me Marrëveshjet Ligjore nga auditorë të pavarur të pranueshëm për Shoqatën, në përputhje me standardet e auditimit të aplikuara në mënyrë konstante të pranueshme për Shoqatën;
- (ii) jo më vonë se në datën e përcaktuar në Marrëveshjet Ligjore, Shoqatës t'i dorëzojë ose të ndikojë në dorëzimin e Pasqyrave të audituara Financiare, dhe informacione të tjera në lidhje me Pasqyrat e audituara Financiare dhe të auditorëve të tillë, si Shoqata mund nga koha në kohë në mënyrë të arsyeshme të kërkojë; dhe
- (iii) të bëjë që Pasqyrat e audituara Financiare, apo të ndikojë që Pasqyrat e audituara Financiare, të jenë publikisht në dispozicion në kohën e duhur dhe në një mënyrë të pranueshme për Shoqatën.

Seksioni 4.10. *Bashkëpunimi dhe Konsultimi*

Përfituesi dhe Shoqata do të bashkëpunojnë plotësisht për të siguruar se qëllimet e Financimit dhe objektivat e Projektit do të realizohen. Për këtë qëllim, Përfituesi dhe Shoqata:

(a) nga koha në kohë, me kërkesën e ndonjërit prej tyre, do të shkëmbejnë pikëpamjet mbi Projektin, Financimin, dhe përmbushjen e detyrimeve të tyre përkatëse sipas Marrëveshjeve Ligjore, dhe t'i dorëzojë palës tjetër të gjitha informatat e tilla të lidhura me ato çështje si ajo në mënyrë të arsyeshme do të kërkojë; dhe

(b) menjëherë do të informojnë njëra-tjetrën për çdo lloj kushti që ndërhyr me, ose kërcënon të ndërhyjë në, çështje të tilla.

Seksioni 4.11. *Vizitat*

(a) Përfituesi do të përballojë të gjitha mundësitë e arsyeshme për përfaqësuesit e Shoqatës për të vizituar çdo pjesë të territorit të tij për qëllime që lidhen me Financimin apo Projektin.

(b) Përfituesi dhe Enti Zbatues i Projektit do t'i mundësojnë përfaqësuesve të Shoqatës: (i) të vizitojnë çdo objekt dhe vendndërtimet e përfshira në Pjesën e tyre Përkatëse të Projektit; dhe (ii) të shqyrtojnë mallrat e financuara nga të ardhurat e Financimit për Pjesët e tyre Përkatëse të Projektit, dhe secilin impiant, instalim, vend, punë, ndërtesë, pronë, pajisje, shënim dhe dokumentet e rëndësishme për kryerjen e detyrimeve të tyre sipas Marrëveshjeve Ligjore.

Seksioni 4.12. *Zona e kontestuar*

Në rast se Projekti është në një zonë e cila është ose bëhet e kontestuar, as financimi i Shoqatës për Projekt, e as ndonjë përcaktim i ose referencë për zonën e tillë në Marrëveshjet Ligjore, ka për qëllim të bëjë një gjykim nga ana e Shoqatës për sa i përket statusit ligjor apo statuteve të tjera të zonës së tillë ose të paragjykojë vendosmërinë e ndonjë pretendimi në lidhje me zonën e tillë.

NENI V

Të Dhënat Ekonomike Dhe Financiare

Seksioni 5.01. *Të Dhënat Ekonomike dhe Financiare*

Pranuesi do t'i paraqesë Asociacionit të gjitha informatat të cilat Asociacioni në mënyrë të arsyeshme i kërkon në lidhje me kushtet financiare dhe ekonomike në territorin e saj, duke përfshirë edhe bilancin e saj të pagesave dhe të borxhit të saj të jashtëm, si dhe atë të nënndarjeve të saj politike ose administrative dhe të çdo entiteti në pronësi të tij apo të kontrolluar nga ai, ose të cilat veprojnë për llogari ose përfitim të Pranuesit ose ndonjë nënndarje të tillë, dhe të çdo institucioni që kryen funksionet e një banke qendrore ose këmben fondet e stabilizimit, ose funksione të ngjashme, për Pranuesin.

NENI VI

Anulimi; Pezullimi; Përsheptimi; Rimbursimi i Grantit

Seksioni 6.01. *Anulimi nga ana e Pranuesit*

Pranuesi mundet, duke e njoftuar Asociacionin, të anulojë çdo sasi të Bilancit të Patërhequr të Financimit, përveç se Pranuesi nuk mund të anulojë shumën të cilat iu nënshtrohen Zotimit të Veçantë.

Seksioni 6.02. *Pezullimi nga Asociacioni*

Nëse ndonjë prej ngjarjeve të specifikuar në paragrafin (a) deri (m) të këtij Seksioni ndodhin dhe janë në vazhdim e sipër, Asociacioni mundet, duke e njoftuar Pranuesin, të pezullojë plotësisht ose pjesërisht të drejtën e Pranuesit për të bërë tërheqje prej Llogarisë së Financimit. Pezullim i tillë do të vazhdojë deri në rastin (ose rastet) kur pezullimi të pushojë së ekzistuari, përveç nëse Asociacioni ka njoftuar Pranuesin se e drejta e tillë për të bërë tërheqje është rikthyer.

(a) *Dështim i pagesës.* Pranuesi ka dështuar që të bëjë pagesën (pavarësisht nga fakti që pagesa të tilla mund të jenë bërë nga një palë e tretë) e kryegjësë, interesit, dhe shërbimit ose ndonjë shumë tjetër të borxhit ndaj Asociacionit apo Bankës: (i) sipas Marrëveshjes së Financimit; ose (ii) sipas ndonjë marrëveshjeje tjetër ndërmjet Pranuesit dhe Asociacionit; ose (iii) sipas ndonjë marrëveshjeje ndërmjet Pranuesit dhe Bankës; ose (iv) si pasojë e ndonjë detyrimi të zgjatur apo obligimi financiar të çfarëdo lloji, të marr përsipër nga Asociacioni apo Banka për çdo palë të tretë me pëlqimin e Pranuesit.

(b) *Dështimi i Performancës.*

- (i) Pranuesi ka dështuar të kryejë ndonjë detyrim tjetër sipas Marrëveshjes së Financimit.
- (ii) Enti Zbatues i Projektit ka dështuar të kryejë ndonjë obligim sipas Marrëveshjes së Projektit.

(c) *Mashtrimi dhe Korrupsioni.* Në çdo kohë, që Asociacioni konstaton se cilido përfaqësues i Pranuesit ose Entit Zbatues të Projektit, apo ndonjë pranues tjetër i ndonjë shume tjetër të Financimit është përfshirë në praktika korruptive, mashtruese, detyruese ose marrëveshjes se fshehtë në lidhje me përdorimin e të ardhurave të Financimit, e Pranuesi ose Entin Zbatues të Projektit (ose ndonjë pranues tjetër i tillë) nuk kanë ndërmarrë veprim në kohë të përshtatshme dhe të kënaqshme për Asociacionin për të adresuar praktikatat e tilla kur ato ndodhin.

(d) *Suspendimi i tërthortë*

- (i) Asociacioni ose Banka ka pezulluar tërësisht ose pjesërisht të drejtën e Pranuesit për të bërë tërheqje në kuadër të ndonjë marrëveshjeje me Asociacionin apo me Bankën për shkak të dështimit nga ana e Pranuesit për të realizuar ndonjë nga detyrimet e tij sipas marrëveshjes së tillë.
- (ii) Banka ka pezulluar tërësisht ose pjesërisht të drejtën e huamarrësit për të bërë ndonjë tërheqje në kuadër të një marrëveshjeje kredie me Bankën e garantuar nga Pranuesi për shkak të një dështimi të tillë nga ana e huamarrësit për të kryer ndonjë nga detyrimet e tij sipas marrëveshjes së tillë.

(e) *Situata të jashtëzakonshme.* Si rezultat i ngjarjeve që kanë ndodhur pas datës së Marrëveshjes së Financimit, është shfaqur një situatë e jashtëzakonshme e cila e bën të pamundur që të kryhet Projekti ose që Pranuesi ose Enti Zbatues i Projektit të jenë në gjendje për të kryer obligimet e veta sipas Marrëveshjes Ligjore për të cilat është palë.

(f) *Ngjarja para hyrjes në fuqi.* Asociacioni ka konstatuar pas datës së hyrjes në fuqi se para datës së tillë, por pas datës së Marrëveshjes së Financimit, ka ndodhur një ngjarje e cila i jep të drejtë Asociacionit për të pezulluar të drejtën e Pranuesit për të bërë tërheqje nga Llogaria e

Financimit nëse Marrëveshja e Financimit ishte në fuqi në datën kur ngjarja e tillë ka ndodhur.

(g) *Deklarime të rrejshme.* Një deklaratë e bërë nga Pranuesi në pajtim me Marrëveshjen e Financimit, apo ndonjë pohim apo deklaratë e dhënë nga Pranuesi dhe në të cilën Asociacioni synon të mbështetet për qëllime të kryerjes së Financimit, ishte e gabuar në ndonjë aspekt material.

(h) *Bashkëfinancimi.* Ndonjë nga ngjarjet e mëposhtme ndodh në lidhje me ndonjë financim të specifikuar në Marrëveshjen e Financimit që do të sigurohet për Projektin ("Bashkë-financimi") nga një financier (përveç Asociacionit ose Bankës) ("Bashkë-financier").

- (i) Në qoftë se Marrëveshja e Financimit specifikon një datë me të cilën marrëveshja me Bashkë-financier parashikon Bashkë-financimin ("Marrëveshje bashkëfinancimi") do të hyjë në fuqi, Marrëveshja e Bashkë-financimit nuk ka hyrë në fuqi deri në atë datë, ose një datë e mëvonshme që Asociacioni ka përcaktuar duke e njoftuar Pranuesin ("Afatit i fundit i Bashkë-financimit"); mirëpo, me kusht që dispozitat e këtij nën-paragrafi nuk vlejnë nëse Pranuesi vërteton në mënyrë të pranueshme për Asociacionin se fonde të mjaftueshme për Projektin janë në dispozicion nga burime të tjera me termat dhe kushtet në përputhje me detyrimet e tij sipas Marrëveshjes së Financimit.
- (ii) Në varësi prej nën-paragrafit (iii) të këtij paragrafi: (A) e drejta për tërheqje të shumës së bashkë-financimit është pezulluar, anuluar ose ndërprerë tërësisht ose pjesërisht, në pajtim me kushtet e Marrëveshjes së Bashkë-financimit; ose (B) Bashkë-financimi është bërë i detyrueshëm dhe i pagueshëm para afatit të dakorduar të maturimit.
- (iii) Nën-paragrafi (ii) i këtij paragrafi nuk zbatohet nëse Pranuesi vërteton në mënyrë të pranueshme për Asociacionin se: (A) pezullimi, anulimi, përfundimi ose para-maturimi i tillë nuk u shkaktua nga dështimi i pranuesit të Bashkë-financimit për të kryer ndonjë nga detyrimet e tij sipas Marrëveshjes së Bashkë-financimit; dhe (B) fonde të mjaftueshme për Projektin janë në dispozicion nga burime të tjera në termat dhe kushtet në përputhje me detyrimet e Pranuesit sipas Marrëveshjes së Financimit.

(i) *Caktimi i Detyrimeve; tjetërsimi i asetëve.* Pranuesi ose Entit Zbatues i Projektit (apo ndonjë subjekti tjetër përgjegjës për zbatimin e ndonjë pjese të Projektit), pa pëlqimin e Asociacionit: (i) ka caktuar ose transferuar, në tërësi ose pjesërisht, detyrimet e tij që rrjedhin nga ose hyjnë në zbatim të Marrëveshjeve Ligjore; ose (ii) ka shitur, ka dhënë me qira, ka transferuar, ka caktuar, ose ndryshe ka tjetërsuar pronën ose asetet e financuara tërësisht ose pjesërisht nga të ardhurat e Financimit; me kusht që dispozitat e këtij paragrafi nuk zbatohen në lidhje me transaksionet në rrjedhën e zakonshme të biznesit të cilat, sipas mendimit të Asociacionit: (A) materialisht dhe negativisht nuk ndikojnë në aftësinë e Pranuesit ose Entit Zbatues të Projektit (apo subjekti tjetër të tillë) për të kryer ndonjë nga detyrimet e tij që rrjedhin nga ose të marr përsipër në pajtim me Marrëveshjet Ligjore ose për të arritur objektivat e Projektit; dhe (B) materialisht dhe negativisht nuk ndikojnë në gjendjen financiare apo operimin e Entit Zbatues të Projektit (apo subjekti tjetër të tillë).

(j) *Anëtarësimi.* Pranuesi: (i) ka qenë i pezulluar nga anëtarësimi në ose është pushuar të jetë anëtar i Asociacionit; ose (ii) ka pushuar të jetë anëtar i Fondit Monetar Ndërkombëtar.

(k) *Kushti i Entit Zbatues të Projektit.*

- (i) Është ndërmarrë çdo veprim për shpërbërjen ose pezullimin e operacioneve të Entit Zbatues të Projektit (ose të çdo personi tjetër përgjegjës për zbatimin e

ndonjë pjese të Projektit).

- (ii) Entit Zbatues i Projektit (apo ndonjë subjekt tjetër përgjegjës për zbatimin e ndonjë pjese të Projektit) ka pushuar ekzistimin në të njëjtën formë ligjore, si ajo që ekzistonte datën e Marrëveshjes së Financimit.
- (iii) Sipas mendimit të Asociacionit, karakteri ligjor, pronësia ose kontrolli i Entit Zbatues të Projektit (ose të ndonjë subjekti tjetër përgjegjës për zbatimin e ndonjë pjese të Projektit) ka ndryshuar nga ajo që ekzistonte në datën e Marrëveshjeve Ligjore ashtu që materialisht dhe negativisht ndikon në aftësinë e Pranuesit ose Entit Zbatues të Projektit (apo subjekt tjetër të tillë) për të kryer ndonjë nga detyrimet e tij që rrjedhin nga ose janë përsipër në pajtim me marrëveshjet ligjore, ose për të arritur objektivat e Projektit..

(l) *Papërshtatshmëria.* Asociacioni ose Banka ka deklaruar se Enti Zbatues i Projektit nuk posedon zotësi juridike për të marrë mjetet e ndonjë financimi të bërë nga Asociacioni ose Banka ose ndryshe për të marrë pjesë në përgatitjen ose zbatimin e ndonjë projekti të financuar në tërësi ose pjesërisht nga Asociacioni apo Banka, si rezultat: (i) i një përcaktimi nga Asociacioni ose Banka që Enti Zbatues i Projektit është përfshirë në praktikatat mashtruese, korruptive, detyruese ose të fshehta në lidhje me përdorimin e të ardhurave nga ndonjë financim të bërë nga Asociacioni apo Banka; dhe/ose (ii) i një deklarate nga një tjetër financier se Enti Zbatues i Projektit është i papërshtatshëm për të marrë mjetet e ndonjë financimi të bërë nga financieri i tillë ose ndryshe për të marrë pjesë në përgatitjen ose zbatimin e ndonjë projekti të financuar në tërësi ose pjesërisht nga financier i tillë si rezultat i një përcaktimi nga financier i tillë që Enti Zbatues i Projektit është përfshirë në praktikatat mashtruese, korruptive, detyruese ose të fshehta në lidhje me përdorimin e të ardhurave nga ndonjë financim të bërë nga financier i tillë

(m) *Ngjarja Shtesë.* Çdo ngjarje tjetër e specifikuar në Marrëveshjen e Financimit për qëllimet e këtij Seksioni kanë ndodhur ("Ngjarja Shtesë e Pezullimit").

Seksioni 6.03. *Anulimi nga Asociacioni*

Nëse ndonjë prej ngjarjeve të specifikuara në paragrafët (a) deri (e) të këtij Seksioni ndodhin në lidhje me shumën e Bilancit të Financimit të Patërhequr, Asociacioni mundet, duke e njoftuar Pranuesin, të ndërpresë të drejtën e Pranuesit për të bërë tërheqje në lidhje me shumën e tillë. Pas dhënies së njoftimit të tillë, shumata e tillë e Financimit do të anulohet.

(a) *Pezullimi.* E drejta e Pranuesit për të bërë tërheqje nga Llogaria e Financimit është pezulluar në lidhje me ndonjë sasi të Financimit për një periudhë të vazhdueshme prej tridhjetë ditësh.

(b) *Shumat e panevojshme.* Në çdo kohë, Asociacioni përcakton, pas konsultimit me Pranuesin, që një sasi e financimit nuk do të jetë e nevojshme për të financuar Shpenzimet e Pranueshme.

(c) *Mashtrimi dhe Korrupsioni.* Në çdo kohë, Asociacioni konstaton, në lidhje me çdo shumë e të ardhurave të Financimit, që janë angazhuar praktikatat korruptuese, mashtruese, detyruese, ose marrëveshjes së fshehte nga përfaqësuesit e Pranuesit ose të Entit Zbatues të Projektit (apo pranuesi tjetër i të ardhurave të Financimit) pa Pranuesin ose Entin Zbatues të Projektit (apo pranuesi tjetër i të ardhurave të Financimit) e pa ndërmarrë veprime në kohë të përshtatshme dhe të kënaqshme për Asociacionin për të adresuar praktikatat e tilla kur ato ndodhin.

(d) *Keq prokurimi.* Në çdo kohë, Asociacioni: (i) përcakton se prokurimi i çdo kontrate

që do të financohet nga shumat e Financimit është në kundërshtim me procedurat e përcaktuara ose të referuara në Marrëveshjet Ligjore; dhe (ii) përcakton shumën e shpenzimeve sipas kontratës së tillë e cila përndryshe do të ishte e përshtatshme për financimin nga të ardhurat e Financimit.

(e) *Data e mbylljes.* Pas Datës së Mbylljes, mbetet një Bilanci i Patërhequr i Financimit.

Seksioni 6.04. *Shumat që i nënshtrohen Zotimit të Veçantë që nuk janë ndikuar nga Suspendimi apo Anulimi nga Asociacioni*

Nuk do të zbatohet asnjë anulim apo pezullim nga Asociacioni për shumat që i nënshtrohen ndonjë Zotimi të Veçantë, përveç kur parashikohet shprehimisht në Zotim të Veçantë.

Seksioni 6.05. *Aplikimi i shumave të anuluar në Maturimin e Kredisë*

Përveç rasteve kur Pranuesi dhe Asociacioni bien dakord ndryshe, çdo shumë e anuluar e Kredisë do të aplikohet pro rata për këstet e shumës kryesore të Kredisë që bien në kohën e duhur pas datës së anulimit të tillë.

Seksioni 6.06. *Ngjarjet e Përshpejtimit*

Nëse ndonjë prej ngjarjeve të specifikuar në paragrafët (a) deri (f) të këtij Seksioni ndodh dhe vazhdon për periudhën e specifikuar (nëse ka), atëherë në çdo kohë të mëvonshme gjatë vazhdimit të ngjarjes, Asociacioni mundet, pasi njofton Pranuesin, të deklarojë të gjithë ose një pjesë të Bilancit të Tërhequr të Kredisë, të gjendjes së hasur në datën e njoftimit të tillë se është i detyrueshëm dhe i pagueshëm menjëherë së bashku me ndonjë Pagesë tjetër të Financimit të detyrueshëm sipas Marrëveshjes së Financimit ose të këtyre Kushteve të Përgjithshme. Pas çdo deklarate të tillë, Bilanci i Tërhequr i Kredisë dhe Pagesat e Financimit bëhen menjëherë të detyrueshme dhe të pagueshme.

(a) *Pagesa e Vonuar.* Vonesa në pagesë paraqitet nga ana e Pranuesit për ndonjë shumë që duhet t'i paguhet Asociacionit apo Bankës: (i) sipas Marrëveshjes së Financimit; or (ii) sipas ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Pranuesit dhe Asociacionit; ose (iii) sipas ndonjë marrëveshjeje ndërmjet Pranuesit dhe Bankës; ose (iv) si pasojë e ndonjë detyrimi të zgjatur apo obligimeve të tjera financiare të çdo lloji të marr përsipër nga Asociacioni apo Banka për ndonjë palë të tretë me pëlqimin e Pranuesit; dhe mospagimi i tillë vazhdon në secilin rast për një periudhë prej tridhjetë ditësh.

(b) *Performanca e Vonuar.*

- (i) Vonesa paraqitet nga ana e Pranuesit në kryerjen e ndonjë detyrimi tjetër sipas Marrëveshjes së Financimit, dhe mospagimi i tillë vazhdon për një periudhë prej gjashtëdhjetë ditësh pas njoftimit të mospagimit të tillë të dhënë nga Asociacioni për Pranuesin.
- (ii) Vonesa ka ndodhur nga ana e Entit Zbatues të Projektit në kryerjen e ndonjë obligimi në bazë të Marrëveshjes së Projektit, dhe mospagimi i tillë vazhdon për një periudhë prej gjashtëdhjetë ditësh pas njoftimit të mospagimit të tillë të dhënë nga Asociacioni për Entin Zbatues të Projektit dhe Pranuesin.

(c) *Bashkë-financimi.* Ngjarja e specifikuar në nën-paragrafin (h) (ii) (B) të Seksionit 6.02 ka ndodhur, duke iu nënshtuar kushtit të nën-paragrafit (h) (iii) të këtij Seksioni.

(d) *Caktimi i Detyrimeve; Tjetërsimi i asetëve.* Çdo ngjarje e specifikuar në paragrafin (i) të Seksionit 6.02 ka ndodhur.

(e) *Kushti i Entit Zbatues të Projektit.* Çdo ngjarje e specifikuar në nën-paragrafin (k) (i), (k) (ii), ose (k) (iii) të Seksionit 6.02 ka ndodhur.

(f) *Ngjarja Shtesë.* Çdo ngjarje tjetër e specifikuar në Marrëveshjen e Financimit për qëllime të këtij Seksioni ka ndodhur dhe vazhdon për periudhën, nëse ka tilla, të specifikuar në Marrëveshjen e Financimit ("Ngjarja Shtesë e përshpejtimit").

Seksioni 6.07. *Rimbursimi i Grantit*

(a) Nëse Asociacioni konstaton se një sasi e Bilancit të Tërhequr të Grantit është përdorur në një mënyrë që është jokonsistente me dispozitat e Marrëveshjes së Financimit ose të këtyre Kushteve të Përgjithshme, Pranuesi, pas njoftimit nga Asociacioni, menjëherë do t'ia kthejë Asociacionit atë shumë. Një përdorim i tillë në kundërshtim përfshin, pa kufizim:

- (i) përdorimin e shumës së tillë për të bërë një pagesë për një Shpenzim që nuk është një Shpenzim i pranueshëm; ose
- (ii) (A) përfshirja në praktika korruptuese, mashtruese, detyruese ose të fshehta në lidhje me përdorimin e shumës së tillë, ose (B) përdorimin e shumës së tillë për të financuar një kontratë gjatë prokurimit ose përdorimi i shumës së tillë për të financuar një kontratë, gjatë prokurimit të së cilës ose në ekzekutimin e të cilave praktikat e tilla ishin të kryera nga përfaqësuesit e Pranuesit ose të Entit Zbatues të Projektit (apo pranuesi tjetër i shumës së tillë të Bilancit të Grantit të Tërhequr), ku në secilin rast Pranuesi ose Enti Zbatues i Projektit (ose marrësit e tjerë të tillë) nuk kanë ndërmarrë veprime në kohë të përshtatshme dhe të kënaqshme për Asociacionin për të adresuar praktikat e tilla kur ato ndodhin.

(b) Përveç kur Asociacioni mund të përcaktojë ndryshe, Asociacioni anulon të gjitha shumat e rimbursuara sipas këtij Seksioni.

Seksioni 6.08. *Efektiviteti i Dispozitave pas Anulimit, Pezullimit, Përsheptimit, ose Rimbursimit*

Pavarësisht nga cilido pezullim, anulim përsheptim, ose rimbursim sipas këtij Neni, të gjitha dispozitat e Marrëveshjeve Ligjore vazhdojnë të jenë në fuqi dhe efekt të plotë, përveç kur parashikohet në mënyrë specifike në këto Kushtet e Përgjithshme.

NENI VII

Zbatueshmëria; Arbitrazhi

Seksioni 7.01. *Zbatueshmëria*

Të drejtat dhe detyrimet e Pranuesit dhe Asociacionit sipas marrëveshjeve ligjore janë të vlefshme dhe të zbatueshme në pajtim me termat e tyre, pavarësisht ligjit të shtetit ose ndonjë nënndarjeje politike i cili pohon për të kundërtën. As Pranuesi as Asociacioni nuk kanë të drejtë në asnjë procedurë sipas këtij Neni të pohojnë ndonjë pretendim që ndonjë dispozitë e këtyre Kushteve të Përgjithshme ose Marrëveshjeve Ligjore është e pavlefshme ose e pazbatueshme për shkak të ndonjë dispozite të Neneve të Marrëveshjes të Asociacionit.

Seksioni 7.02. *Dështimi për të Ushtruar të Drejtat*

Asnjë vonesë në ushtrim, apo lëshim në ushtrimin e çfarëdo të drejte, kompetence ose mjeti të akumuluar për cilëndo palë sipas ndonjë Marrëveshje Ligjore lidhur me ndonjë vonesë, do të pengojë që e drejta, kompetenca apo mjeti juridik të interpretohet si një dokument i heqjes dorë prej saj ose një pranim i heshtur i mungesë të tillë. Asnjë veprim i palës së tillë në lidhje me ndonjë mungesë, ose ndonjë pajtim lidhur me ndonjë mungesë, ndikon ose pengon ndonjë të drejtë, kompetencë apo mjet të palës së tillë në lidhje me ndonjë mungesë tjetër ose pasuese.

Seksioni 7.03. Arbitrazhi

(a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të Marrëveshjes së Financimit dhe çdo pretendim nga cilado palë kundër tjetrës që rrjedhin sipas Marrëveshjes së Financimit i cili nuk është vendosur me marrëveshje të palëve do të dorëzohet në arbitrazh nga një Gjykatë e Arbitrazhit ("Gjykata e Arbitrazhit") siç parashihet më tej.

(b) Palët në arbitrazh të tillë do të jenë Pranuesi dhe Asociacioni.

(c) Gjykata e Arbitrazhit të përbëhet nga tre arbitrarë të emëruar si më poshtë: (i) një arbitër do të caktohet nga Asociacioni; (ii) arbitri i dytë do të caktohet nga Pranuesi; dhe (iii) arbitri i tretë ("Kryearbitri") do të emërohet me marrëveshje të palëve, ose, në qoftë se ata nuk bien dakord, nga Kryetari i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë ose, në mungesë të emërimit nga Kryetari i lartpërmendur, nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara. Nëse ndonjëra nga palët dështon të emërojë arbitrin, arbitri i tillë do të emërohet nga Kryearbitri. Në rast se ndonjë arbitër i emëruar në përputhje me këtë Seksion jep dorëheqje, vdes ose bëhet i paaftë për të vepruar, arbitri pasardhës do të emërohet në të njëjtën mënyrë siç përshkruhet në këtë Seksion për emërimin e arbitrit fillestar dhe pasardhësi i tillë do të ketë të gjitha kompetencat dhe detyrat e arbitrit të tillë fillestar.

(d) Një procedurë arbitrazhi mund të iniciohet sipas këtij Seksioni pas njoftimit nga pala që e krijon procedimin e tillë drejt palës tjetër. Njoftimi i tillë duhet të përmbajë një deklaratë që parashtron natyrën e polemikave ose pretendimin që duhet të dorëzohet në arbitrazh, natyra e zgjidhjes së kërkuar dhe emrin e arbitrit të emëruar nga pala që inicion procedimin e tillë. Brenda tridhjetë ditëve pas njoftimit të tillë, pala tjetër njofton palën iniciuese të procedimit emrin e arbitrit të emëruar nga pala tjetër.

(e) Nëse brenda gjashtëdhjetë ditëve pas njoftimit të inicimit të procedimit të arbitrazhit, palët nuk kanë rënë dakord mbi një Gjyqtar, secila palë mund të kërkojë caktimin e një Gjyqtari, siç parashikohet në paragrafin (c) të këtij Seksioni.

(f) Gjykata e Arbitrazhit do të mblidhet në kohën dhe vendin i cili caktohet nga Gjyqtari. Pas kësaj, Gjykata e Arbitrazhit do të përcaktojë se ku dhe kur do të mblidhen.

(g) Gjykata e Arbitrazhit do të vendosë të gjitha pyetjet në lidhje me kompetencën e saj dhe, në përputhje me dispozitat e këtij Seksioni dhe përveç rasteve kur palët do të bien dakord ndryshe, do të përcaktojë procedurën e vet. Të gjitha vendimet e Gjykatës së Arbitrazhit do të jenë me shumicë votash.

(h) Gjykata e Arbitrazhit do t'iu ofrojë palëve një seancë të drejtë dhe do të japë vendimin e saj me shkrim. Vendimi i tillë mund të jepet automatikisht. Vendimi i nënshkruar nga shumica e Gjykatës së Arbitrazhit do të përbëjë vendimin e Gjykatës së Arbitrazhit. Ekzemplari i nënshkruar i vendimit do të dorëzohet për çdo palë. Çdo vendim i tillë i dhënë në përputhje me dispozitat e këtij Seksioni do të jetë përfundimtar dhe detyrues për palët në Marrëveshjen e Financimit. Secila palë do të përmbahet dhe të pajtohet me çdo vendim të tillë të dhënë nga Gjykata e Arbitrazhit, në pajtim me dispozitat e këtij Seksioni.

(i) Palët do të caktojnë shumën e shpërblimit të arbitrave dhe personave të tjerë të nevojshëm për kryerjen e procedurës së arbitrazhit. Nëse palët nuk bien dakord për shumën e tillë para se Gjykata e Arbitrazhit të mblidhet, Gjykata e Arbitrazhit do të caktojë shumën e cila do të ishte e arsyeshme sipas rrethanave. Secila palë do të mbuloj shpenzimet e veta në procedimet e arbitrazhit. Shpenzimet e Gjykatës së Arbitrazhit do të ndahen dhe mbulohen nga palët në mënyrë të barabartë. Çdo pyetje në lidhje me ndarjen e kostove të Gjykatës së Arbitrazhit ose procedurës për pagesën e shpenzimeve të tilla do të përcaktohen nga Gjykata e Arbitrazhit.

(j) Dispozitat për arbitrazh të përcaktuara në këtë Seksion zëvendësojnë ndonjë procedurë tjetër për zgjidhjen e kundërthënieve midis palëve në Marrëveshjen e Financimit ose ndonjë pretendim nga cilado palë kundër palës tjetër që lind sipas Marrëveshjes së Financimit.

(k) Nëse, brenda tridhjetë ditësh pasi ekzemplarët e vendimit u janë dorëzuar palëve, vendimi nuk është respektuar, secila palë mund: (i) të hyjë në gjykimin mbi, ose të iniciojë procedurë për të zbatuar vendimin në ndonjë gjykatë të juridiksionit kompetent kundrejt palës tjetër; (ii) zbatojë gjykimin e tillë me ekzekutim; ose (iii) të ndjekë ndonjë mjet tjetër të përshtatshëm kundër palës tjetër për zbatimin e vendimit dhe dispozitave të Marrëveshjes së Financimit. Pavarësisht nga e mësipërmja, ky Seksion nuk do të autorizojë asnjë hyrje të aktgjykimit apo ekzekutimit të vendimit ndaj Pranuesit, përveç nëse procedura e tillë mund të jetë në dispozicion në mënyra të tjera, përveç me dispozitat e këtij Seksioni.

(l) Dorëzimi i çdo njoftimi ose procesi në lidhje me çdo veprim sipas këtij Seksioni ose në lidhje me çdo procedurë për të zbatuar çdo vendim të dhënë në bazë të këtij Seksioni mund të bëhet në mënyrën e parashikuar në Seksionin 9.01. Palët në Marrëveshjen e Financimit heqin dorë nga çfarë do dhe të gjitha kërkesat e tjera për dorëzimin e ndonjë njoftimi apo procesi të tillë.

NENI VIII

Hyrja në fuqi; Ndërprerja

Seksioni 8.01. *Kushtet të cilat i paraprijnë hyrjes në fuqi të Marrëveshjeve Ligjore*

Marrëveshjet ligjore nuk hyjnë në fuqi përderisa Asociacionit nuk dorëzohen prova të kënaqshme që kushtet e specifikuar në paragrafët (a) deri në (c) të këtij Seksioni janë plotësuar.

(a) Ekzekutimi dhe zbatimi i çdo marrëveshjeje ligjore në emër të Përfituesit ose Entit Zbatues të Projektit i cili është palë në Marrëveshjen e tillë Ligjore janë autorizuar ose ratifikuar nga të gjitha veprimet e nevojshme qeveritare dhe të korporatave.

(b) Nëse Asociacioni ashtu kërkon, gjendja e Entit Zbatues të Projektit, siç iu është prezantuar ose garantuar Asociacionit në datën e Marrëveshjeve Ligjore, nuk ka pësuar asnjë ndryshim material negativ pas kësaj date.

(c) Çdo kusht tjetër i specifikuar në Marrëveshjen e Financimit si një kusht i efikasitetit të tij është përmbushur ("Kushti Shtesë i Efektivitetit").

Seksioni 8.02. *Mendimet apo certifikatat ligjore.*

Si pjesë e provave që duhet të jepen në pajtim me Seksionin 8.01, Asociacionit i parashtrohet një mendime ose mendime të kënaqshme për Asociacionin nga avokati i pranueshëm për Asociacionin, ose, nëse Asociacioni ashtu kërkon, një certifikatë të kënaqshme për Asociacionin nga zyrtari kompetent i Përfituesit, ku tregohen çështjet në vijim:

(a) në emër të Përfituesit dhe Entit Zbatues të Projektit, që Marrëveshja Ligjore në të cilën ajo është një palë ka qenë i autorizuar ose ratifikuar nga, dhe ekzekutuar dhe dorëzuar në emër të, palës së tillë dhe është ligjërisht detyruese ndaj palës së tillë në përputhje me kushtet e saj; dhe

(b) çdo çështje tjetër e përcaktuar në Marrëveshjen e Financimit ose në mënyrë të arsyeshme kërkohet nga Asociacioni, në lidhje me Marrëveshjet Ligjore për qëllim të këtij Seksioni ("Çështje Shtesë Ligjore").

Seksioni 8.03. *Data e hyrjes në fuqi*

(a) Përveç rasteve kur Përfituesi dhe Asociacioni bien dakord ndryshe, Marrëveshjet Juridike hyjnë në fuqi në datën kur Asociacioni i dërgon Përfituesit dhe Entit Zbatues të Projektit njoftimin e pranimit të saj të provave të kërkuara në pajtim me Seksionin 8.01 ("Data Efektive").

(b) Në qoftë se, para datës së hyrjes në fuqi, ndonjë ngjarje ka ndodhur e cila i jep të drejtën Asociacionit për të pezulluar të drejtën e Përfituesit për të bërë tërheqje nga Llogaria e Financimit nëse Marrëveshja e Financimit ka qenë efektive, Asociacioni mund të shtyjë dërgimin e njoftimit të përmendur në paragrafin (a) të këtij Seksioni derisa ngjarja e tillë (ose ngjarjet) ka pushuar së ekzistuari.

Seksioni 8.04. *Përfundimi i marrëveshjeve ligjore për shkak të dështimit të hyrjes në fuqi*

Marrëveshjet Ligjore dhe të gjitha detyrimet e palëve nën Marrëveshjet Ligjore do të përfundojnë nëse Marrëveshjet Ligjore nuk kanë hyrë në fuqi deri në datën ("Afati i Efektivitetit") e përcaktuar në Marrëveshjen e Financimit për qëllim të këtij Seksioni, përveç nëse Asociacioni, pas konsiderimit të arsyeve për vonesë, vendos një Afat të më vonshëm të Efektivitetit për qëllime të këtij Seksioni. Asociacioni menjëherë njofton Përfituesin dhe Entin Zbatues të Projektit për Afatin e tillë të mëvonshëm të Efektivitetit.

Seksioni 8.05. *Përfundimi i Marrëveshjeve Ligjore mbi Performancën e të Gjitha Detyrimeve*

(a) Në varësi të dispozitave të paragrafëve (b) dhe (c) të këtij Seksioni, Marrëveshjet Ligjore dhe të gjitha detyrimet e palëve nën Marrëveshjet Ligjore do të përfundojnë menjëherë pas pagesës së plotë të Bilancit të Kredisë së Tërhequr dhe të gjitha Pagesat e tjera detyruese të Financimit.

(b) Nëse Marrëveshja e Financimit specifikon një datë me të cilën dispozita të caktuara të Marrëveshjes së Financimit (përveç atyre për sigurimin e detyrimeve të pagesës) do të përfundojnë, dispozita të tilla dhe të gjitha detyrimet e palëve sipas tyre do të përfundojnë më herët se: (i) data e tillë; dhe (ii) data në të cilën Marrëveshja e Financimit përfundon në përputhje me kushtet e saj.

(c) Nëse Marrëveshja e Projektit specifikon një datë në të cilën Marrëveshja e Projektit do të përfundojë, Marrëveshja e projektit dhe të gjitha detyrimet e palëve sipas Marrëveshjes së Projektit do të përfundojnë më herët se: (i) data e tillë; dhe (ii) data në të cilën Marrëveshja e Financimit përfundon në përputhje me kushtet e saj. Asociacioni menjëherë do të njoftojë Entin Zbatues të Projektit, nëse Marrëveshja e Financimit përfundon në përputhje me kushtet e saj para datës së specifikuar në Marrëveshjen e Projektit.

NENI IX

Dispozitat e Ndryshme

Seksioni 9.01. *Njoftimet dhe Kërkesat*

Çdo njoftim ose kërkesë e kërkuar ose lejuar të jepet ose bëhet sipas ndonjë Marrëveshje Ligjore apo ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet palëve të parashikuara në Marrëveshjen Ligjore bëhen me shkrim. Përveç kur parashikohet ndryshe në Seksionin 8.03 (a), njoftimi ose kërkesa e tillë konsiderohet të jetë dorëzuar ose bërë kur ajo është dorëzuar me dorë ose me postë, teleks ose faks (ose, nëse lejohet sipas Marrëveshjes Ligjore, me anë të mjeteve të tjera elektronike) palës për të cilën kërkohet ose lejohet t'i jepet ose bëhet në adresën e palës të përcaktuar në Marrëveshjen Ligjore ose në adresën tjetër të palës si e ka caktuar me njoftim palën që e dorëzon njoftimin ose kërkesën e tillë.

Dërgesat e bëra me anë të faksit, gjithashtu do të konfirmohen me e-mail.

Seksioni 9.02. *Veprimet në emër të Përfituesit dhe Entit Zbatues të Projektit*

(a) Përfaqësuesi i caktuar nga Përfituesi në Marrëveshjen e Financimit (dhe përfaqësuesi i caktuar nga Enti Zbatues i Projektit në Marrëveshjen e Projektit) për qëllime të këtij Seksioni, apo çdo person i autorizuar me shkrim nga përfaqësuesi i tillë për këtë qëllim, mund të merr çdo veprim që kërkohet ose lejohet që të merret në bazë të një Marrëveshjeje të tillë Ligjore, dhe të nënshkruhen të gjitha dokumentet që kërkohen ose lejohen të nënshkruhen në pajtim me ato Marrëveshje Ligjore në emër të Përfituesit (ose Entit Zbatues të Projektit, siç mund të jetë rasti).

(b) Përfaqësuesi i caktuar në këtë mënyrë nga Përfituesi ose personi i autorizuar nga përfaqësuesi mund të bien dakord për çdo modifikim ose përforcim të dispozitave të Marrëveshjes së Financimit në emër të Përfituesit nga instrumenti me shkrim i nënshkruar nga përfaqësuesi i tillë ose personi i autorizuar; me kusht që, në mendimin e përfaqësuesit të tillë, modifikimi ose amplifikimi është i arsyeshëm sipas rrethanave dhe nuk do t'i rris ndjeshëm detyrimet e Përfituesit sipas Marrëveshjes së Financimit. Asociacioni mund të pranojë ekzekutimin nga përfaqësuesi i tillë apo personi tjetër i autorizuar të ndonjë instrumenti të tillë si dëshmi bindëse se përfaqësuesi i tillë është i mendimit të tillë.

Seksioni 9.03. *Dëshmia e Autoritetit*

Përfituesi dhe Enti Zbatues i Projektit i dorëzojnë Asociacionit: (a) prova të mjaftueshme rreth autoritetit të personit ose personave që, në emër të palës së tillë, do të ndërmarrin çfarëdo veprimi ose të nënshkruajnë çdo dokument që kërkohet ose lejohet të ndërmerret ose ekzekutohet nga ajo sipas Marrëveshjes Ligjore për të cilën ajo është një palë; dhe (b) nënshkrimi i vërtetuar i ekzemplarit nga çdo person të tillë.

Seksioni 9.04. *Nënshkrimi në Ekzemplarë*

Çdo Marrëveshje Ligjore mund të nënshkruhet në disa ekzemplarë, secila prej të cilave do të jetë një origjinal.

Seksioni 9.05. *Shpalosja*

Asociacioni mund të shpalosë Marrëveshjet Ligjore dhe çfarëdo informata të tjera lidhur me Marrëveshjet Ligjore në përputhje me politikën e saj mbi qasje ndaj informacionit, të cilat janë në fuqi në kohën e zbulimit të tillë.

ANEKSI

Përkufizimet

1. "Kushti Shtesë i Efektivitetit" nënkupton çdo gjendje të efektivitetit të specifikuar në Marrëveshjen e Financimit për qëllimin e Seksionit 8.01 (c).
2. "Ngjarja Shtesë e Përshpejtimit" nënkupton çdo ngjarje të nxitimit të specifikuar në Marrëveshjen e Financimit për qëllimin e Seksionit 6.06 (f).
3. "Ngjarja Shtesë e Pezullimit" do të thotë çdo rast i pezullimit të specifikuar në Marrëveshjen e Financimit për qëllimin e Seksionit 6.02(m).
4. "Çështje Shtesë Ligjore" nënkupton çdo çështje e specifikuar në Marrëveshjen e Financimit ose e kërkuar nga Asociacioni në lidhje me Marrëveshjet Ligjore për qëllimin e Seksionit 8.02 (b).
5. "Gjykata e Arbitrazhit" nënkupton gjykatën e arbitrazhit të themeluar në pajtim me Seksionin 7.03.
6. "Asociacioni" nënkupton Asociacionin Ndërkombëtar për Zhvillim.
7. "Adresa e Asociacionit" nënkupton Adresën e Asociacionit të specifikuar në Marrëveshjet Ligjore për qëllime të Seksionit 9.01.
8. "Banka" nënkupton Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim.
9. "Data e mbylljes" nënkupton datën e specifikuar në Marrëveshjen e Financimit (ose ndonjë datë më vonë si Asociacioni do të vendosë duke e njoftuar Përfituesin), pas të cilës Asociacioni mundet, me anë të një njoftimi drejtuar Përfituesit, të ndërpresë të drejtën e Përfituesit për tërheqje nga Llogaria e Financimit.
10. "Bashkë-financier" do të thotë financier (përveç Asociacionit apo Bankës) duke iu referuar në Seksionin 6.02 (h) ku parashihet Bashkë-financimi. Nëse Marrëveshja e Financimit specifikon më shumë se një financier të tillë, "Bashkë-financier" i referohet veçmas për secilin prej financierëve të tillë.
11. "Bashkë-financimi" do të thotë financimi i referuar në Seksionin 6.02 (h) dhe i specifikuar në Marrëveshjen e Financimit i paraparë apo të parashikohet për Projektin nga Bashkë-financieri. Nëse Marrëveshja e Financimit specifikon më shumë se një financim të tillë, "Bashkë-financimi" i referohet veçmas për secilin prej financimeve të tilla.
12. "Marrëveshja e Bashkë-financimit" nënkupton marrëveshjen që i referohet Seksionit 6.02 (h) duke parashikuar për Bashkë-financimin.

34. "Norma e Pagesës Maksimale të Përkushtimit" nënkupton normën maksimale të specifikuar në Marrëveshjen e Financimit në të cilën Asociacioni mund të përcaktojë Pagesën e Angazhimit në pajtim me Seksionin 3.01.
35. "Valuta e Pagesës" nënkupton Valutën e specifikuar në Marrëveshjen e Financimit në të cilën Pagesat Financiare do të paguhen në përputhje me Seksionin 3.07 (a).
36. "Data e pagesës" do të thotë secila datë e specifikuar në Marrëveshjen e Financimit që ndodh në ose pas datës së Marrëveshjes së Financimit në të cilën Pagesat e Shërbimit dhe Pagesat e Angazhimit janë të pagueshme.
37. "Parapagimi i Përgatitjes", do të thotë parapagimi i referuar në Marrëveshjen e Financimit dhe shlyerja në pajtim me Seksionin 2.07.
38. "Data e Pagesës së Kryegjësë" do të thotë çdo datë e specifikuar në Marrëveshjen e Financimit në të cilën një këst i shumës kryesore të Kredisë është i pagueshëm.
39. "Projekti" nënkupton projektin e përshkruar në Marrëveshjen e Financimit, për të cilin Financimi është dhënë, derisa përshkrimi i projektit të tillë mund të ndryshohet herë pas here me marrëveshje ndërmjet Përfituesit dhe Asociacionit.
40. "Marrëveshja e Projektit" nënkupton marrëveshjen ndërmjet Asociacionit dhe Entit Zbatues të Projektit në lidhje me zbatimin e të gjitha ose një pjese të projektit, dhe marrëveshja e tillë mund të ndryshohet kohë pas kohe. "Marrëveshja e Projektit" përfshin këto Kushte të Përgjithshme siç është aplikuar në Marrëveshjen e Projektit, dhe të gjitha anekset, shtojcat dhe marrëveshjet plotësuese të Marrëveshjes së Projektit.
41. "Enti Zbatues i Projektit" do të thotë një person juridik (përveç Përfituesit) i cili është përgjegjës për zbatimin e të gjitha ose një pjese të Projektit dhe i cili është një palë e Marrëveshjes së Projektit. Nëse Asociacioni hyn në një Marrëveshje Projektit me më shumë se një entitet të tillë, "Enti Zbatues i Projektit" i referohet veçmas secilit entitet të tillë.
42. "Adresa e Entit Zbatues të Projektit" nënkupton adresën e Entit Zbatues të Projektit të specifikuar në Marrëveshjen e Projektit për qëllimin e Seksionit 9.01.
43. "Përfaqësuesi i Entit Zbatues të Projektit" nënkupton përfaqësuesin e Entit Zbatues të Projektit të specifikuar në Marrëveshjen e Projektit për qëllimin e Seksionit 9.02 (a).
44. "Raporti i Projektit" nënkupton çdo raport për Projektin të përgatitet dhe t'i dërgohet Asociacionit për qëllimin e Seksionit 4.08 (b).
45. "Përfituesi" do të thotë anëtar i Asociacionit i cili është palë në Marrëveshjen e Financimit dhe për të cilin është shtrirë Financimi.
46. "Adresa e Përfituesit" do të thotë adresa e Përfituesit e specifikuar në Marrëveshjen e Financimit për qëllimin e Seksionit 9.01.
47. "Përfaqësuesi i Përfituesit" nënkupton përfaqësuesin e Përfituesit të përcaktuar në Marrëveshjen e Financimit për qëllimin e Seksionit 9.02.
48. "Pjesa Përkatëse e Projektit" nënkupton, për Përfituesin dhe për çdo Ent Zbatues të Projektit, pjesa e Projektit të përcaktuar në Marrëveshjet Ligjore që do të kryhen nga ai.

49. "Pagesa e Shërbimit" nënkupton pagesën e specifikuar në Marrëveshjen e Financimit për qëllimin e Seksionit 3.02.
50. "Angazhimi i Veçantë" do të thotë çdo angazhim i veçantë i llogaritur ose për t'u llogaritur nga Asociacioni sipas Seksionit 2.02.
51. "Të Drejta të Veçanta për Tërheqjeje " dhe "SDR" secila nënkupton të drejtën e veçantë të tërheqjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar siç është vlerësuar nga ajo në përputhje me Nenet e Marrëveshjes.
52. "Sterlina", "£" and "GBP" secila do të thotë valuta e ligjshme e Mbretërisë së Bashkuar.
53. "Taksat" përfshijnë tatimet, tarifat dhe detyrimet e çfarëdo natyre, qoftë në fuqi në datën e Marrëveshjes së Financimit qoftë e vendosur pas asaj date.
54. "Gjyqtar" do të thotë arbitri i tretë i emëruar në pajtim me Seksionin 7.03 (c).
55. "Bilanci i Patërhequr i Kredisë" nënkupton shumën e Kredisë së mbetur të patërhequr nga Llogaria e Kredisë nga koha në kohë.
56. "Bilanci i Patërhequr i Financimit" nënkupton shumën e Financimit të mbetur të patërhequr nga llogaria Financimit nga koha në kohë.
57. "Bilanci i Patërhequr i Grantit" nënkupton shumën e Grantit të mbetur të patërhequr nga llogaria e Grantit nga koha në kohë.
58. "Bilanci i Tërhequr i Kredisë" nënkupton shumën e Kredisë të tërhequra nga Llogaria e Kredisë dhe borxhi nga koha në kohë.
59. "Bilanci i Tërhequr i Grantit" nënkupton shumën e Grantit të tërhequra nga Llogaria e Grantit dhe borxhi nga koha në kohë.
60. "Yen", "¥" dhe "JPY" secila nënkupton valutën e ligjshme të Japonisë.

UDHËZIME
PROKURIMI
I MALLRAVE, PUNËVE DHE
SHËRBIMEVE JO-KONSULENTE
NË KUADËR TË HUAVE TË IBRD-së dhe
KREDIVE E GRANTEVE TË IDA-së
NGA HUAMARRËSIT E BANKËS BOTËRORE

Janar 2011

Tabela e përmbajtjes

I. HYRJE	71
Qëllimi	71
Konsiderata të përgjithshme.....	71
Zbatueshmëria e Udhëzimeve.....	72
Konflikti i Interesit.....	73
Pranueshmëria.....	74
Kontraktimi Paraprak dhe Financimi Retroaktiv	75
Ndërmarrjet e Përbashkëta	75
Shqyrtimi i Bankës.....	75
Keq prokurimi	75
Referenca për Bankën	76
Mashtrimi dhe Korrupsioni	76
Plani i prokurimit	78
II. TENDERI I HAPUR NDËRKOMBËTAR	79
A. Të përgjithshmet	79
Hyrje	79
Lloji dhe Madhësia e Kontratave	79
Oferta në Dy Faza	80
Njoftimi dhe Reklama.....	80
Parakualifikimi i Ofertuesve	81
B. Dokumentet e Ofertimit	82
Të përgjithshmet	82
Vlefshmëria e Ofertave dhe Sigurimi i Ofertës	83
Gjuha.....	83

Qartësia e Dokumenteve të Tenderit.....	84
Standardet	85
Përdorimi i Emrave të Markave	85
Çmimet.....	85
Rregullimi i Çmimit.....	86
Transporti dhe Sigurimi	87
Dispozitat e Valutës	87
Valuta e Ofertës	88
Konvertimi i Valutës për Krahasimin e Ofertës.....	88
Valuta e Pagesës	88
Termet dhe metodat e pagesës	88
Ofertat Alternative	89
Kushtet e Kontratës.....	89
Siguria e Ekzekutimit dhe Paratë e Mbajtura.....	89
Dëmet e Likuiduara dhe Klauzolat e Bonusit	90
Forca Madhore	90
Ligji i Aplikueshëm dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve	90
C. Hapja e Ofertës, Vlerësimi, dhe Dhënia e Kontratës	91
Koha për Përgatitjen e Ofertave.....	91
Procedurat e Hapjes së Ofertave	91
Sqarimet ose Ndryshimet e Ofertave	91
Konfidencialiteti	92
Ekzaminimi i Ofertave	92
Vlerësimi dhe Krahasimi i Ofertave	92
Preferencat vendore	93
Zgjatja e vlefshmërisë së ofertave.....	94
Kualifikimi pasues i ofertuesve.....	94

Dhënia e kontratës.....	94
Publikimi i dhënies së Kontratës.....	94
Refuzimi i të gjitha ofertave.....	95
Pas-informimi nga Huamarrësi	95
D. ICB-ja e ndryshuar	96
Operacionet që kanë programe importi.....	96
Prokurimi i komoditeteve	96
III. METODAT TJERA TË PROKURIMIT	97
IV. HYRJE	Error! Bookmark not defined.
Qëllimi	Error! Bookmark not defined.
Çështje të përgjithshme.....	Error! Bookmark not defined.
Vlefshmëria e udhëzimeve.....	Error! Bookmark not defined.
Konflikti i interesit.....	Error! Bookmark not defined.
Përparësia jo e drejtë konkurruese	Error! Bookmark not defined.
V. PËRZGJEDHJA E BAZUAR NË CILËSI DHE KOSTO (QCBS).....	Error! Bookmark not defined.
Procesi i përzgjedhjes	Error! Bookmark not defined.
Termet e referencës (TOR)	Error! Bookmark not defined.
Qartësimi apo ndryshimi i propozimeve.....	Error! Bookmark not defined.
Vlerësimi i propozimeve: shqyrtimi i cilësisë dhe kostos.....	Error! Bookmark not defined.
Vlerësimi i cilësisë.....	Error! Bookmark not defined.
Hapja e propozimeve financiare dhe vlerësimi i kostos.....	Error! Bookmark not defined.
VI. METODAT TJERA TË PËRZGJEDHJES.....	Error! Bookmark not defined.
Të përgjithshmet	Error! Bookmark not defined.
VII. LLOJET E KONTRATAVE DHE DISPOZITAT E RËNDËSISHME.....	Error! Bookmark not defined.
VIII. PËRZGJEDHJA E KONSULENTËVE INDIVIDUAL	Error! Bookmark not defined.

ANEKSI 1: SHQYRTIMI I PËRZGJEDHJES SË KONSULENTËVE NGA BANKA DHE PUBLIKIMI I DHËNIES SË KONTRATËS **Error! Bookmark not defined.**

ANEKSI 2: UDHËZIME KONSULENTËVE DHE TABELA E TË DHËNAVE (ITC) E KPP-së **Error! Bookmark not defined.**

ANEKSI 3: UDHËZIME KONSULENTËVE **Error! Bookmark not defined.**

Qëllimi **Error! Bookmark not defined.**

Përgjegjësia për përzgjedhjen e konsulentëve..... **Error! Bookmark not defined.**

Informatat mbi shërbimet e konsulencës **Error! Bookmark not defined.**

Roli i konsulentëve **Error! Bookmark not defined.**

Konfidencialiteti **Error! Bookmark not defined.**

Veprimi nga Banka **Error! Bookmark not defined.**

Shkurtesat

BOO	Build, own, operate - Ndërtojë, posedojë, operojë
BOOT	Build, own, operate, transfer - Ndërtojë, posedojë, operojë, transferojë
BOT	Build, operate, transfer - Ndërtojë, posedojë, transferojë
CDD	Community Driven Development - Zhvillimi i Nxitur nga Komuniteti
CIF	Cost, Insurance, and Freight - Kosto, Sigurim dhe Transport
CIP	Carriage and Insurance Paid (place of destination) - Transporti dhe Pagesa e Sigurimit (vendi i destinacionit)
CPT	Carriage Paid To (named place of destination) - Transporti i paguar për (vendi i quajtur i destinacionit)
DDP	Delivered Duty Paid – Pagesa e Detyrimit të Dorëzuar
EXW	Ex works, Ex factory, or Off the Shelf – Ish Punimet, Ish fabrika, ose jashtë raftit
FA	Framework Agreements - Marrëveshjet Kornizë
FCA	Free Carrier (named place) - Transporti pa pagesë (emri i vendit)
GNP	Gross National Product - Bruto Produkti Kombëtar
IBRD	International Bank for Reconstruction and Development (World Bank) - Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka Botërore)
ICB	International Competitive Bidding – Tenderimi i Hapur Ndërkombëtar
IDA	International Development Association - Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim
IFC	International Finance Corporation - Korporata Financiare Ndërkombëtare
LIB	Limited International Bidding - Tender i kufizuar Ndërkombëtar
MDTF	Multi Donor Trust Fund – Fond Besimi Multi donator
MIGA	Multilateral Investment Guarantee Agency - Agjencia për Garantimin e Investimeve Multilaterale
NCB	National Competitive Bidding - Tenderi i Hapur Kombëtar
NGO	Nongovernmental organization - Organizatë Joqeveritare
PAD	Project Appraisal Document - Dokumenti i Vlerësimit të Projektit
PID	Project Information Document - Dokumenti i Informacionit të Projektit
PPA	Project Preparation Advance - parapagim për përgatitje të projektit
PPP	Public Private Partnership - Partneriteti Publik Privat
PPR	Procurement Post Review - Shqyrtimi i Mëvonshëm i Prokurimit
SA	Special Account - Llogaria Speciale
SBDs	Standard Bidding Documents - Dokumentet Standarde të Tenderit
SWAp	Sector Wide Approach - Përfaqshet e Gjera Sektoriale
UCS	Use of Country Systems - Përdorimi i Sistemeve të Vendi
UN	United Nations - Kombet e Bashkuara
UNDB	United Nations Development Business – Zhvillimi i Biznesit të Kombeve të Bashkuara

I. HYRJE

Qëllimi

- 1.1 Qëllimi i këtyre Udhëzimeve është t'i informojë ata e kryejnë një projekt që është financuar në tërësi ose pjesërisht me një kredi nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), një kredi ose grant nga Asociacioni për Zhvillim Ndërkombëtar (IDA)¹⁰, një parapagim për përgatitje të projektit (PPA), një grant nga Banka, ose një fond besimi i administruar nga Banka dhe ekzekutuar nga përfituesi¹¹, nga politikat që qeverisin prokurimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve¹² jo-këshilluese të kërkuara për projektin. Marrëveshja e Kredisë rregullon marrëdhëniet juridike ndërmjet Huamarrësit dhe Bankës, dhe Udhëzimet janë bërë të zbatueshme për prokurimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve jo-këshilluese për projektin, siç parashikohet në marrëveshjen. Të drejtat dhe detyrimet e Huamarrësit dhe ofruesit të mallrave, punëve dhe shërbimeve jo-konsultuese për projektin rregullohen nga dokumentet e tenderit¹³, si dhe nga kontratat e nënshkruara nga Huamarrësi me ofruesit e mallrave, punimeve dhe shërbimeve jo-këshilluese, dhe jo nga këto Udhëzime apo Marrëveshje të Kredisë. Asnjë palë tjetër përveç palëve në Marrëveshjen e Kredisë do të nxjerrin ndonjë të drejtë prej tyre ose të kenë ndonjë pretendim për të ardhurat e kredisë.

Konsiderata të përgjithshme

- 1.2 Përgjegjësia për zbatimin e projektit, dhe kështu për dhënien dhe administrimin e kontratave sipas projektit, i takon Huamarrësit¹⁴. Banka, nga ana e saj, kërkohet nga Nenet e Marrëveshjes së saj të "të sigurojë që të ardhurat e çdo kredie janë përdorur vetëm për qëllimet për të cilat kredia është dhënë, me vëmendjen e duhur ndaj konsideratave të ekonomisë dhe efikasitetit dhe pa lidhje politike apo ndikimet dhe konsideratat tjera jo-ekonomike,"¹⁵ dhe ajo ka vendosur procedurat e detajuara për këtë qëllim. Ndërsa në praktikë rregullat specifike të prokurimit dhe procedurat që do të ndiqen në zbatimin e një projekti

¹⁰ Kërkesat e prokurimit të IBRD dhe IDA janë identike, dhe referencat në këto udhëzime për *Bankën* i përfshijnë të dyja *IBRD* dhe *IDA*, dhe referencat për "*kreditë*" përfshijnë kreditë e *IBRD* si dhe *IDA* kreditë ose grantet, PPP, grante nga Banka, dhe fondet e besimit të administruara nga Banka dhe ekzekutuara nga përfituesi.

Referencat në "*Marrëveshja për Kredi*" përfshijnë marrëveshje ligjore midis Bankës dhe Huamarrësit, dhe mund të përfshijnë marrëveshjen e projektit ndërmjet Bankës dhe entit zbatues të projektit.

Referencat në "*Huamarrës*" përfshijnë marrësit e kredisë, grantit dhe PPA që ekzekutojnë projekte të tilla, dhe mund të përfshijnë nën-huamarrësit ose entet zbatuese të projektit

¹¹ Për aq sa sigurimi i marrëveshjes për e fondet e besimit të administrohet nga Banka nuk bie ndesh me këto dispozita si përjashtime, duke përfshirë Marrëveshjen e Parimeve të Besueshmërisë (FPA) të UN-it ose Fondi Multi Donator i Besimit (MDTF) në situata emergjente

¹² Referencat në "mallrat" dhe "punimet" në këto Udhëzime përfshijnë shërbime të lidhura të tilla si transporti, sigurimi, instalimi, komisioni, trajnimi, dhe mirëmbajtja fillestare. "Mallrat" përfshijnë ato mallra si; materiale të papërpunuara, makineri, pajisje, automjete, dhe fabrikat industriale. Dispozitat e këtyre Udhëzimeve gjithashtu zbatohen edhe për shërbimet e jo-këshilluese për të cilët aspektet fizike të mbizotërimit të veprimtarisë, ofertohehen dhe kontraktohen në bazë të performancës së autputeve të matshme fizike, dhe për të cilat standardet e performancës mund të identifikohen qartë dhe të aplikohen në mënyrë konsistente, të tilla si shpimi, fotografi ajrore, imazhet satelitore, hartat dhe operacione të ngjashme. Këto Udhëzime nuk i referohen shërbimeve të konsulentëve (p.sh. këshilluese), për të cilat Udhëzimet aktuale: Përzgjedhja dhe Punësimi i Konsulentëve sipas Kredive të IBRD dhe IDA Kredive dhe Granteve nga Banka Botërore që Huamarrësit aplikojnë (referuar këtu si Udhëzimet e Konsulentëve)

¹³ Për qëllimet e këtyre Udhëzimeve, fjalët "oferta" dhe "tender" do të kenë kuptimin e njëjtë

¹⁴ Në disa raste, Huamarrësi vepron vetëm si një ndërmjetës, ndërsa projekti kryhet nga një agjenci tjetër apo entitet. Referencat në këto Udhëzime për Huamarrësit përfshijnë agjencitë dhe entitetet e tilla, si edhe Nën-Huamarrësit sipas në-huadhënie marrëveshjet

¹⁵ Nenet e Bankës për Marrëveshje, Neni III, Seksioni 5(b); dhe Nenet për Marrëveshje nga IDA, Neni V Seksioni 1(g)

varen nga rrethanat e rastit të veçantë, përgjithësisht katër konsiderata drejtojnë kërkesat e Bankës:

- (a) nevoja për ekonominë dhe efikasitetin në zbatimin e projektit, duke përfshirë prokurimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve jo-këshilluese;
- (b) interesi i Bankës në dhënien e të gjithë ofertuesve të pranueshëm nga vendet e zhvilluara dhe vendet në zhvillim¹⁶ informacione të njëjta dhe mundësi të barabarta për të konkurruar në ofrimin e mallrave, punëve dhe shërbimet jo-këshilluese të financuara nga Banka;
- (c) interesi i Bankës në inkurajimin e zhvillimit të kontraktimit të brendshëm dhe industritë prodhuese në vendin huamarrës; dhe
- (d) rëndësia e transparencës në procesin e prokurimit.

1.3 Konkurrenca e hapur është baza për prokurimet publike efikase. Huamarrësit do të zgjedhin metodën më të përshtatshme për prokurime specifike. Në shumicën e rasteve, Tenderimi Ndërkombëtar Konkurrues (ICB), administrohet siç duhet, dhe me ndihmë për preferencat për mallrat e prodhuara në vend dhe, kur është e përshtatshme, për kontraktorët¹⁷ vendas për punimet nën kushtet e përshkruara është metoda më e përshtatshme. Në shumicën e rasteve, për këtë arsye, Banka kërkon prej huamarrësve të saj për të marrë mallrat, punimet dhe shërbimet jo-këshilluese përmes ICB, e hapur për furnizuesit, ofruesit e shërbimeve dhe kontraktorët e pranueshëm¹⁸. Seksioni II i këtyre Udhëzimeve përshkruan procedurat për ICB.

1.4 Atëherë kur ICB nuk është metoda më e përshtatshme e prokurimit, mund të përdoren metodat e tjera të prokurimit. Seksioni III përshkruan këto metoda të tjera të prokurimit dhe rrethanat nën të cilat zbatimi i tyre do të ishte më i përshtatshëm. Metodat e veçanta që mund të ndiqen për prokurim sipas një projekti të caktuar janë të parashikuara në Marrëveshjen e Kredisë. Kontratat e veçanta që do të financohen në kuadër të projektit, si dhe metodat e tyre të prokurimit, në përputhje me Marrëveshjen e Kredisë, janë specifikuar në Planin e Prokurimit siç tregohet në paragrafin 1.18 të këtyre Udhëzimeve.

Zbatueshmëria e Udhëzimeve

¹⁶ Shih paragrafët 1.8, 1.9, dhe 1.10

¹⁷ Për qëllimet e këtyre Udhëzimeve, "Kontraktori" i referohet vetëm një firmë që ofrojnë shërbime të ndërtimit

¹⁸ Shih paragrafët 1.8, 1.9, dhe 1.10

- 1.5 Parimet, rregullat dhe procedurat e përcaktuara në këto Udhëzime zbatohen për të gjitha kontratat për mallrat, punimet dhe shërbimet jo-këshilluese të financuara në tërësi ose pjesërisht nga Kreditë Bankare¹⁹. Dispozitat e përshkruara në këtë Seksion I zbatohen për të gjitha Seksionet e tjera të Udhëzimeve. Për prokurimin e atyre kontratave për mallra, punimet dhe shërbimet jo-këshilluese jo të financuara në tërësi ose pjesërisht nga një kredi Bankare, por të përfshira në kuadër të projektit të marrëveshjes së kredisë, Huamarrësi mund të miratojë rregulla dhe procedura të tjera.

Në raste të tilla Banka do të jetë e kënaqur se procedurat që do të përdoren do të përmbushë detyrimet e Huamarrësit që të shkaktojnë projektin të kryhet me zell dhe në mënyrë efikase, dhe se mallrat, punimet dhe shërbimet jo-këshilluese që do të prokurohen:

- (a) janë të cilësisë së pranueshme dhe janë në përputhje me bilancin e projektit;
- (b) do të dorëzohen apo të përfundojë në kohën e duhur; dhe
- (c) i kanë ato çmime sa të mos ndikojnë negativisht në qëndrueshmërinë ekonomike dhe financiare të projektit.

Konflikti i Interesit

- 1.6 Politika e Bankës kërkon që një firmë që merr pjesë në një proces të prokurimit në projektet e financuara nga Banka nuk do të ketë konflikt të interesit. Çdo firmë e gjetur të ketë një konflikt të interesit do të jetë e papërshtatshme për dhënien e një kontrate.

- 1.7 Një firmë do të konsiderohet të ketë një konflikt të interesit në procesin e prokurimit, nëse:

- (a) firma e tillë që i siguron mallrat, punët, apo shërbimet jo-këshilluese që rrjedhin nga ose janë të lidhura drejtpërdrejt me shërbimet e konsulencës për përgatitjen ose zbatimin e një projekti që ka siguruar për ose është siguruar nga çdo filial që në mënyrë direkte ose indirekte kontrollon, kontrollohet nga , ose është nën kontroll të përbashkët me atë firmë. Kjo dispozitë nuk zbatohet për firmat e ndryshme (konsulentët, kontraktorët, ose furnizuesit), të cilat së bashku i kryejnë detyrimet e Kontraktuesit sipas një gardiani ose hartojnë dhe ndërtojnë kontratën²⁰; ose
- (b) firma e tillë paraqet më shumë se një ofertë, qoftë individualisht qoftë si një partner me një firmë tjetër, përveç ofertave alternative të lejuara. Kjo do të rezultojë me përjashtimin e gjitha kërkesave në të cilët Ofertuesi është përfshirë. Megjithatë, kjo nuk e kufizon përfshirjen e një firme si një nënkontraktor në më shumë se një ofertë. Vetëm për lloje të caktuara të prokurimit, pjesëmarrja e një ofertuesi, si një nënkontraktor në një ofertë tjetër mund të lejohet nëse nuk i nënshtrohet kundërshtimit të Bankave dhe siç lejohet nga Dokumentet Standarde Tenderuese të Bankës e të zbatueshme për llojet e tilla të prokurimit; ose
⁵⁰ Çmimi EXW do të përfshijë të gjitha detyrimet, shitjet, dhe taksat e tjera tashmë të paguara ose të pagueshme për komponentët dhe lëndës së parë të përdorura në prodhimin ose montimin e pajisjeve, të ofruara në ofertë. Mallra të përpunuara përfshijnë mallra të montuara.

⁵¹ Shih paragrafët 1.8, 1.9 dhe 1.10.

⁵² Mallrat në ofertat për kontrata gardian mund të ftohen në bazë të DDP (vendi i quajtur i destinacionit) dhe Ofertuesit duhet të jenë të lirë të zgjedhin marrëveshje më të mirë në mes të mallrave të importuara apo të mallrave të prodhuesve në vendin e Huamarrësit, në përgatitjen e ofertave të tyre.

pajisjeve, pavarësisht nga koha e dorëzimit dhe, në raste të tilla, dispozitat e rregullimit të çmimeve nuk janë të nevojshme.

- 2.25 Çmimet do të rregullohen nga përdorimi i një formule të caktuar (ose formula), e cila e then çmimin total në komponentë që janë të përshtatura nga indekset e çmimeve të specifikuara për secilin komponent. Formula (e) dhe data bazë për aplikim do të përcaktohet qartë në dokumentet e tenderit. Nëse valuta e pagesës është e ndryshme nga burimi i inputit dhe indeksi përkatës, një faktor korrigjimi do të zbatohet në formulën, për të shmangur rregullim të pasaktë. Nën rrethana të jashtëzakonshme, dokumentet e ofertimit mund të parashikojnë për rregullim të çmimeve në bazë të dëshmive të dokumentuara (duke përfshirë faturat aktuale) të ofruara nga furnizuesi ose kontraktori.

Transporti dhe Sigurimi

- 2.26 Dokumentet e ofertimit do të lejojnë furnizuesit dhe kontraktuesit të organizojnë transportin dhe sigurimin nga çdo burim i pranueshëm. Dokumentet e tenderit përcaktojnë llojet dhe kushtet e sigurimit të ofruar nga ofertuesi. Për të gjitha kontratat, zakonisht forma Gjithë Rreziku i politikës do të specifikohet. Për mallrat dhe për kontratat me përgjegjësi të vetme, dëmshpërblimi i pagueshëm nën sigurim të transportit do të jetë të paktën 110 për qind e CIP çmimit të mallrave të importuara në valutën e kontratës ose në një valutë lirshëm të konvertueshme për të mundësuar zëvendësimin të menjëhershëm të mallit të humbur apo dëmtuar. Për ndërtim të madh apo projektet e furnizimit dhe instalimit me disa kontraktorët në një vend, një "përmbyllje" ose marrëveshja e sigurimit total të projektit mund të merret nga Huamarrësi, ku Huamarrësi do të kërkojë konkurrencë për atë sigurim sipas procedurave të pranueshme për Bankën në qoftë se kosto e sigurimit do të financohet nga Banka.
- 2.27 Si një përjashtim, nëse Huamarrësi nuk dëshiron të marrë mbulim të sigurimit nëpërmjet kontratës, dhe dëshiron të bëjë rregullimet e veta ose të rezervoj transportin dhe sigurimin për kompanitë kombëtare apo burime të tjera të caktuara, do të sigurojë evidencë të kënaqshme për Bankën që (a) burimet janë të gatshme në dispozicion për pagesë të menjëhershme, në një valutë lirisht të konvertueshme në mesin e valutave të pagesës së kontratës, e dëmshpërblimeve që kërkohen për të zëvendësuar mallrat e humbura apo dëmtuara, dhe (b) rreziqet janë të mbuluara në mënyrë adekuate. Përveç kësaj, për importin e mallrave, ofertuesit nevojiten të japin kuotën e FCA (vendi i quajtur i dërgimit) ose CPT (vendi i quajtur i destinacionit)⁵³ çmimet përveç CIP (vendi i destinacionit) çmimi i specifikuar në paragrafin 2.21. Zgjedhja e ofertës më të ulët të vlerësuar, do të jetë mbi bazën e CIP (vendi i destinacionit) çmimi, por Huamarrësi mund të nënshkruajë kontratën në FCA ose CPT termat dhe të bëjë

⁵³ INKOTERMET 2010 për transport pa pagesë (vendi i quajtur) dhe për transportin e paguar për (vendi i quajtur i destinacionit), përkatësisht.

marrëveshjet e veta për transport dhe/ose sigurim. Në këto rrethana, financimi i Bankës do të jetë i kufizuar në FCA ose CPT koston e kontratës.

Dispozitat e Valutës

2.28 Dokumentet e tenderit përcaktojnë valutën apo valutat në të cilën ofertuesit do të deklarojnë çmimet e tyre, procedura për konvertimin e çmimeve të shprehura në valuta të ndryshme në një valutë të vetme për qëllim të krahasimit të ofertave, dhe valutave në të cilat çmimi i kontratës do të paguhet. Dispozitat e mëposhtme (paragrafët 2.29 - 2.33) janë të destinuara që (a) të sigurojnë që ofertuesit të kenë mundësinë për të minimizuar çdo rrezik të këmbimit në lidhje me valutën e ofertës dhe të pagesës, dhe kështu mund të ofrojnë çmimet e tyre më të mira; (b) të japin mundësi ofertuesve në vendet me valutat e dobëta për të përdorur një monedhë të fortë dhe në këtë mënyrë të sigurojnë një bazë të fortë për çmimin e ofertës së tyre; dhe (c) të sigurojë drejtësi dhe transparencë në procesin e vlerësimit.

Valuta e Ofertës

2.29 Dokumentet e ofertimit përcaktojnë se ofertuesi mund të shpreh çmimin e ofertës në çdo valutë. Nëse ofertuesi dëshiron të shprehë çmimin e ofertës si shuma e sasive në valuta të ndryshme të huaja, ata mund ta bëjnë këtë, me kusht që çmimi përfshin jo më shumë se tre valutat e huaja. Për më tepër, Huamarrësi mund të kërkojë nga ofertuesit që të deklarojnë pjesën e çmimit të ofertës që përfaqësojnë kostot lokale të shkaktuara në valutën⁵⁴ e vendit të Huamarrësit.

2.30 Në dokumentet e tenderit për punimet, Huamarrësi mund të kërkojë ofertuesve të deklarojnë çmimin e ofertës tërësisht në valutën vendase, së bashku me kërkesat për pagesat deri në tre valutat e huaja të zgjedhjes së tyre për inputet e pritura nga jashtë vendit të Huamarrësit, e shprehur si përqindje e çmimit të ofertës, së bashku me kursin e këmbimit të përdorura në këto llogaritje.

Konvertimi i Valutës për Krahasimin e Ofertës

2.31 Çmimi i Ofertës është shuma e të gjitha pagesave në valuta të ndryshme e kërkuar nga ofertuesi. Për qëllim të krahasimit të çmimeve, çmimet e ofertës do të konvertohen në një valutë të vetme të zgjedhur nga Huamarrësi (valuta vendase ose valuta e huaj plotësisht e konvertueshme) dhe të përcaktuar në dokumentet e tenderit. Huamarrësi do të bëjë këtë konvertim duke përdorur normat (shkëmbimi) e shitjes për ato monedhat e cituara nga një burim zyrtar (si Banka Qendrore), ose nga një bankë komerciale ose nga një gazetë me qarkullim ndërkombëtar për transaksione të ngjashme në një datë të përzgjedhur paraprakisht, burimi dhe data të specifikohen në dokumentet e tenderit, me kusht që data nuk do të jetë më herët se katër javë para afatit të fundit për pranimin e ofertave, as më vonë se data origjinale për skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës.

Valuta e Pagesës

2.32 Pagesa e çmimit të kontratës duhet të bëhet në valutën apo valutat në të cilën është kërkuar pagesa në ofertën e ofertuesit të suksesshëm sipas paragrafit 2.29.

2.33 Kur çmimi i ofertës kërkohet të përcaktohet në valutën vendase, por ofertuesi ka kërkuar pagesën në valuta të huaja të shprehura si përqindje e çmimit të ofertës,

⁵⁴ Tutje e referuar si valuta vendore

normat e këmbimit që do të përdoret për qëllime të pagesave do të jenë ato të specifikuar në ofertë nga ofertuesit, në mënyrë që të sigurojë që vlera e pjesëve të valutës së huaj të ofertës është ruajtur pa ndonjë humbje ose fitim.

Termet dhe metodat e pagesës

2.34 Kushtet e pagesës do të jetë në përputhje me praktikat ndërkombëtare tregtare që zbatohen për mallra, punimet dhe shërbimet jo-këshilluese të caktuara.

(a) Kontratat për furnizimin e mallrave do të parashikojnë për pagesën e plotë në dërgim dhe inspektim, nëse kërkohet, të mallrave të kontraktuara me përjashtim të kontratave që përfshijnë instalimin dhe komisionin, ku një pjesë e pagesës mund të bëhet pasi furnizuesi është në pajtueshmëri me të gjitha detyrimet e tij sipas kontratës. Banka zakonisht kërkon përdorimin e letrave të kredisë në mënyrë që të siguroj pagesën e shpejtë tek furnizuesi. Në kontratat e mëdha për pajisjet dhe impiantet, dispozita do të bëhet për parapagimet e përshtatshme dhe, në kontratat me kohëzgjatje të gjatë, për pagesat e progresit gjatë periudhës së prodhimit ose montimit.

(b) Kontratat për punimet do të ofrojnë në raste të përshtatshme për parapagimet e mobilizimit, parapagimet e pajisjeve dhe materialeve të kontraktorit, pagesat e rregullta të progresit, dhe sasi të arsyeshme të mbajtjes të lirohen mbi përputhjet me detyrimet e Kontraktuesit sipas kontratës.

2.35 Çdo parapagim për mobilizim dhe shpenzime të ngjashme, të bëra pas nënshkrimit të një kontrate për mallra, punimet, dhe shërbimet jo-këshilluese do të jetë e lidhur me shumën e vlerësuar të këtyre shpenzimeve dhe do të specifikohet në dokumentet e tenderit. Shumat dhe koha e parapagimeve të tjera që duhet të bëhen, si për materialet e dorëzuara në vend për inkorporim në punimet, gjithashtu do të specifikohet. Dokumentet e ofertimit do të specifikojnë rregullimet për çfarëdo sigurie të kërkuar për parapagimet.

2.36 Dokumentet e ofertimit do të specifikojnë metodën e pagesës dhe kushtet e ofruara, nëse metodat dhe kushtet alternative të pagesës do të lejohen dhe, nëse po, si do të ndikojnë këto termat në vlerësimin e ofertës.

Ofertat Alternative

2.37 Dokumentet e tenderit do të përcaktojnë qartë kur ofertuesit janë të lejuar të paraqesin ofertat alternative, si oferta alternative duhet të dorëzohen, si çmimet e ofertës duhet të ofrohen dhe baza mbi të cilët ofertat alternative do të vlerësohen.

Kushtet e Kontratës

2.38 Dokumentet e kontratës do të përcaktojnë qartë qëllimin e punës që duhet kryer, mallrat për t'u furnizuar, shërbimet që do të ofrohen, të drejtat dhe detyrimet e Huamarrësit dhe të furnizuesit ose kontraktorit, si dhe funksionet dhe autoriteti i inxhinierit, arkitektit, ose menaxherit të ndërtimit, nëse është i punësuar nga Huamarrësi, në mbikëqyrjen dhe administrimin e kontratës. Përveç kushteve të përgjithshme të kontratës, çdo kusht i veçantë për mallra, punimet dhe shërbimet jo-këshilluese të caktuara që do të prokurohen dhe lokacioni i projektit do të përfshihet.

Kushtet e kontratës do të sigurojnë një shpërndarje të ekuilibruar të rreziqeve dhe detyrimeve.

Siguria e Ekzekutimit dhe Paratë e Mbajtura

2.39 Kontratat për kontratat e punimeve dhe kontratat me përgjegjësi të vetme do të kërkojnë siguri në një sasi të mjaftueshme për të mbrojtur Huamarrësin në rast të shkeljes së kontratës nga kontraktori. Kjo siguri do të ofrohet në një formë dhe sasi të përshtatshme, ashtu siç është specifikuar nga Huamarrësi në dokumentin e tenderit⁵⁵. Shuma e sigurimit mund të ndryshojë, në varësi të llojit të sigurisë së furnizuar dhe mbi natyrën dhe intensitetin e punimeve apo të objekteve. Një pjesë e kësaj sigurie do të shtrihet mjaft përtej datës së përfundimit të punimeve apo të objekteve për të mbuluar përgjegjësinë defekteve apo periudhën e mirëmbajtjes deri në pranimin përfundimtar nga Huamarrësi. Kontratat për punimet mund të parashikojë për një përqindje të çdo pagese periodike që do të mbahet si paratë e mbajtjes deri në pranimin përfundimtar. Kontraktorët mund të lejohen të zëvendësojnë paratë e mbajtjes me një siguri ekuivalente në formën e një sigurie Bankare ose garancionit pas pranimit të përkohshëm.

2.40 Në kontratat për furnizimin e mallrave, nevoja për sigurimin e ekzekutimit varet nga kushtet e tregut dhe praktika tregtare për lloj të veçantë të mallrave. Furnizuesve apo prodhuesve mund t'i kërkohej të sigurojnë një siguri në një sasi të përshtatshme dhe të arsyeshme për t'u mbrojtur ndaj moskryerjes së kontratës. Sigurimi, nëse kërkohet, do të mbulojë edhe detyrimet e garancisë dhe çdo kërkesë të instalimit apo komisionit në përputhje me SBD të aplikueshme.

Dëmet e Likuiduara dhe Klauzolat e Bonusit

2.41 Dispozitat për dëmet e likuiduara ose dispozita të ngjashme në një sasi të përshtatshme do të përfshihet në kushtet e kontratës, kur vonohen në shpërndarjen e mallrave, përfundimin e punimeve apo dështimi i mallrave, punimeve, dhe shërbimeve jo-këshilluese për të përmbushur kërkesat e performancës do të rezultojë në kosto shtesë, ose humbje e të ardhurave ose humbjes së përfitimeve të tjera për Huamarrësin. Dispozita gjithashtu mund të bëhet edhe për një bonus që t'i paguhet furnizuesve apo kontraktorëve për përfundimin e punimeve ose shpërndarjen e mallrave para datës së specifikuar në kontratë, ku ky përfundim apo shpërndarje e mëhershme do të jetë në dobi të Huamarrësit.

Forca Madhore

2.42 Kushtet e kontratës do të përcaktojnë se dështimi nga ana e palëve për të kryer detyrimet e tyre sipas kontratës nuk do të konsiderohet vonesë në qoftë se dështimi i tillë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore, siç përcaktohet në kushtet e kontratës.

Ligji i Aplikueshëm dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

2.43 Kushtet e kontratës do të përfshijë dispozitat që kanë të bëjnë me ligjin e zbatueshëm dhe forumin për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Arbitrazhi ndërkombëtar komercial në një vend neutral ka avantazhe praktike mbi metodat e tjera për zgjidhjen e

⁵⁵ Format i sigurisë së ekzekutimit duhet të jetë në përputhje me dokumentet standarde të tenderit dhe duhet lëshuar nga një bankë ose institucion financiar me reputacion, si kompania e sigurimit, lidhjes ose garancionit, e përzgjedhur nga ofertuesi. Nëse siguria është lëshuar nga një institucion financiar i ndodhur jashtë vendit të Huamarrësit, institucioni financiar do të ketë një institucion financiar korrespondent të vendosur në vendin e Huamarrësit për të bërë atë të zbatueshëm. Ofertuesit do të lejohen të paraqesin garanci bankare të lëshuara direkt nga Banka e zgjedhjes së tyre e vendosur në çdo vend të pranueshëm

mosmarrëveshjeve. Për këtë arsye, Banka kërkon që Huamarrësit të përdorin këtë lloj të arbitrazhit në kontratat për prokurimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve jokëshilluese përveç nëse Banka ka rënë dakord në mënyrë specifike që të heqë dorë nga kjo kërkesë për shkaqe të justifikuara siç janë rregulloret ekuivalente kombëtare dhe procedurat e arbitrazhit, ose kontrata është dhënë për një ofertues nga vendi e Huamarrësit. Banka nuk do të emërohet arbitri apo të kërkohet që të emërojë një arbitër⁵⁶. Në rastin e kontratave për punë, kontratave për furnizim dhe instalim, dhe kontratave me përgjegjësi të vetme (duke përfshirë gardian), dispozita zgjidhjes së mosmarrëveshjeve do të përfshijë mekanizma si bordet e rishikimit të mosmarrëveshjeve, ose gjykatësit, të cilat janë përcaktuar për të lejuar një zgjidhje të shpejtë të kontesteve.

C. Hapja e Ofertës, Vlerësimi, dhe Dhënia e Kontratës

Koha për Përgatitjen e Ofertave

2.44 Koha e lejuar për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertave do të përcaktohet me konsideratë të duhur të rrethanave të veçanta të projektit dhe madhësisë dhe kompleksitetit të kontratës. Përgjithësisht, jo më pak se gjashtë javë nga data e ftesës për ofertë ose data e disponueshmërisë së ofertimit, dokumenteve, cilado që është më vonë, do të lejohet për ICB. Ku punimet e mëdha ose artikuj komplekse të pajisjeve janë të përfshirë, kjo periudhë në përgjithësi do të jetë jo më pak se dymbëdhjetë javë për t'i mundësuar ofertuesit e mundshëm për të kryer hetime para se të dorëzojnë ofertat e tyre. Në raste të tilla, Huamarrësi është i inkurajuar që të thërras konferenca para-ofertuese dhe të organizojë vizita në terren. Ofertuesit do të lejohen që të dorëzojnë ofertat me postë ose me dorë. Huamarrësit gjithashtu mund të përdorin edhe sistemet elektronike që lejojnë ofertuesit për të paraqitur ofertat nëpërmjet mjeteve elektronike, me kusht që Banka është e kënaqur me përshtatshmërinë e sistemit, duke përfshirë, inter alia, që sistemi është i sigurt, ruan konfidencialitetin, integritetin dhe origjinalitetin e ofertave të dorëzuara, përdor një sistem të nënshkrimit elektronik ose ekuivalente për të mbajtur ofertuesit të detyruar në ofertat e tyre. Afati dhe vendi për dorëzimin e ofertave do të specifikohen në ftesën për të konkurruar.

Procedurat e Hapjes së Ofertave

2.45 Koha për hapjen e ofertave do të jetë i njëjtë si për afatin e fundit për dorëzimin e ofertave ose menjëherë⁵⁷ pas kësaj, dhe do të shpallet, së bashku me vendin për hapjen e ofertave, në ftesën për të konkurruar. Huamarrësi do të hapë të gjitha ofertat e pranuar nga deri në afatin e dorëzimit të ofertave në vendin e caktuar të përcaktuar në dokumentet e tenderit, pavarësisht nga numri i ofertave të pranuar deri në atë afat. Në hapjen e ofertave, Huamarrësi nuk do të diskutojë as për meritat e ndonjë ofertuesi e as për refuzim. Ofertat do të hapen në publik; Ofertuesit ose përfaqësuesit e tyre do të jenë të lejuar të jenë të pranishëm (personalisht ose online, kur Ankandi elektronik është përdorur). Emri i ofertuesit dhe shuma totale e çdo oferte, dhe të ndonjë oferte alternative, nëse ata kanë qenë të kërkuara ose të lejuara, do të lexohen me zë të lartë (dhe postuar në internet kur Ankandi elektronik është përdorur) dhe regjistrohen kur u

⁵⁶ Është e kuptueshme, megjithatë, se zyrtarët e Qendrës Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve (ICSID) do të mbetet e lirë për të emëruar arbitra në kapacitetin e tyre si zyrtarë të ICSID.

⁵⁷ Për të lejuar kohë të mjaftueshme për të marrë ofertat në vendin e njoftuar për hapjen e ofertës publike.

hap dhe një kopje e këtij procesverbali duhet dërgohet menjëherë për Bankën dhe për të gjithë ofertuesit që kanë dorëzuar oferta me kohë. Ofertat e pranuar pas kohës së përcaktuar, si edhe ato që nuk hapen dhe lexohen në hapjen e ofertave, nuk do të konsiderohen.

Sqarimet ose Ndryshimet e Ofertave

2.46 Përveç kur parashikohet ndryshe në paragrafët 2.63 dhe 2.64 të këtyre Udhëzimeve, Ofertuesve nuk do t'i kërkohet ose lejohet të ndryshojnë ofertat e tyre, duke përfshirë edhe ndonjë rritje apo ulje vullnetare në çmimet e ofertës, pas afatit të fundit për dorëzimin e ofertave. Huamarrësi do t'i kërkojë ofertuesve sqarime të nevojshme për të vlerësuar ofertat e tyre, por nuk do t'i kërkojë ose të lejojë ofertuesve të ndryshojnë substancën ose çmimin e ofertave të tyre pas hapjes së ofertave. Kërkesat për sqarimet dhe përgjigjet e ofertuesve duhet të bëhen me shkrim, në letër apo me sistem elektronik të kënaqshme për Bankën⁵⁸.

Konfidencialiteti

2.47 Pas hapjes publike të ofertave, informacioni në lidhje me shqyrtimin, sqarimin dhe vlerësimin e ofertave dhe rekomandimet lidhur me dhënien nuk do t'i zbulohet ofertuesve ose personave të tjerë që nuk janë zyrtarisht në këtë proces, deri në publikimin e dhënies së kontratës.

Ekzaminimi i Ofertave

2.48 Huamarrësi do të konstatojë nëse ofertat (a) plotësojnë kërkesat e specifikuar në paragrafin 1.8, 1.9 dhe 1.10 të këtyre Udhëzimeve, (b) janë nënshkruar si duhet, (c) janë shoqëruar nga sigurimet e kërkuara ose deklarata e kërkuar e nënshkruar siç specifikohet në paragrafin 2.14 të Udhëzimeve, (d) janë thelbësisht të përgjegjshëm për dokumentet e tenderit, and (e) janë ndryshe në përgjithësi, në rregull. Në qoftë se një ofertë, duke përfshirë në lidhje me sigurinë e kërkuar të ofertës, nuk është në thelb e përgjegjshme, që është në qoftë se ajo përmban devijime materiale apo rezerva për termat, kushtet, dhe specifikimet në dokumentet e ofertimit, ajo nuk do të konsiderohet më tutje. Ofertuesi as nuk do të lejohet e as të ftohet nga Huamarrësi për të korrigjuar ose tërhequr devijime materiale apo rezerva pasi Ofertat janë hapur⁵⁹.

Vlerësimi dhe Krahasimi i Ofertave

2.49 Qëllimi i vlerësimit të ofertave është për të përcaktuar koston për Huamarrës të çdo oferte në një mënyrë që lejon një krahasim mbi bazën e koston së tyre të vlerësuar. Subjekt i paragrafit 2.58, oferta me kosto më të ulët të vlerësuar⁶⁰, por jo domosdoshmërisht çmimi më i ulët të paraqitur, do të përzgjidhen për dhënien.

2.50 Çmimi i ofertës i lexuar në hapjen e ofertave do të rregullohet për të korrigjuar ndonjë gabim aritmetik. Gjithashtu, për qëllime të vlerësimit, do të bëhen rregullime për çfarëdo devijimi sasior jomaterial ose rezervimet. Dispozitat për rregullimin e çmimeve që zbatohen në periudhën e zbatimit të kontratës nuk do të merren parasysh në vlerësim.

⁵⁸ Shih paragrafin 2.44

⁵⁹ Shih paragrafin 2.50 lidhur me korrigjimet

⁶⁰ Shih paragrafin 2.52

- 2.51 Vlerësimi dhe krahasimi i ofertave do të jetë në çmimet e CIP (vendi i destinacionit) për furnizimin e mallrave⁶¹ të importuara dhe çmimet EXW, plus koston e transportit në vend dhe sigurimi në vendin e destinacionit, për mallrat e prodhuara brenda vendit të Huamarrësit, së bashku me çmimet për ndonjë, instalim, trajnim, komisionim, të nevojshëm dhe shërbime të tjera të ngjashme jo- këshilluese⁶².
- 2.52 Dokumentet e ofertimit gjithashtu do të specifikojnë faktorët relevant përveç çmimit të merren parasysh në vlerësimin e ofertave dhe mënyrën në të cilën ata do t'i aplikojnë për qëllim të përcaktimit të ofertës së vlerësuar më të ulët. Për mallrat dhe pajisjet, faktorët tjerë mund të merren në konsideratë, duke përfshirë, ndër të tjera, orarin e pagesës, kohën e dorëzimit, kostot operative, efikasitetin dhe pajtueshmërinë e pajisjeve, disponueshmërinë e shërbimit dhe pjesë rezervë, dhe trajnimin përkatës, sigurinë dhe përfitimet mjedisore. Faktorët tjerë përveç çmimit që do të përdoren për përcaktimin e ofertës së vlerësuar më të ulët, do të jenë, për aq sa praktike, të shprehur në terma monetarë në dispozitat e vlerësimit në dokumentet e tenderit⁶³.
- 2.53 Në kontratat e punimeve dhe gardian, kontraktorët janë përgjegjës për të gjitha detyrimet, taksat dhe detyrimet tjera⁶⁴, dhe ofertuesit do të marrë parasysh këta faktorë në përgatitjen e ofertave të tyre. Vlerësimi dhe krahasimi i ofertave do të jetë në këtë bazë. Vlerësimi i ofertave për punimet do të jetë në mënyrë rigoroze në terma monetare. Çdo procedurë nën të cilës ofertat e mësipërme ose të mëposhtme, një vlerësim i paracaktuar i vlerave të ofertave janë diskualifikuar automatikisht, nuk është e pranueshme. Nëse koha është një faktor kritik, vlera e përfundimit të hershëm të Huamarrësit mund të merret parasysh sipas kriterëve të paraqitura në dokumentet e tenderit, vetëm nëse kushtet e kontratës parashikojnë dënime proporcionale për mospajtueshmëri.
- 2.54 Huamarrësi përgatitë një raport të detajuar mbi vlerësimin dhe krahasimin e ofertave ku ceken arsyet specifike mbi të cilat është bazuar rekomandimi për dhënien e kontratës. Huamarrësit së paku sigurojnë të gjitha informatat e kërkuara në formularin standard të Raportit të Vlerësimit të ofertës lëshuar nga Banka, përveç informatave të tjera të cilat Banka i konsideron relevante.

Preferencat vendore

⁶¹ Huamarrësit mund të kërkojnë çmimet në bazat e CIF (dhe ofertat në krahasim më atë bazë të njëjtë) vetëm kur mallrat transportohen nga deti dhe mallrat nuk janë kontenerët. CIF nuk do të përdoret për ndonjë gjë tjetër përveç transportit detar. Në rastin e mallrave të prodhuara, nuk ka gjasa që zgjedhja e CIF do të jetë e përshtatshme, për shkak se këto mallra janë zakonisht kontenerët. CIP mund të përdoret për çdo lloj transporti, duke përfshirë transportin detar dhe transportin multimodal.

⁶² Vlerësimi i ofertave nuk do të marrë parasysh: (a) detyrimet doganore dhe taksat e tjera të vendosura mbi mallrat e importuara kanë cituar CIP (që janë ekskluzive nga detyrimet doganore); (b) shitjet dhe taksat e ngjashme të mbledhura në lidhje me shitjen ose shpërndarjen e mallrave.

⁶³ Përfundimisht, pesha relative mund të jepet kur specifikimet nuk mund të përcaktohen saktësisht, ose faktorët tjerë përveç çmimit nuk mundin gjithmonë të shprehen në terma monetarë siç mund të ndodhë për prokurimin e teknologjisë së ndërlikuar të informacionit dhe të teksteve.

⁶⁴ Përveç rastit kur dokumentet e tenderit specifikojnë ndryshe për disa kontrata gardiane (shih paragrafin 2.22)

- 2.55 Me kërkesë të Huamarrësit, dhe siç është përcaktuar në Planin e dakorduar të Prokurimit dhe në dokumentet e tenderit, në vlerësimin e ofertave mund të shfaqet një margjinë e preferencës për:
- (a) mallrat e prodhuara në vendin e Huamarrësit, kur krahasohen ofertat të cilat ofrojnë mallra të tilla me mallra të prodhuara jashtë shtetit; dhe
 - (b) punimet në vendet anëtare nën një prag të caktuar të GNP⁶⁵ për kokë banori, kur krahasohen ofertat nga kontraktorët e kualifikuar vendas me ata të firmave të huaja.
- 2.56 Ku lejohet preferenca për mallrat e prodhuara në vend apo për kontraktorët e brendshëm, për krahasimin dhe vlerësimin e ofertave aplikohen metodat dhe fazat e përcaktuara në Shtojcën 2 të këtyre Udhëzimeve.

Zgjatja e vlefshmërisë së ofertave

- 2.57 Huamarrësit kryejnë vlerësimin e ofertave dhe dhënien e kontratës brenda periudhës fillestare të vlefshmërisë së ofertës ashtu që zgjatjet të mos jenë të nevojshme. Një zgjatje e vlefshmërisë së ofertës, në qoftë se justifikohet nga rrethana të jashtëzakonshme, kërkohet me shkrim nga të gjithë tenderuesit para datës së skadimit. Zgjerimi bëhet për periudhën minimale të nevojshme për të përfunduar vlerësimin, për marrjen e miratimeve të nevojshme, dhe për dhënie të kontratës. Në rastin e kontratave me çmime fikse, kërkesa për zgjerimet e dytë dhe të mëvonshëm lejohen vetëm nëse Huamarrësi ka siguruar një mekanizëm të përshtatshëm, siç parashikohet në SBD-të përkatëse të Bankës për të rregulluar çmimin e kuotuar të ofertuesit fitues për të reflektuar ndonjë rritje në koston e inputeve për kontratë gjatë periudhës së zgjatjes. Kurdo që kërkohet një zgjatje e periudhës së vlefshmërisë së ofertës, Ofertuesve nuk u kërkohet dhe as u lejohet të ndryshojnë çmimin e kuotuar (bazë) ose kushtet tjera të ofertës së tyre. Ofertuesit kanë të drejtën të refuzojnë dhënien e një zgjerimi të tillë. Nëse dokumentet për ofertim kërkojnë sigurimin e ofertës, Ofertuesit mund të ushtrojnë të drejtën e tyre për të refuzuar të japin një zgjatje të tillë, pa humbur sigurimin e ofertës së tyre dhe së këndejmi edhe diskualifikimin e tyre, por atyre që do të jenë të gatshëm të zgjasin vlefshmërinë e ofertës së tyre do t'u kërkohet të sigurojnë një zgjerim të përshtatshëm të sigurimit të ofertës.

Kualifikimi pasues i ofertuesve

- 2.58 Nëse ofertuesit nuk janë parakualifikuar, Huamarrësi konstaton nëse ofertuesi, oferta e të cilit ka ofruar kosto më të ulët të vlerësuar, ka aftësinë dhe burimet në mënyrë që të kryejë kontratën në mënyrë efektive, ashtu siç është ofruar ofertë. Kriteret që duhet të plotësohen, përcaktohen në dokumentet e tenderit, dhe nëse ofertuesi nuk i plotëson ato, oferta refuzohet. Në një rast të tillë, Huamarrësi bën një përcaktim të ngjashëm edhe për ofertuesin tjetër të radhës.

Dhënia e kontratës

- 2.59 Huamarrësi jep kontratën, brenda periudhës së vlefshmërisë së ofertave, ofertuesit i cili plotëson standartet e duhura të aftësive dhe burimeve dhe oferta për të cilën është konstatuar se (i) është e përgjegjshme me dokumentet e ofertimit, dhe (ii) ofron koston më të ulët të vlerësuar⁶⁶. Ofertuesit nuk do t'i kërkohet dhe as t'i lejohet që, si kusht të dhënies, të merr

⁶⁵ Bruto produkti kombëtar, i definuar çdo vit nga Banka.

⁶⁶ I quajtur “ofertuesi më i ulët i vlerësuar” dhe “oferta më e ulët e vlerësuar”.

përsipër përgjegjësitë për punë që nuk janë përcaktuar në dokumentet e tenderit ose të modifikojë në mënyra të tjera ofertën e dorëzuar fillimisht.

Publikimi i dhënies së Kontratës

2.60 Ofertuesi kujdeset që të pasohet procedura për publikimin e dhënies e paraparë në paragrafin 7 të Shtojcës 1.

Refuzimi i të gjitha ofertave

2.61 Dokumentet e tenderit zakonisht parashohin që Huamarrësi mund të refuzojë të gjitha ofertat. Refuzimi i të gjitha ofertave është i arsyetuar kur ekziston mungesa e konkurrencës efektive, apo kur asnjë ofertë nuk është thelbësisht e përgjegjshme, ose kur asnjë ofertues nuk i plotëson kriteret e specifikuar për kualifikim, ose kur çmimi i ofertës më të ulët të vlerësuar fituese është ndjeshëm më i lartë se kostoja e azhurnuar e vlerësuar e Huamarrësit ose më e lartë se buxheti në dispozicion. Mungesa e konkurrencës nuk përcaktohet vetëm në bazë të numrit të ofertuesve. Edhe kur vetëm një ofertë të jetë dorëzuar, procesi i tenderimit mund të konsiderohet i vlefshëm, në qoftë se oferta është shpallur e kënaqshme, kriteret e kualifikimit nuk ishin padrejtësisht kufizuese, dhe çmimet janë të arsyeshme në krahasim me vlerat e tregut. Nëse të gjitha ofertat refuzohen, Huamarrësi shqyrton shkaqet të cilat arsyetojnë refuzimin e të gjitha ofertave dhe bën ndryshimet e duhura në dokumentet e tenderit)⁶⁷ para se të ri-ftojë ofertat. Rishikimi i kriterëve të kualifikimit mund të justifikohet vetëm kur ata të vendosur janë shumë të rreptë.

2.62 Nëse për shkaqe të justifikuara, ri-shpallja nuk është praktike ose refuzimi është për shkak se të gjitha ofertave ishin jo të përgjegjshme, mund të ftohen oferta të reja, me miratimin paraprak të Bankës, nga firmat fillimisht të para-kualifikuara, ose, në mungesë të parakualifikimit, nga të gjitha firmat që kanë blerë dokumentet fillestare për ofertim. Përfundimisht, kur arsyetohet, Banka mund të bie dakord për të ri-ftuar vetëm ato firma të cilat kanë parashtruar ofertat në instancën e parë.

2.63 Të gjitha ofertat nuk refuzohen dhe ofertat e reja nuk ftohen për ofertim të njëjtë vetëm me qëllim të sigurohen çmimet më të ulëta. Nëse oferta më e ulët e vlerësuar tejkalon vlerësimet e azhurnuara të kostos nga Huamarrësi dhe atë me një margjinë thelbësore, Huamarrësi hulumton shkaqet për koston e tepruar dhe shqyrton kërkimin e ofertave të reja, siç përshkruhet në paragrafët e mësipërm. Përndryshe, Huamarrësi mund të negociojë me ofertuesit më të ulët të vlerësuar për t'u përpjekur që të fitojë një kontratë të kënaqshme përmes një reduktimi në fushëveprimin dhe / ose një rindarje të rrezikut dhe përgjegjësisë që mund të reflektohet në uljen e çmimit të kontratës. Megjithatë, ulja e konsiderueshme në fushëveprim ose modifikim të dokumenteve të kontratës mund të ngre pas vetes ri-ofertimin.

2.64 Para refuzimit të të gjitha ofertave, kërkimit të ofertave të reja apo hyrjes në negociata me ofertuesit më të ulët të vlerësuar, kërkohet miratimi paraprak i Bankës.

Pas-informimi nga Huamarrësi

2.65 Në publikimin e dhënies së kontratës së përmendur në paragrafin 2.60 dhe paragrafin 7 të Aneksit 1, Huamarrësi specifikon se çdo ofertues i cili dëshiron të vërtetojë arsyet

⁶⁷ Ndryshimet e tilla mund të ndërlihen me fushëveprimin e kontratës, apo kriteret minimale të pas-kualifikimit (në mungesë të para-kualifikimit), ose dizajni dhe specifikacionet, etj. apo kombinimi i tyre.

se pse oferta e tij nuk ishte e përzgjedhura, duhet të kërkojë një shpjegim nga Huamarrësi. Huamarrësi siguron menjëherë me shkrim një shpjegim se pse oferta e tillë nuk ishte zgjedhur. Nëse ofertuesi kërkon një takim informativ, ai bartë të gjitha shpenzimet e tyre për të marr pjesë në takim të tillë pas-informues.

D. ICB-ja e ndryshuar

Operacionet që kanë programe importi⁶⁸

- 2.66 Ku huaja siguron financim për një program importi, ICB-ja me dispozita të thjeshtëzuara për reklamat dhe dispozita mund të përdoret për kontratat me vlerë të madhe, siç përcaktohet në Marrëveshjen e Huasë⁶⁹
- 2.67 Dispozitat e thjeshtësuara për njoftimin e prokurimit sipas ICB nuk kërkojnë një Njoftim të Përgjithshëm të Prokurimit. Njoftimet e veçanta të prokurimit duhet të futen në të paktën një gazetë me qarkullim kombëtar në vendin e Huamarrësit (ose në gazetën zyrtare, nëse ka ndonjë, ose në një faqe interneti të përdorur gjerësisht ose në portal elektronik me qasje të lirë kombëtare dhe ndërkombëtare), përveç *UNDB online* dhe faqes së jashtme të internetit të Bankës. Periudha e lejuar për dorëzimin e ofertave mund të reduktohet në katër javë. Ofertimi dhe pagesa mund të kufizohet në një valutë që përdoret gjerësisht në tregtinë ndërkombëtare.

Prokurimi i komoditeteve

- 2.68 Çmimet e tregut të mallrave, siç janë drithërat, ushqimi i kafshëve, vaj gatimi, lëndët djegëse, plehu, dhe metalet, luhaten, në varësi të kërkesës dhe ofertës në moment të caktuar. Shumë prej tyre kuotohen në tregjet e zhvilluara mallrave. Prokurimi shpesh përfshin çmime të shumta për sasi të pjesshme për të arritur sigurinë e furnizimit dhe blerje të shumta gjatë një periudhe kohore dhe për të përfituar nga kushtet e favorshme të tregut dhe për të mbajtur inventarin në nivel të ulët. Lista e ofertuesve të parakualifikuar mund të hartohet për të cilët lëshohen ftesa periodike. Ofertuesit mund të ftohen të japin kuotën e çmimeve të lidhura me çmimin e tregut në kohën e fillimit të dërgesave ose para fillimit të tyre. Vlefshmëria e ofertave është sa më e shkurtër të jetë e mundur. Për ofertim dhe pagesë, mund të përdoret një valutë e vetme, në të cilën mallit i caktohet çmimi në treg. Valuta përcaktohet në dokumentin e tenderit. Dokumentet e ofertimit mund të dërgohen me telex ose me faks ose oferta të dorëzuara me mjete elektronike, dhe në raste të tilla nuk kërkohet ose sigurimi i ofertës, ose jepet sigurimi i përhershëm i ofertës i vlefshëm për një periudhë të caktuar kohe, të dorëzuar nga ofertuesit e parakualifikuar. Aplikohen kushtet dhe formularët standard të kontratës në përputhje me praktikat e tregut.

⁶⁸ Gjithashtu shih paragrafin 3.12.

⁶⁹ Prokurimi i kontratave më të vogla zakonisht kryhet në përputhje me procedurat e ndjekura nga subjekti privat ose public i cili merret me importe, apo sipas praktikave të tjera të standardizuara tregtare të pranueshme për Bankën, ashtu siç përshkruhen në paragrafin 3.13.

III. METODAT TJERA TË PROKURIMIT

Të përgjithshmet

- 3.1 Ky seksion përshkruan metodat e prokurimit që mund të përdoren ku ICB-ja nuk do të ishte metoda më ekonomike dhe më efikase e prokurimit, dhe ku metoda të tjera konsiderohen si më të **qëlluara**⁷⁰ ose në rastin e paragrafit 3.20, kur Banka ka rënë dakord për përdorimin e sistemit të prokurimit publik të vendit huamarrës. Politikat e Bankës në lidhje me kufijtë e preferencës për mallrat, punë dhe kontrata për shërbime jo konsulentë të prodhuara në vend nuk vlejnë për metodat tjera të prokurimit, përveç ICB. Paragrafët 3.2 deri në 3.5 dhe paragrafi 3.7 përshkruajnë metodat që përdoren në përgjithësi në rendin zbritës të preferencës dhe paragrafët dhe metodat e përdorura në rrethana të veçanta.

Ofertimi i kufizuar ndërkombëtar

- 3.2 Ofertimi i kufizuar ndërkombëtar (LIB) është në thelb ICB me ftesë të drejtpërdrejtë pa konkurs të hapur. Kjo mund të jetë një metodë e përshtatshme e prokurimit ku (a) ekziston vetëm një numër i kufizuar i furnitorëve, ose (b) shkaqe të tjera të jashtëzakonshme mund të arsyetojnë devijimin nga procedurat e plota të ICB-së. Në kuadër të LIB-it, Huamarrësit kërkojnë oferta nga një listë e furnizuesve të mundshëm, e gjerë sa për të siguruar çmimet konkurruese, dhe e cila përfshin të gjithë furnizuesit, në raste ku ka vetëm një numër i kufizuar. Preferencat e brendshme nuk janë të zbatueshme në vlerësimin e ofertave në kuadër të LIB-it. Në të gjitha aspektet tjera, përveç shpalljes dhe preferencave, zbatohet procedura ICB, duke përfshirë publikimin e Dhënies së Kontratës siç tregohet në paragrafin 7 të Aneksit I

Ofertimi konkurrues kombëtar

- 3.3 **Tenderi i hapur kombëtar** (NCB) është procedura e tenderimit konkurrues e cila përdoret zakonisht për prokurimin publik në vendin e Huamarrësit, dhe mund të jetë metoda më e përshtatshme për prokurimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve jo-konsulente të cilat, për nga natyra apo fushëveprimi i tyre, kanë pak gjasa të tërheqin konkurrencën e huaj. Për të qenë e pranueshme për aplikim në prokurimin e financuar nga Banka, këto procedura shqyrtohen dhe ndryshohen⁷¹ sipas nevojës për të siguruar

⁷⁰ Kontratat nuk ndahen në njësi më të vogla për t'i bërë atom ë pak atraktive për procedura të ICB-së; çdo propozim për të ndarë kontratën në pako më të vogla kërkon miratimin (mos kundërshtimin) paraprak nga Banka.

⁷¹ Çfarëdo ndryshimi i tillë pasqyrohet në Marrëveshjen mbi huanë.

Banka mund të pajtohet, nëse kërkohet nga Huamarrësi, që dokumentet e ofertimit në kuadër të procedurave të NCB-së, të përfshihet një klauzolë me të cilën Banka nuk mund të financojë firma, individ, apo Shtet huamarrës të cilët janë nën dënimin e ndalesës së dhënies së kontratës dhe atë nga autoriteti përkatës gjyqësor i shtetit të

ekonominë, efikasitetin, transparencën dhe përputhshmërinë më të gjerë me dispozitat e përfshira në Seksionin I të këtyre Udhëzimeve⁷². NCB mund të jetë metoda më e përshtatshme e prokurimit ku pjesëmarrësit e huaj nuk pritet të jenë të interesuar për shkak të (a) madhësisë dhe vlerës së kontratës, (b) punët janë të shpërndara gjeografikisht ose të shpërndarë në kohë, (c) punët kërkojnë fuqi të madhe punëtore, ose (d) mallrat, punët dhe shërbimet jo-konsulente mund të ofrohen nga subjektet vendore me çmime më të ulëta se në tregun ndërkombëtar. Procedurat e NCB gjithashtu mund të aplikohen ku përparësitë e ICB-së minohen nga ngarkesat administrative ose financiare.

- 3.4 Teksti i plotë i konkursit publikohet në një gazetë kombëtare me tirazh të madh në gjuhën kombëtare, siç përcaktohet në paragrafin 2.15, ose në gazetën zyrtare me kusht që ajo është e qarkullimit të gjerë, ose në një faqe interneti të përdorur gjerësisht ose portal elektronik me qasje të lirë kombëtare dhe ndërkombëtare. Huamarrësi mund të publikojë një version më të shkurtër të tekstit të shpalljes, duke përfshirë informata minimale relevante, në shtypin kombëtar, me kusht që teksti i plotë jetë publikuar në të njëjtën kohë në gazetën zyrtare ose në një faqe interneti të përdorur gjerësisht ose portal elektronik me qasje të lirë kombëtare dhe ndërkombëtare. Ofertuesve të ardhshëm njoftimi u jepet me kohë të mjaftueshme për t'u mundësuar atyre që të marrin dokumente përkatëse. Dokumentet e tenderit mund të lëshohen në gjuhën kombëtare. Valuta e vendit të Huamarrësit në përgjithësi përdoret për qëllime të ofertave dhe të pagesës. Gjithashtu, dokumentet e tenderit duhet të ofrojnë udhëzime të qarta se si dorëzohen Ofertat, se si ofrohen çmimet, dhe kohën dhe vendin për dorëzimin e ofertave. Për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertave mundësohet kohë e mjaftueshme. Procedurat duhet të sigurojnë dhe të mundësojnë konkurrencë adekuate në mënyrë që të sigurohen çmime të arsyeshme, dhe metodat e përdorura në vlerësimin e ofertave dhe dhënien e kontratave duhet të jenë objektive dhe t'u komunikohen të gjithë ofertuesve në dokumentet e tenderit dhe nuk aplikohen në mënyrë arbitrare. Krahasimi i të gjitha ofertave dhe dhënia e kontratës mund të bazohet mbi koston totale në destinacion duke përfshirë të gjitha tatimet dhe taksat. Procedura duhet të përfshijë edhe hapjen publike të ofertave, publikimin e rezultateve të vlerësimit dhe të dhënies së kontratës sipas paragrafit 7 të Aneksit 1. Huamarrësit duhet të kenë një mekanizëm efektiv dhe të pavarur të ankesave për të lejuar ofertuesit që të ankohen dhe që ankesat e tyre të shtjellohen me kohë. Nëse firmat e huaja dëshirojnë të marrin pjesë në NCB atyre do t'u lejohet kjo mbi bazën e termave dhe kushteve që vlejné edhe për ofertuesit kombëtar.

Blerja e lirë (shoppingu)

- 3.5 Blerja e lirë është një metodë e prokurimit e bazuar në krahasimin e kuotimit të çmimeve të marra nga disa furnizues (në rastin e mallrave), nga disa kontraktorë (në rastin e punimeve ndërtimore), ose ofruesit e shërbimeve (në rastin e shërbimeve jo konsulente) me një minimum prej tre, për të siguruar çmimet konkurruese, dhe është një metodë e përshtatshme për të siguruar sasi të kufizuara të mallrave lirshëm në dispozicion ose mallrave me specifikime standarde me vlerë të vogël, ose punë të

Huamarrësith dhe në përputhje me ligjet e saj, me kusht që Banka të ketë konstatuar se firma, apo individ, janë përfshirë në mashtrim apo korrupsion dhe se procedura gjyqësore i ka dhënë firmës apo individit mundësinë e procesit të duhur.

⁷² Kjo metodë është e veçantë prej atyre në kuadër të Programit pilot të UCS të përshkruar në paragrafin 3.20.

thjeshta ndërtimore me vlerë të ulët⁷³ kur metodat më konkurruese nuk arsyetohen në bazë të kostos dhe efikasitetit. Nëse Huamarrësi nuk mund të sigurojë të paktën tre oferta, ajo i siguron Bankës arsye dhe arsyetim se pse nuk ka mund të shqyrtohet metoda tjetër konkurruese dhe të merr miratim (mos kundërshtim) para se të procedojë vetëm në bazë të përgjigjeve të marra tashmë. Kërkesat për kuotim duhet të tregojnë përshkrimin dhe sasinë e mallrave ose specifikacionin e punëve, si dhe datën e dëshiruar të liferimit (ose përfundimit)së bashku me kohën dhe vendin. Kuotimet mund të dorëzohen me letër, me faks, ose me mjete elektronike. Vlerësimi i kuotimeve ndjek të njëjta parime si ofertim i hapur. Termat e ofertës së pranuar inkorporohen në urdhër blerjen apo në kontratën afatshkurtër.

- 3.6 Një Marrëveshje Kornizë (MK) është një marrëveshje afatgjatë me furnitorët, kontraktuesit dhe ofruesit e shërbimeve jo-konsulente e cila përcakton termat dhe kushtet nën të cilat mund të bëhen prokurime specifike (thirrje) gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëveshjes. MK-të në përgjithësi bazohen në çmime të cilat ose pajtohen paraprakisht, ose përcaktohen në kohën e thirrjes - përmes konkurrencës ose procesit me të cilin lejohet rishikimi i tyre pa konkurrencë të mëtejme⁷⁴. FAS mund të lejohet si një alternativë ndaj metodave të Blerjes së lirë dhe NCB për: (a) mallrat që mund të prokurohen nga rafti, ose janë të përdorimit të zakonshëm me specifikimet standarde, (b) shërbimet jo konsulentë të cilat janë të natyrë të thjeshtë dhe jo-komplekse dhe mund të kërkohet kohë pas kohe nga agjencioni i njëjtë (ose agjencitë e shumta) të Huamarrësit; ose (c) kontratat me vlerë të vogël për punët në kuadër të operacioneve emergjente. Huamarrësi i paraqet Bankës për miratim rrethanat dhe arsyetimin për përdorimin e një MK, qasjen dhe modelin e caktuar të përvetësuar, procedurat e përzgjedhjes dhe dhënies, dhe termat dhe kushtet e kontratave. MK nuk kufizojnë konkurrencën e huaj, dhe duhet të jenë të kufizuara për një kohëzgjatje maksimale prej 3 vjetësh. Procedurat e MK-së të cilat vlejnjë për Projektin janë procedurat e Huamarrësit të cilat konsiderohet të jenë të pranueshme nga Banka, dhe përshkruhen në Marrëveshjen e Huasë. Shumat agregate maksimale për përdorimin e një MK përcaktohet në planin e prokurimit në përputhje me rreziqet, dhe në asnjë rast nuk duhet të jenë më të lartë se shuma maksimale e kombinuar (agregate) që vlen për NCB, dhe dakordohet me Bankën. MK ndjekë të gjitha parimet udhëzuese dhe procedurat e NCB-së në bazë të paragrafëve 3.3 dhe 3.4, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në procedurat për shpallje, konkurrencës së drejtë dhe të hapur, një mekanizëm efektiv dhe të pavarur të ankimit, si dhe kriteret transparente për vlerësim dhe përzgjedhje të ofertës. Publikimi i dhënies së MK ndjekë procedurën e përshkruar në paragrafin 7 të Aneksit 1.

⁷³ Për qëllime të blerjes së lirë dhe prokurimit nga agjencionet e OKB-së sipas paragrafit 3.10(c) të këtyre Udhëzimeve, kontrata me vlerë të vogël zakonisht nuk tejkalon \$100,000 për mallra dhe komoditete nga rafti ndërsa \$200,000 për punë të thjeshta ndërtimore. Pragjet që vlejnjë për çdo projekt definojnë në Planin e prokurimit.

⁷⁴ Huamarrësit kanë përvetësuar modele të ndryshme të MK me emra të ndryshëm. Ekzistojnë tre modele më të shpeshta, bazuar në metoda të hapura apo të mbyllura, një fazëshe apo dy fazëshe; (i) “MK e mbyllur” bazuar në kritere të para-definuara përfshirë ato për thënien e “thirrjes”, të nënshkruar me një apo më shumë furnitorë/kontraktues dhe mos lejimi i palëve të reja gjatë kohëzgjatjes së marrëveshjes; (ii) “MK e mbyllura” me kufizim për pale të reja por të kryer në dy faza: faza e parë për përzgjedhjen e më shumë se një furnitori/kontraktuesi, dhe faza e dytë kur të vendosen thirrjet me konkurrencë në mesin e furnitorëve/kontraktuesve të përzgjedhur në fazën e pare dhe kontrata i jepet ofertuesit më të ulët të vlerësuar, bazuar në çmimin e ofruar dhe kushtet e liferimit; dhe (iii) “MK e hapur” e cila gjithashtu ndjek një qasje dy fazëshe sipas modelit më lartë, por pa kufizime në pjesëmarrjen e palëve të reja.

Kontraktimi Direkt

- 3.7 Kontraktimi direkt është kontraktim pa konkurrencë (me burim të vetëm) dhe mund të jetë një metodë e përshtatshme në rrethanat e mëposhtme. Huamarrësi i parashtron Bankës për rishikim dhe miratim një arsyetim të detajuar, duke përfshirë edhe arsyeshmërinë për kontraktimin e drejtpërdrejtë në vend të një procesi konkurrues të prokurimit dhe bazën për rekomandimin e ndonjë firme të caktuar në të gjitha rastet e tilla, me përjashtim të kontratave nën kufirin e përcaktuar mbi bazën e rreziqeve dhe fushëveprimit të projektit, dhe të parapara me Planin e Prokurimit.
- (a) Një kontratë ekzistuese për mallrat, punimet dhe shërbimet jo-konsulente, të akorduar në përputhje me procedurat e pranueshme për Bankën, mund të zgjatet për mallrat, punimet dhe shërbimet jo-konsulente shtesë të një natyre të ngjashme. Në raste të tilla, Banka duhet të jetë e kënaqur që asnjë avantazh nuk mund të fitohet nga konkurrenca e mëtejme dhe se çmimet në kontratën e zgjeruar janë të arsyeshme. Dispozitat për një zgjatje të tillë, nëse konsiderohen si të mundshme paraprakisht, përfshihen në kontratën origjinale;
 - (b) standardizimi i pajisjeve ose pjesëve të këmbimit, për të qenë në përputhje me pajisjet ekzistuese, mund të arsyetojë blerjet shtesë nga furnizuesi fillestar. Në mënyrë që blerjet e tilla të arsyetohen, pajisje origjinale duhet të jetë e përshtatshme, numri i artikujve të rinj në përgjithësi duhet të jetë më pak se numri ekzistues, çmimi të jetë i arsyeshëm, dhe avantazhet e një tjetër prodhuesi ose burimi të pajisjeve duhet të jenë shqyrtuar dhe hedhur poshtë në baza të pranueshme të Banka;
 - (c) pajisjet e nevojshme nëse janë teknologji unike dhe mund të sigurohen vetëm nga një burim;
 - (d) prokurimi i mallrave të caktuara nga një furnizues i caktuar është thelbësor për të arritur performancën e kërkuar ose një garanci funksionale të pajisjeve, impianteve ose objektit;
 - (e) në raste të veçanta, siç janë, por të cilat nuk kufizohen vetëm në, përgjigje ndaj fatkeqësive natyrore dhe situatave emergjente të shpallura nga Huamarrësi dhe të njohura nga Banka; dhe
 - (f) në rrethanat të cilat janë në përputhje me dispozitat e paragrafit 3.10 për prokurim nga Agjencitë e Kombeve të Bashkuara.

3.8 Procedura për publikimin e kontratës përshkruhet në paragrafin 7 të Aneksit I.

Llogaria e detyruar

- 3.9 Llogaria e detyruar, për punë siç janë ndërtimi dhe instalimi i pajisjeve dhe për shërbime jo-konsulente të cilat kryhen nga departamenti i Qeverisë në shtetin e Huamarrësit duke përdorur personel dhe pajisje të vet⁷⁵, mund të jetë metodë e vetme

⁷⁵ Njësia ndërtimore në pronësi të qeverisë e cila nga aspekti menaxherial, ligjor apo financiar nuk është e pavarur mund të llogaritet si një njësi e Llogarisë së detyruar. Llogaria e detyruar përndryshe njihet si “fuqi punëtoare direkte”, “forca të departamentit” apo “punë direkte”.

praktike e prokurimit në rrethana të caktuara. Përdorimi i llogarisë së detyruar kërkon që Huamarrësi të përcaktojë shumën maksimale të agregate për përdorimin e Llogarisë së detyruar, për të cilat banka jep miratimin e saj (mos kundërshtimin), dhe aplikon të njëjta kontrolle rigorozë të cilësisë dhe inspektimit si për kontratat e dhënë palëve të treta. Llogaria e detyruar arsyetohet dhe mund të përdoret vetëm pas mos kundërshtimit të Bankës dhe atë në cilën do prej rrethanave vijuese:

- (a) Sasitë e ndërtimeve apo punëve të instalimit nuk mund të definohen më herët;
- (b) Punët ndërtimore dhe të instalimit janë të vogla dhe të shkapërderdhura apo në lokacione të largëta për të cilat firmat e kualifikuara ndërtimore kanë pak gjasa të ofertojnë me çmime të arsyeshme;
- (c) Punët ndërtimore dhe të instalimit duhet të kryhen pa ndërprerë punët në vazhdim e sipër;
- (d) rreziku i ndërprerjes së paevitueshme të punës mbulohet më mirë nga Huamarrësi sesa nga një kontraktuesi;
- (e) shërbimet e specializuara jo-konsulente siç janë incizime nga ajri dhe përgatitja e hartave, si çështje të ligjeve apo rregulloreve zyrtare të Huamarrësit për t'u marrë parasysh e që prekin sigurinë kombëtare, mund të kryhen vetëm nga degë të specializuara të Qeverisë; ose
- (f) riparime urgjente për të parandaluar dëme të mëtejshme, të cilat kërkojnë vëmendje të menjëhershme, ose punë që duhet të kryhen në zonat e prekura nga konflikti, ku firmat private nuk mund të jenë të interesuara.

Prokurimi nga Agjencitë e Kombeve të Bashkuara

3.10 Mund të ketë situata ku prokurimi direkt nga agjencionet⁷⁶ e Kombeve të Bashkuara (OKB), të cilat pasojnë procedurat e veta të prokurimit mund të jenë metodë më e qëlluar e prokurimit:

- (a) të sasive të vogla të mallrave lirshëm në dispozicion, kryesisht në fushat e arsimit dhe të shëndetësisë;
- (b) të mallrave të ndërlidhura me shëndetësi për trajtimin e njerëzve dhe kafshëve, duke përfshirë edhe vaksinat, barnat dhe farmaceutikët, pajisje preventive shëndetësore dhe pajisje kontraceptive, dhe pajisje biomjekësore, me kusht që:
 - (i) numri i furnizuesve të jetë i kufizuar;
 - (ii) agjencia e OKB-së është e vetme ose jashtëzakonisht e kualifikuar që të prokurojë mallrat e tilla ose shërbime të ndërlidhura jo-konsulente; dhe
 - (iii) Huamarrësi përdor formën standarde të Marrëveshjes ndërmjet Huamarrësit dhe një agjencie të OKB-së për prokurimin e furnizimeve dhe ofrimit të disa shërbimeve të rënë dakord nga Banka;

⁷⁶ Një agjencion i Kombeve të Bashkuara i referohet ndonjë departamenti të Kombeve të Bashkuara, agjencioni të specializuar dhe zyreje të tyre rajonale (p.sh. PanAmerican Health Organization – PAHO), fondi apo programi. Huamarrësi i parshtron për miratim Bankës arsyetimin e plotë dhe draft formën e marrëveshjes me agjencionin e OKB-së.

- (c) të kontratave me vlerë të vogël (siç përcaktohet në fusnotën 64) për veprat e një natyre të thjeshtë kur agjencitë e OKB-së veprojnë si kontraktues, ose drejtpërsëdrejti punësojnë kontraktues të vegjël, dhe punëtorë të kualifikuar ose të pakualifikuar; ose
- (d) në raste të veçanta, siç është reagim ndaj fatkeqësive natyrore dhe situatave emergjente të deklaruara nga Huamarrësi dhe të pranuar nga Banka.

Agjentët e prokurimit dhe menaxherët e ndërtimit

3.11 Në rastet kur Huamarrësve u mungojnë organizatat, burimet, dhe përvoja e nevojshme, Huamarrësit mund të dëshirojnë (ose të kërkojnë nga Banka) që të punësojnë, si agjent të tyre, një firmë të specializuar në kryerjen e prokurimit. Menaxherët e ndërtimit mund të punësohen në mënyrë të ngjashme me honorar, p.sh., të kontraktojë punë të ndryshme që përfshijnë rindërtimin, riparimin, rehabilitimin, dhe ndërtime të reja në situata emergjente dhe post-konfliktuale, ose kur është fjala për një numër të madh të kontratave të vogla, ose kur kapaciteti i Huamarrësit është i kufizuar. Agjent të prokurimit ose menaxher të ndërtimit ndjekin të gjitha metodat e prokurimit të parashikuara në Marrëveshjen e Huasë dhe siç shtjellohen më tutje në Planin e Prokurimit të miratuar nga Banka në emër të Huamarrësit, duke përfshirë përdorimin e SBD-ve të Bankës, procedurave për shqyrtim dhe dokumentacionin. Kjo gjithashtu vlen edhe për rastet kur agjencionet e OKB-së veprojnë si agjentë të prokurimit. Huamarrësi përfshin masat për ngritje të kapaciteteve në kontratë, ashtu siç dakordohen me Bankën⁷⁷.

Shërbimet e inspektimit

3.12 Inspektimi para dërgesës dhe certifikimi i importeve është një prej masave mbrojtëse për Huamarrësin, veçanërisht kur vendi ka një program të madh të importit. Inspektimi dhe certifikimi zakonisht mbulon sasinë, cilësinë, dhe arsyeshmërinë e çmimit. Importet e prokuruar me anë të procedurave ICB nuk iu nënshtrohen verifikimit të çmimeve, por vetëm verifikimit të cilësisë dhe sasisë. Megjithatë, importet të cilat nuk prokurohen nëpërmjet ICB-së mund gjithashtu t'i u nënshtrohen verifikimit të çmimeve. Shërbimet e inspektimit fizik gjithashtu mund të përfshihen. Ofruesit e shërbimeve të inspektimit paguhen zakonisht për mbi një bazë të tarifës të vjelur mbi vlerën e mallit. Shpenzimet për certifikimin e importeve nuk merren parasysh në vlerësimin e ofertave me ICB.

Prokurimi në rastet e Huave institucioneve dhe subjekteve ndërmjetësuese financiare

3.13 Kur kredia siguron fonde për një institucion financiar ndërmjetës ose subjekteve (ose agjencioneve të emëruara prej saj), siç janë institucione kreditore bujqësore, kompanie për financim të zhvillimit apo fondit për zhvillim të infrastrukturës, i cili më tej iu

⁷⁷ Udhëzimet për konsulentë vlejné për përzgjedhjen e agjentëve të prokurimit dhe menaxherëve të ndërtimit, si dhe për ofruesit e shërbimeve të inspektimit. Kostoja apo honorari për agjentë të prokurimit dhe menaxherë të ndërtimit apo ofrues të shërbimeve të inspektimit (shih paragrafin 3.12) mund të financohet nga huaja e Bankës, nëse kjo parashihet në Marrëveshjen e huasë dhe në Planin e prokurimit, dhe me kusht që termat dhe kushtet e përzgjedhjes dhe punësimit janë të pranueshme për Bankën.

huazohet përfituesve siç janë individë, ndërmarrje të sektorit privat, ndërmarrje të vogla dhe të mesme, ose ndërmarrje autonome tregtare të sektorit publik për financimin e pjesshëm të nënprojekteve, prokurimi i mallrave, punimeve dhe shërbimeve jo-konsulente zakonisht bëhet nga përfituesit përkatës, në përputhje me metodat tashmë të standardizuara të prokurimit të sektorit privat apo praktikave komerciale të pranueshme për Bankën. Megjithatë, edhe në këto situata, ofertimi konkurrues ndërkombëtar i hapur ose i kufizuar mund të jetë metoda më e përshtatshme e prokurimit për blerjen e gjëseneve të mëdha të vetme ose në rastet kur sasi të mëdha të mallrave të ngjashme mund të grupohen së bashku për blerje ranfuz⁷⁸. Kur fondet e kredisë iu huazohen më tej përfituesve të sektorit publik apo janë për kontrata të mëdha dhe komplekse, merret parasysh aplikimi i metodave të prokurimit konkurrues të përcaktuara në këto Udhëzime. Nëse fondet huazohen për operationet në kuadër të Partneritetit Publiko-Privat (PPP), vlejnjë paragrafët 3.14 dhe 3.15 më poshtë. Dokumenti apo Doracak i përdorur për zbatim të projektit përshkruan parimet elementare udhëheqëse dhe procedurat e pranueshme të cilat vlejnjë për huanë. Këto parime përfshijnë, ndër të tjera, dispozitën ku ceket që përfituesit e huasë nuk u japin kontrata kompanive të tyre amë apo kompanive të ndërlidhura, përveç nëse nuk ekziston ndonjë marrëveshje sipas parimit ku këto dy subjekte nuk kanë interesa apo lidhje të përbashkëta (arm's-length). Dokumentacioni definon përgjegjësitë kryesore të institucioneve ndërmjetëse dhe subjekteve (apo agjencioneve të tyre të emëruara) siç janë: (a) vlerësimi i kapacitetit të përfituesve për kryerjen e planeve të prokurimit në mënyrë efikase; (b) aprovimin e planeve të pranueshme për prokurimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve jo-konsulente dhe për përzgjedhjen e konsulentëve, nëse ka nevojë; (c) dakordimi i arranzhmaneve për mbikëqyrje për çdo nën-hua (gjithnjë sipas dispozitave mbi huanë e Bankës) dhe atë për prokurimin që duhet të kryhet nga përfitues në mënyrë që të sigurohet përputhshmëri me metodat e dakorduara të sektorit privat dhe praktikave komerciale për nën-huatë; dhe (d) ruajtja e të gjitha shënimeve relevante për rishqyrtimin dhe auditimin pasues nga Banka, sipas kërkesës. Institucioni financiar ndërmjetës apo subjekti (apo agjencioni i emëruar) duhet të jenë të kënaqur mbi arsyeshmërinë e çmimeve të kontratave të dhënë nga përfituesit në tregun e caktuar, e nëse kërkohet, edhe me angazhimin e ndonjë subjekti apo auditori të pavarur.

Prokurimi sipas Marrëveshjeve për Partneritet publiko-privat (PPP)

- 3.14 Aty ku Banka po merr pjesë në financimin e kostos së një projekti ose një kontrate të prokuruar në bazë të marrëveshjeve të PPP-ve siç janë BOO/BOT/BOOT⁷⁹,

⁷⁸ Banka shqyrton metodat dhe procedurat e prokurimit dhe përzgjedhjen e konsulentëve të sektorit privat dhe praktikave tregtare në vendin e Huamarrësit për të përcaktuar pranueshmërinë e tyre. Procedurat dhe praktikave të sektorit privat nuk janë subjekt i mbikëqyrjes njëjtë si në rastin e shfrytëzimit të fondeve publike, dhe për këtë arsye janë të thjeshta me vetëm një pikë të vendimmarrjes dhe kërkojnë më pak dokumentacion. Banka normalisht njih procedurat të cilat së paku plotësojnë kushtet kombëtare të përcaktuara nga oda ekonomike, ndërmarrjet e përzgjedhura dhe të njohura të sektorit privat, banka qendrore, ose autoritetet për licencimin e importit dhe doganore. Nuk ka nevojë që Marrëveshja e huasë apo plani i prokurimit të përcaktojë pragjeve të vlerave të kontratave për shfrytëzimin e tyre, pavarësisht metodave specifike të miratuara të prokurimit dhe praktikave komerciale. Duke pasur parasysh natyrën e projekteve të tilla të shtyrë nga kërkesa, mund të mos jetë gjithmonë praktike të përgatiten Planet e prokurimit sipas paragrafit 1.18, sidomos kur zgjedhja e konsulentëve kryhet nga përfituesit. Planet e thjeshtëzuara të prokurimit, ku është e mundur dhe praktike, duhet të përgatiten në bazë të një liste indikativë të aktiviteteve të pranueshme për t'u zbatuar.

⁷⁹ BOO: Build, Own, Operate (ndërtimi, posedimi, funksionimi); BOT: Build, Operate, Transfer (ndërtimi, funksionimi, transferi); BOOT: build, own, operate, transfer (ndërtimi, posedimi, funksionimi, transferi).

koncesionet apo llojet e ngjashme të marrëveshjes të sektorit privat, aplikohet njëra prej procedurave të mëposhtme të prokurimit, ashtu siç parashihen në Marrëveshjen e Huasë dhe të shtjelluara më tej në planin e prokurimeve të miratuar nga Banka:

- (a) Koncesionari ose sipërmarrësi në kuadër të kontratës BOO / BOT / BOOT apo ndonjë lloj të ngjashëm të kontratës do të përzgjidhen nga Huamarrësi në bazë të procedurave të hapura konkurruese të tenderimit, të gjykuara si të pranueshme nga Banka⁸⁰, e cila mund të përfshijë disa faza, në mënyrë që të arrihet kombinimi optimal i kriterëve të vlerësimit, siç janë kostoja dhe madhësia e financimit të ofruar, specifikacionet e performancës të stabilimentit të ofruar, kostoja që i ngarkohet përdoruesit të skajshëm, të ardhura të tjera të krijuara për koncesionerin apo sipërmarrësin nga stabilimenti, dhe periudha e amortizimit të stabilimentit. Koncesionari ose sipërmarrësi në fjalë i përzgjedhur në këtë mënyrë atëherë do të jetë i lirë që të prokurojë mallrat, punimet dhe shërbimet konsulentë dhe jo-konsulente të nevojshme për objektin nga burimet e pranueshme, duke përdorur procedurat e veta. Në këtë rast, Dokumenti i Vlerësimit të Projektit (PAD) dhe Marrëveshja e huasë specifikojnë llojet e shpenzimeve të shkaktuara nga koncesionari apo sipërmarrësi në fjalë për të cilat do të vlejë financimi i Bankës.

Ose,

- (b) Nëse koncesionari apo sipërmarrësi në fjalë nuk është përzgjedhur në mënyrën e paraparë me nën-paragrafin (a) më lartë, mallrat, punët apo shërbimet jo konsulentë të nevojshme për stabilimentin dhe të cilat financohen nga Banka prokurohen në përputhje me procedurat ICB ose LIB për prokurimin me vlerë të madhe, ashtu siç definohet në Seksionin II dhe metodat tjera të përshatshme të prokurimit, të cilët gjykohen si të pranueshme nga Banka për kontrata me vlera të vogla dhe për shërbime konsulentë, në përputhje me Udhëzimet për konsulentë.

- 3.15 Pavarësisht dispozitave të paragrafit 3.14(b), Banka, në raste të jashtëzakonshme, mund të pranojë edhe zgjerime të shkallë së ulët të sistemeve ekzistuese i cili operohet nga ndonjë koncesionar apo sipërmarrës i cili ose është në pronësi private ose është një kompani në pronësi qeveritare, ndërsa kur një metodë e hapur konkurruese mund të mos jetë e nevojshme, aplikimi i metodave të prokurimit të kompanisë së tillë mund të lejohet, me kusht që: (i) subjekti i plotëson kriteret e paragrafit 1.10(b) të këtyre Udhëzimeve; (ii) Banka konstaton se kapaciteti për prokurim, praktikat dhe procedurat nga të cilat varet subjekti në punën e përditshme janë të pranueshme; (iii) në varësi prej dispozitave të paragrafit 1.7(a), subjekti nuk shfaq preferencë apo jep kontrata kompanive të saj amë apo degëve apo aksionarëve kontrollues; dhe (iv) procedurat për prokurim sigurojnë konkurrencë, ekonomi, efikasitet cilësi dhe transparencë të drejtë. Banka kryen shqyrtime pasuese periodike gjatë implementimit për t'u kënaqur që kapaciteti dhe praktikat mbesin të pranueshme dhe se procedurat e dakorduara për prokurim sipas huasë respektohen në tërësi.

Prokurimi i bazuar në performancë

⁸⁰ Për projektet siç janë rrugët me pagesë, tunelet, limanet, urrat, termocentralet, impiantet për hüdhe të mbeturinave si dhe ujësjellësit, Ofertimi i hapur konkurrues nënkupton: 1) ofertimin konkurrues ndërkombëtar, ose 2) ofertimi konkurrues kombëtar për kontratat për një shumë të vlerësuar nën pragun e përcaktuar nga Menaxherët regional të prokurimit. Përveç kësaj, mund të merren parasysh

- 3.16 Prokurimi i bazuar në performancë⁸¹, gjithashtu i njohur si Prokurimi i bazuar në output, i referohet proceseve konkurruese të prokurimit (ICB, LIB ose NCB) të cilat dalin nga marrëdhënia kontraktuese ku pagesat bëhen për outpute të matshme në vend të mënyrës tradicionale, ku maten inputet. Specifikacionet teknike definojnë rezultatin e dëshiruar dhe cilat outpute do të maten, përfshirë edhe mënyrën e matjes. Këto outpute synojnë të kënaqin një nevojë funksionale, si për nga cilësia dhe sasia ashtu edhe për nga besueshmëria. Pagesa bëhet në përputhje me sasinë e outputeve të ofruara, me kusht që ato ofrohen apo liferohen në nivelin e kërkuar të cilësisë. Uljet nga pagesat (apo ndalesat) bëhen për outpute me nivel më të ulët, dhe në disa raste, mund të paguhet edhe prime për outpute me nivele më të larta. Dokumentet e ofertimit zakonisht nuk i përcaktojnë inputet, dhe as metodën e punës së kontraktuesit. Kontraktuesi ka lirinë që të propozojë zgjidhjen më të qëlluar, bazuar në përvojën e pjekur dhe të dëshmuar dhe demonstroi se niveli i cilësisë, i përcaktuar në dokumentet e ofertimit mund të arrihet.
- 3.17 Prokurimi i bazuar në performancë (ose Prokurimi i bazuar në outpute) mund të ngërthejë në vete: (a) dispozitën që shërbimet jo-konsulente të paguhet në bazë të outputeve; (b) dizajnin, furnizimin, ndërtimin (apo rehabilitimin) dhe lëshimin në punë të një stabilimenti, i cili do të operohet nga Huamarrësi; ose (c) dizajnin, furnizimin, ndërtimin (apo rehabilitimin) e stabilimenti dhe ofrimin e shërbimeve jo-konsulente për punën dhe mirëmbajtjen, për një periudhë të caktuar të viteve pas lëshimit në punë⁸².

Prokurimi sipas Huave të garantuara nga Banka

- 3.18 Nëse Banka garanton shlyerjen e një kredie të bërë nga një huadhënës, punët, mallrat dhe shërbimet jo-konsulente të financuara nga kredia fjalë do të prokurohen me vëmendjen e duhur ndaj ekonomisë dhe efikasitetit dhe në përputhje me procedurat të cilat përmbushin kërkesat e paragrafit 1.5. Banka mund të kryejë një rishikim të transaksioneve të prokurimit sipas huasë pas mbylljes së tij.

Pjesëmarrja e komunitetit në prokurim

- 3.19 Kur, në interes të qëndrueshmërisë së projektit, apo për të arritur objektiva të caktuara specifike shoqërore të projektit, është e dëshirueshme që në komponentët e përzgjedhura të projektit të (a) bëhet thirrje për pjesëmarrjen e komuniteteve lokale dhe / ose organizatave joqeveritare (OJQ) në punët ndërtimore dhe në ofrimin e shërbimeve jo-konsulente, ose (b) të rritet shfrytëzimi i dijes lokale (know-how), mallrave dhe materialeve, ose (c) të aplikohen teknologji të punës intensive dhe teknologji të tjera të përshtatshme, atëherë procedurat e prokurimit, specifikacionet, dhe paketimi i kontratës përshtaten si duhet për të reflektuar këto konsiderata, me

⁸¹ Aplikimi i Prokurimit të bazuar në performancë në projektet e financuara nga Banka dakordohet me Bankën si rezultat i një analize të mirëfilltë teknike për opsionet e ndryshme në dispozicion, dhe definohe në PAD dhe inkomporohen në Planin e prokurimit.

⁸² Shembuj të llojit të tillë të prokurimit janë: (i) për rastin e prokurimit të shërbimeve: Sigurimi i shërbimeve mjekësore, pagesat për shërbime të veçanta, si vizita në zyre, apo testet laboratorike të përcaktuara, etj, (ii) për rastin e prokurimit të një objekti: dizajni, prokurimi, ndërtimi, dhe lëshimi në punë i një termocentral që vihet në punë nga Huamarrësi; (iii) për rastin e sigurimit të një stabilimenti apo shërbimeve: Projektimi, prokurimi, ndërtimi (ose Rehabilitimi) i një rruge dhe funksionimi dhe mirëmbajtja e rrugës për 5 (pesë) vjet pas ndërtimit.

kusht që këto të jenë të pranueshme për Bankën. Procedurat e propozuara dhe aktivitetet e projektit që do të kryhen nga pjesëmarrja e komunitetit përshkruhen në Marrëveshjen e Huasë dhe përpunohen më tej në planin e prokurimeve ose dokumente (apo Doracak) relevant të Zbatimit të Projektit të dokumentit të miratuar nga Banka dhe i bërë publikisht në dispozicion nga Huamarrësi. Duke pasur parasysh natyrën e projekteve Zhvillimore të nxitur nga komuniteti (CDD) të shtyrë nga kërkesa, mund të mos jetë gjithmonë praktike të përgatiten planet e detajuara të prokurimit në kohën e negociatave, siç kërkohet sipas paragrafit 1.18 për komponentin e projekteve CDD, sidomos kur prokurimi i aktiviteteve ose vetë aktivitetet kryhen drejtpërdrejt nga komuniteti. Planet e thjeshtësuara të prokurimit mund të përgatiten, nëse është praktike, bazuar në një listë indikativë të aktiviteteve të pranueshme për implementim⁸³.

Shfrytëzimi i sistemeve të shtetit

- 3.20 Shfrytëzimi i sistemeve të shtetit (USC) i referohet shfrytëzimit të procedurave dhe metodave të prokurimit të cilat aplikohen në sistemin publik të prokurimit në shtetin e Huamarrësit e për të cilat konstatohet se janë në përputhje me këto udhëzime dhe të pranueshme për Bankën dhe në kuadër të Programit provues të Bankës për shfrytëzimin e sistemeve të shtetit⁸⁴. Ato mund të shfrytëzohen nga Huamarrësit në projekte provuese të cilat janë miratuar nga Banka sipas Programit të tillë provues.

⁸³ Projektet CDD përgjithësisht parashikojnë një numër të madh të kontratave me vlerë të vogla për mallra dhe shërbimeve të konsulencës dhe jo-konsulencës, dhe një numër të madh të punimeve të vogla të shpërndara në zonat e largëta. Procedurat e prokurimit të përdorura zakonisht përfshijnë, blerje të lira, ofertimi lokal konkurrues ku ftohen ofertuesit e mundshëm të ofertojnë për mallra dhe punime që gjenden në dhe rreth komunitetit lokal, kontraktimin e drejtpërdrejtë për mallra me vlerë të vogël, punimeve dhe shërbimeve jo-konsulente dhe përdorimi i punës dhe burimeve të komunitetit. Dokumenti i Zbatimit të Projektit (ose Doracaku), siç përmendet në Marrëveshjen e Huasë, përshkruajë në detaje të mjaftueshme të gjitha marrëveshjet e prokurimit, metodat dhe procedurat, duke përfshirë rolet, përgjegjësitë dhe shkallën e pjesëmarrjes së komunitetit në përgjithësi (duke përfshirë, në rrethana të caktuara, edhe komisione të komunitetit për tenderë, siç mund të jenë të nevojshme), hapa të thjeshtësuara për të gjitha metodat e zbatueshme të prokurimit, dispozitat për ndonjë ndihmë teknike ose ndihmë tjetër të kërkuara nga komuniteti, procedurat e pagesës dhe procedurat për mbajtjen e shënimeve, forma të thjeshtuara të kontratave që do të përdoren, rolet dhe funksionet mbikëqyrës i agjencionit për zbatim etj. Arranzhmanet e Bankës për mbikëqyrje të prokurimit, duke përfshirë rishikimet teknike dhe financiare dhe kërkesat e auditimit, parashihen në PAD, në Marrëveshjen mbi huanë, Planin e thjeshtuar të Prokurimit, dhe Dokumentin për implementim të projektit (ose Doracakun). Fushëveprimi i auditimit duhet të mbulojë edhe verifikimin e cilësisë dhe sasisë së mallrave, punëve dhe shërbimeve të prokuruar dhe përdorimin e duhur të fondeve.

⁸⁴ Programi provues përshkruhet në punimin e Bordit të datës 3 mars dhe 25 mars 2008, me titull “Shfrytëzimi i sistemeve të shtetit në operacionet e mbështetura nga Banka: Programi i propozuar provues” (R2008-0036 dhe 0036 dhe 0036/1), të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve ekzekutivë të Bankës më 24 prill, 2008.

SHTOJCA 1: SHQYRTIMI I VENDIMEVE TË PROKURIMIT NGA BANKA DHE PUBLIKIMI I VENDIMIT MBI DHËNIEN E KONTRATËS

Orari i prokurimit

1. Banka shqyrton⁸⁵ Planin e prokurimit dhe azhurnimet e tyre të cilat përgatiten nga Huamarrësit në përputhje me dispozitat e paragrafit 1.18. Këto duhet të jenë në përputhje me Planin për implementim të projektit, Marrëveshjen e huasë dhe këto Udhëzime.

Shqyrtimi paraprak

2. Në lidhje me të gjitha kontratat⁸⁶, të cilat i nënshtrohen shqyrtimit paraprak të Bankës:
 - (a) Në rastet kur përdoret para-kualifikimi, Huamarrësi, para se të ftojë parashtrësit për para-kualifikim, i ofron Bankës draft dokumentet të cilat do të përdoren, përfshirë edhe tekstin e ftesës për para-kualifikim, pyetësoin për para-kualifikim, si dhe metodologjinë e vlerësimit, së bashku me një përshkrim të procedurave të shpalljes të cilat do të aplikohen, dhe kryen ndryshimet në procedura dhe dokumente të cilat Banka i kërkon në mënyrë të arsyeshme. Raporti me të cilin vlerësohen kërkesat e pranuar nga Huamarrësi, lista e ofertuesve të propozuar të para-kualifikuar, së bashku me deklaratat e kualifikimeve të tyre si dhe arsyet për përjashtimin e ndonjë ofertuesi nga para-kualifikimi, i dorëzohen Bankës për komente para se ofertuesit të mund të njoftohen me vendimin e Huamarrësit, ndërsa Huamarrësi bën plotësime dhe fshirje, apo ndryshime në listën në fjalë të cilat Banka i kërkon në mënyrë të arsyeshme.
 - (b) Para se të ftohen ofertat, Huamarrësi i ofron Bankës për komente, draftet e dokumenteve të ofertimit, përfshirë edhe ftesën për ofertim; udhëzime ofertuesve, përfshirë edhe bazën për vlerësim të ofertave dhe për dhënie të kontratës; si dhe kushtet e kontratës dhe specifikacionet për punët ndërtimore,

⁸⁵ Paragrafet 11 deri 15 të Aneksit III, përcakton veprimet e ndërmarra nga Banka si përgjigje ndaj komunikimeve me ofertues, përfshirë ankesat e ofertuesve, si dhe kërkesat e ofertuesve për bisedë pas procedurës.

⁸⁶ Pragjet e shqyrtimit paraprak shprehen në formë monetare, përcaktohen në bazë të rreziqeve të vlerësuara dhe cekën në Planin e prokurimit për të gjitha metodat e prokurimit që aplikohen për Huanë. Ato përfaqësojnë vlerën totale të kontratës, përfshirë të gjitha tatimet dhe ngarkesat, nëse paguhën sipas kontratës. Për kontratat të cilat prokurohen në bazë të kontraktimit direkt sipas paragrafit 3.7, Huamarrësi i parashtron Bankës për miratim kopje të specifikacioneve dhe draftin e kontratës para nënshkrimit të kontratës. Kontrata nënshkruhet vetëm pasi Banka e jep miratimin (mos kundërshtimin) e saj, ndërsa lidhur me kontratën e nënshkruar vlejnjë dispozitat e pikes (h) të këtij paragrafi.

furnizimin e mallrave, apo instalimin e pajisjes, etj. varësisht prej rastit, së bashku me një përshkrim të procedurave të shpalljes të cilat do të aplikohen gjatë ofertimit (nëse nuk është përdorur para-kualifikim), dhe bën ndryshimet në dokumente të tilla, të cilat Banka i kërkon në mënyrë të arsyeshme. Për çfarëdo ndryshime të tjera kërkohet miratimi i Bankës para se këto t'u lëshohen ofertuesve të mundshëm.

- (c) Pasi të jenë pranuar dhe vlerësuar ofertat, Huamarrësi, para marrjes së vendimit përfundimtar mbi dhënien e kontratës, i dorëzon Bankës në shqyrtim një raport të detajshëm (të përgatitur, nëse Banka e kërkon, nga ekspertë të pranueshëm për Bankën), lidhur me vlerësimin dhe krahasimin e ofertave të pranuara (për çdo fazë, në raste të ofertimit dy fazor dhe marrëveshjeve kornizë) së bashku me rekomandimet për dhënien dhe informata të tjera të cilat i kërkon Banka. Banka, nëse konstaton se dhënia e synuar e kontratës nuk do të ishte në përputhje me Marrëveshjen për huanë dhe/ose me Planin e prokurimit, informon pa vonesë Huamarrësin dhe cek arsyet e veta për një konstatim të tillë. Përndryshe, Banka jep miratimin për rekomandimin e dhënies së kontratës. Huamarrësi jep kontratën vetëm pasi të ketë marr miratimin e Bankës.
- (d) Nëse Huamarrësi kërkon një zgjatje të vlefshmërisë së ofertës për të përfunduar procesin e vlerësimit, për të marrë aprovimet e nevojshme të brendshme dhe të Bankës, dhe për të kryer dhënien e kontratës, ajo kërkon miratimin e Bankës për kërkesën e parë për zgjatje, nëse është më e gjatë se katër javë, dhe për të gjitha kërkesat pasuese për zgjatje, pavarësisht periudhës.
- (e) Nëse pas publikimit të dhënies Huamarrësi merr protesta apo ankesa nga ofertuesit, një kopje e ankesës, komenteve të Huamarrësit lidhur me çdo çështje të ngritur në ankesë, dhe një kopje të përgjigjes së Huamarrësit i dërgohet Bankës për shqyrtim dhe komente.
- (f) Nëse si rezultat i analizës së një proteste Huamarrësi ndryshon rekomandimin e vet për dhënien e kontratës, arsyet për një vendim të tillë dhe një raport të rishikuar të vlerësimit i dorëzohen Bankës për miratim. Huamarrësi kujdeset për ribotimin e dhënies së kontratës në Formatin e paragrafit 7 të Aneksit I të këtyre Udhëzimeve.
- (g) Termat dhe kushtet e një kontrate nuk duhet, pa miratimin paraprak të Bankës, të dallojnë materialisht nga ato me të cilat janë kërkuar Ofertat ose parakualifikimi i kontraktorëve, nëse ka të tilla.
- (h) Një kopje konformuar e kontratës, dhe e sigurisë mbi pagesën e avansit si dhe siguria e ekzekutimit nëse janë kërkuar, i dorëzohen Bankës menjëherë pas nënshkrimit të saj dhe përpara parashtrimit në Bankë të kërkesës së parë për tërheqjen e fondeve nga llogaria e kredisë në lidhje me kontratën e tillë. Kur pagesa për kontratë duhet të bëhen në një llogari të veçantë (SA), kopjet e kontratës, dhe siguria mbi pagesën e avansit dhe siguria e ekzekutimit, nëse janë kërkuar, i dorëzohen Bankës përpara kryerjes së pagesës së parë nga SA në lidhje me kontratën e tillë.

- (i) Të gjitha raportet e vlerësimit shoqërohen nga një përmbledhje e prokurimit në një formular të dhënë nga Banka. Përshkrimi dhe vlera e kontratës, së bashku me emrin dhe adresën e ofertuesit të suksesshëm, i nënshtrohen deklaramit publik nga Banka në pajtim me nën-paragrafin (h) më lartë pas marrjes së kopjes së nënshkruar të kontratës nga Huamarrësi .
 - (j) Huamarrësi ruan të gjithë dokumentacionin përkitazi me çdo kontratë gjatë implementimit të Projektit deri në dy vjet pas datës së mbylljes së Marrëveshjes së huasë. Dokumentacioni përfshin, por nuk kufizohet vetëm në: (i) origjinalin e nënshkruar të kontratës dhe të gjitha ndryshimet dhe plotësimet pasuese; (ii) ofertat origjinale, të gjitha dokumentet dhe korrespondenca e ndërlidhur me prokurimin dhe zbatimin e kontratës, përfshirë ato në mbështetje të vlerësimit të ofertave, si dhe rekomandimin për dhënie të bërë Bankës; dhe (iii) faturat apo dëftesat e pagesës, si dhe certifikatat për inspektim, dorëzim, kryerje apo pranim të mallrave, punëve dhe shërbimeve jo-konsulente. Për kontratat e dhënë në bazë të kontraktimit direkt, dokumentacioni përfshin arsyetimin për aplikimin e metodës, kapacitetin teknik dhe financiar të firmës, si dhe origjinalin e nënshkruar të kontratës. Huamarrësi i ofron Bankës një dokumentacion të tillë me kërkesë për shqyrtim nga Banka ose nga konsulentët/auditorët e saj.
 - (k) Banka mund të shpall keq-prokurimin për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.14 të Udhëzimeve, duke përfshirë edhe nëse konstaton se mallrat, punimet ose shërbimet konsulente për HMI nuk janë prokuruar në përputhje me procedurat e dakorduara dhe metodat e reflektuar në Marrëveshjen e Huasë dhe të detajuara më tej në Planin e Prokurimit për të cilat Banka ka dhënë miratimin e saj, ose se vetë kontrata nuk është në përputhje me procedurat e tilla. Banka informon menjëherë Huamarrësin për arsyet e një vendimi të tillë.
3. *Ndryshimet e kontratës së nënshkruar.* Në rastin e kontratave që i nënshtrohen rishikimit paraprak, para se të dakordohen për (a) një zgjatje materiale të kohës së përcaktuar për kryerjen e një kontrate, ose (b) ndryshime thelbësore në fushëveprimin e shërbimeve apo ndryshimeve të tjera të rëndësishme në termat dhe kushtet e kontratës, ose (c) çfarëdo urdhri për ndryshim apo amendamentim (përveç në rastet e urgjencës ekstreme) të cilat, veçmas apo të kombinuara me të gjitha urdhrat për variacion ose plotësimet e lëshuara më parë, rrisin shumën fillestare të kontratës për më shumë se 15 për qind, ose (d) ndërprerjen e propozuar të kontratës, Huamarrësi merr miratimin e Bankës. Nëse banka përcakton se propozimi është në kundërshtim me dispozitat e Marrëveshjes së Huasë dhe / ose planin e prokurimit, ajo informon menjëherë Huamarrësin dhe tregon arsyet për vendimin e saj. Një kopje e të gjitha amendamenteve të kontratës i dorëzohen Bankës për shënimet e saj.
4. *Përkthimet.* Nëse një kontratë e dhënë sipas procedurave ICB i nënshtrohet shqyrtimit paraprak dhe është e nënshkruar në Gjuhën kombëtare⁸⁷, Huamarrësi ka përgjegjësinë që Bankës t'i sigurojë përkthimin e saktë të raportit për vlerësim të ofertave dhe draftin e kontratës me initiale, në gjuhën e përdorur ndërkombëtarisht të cekur në dokumentet e ofertimit (gjuha angleze, franceze apo spanjolle). Përkthimet e sakta i sigurohen Bankës edhe në raste të ndryshimeve pasuese të kontratave të tilla.

Shqyrtimi pasues

5. Shqyrtimet pas prokurimit (SHPP) kryhen normalisht nga Banka. Huamarrësi mban të gjithë dokumentacionin në lidhje me çdo kontratë e cila nuk rregullohet nga paragrafi 2 i këtij Aneksi gjatë zbatimit të projektit dhe deri në dy vjet pas datës së mbylljes së Marrëveshjes së Huasë. Ky dokumentacion përfshin, por nuk kufizohet vetëm në, origjinalin e nënshkruar të kontratës dhe të gjitha ndryshimet ose plotësimet e mëvonshme, ofertat, raportet e vlerësimit të ofertave dhe rekomandimi për dhënie të kontratës, faturat apo dëftesat e pagesës, si dhe certifikatat për inspektim, dorëzim, kryerje dhe pranim të mallrave, punëve dhe shërbimeve jo-konsulente, për shqyrtim nga Banka dhe konsulentët/auditorët e saj. Huamarrësi gjithashtu jep dokumentacionin tjetër të cilin Banka mund ta kërkojë. Banka mund të shpall keq-prokurimin për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.14 të Udhëzimeve, duke përfshirë edhe nëse konstaton se mallrat, punimet ose shërbimet konsulente nuk janë prokuruar në përputhje me procedurat e dakorduara dhe metodat e reflektuar në Marrëveshjen e Huasë dhe të detajuara më tej në Planin e Prokurimit për të cilat Banka ka dhënë miratimin e saj, ose se vetë kontrata nuk është në përputhje me procedurat e tilla. Banka informon menjëherë Huamarrësin për arsyet e një vendimi të tillë. Gjithashtu, varësisht prej rrezikut dhe fushëveprimit të projektit (p.sh. nëse përfshin shumë kontrata të thjeshta dhe me vlerë të ulët), Banka mund të pajtohet me Huamarrësin që të emërojnë subjekte të pavarura për të kryer SHPP-në, në përputhje me termat, kushtet dhe procedurat e raportimit të pranueshme për Bankën. Në rastet e tilla, Banka shqyrton raportet e parashtruara nga Huamarrësi dhe e ruan të drejtën që të bëjë shqyrtimet pasuese vet dhe atë gjatë implementimit të projektit, sipas nevojës.

Ndryshimi nga Shqyrtimi pasues në Shqyrtimin paraprak

6. Një kontratë, vlerësimi i kostos i së cilës nën pragun e Bankës për shqyrtim paraprak të cekur në Planin e Prokurimit, biejnë në kuadër të shqyrtimit paraprak nëse çmimi i ofertuesit më të ulët të vlerësuar tejkalon pragun e tillë. I gjithë dokumentacioni lidhur me prokurimin i cili është përpunuar, duke përfshirë raportin e vlerësimit dhe rekomandimin për dhënien e kontratës, i dorëzohet Bankës për shqyrtim paraprak dhe për miratim para dhënies së kontratës. Kur, në të kundërtën, çmimi i ofertuesit të përzgjedhur bie nën pragun e shqyrtimit paraprak, procesi i shqyrtimit paraprak vazhdon. Në rrethana të caktuara, Banka mund të kërkojë që Huamarrësi të ndjek një proces të rishikimit paraprak për një kontratë nën pragun e Bankës për shqyrtim paraprak në rast të ankesës për të cilën konstaton se është e natyrës serioze. Gjithashtu, kur metoda e prokurimit kërkon ndryshim për shkak të vlerësimeve më të larta ose më të ulëta sesa kostoja e vlerësuar më parë, për shembull nga NCB në ICB apo anasjelltas, plani i prokurimit ndryshohet Huamarrësi dhe i dorëzohet Bankës për shqyrtim dhe mos kundërshtim.

Publikimi i njoftimit të dhënies së Kontratave

7. Huamarrësi publikon informatat në UNDB *online* për të gjitha kontratat sipas ICB dhe LIB, kontratat me koncesionarë sipas PPP dhe nën-projektet sipas Huave për institucione dhe subjekte ndërmjetëse financiare, dhe për të gjitha kontratat direkte

sipas këtyre Kushteve, ndërsa në shtypin kombëtar⁸⁸ për të gjitha kontratat në kuadër të NCB, përfshirë ato të dhënë në kuadër të Marrëveshjeve kornizë dhe në kuadër të Llogarisë së detyrueshme, dhe kontratat direkte të vlerës së ulët (shih fusnotën 64). Publikimi i tillë bëhen brenda dy javëve pas pranimit të miratimit nga Banka për rekomandimin e dhënies, për kontratat që i nënshtrohen shqyrtimit paraprak të Bankës, dhe brenda dy javëve për vendimet e Huamarrësit për dhënie të kontratës për kontratat të cilat i nënshtrohen shqyrtimit pasues. Publikimi përfshin numrin e ofertës dhe të lotit, si dhe informatat vijuese, të cilat janë relevante dhe vlejshme për çdo metodë: (a) emrin e çdo ofertuesi i cili ka parashtruar ofertë; (b) çmimet e ofertës të cilat janë lexuar në hapjen e ofertave; (c) çmimet e vlerësuara të çdo oferte e cila është vlerësuar; (d) emrat e ofertuesve, ofertat e të cilëve ose janë refuzuar si jo të përgjegjshme ose nuk i kanë përmbushur kriteret e kualifikimit, ose nuk janë vlerësuar për arsyet e tilla, dhe (e) emrin e ofertuesit fitues, çmimin e përgjithshëm final të kontratës, si dhe kohëzgjatjen dhe përmbledhjen e fushëveprimit të kontratës. Banka rregullon publikimin e njoftimit për dhënie të kontratave me shqyrtim paraprak në ueb faqen e vet të jashtme pas pranimit të kopjes së konformuar të kontratës së nënshkruar nga Huamarrësi dhe sigurinë e performancës, nëse është kërkuar, në përputhje me nën-paragrafin 2(h) më lartë.

Hulumtimi paraprak lidhur me Politikën dhe Procedurat e Bankës lidhur me dënimet

8. Kur bëhet vlerësimi i ofertave, Huamarrësi kontrollon përshtatshmërinë e ofertuesve nga listat e firmave dhe individëve të cilët janë ndaluar dhe suspenduar, në përputhje me paragrafin 1.16 (d) të këtyre Udhëzimeve dhe / ose paragrafin 1.23 (d) të Udhëzimeve për konsulentë, nga Banka, e të cilat janë postuar në faqen e internetit të jashtëm të Bankës. Huamarrësi kryen hulumtime të tjera paraprake (due diligence) duke bërë nga afër mbikëqyrjen dhe monitorimin e çfarëdo kontrate aktuale (qoftë me shqyrtim paraprak apo pasues) të firmës ose individit i cili është sanksionuar nga Banka, pas nënshkrimit të një kontrate të tillë. Huamarrësi nuk nënshkruan ndonjë kontratë të re dhe as ndryshim të ri, përfshirë çdo zgjatje të kohës për përfundim ose urdhër për ndryshim ose variacion, për kontrata në vazhdim e sipër me një firmë apo individ të pezulluar apo të përjashtuar pas hyrjes në fuqi të pezullimit ose përjashtimit, pa shqyrtimin paraprak të Bankës dhe miratimin e saj. Banka financon shpenzimet shtesë vetëm në qoftë se ato janë bërë para datës së përfundimit të kontratës origjinale ose datës së ndryshuar të përfundimit: (i) për kontratat me shqyrtim paraprak, për një amendament për të cilin Banka ka dhënë miratimin e saj; dhe (ii) për kontratat me shqyrtim pasues, për një amendament të nënshkruar para hyrjes në fuqi të pezullimit ose përjashtimit. Banka nuk financon asnjë kontratë të re, ose çfarëdo ndryshimi ose shtesë me të cilën bëhet ndryshim material i kontratës ekzistuese e cila është nënshkruar me një firmë apo me individ të pezulluar apo të përjashtuar më ose pas datës efektive të pezullimit ose përjashtimit.

ANEKSI 2: PREFERENCAT VENDORE

Preferencat për mallrat e prodhuara në vend

1. Huamarrësi, në pajtim me Bankën, mund të lejojë një margjinë të preferencës gjatë vlerësimit të ofertave sipas procedurës ICB për ofertat të cilat ofrojnë mallra të caktuara të prodhuara në shtetin e Huamarrësit, kur mallrat e tilla krahasohen me mallrat e prodhuara gjetiu. Në rastet e tilla, dokumentet e ofertimit qartazi vënë në pah çfarëdo preference që iu ofrohet prodhimeve vendore dhe informatat e nevojshme për të konstatuar pranueshmërinë e ofertës për një ofertë të tillë. Kombësia e prodhuesit apo furnitorit nuk është kusht i një pranueshmërie të tillë. Gjatë vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, aplikohen metodat dhe fazat e parapara me këtë dokument.
2. Për krahasim, ofertat e përgjegjshme klasifikohen në një apo më shumë grupe:
 - (a) Grupi A: ofertat të cilat ofrohen ekskluzivisht për mallrat e prodhuara në vendin e Huamarrësit nëse ofertuesi dëshmon, në masën e kënaqshme për Ofertuesin dhe për Bankën, se (i) puna, lënda e parë dhe komponentet brenda shtetit të Huamarrësit marrin pjesë me 30 apo më shumë përqind të çmimit EXW të produktit të ofruar, dhe (ii) stabilimenti, në të cilin ato mallra prodhohen apo montohen, të jetë përfshirë në prodhimin/montimin e mallrave të paktën që nga koha e parashtrimit të ofertës.
 - (b) Grupi B: të gjitha ofertat tjera të cilat ofrojnë mallrat e prodhuara në shtetin e Huamarrësit.
 - (c) Grupi C: ofertat të cilat ofrojnë mallrat e prodhuara jashtë vendit e të cilat janë importuar ose që do të importohen në mënyrë të drejtpërdrejtë.
3. Çmimi i ofertuar për mallra në ofertat në kuadër të Grupeve A dhe B përfshijnë të gjitha detyrimet dhe tatimet e paguara apo që duhet të paguhet për materiale apo komponentë themelore të blerë apo të importuar në tregun vendor, por përjashtojnë tatimet për shitjes apo tatime të ngjashme që aplikohen për produktin e gatshëm. Çmimi i ofertuar për mallrat në ofertat në Grupin C janë me CIP (Carriage and Insurance Paid – Transporti dhe Sigurimi i Paguar)(për vendin e destinacionit), ku përjashtohen doganat dhe tatimet tjera të importit të cilat janë paguar apo duhet të paguhet.

4. Në hapin e parë, të gjitha ofertat e vlerësuara në çdo grup krahasohen për të përcaktuar ofertën më të ulët në çdo grup. Ofertat e tilla më të ulëta të vlerësuara krahasohen me njëra tjetrën dhe, nëse si rezultat i këtij krahasimi, oferta nga Grupi A apo B rezulton më e ulët, ajo përzgjidhet për dhënie të kontratës.
5. Nëse, si rezultat i krahasimit sipas paragrafëve më lartë, ofertat më e ulët e vlerësuar është oferta nga Grupi C, të gjitha ofertat nga Grupi C krahasohen më tej me ofertën më të ulët të Grupit A, pasi t'i jenë shtuar çmimit të vlerësuar të mallrave të ofruar në çdo ofertë të Grupit C, dhe atë vetëm për qëllime të këtij krahasim, një shumë prej 15% të çmimit ofertues CIP për mallrat që duhet të importohen apo që janë importuar. Të dy çmimet përfshijnë zbritje të pakushtëzuar dhe korrigjohen për gabime aritmetikore. Nëse oferta nga Grupi A është më e ulët, ajo përzgjedhet për dhënie të kontratës. Nëse jo, oferta më e ulët e vlerësuar nga Grupi C përzgjedhet sipas paragrafit 4 më lartë.
6. Nuk aplikohet margjina e preferencave për kontratat sipas parimit me çelës në dorë për furnizimin e një numri të artikujve të veçanta të pajisjeve, si dhe për monitimin, instalimin dhe / ose ndërtimin, i cili përcaktohet me paragrafin 2.4 të Seksionit II⁸⁹. Megjithatë, pa kundërshtimin e Bankës, ofertat për kontratat sipas parimit me çelës në dorë, mund të ftohen dhe të vlerësohen në bazë të çmimeve DDP⁹⁰ (destinacionin e emërtuar) për mallrat e prodhuara jashtë vendit.
7. Në rast të përgjegjësisë së vetme (përveç çelësit në dorë) kontratat për impiante dhe stabilimente të mëdha industriale, të cilat përcaktohen në paragrafin 2.4 të Seksionit II, margjina e preferencës nuk vlen për tërë pakon por vetëm për prodhimet e prodhuara në vend. Pajisjet që ofrohen nga jashtë kuotohen me CIP, ndërsa pasjisjet që ofrohen në vend, me EXW. Të gjitha komponentët tjera, siç janë dizajni, ndërtimi, transporti lokal dhe sigurim deri në vendin e destinacionit, montimi, instalimi dhe mbikëqyrja, sipas nevojës, ofertohej ndaras. Ofertat nuk klasifikohen në Grupe A, B ose C. Gjatë krahasimit të ofertave, vetëm çmimi CIP për çdo ofertë të pajisjeve të ofruar nga jashtë shtetit të Huamarrësit rritet për 15 përqind. Preferencat nuk vlejné për shërbimet apo punë të ndërlidhura apo jo-konsulente që janë të përfshira në pako. Oferta e përcaktuar si më e ulët në përputhje me kriteret për vlerësim, përfshirë preferencat vendore, nëse ka të tilla, dhe të aplikuara si më lartë, përzgjidhen për dhënie të kontratës.

Preferenca për kontraktues vendor

⁸⁹ Kjo nuk iu referohet furnizimit të mallrave me mbikëqyrje të instalimit në të njëjtën kontratë e cila konsiderohet kontratë për furnizim të mallrave, dhe së këndejmi edhe i përmbushin kushtet për aplikimin e preferencës vendore për komponentën e mallrave.

⁹⁰ DDP është sipas INCOTERM, që nënkupton "Delivered Duty Paid" (Liferim me doganë të paguar) ku shitësi i liferon mallin e zhdoganuar blerësit, dhe jo të shkarkuar nga çfarëdo mjet transporti në vendin e caktuar të destinacionit. Shitësi bart të gjitha shpenzimet dhe rreziqet e ndërlidhura me sjelljen e mallit deri aty përfshirë, sipas rastit, edhe doganën për importin në vendin e destinacionit, dhe shkarkimin në destinacionin final si pjesë e kontratës me parimin çelës në dorë. Në shtetet të cilat lirojnë ofertuesit nga pagesa për import për kontratat e financuara nga Banka, krahasimi për qëllime të vlerësimit të ofertave bëhet në bazë të mos-përrjashtimit nga detyrimet dhe tatimet për importin e mallrave të prodhuara jashtë dhe dokumentet e ofertimit mund të vënë në pah që, para nënshkrimit të kontratës, blerësimi dhe ofertuesi fitues do të identifikojnë shumën e tatimeve që duhet të paguhet për importin e mallit të ofruar si rezultat i një lirimi të tillë. Mlirëpo, shumën e kontratës që do të nënshkruhet nuk përfshinë shumën e përgjithshme të detyrimeve dhe tatimeve të liruara.

8. Për kontrata për punë që jepen në bazë të ICB, Huamarrësit që i plotësojnë kushtet mund, me pajtimin e Bankës, të ofrojnë një margjinë preference prej 7.4 përqind për kontraktuesit vendor⁹¹, në përputhje me, dhe në varësi prej, dispozitave vijuese:
- (a) Kontraktuesve që aplikojnë për preferencë të tillë duhet t'u kërkohej të ofrojnë, si pjesë e të dhënave për kualifikim⁹², informata siç janë detajet e pronësisë, të cilat janë të nevojshme për të përcaktuar nëse, në përputhje me klasifikimin e përcaktuar nga Huamarrësi dhe të pranuar nga Banka, një kontraktues apo grup i caktuar i kontraktuesve mund të kualifikohen për preferencë vendore. Dokumentet e ofertimit tregojnë qartazi preferencën dhe metodën e cila do të pasohet gjatë vlerësimit dhe krahasimit të ofertave në mënyrë që një preferencë e tillë të hyjë në fuqi.
 - (b) Pasi ofertat të jenë pranuar dhe shqyrtuar nga Ofertuesi, ofertat e përgjegjshme klasifikohen në grupet vijuese:
 - (i) Grupi A: ofertat e ofruara nga kontraktues vendor të cilët përmbushin kushtet për preferencë.
 - (ii) Grupi B: ofertat e ofruara nga kontraktuesit e tjerë.
9. Të gjitha ofertat e vlerësuara në secilin grup, si një hap i parë i vlerësimit, krahasohen për të përcaktuar ofertën më të ulët, dhe ofertat më të ulëta të vlerësuara në secilin grup krahasohen më tej me njëri-tjetrin. Nëse, si rezultat i këtij krahasimi, një ofertë nga Grupi A, është më e ulët, ajo do të përzgjidhet për dhënie të kontratës. Nëse një ofertë nga Grupi B është më e ulët, si një hap të dytë të vlerësimit, të gjitha ofertat nga Grupi B krahasohen më tej me ofertën më të ulët të vlerësuar nga Grupi A. Vetëm për qëllime të këtij krahasimi të mëtejshëm, një shumë të barabartë me 7.5 përqind të çmimit të ofertës përkatëse korrigjuar për gabimet aritmetike, duke përfshirë ulje të pakushtëzuar por duke përjashtuar shumat e përkohshme dhe kostot e punëve të ditës, nëse ka, i shtohen çmimit të vlerësuar të ofruar në çdo ofertë nga Grupi B. Nëse oferta nga Grupi A, është më e ulët, ajo përzgjidhet për dhënie. Nëse jo, oferta më e ulët e vlerësuar nga Grupi B bazuar në hapin e parë të vlerësimit, përzgjidhet.

⁹¹ Preferenca për Kontraktues vendor vlen vetëm për shtetet të cilat kualifikohen.

⁹² Në fazën e para-kualifikimit dhe / ose të ofertimit.

ANEKSI 3: UDHËZIME OFERTUESVE

Qëllimi

1. Ky Aneks ofron udhëzime për ofertues të mundshëm të cilët dëshirojnë të marrin pjesë në prokurim të financuar nga Banka.

Përgjegjësia për prokurim

2. Përgjegjësia për implementim të projektit, dhe së këndejmi, edhe për pagesën e mallrave, punëve dhe shërbimeve jo-konsulente sipas projektit, bie tërësisht tek Huamarrësi. Banka, nga ana e saj, obligohet sipas neneve të kësaj Marrëveshje që të sigurohet që mjetet nga huaja e Bankës paguhet vetëm pasi shpenzimet të jenë shkaktuar. Huamarrësi i parashtron Bankës kërkesë për tërheqje me dokumentacion mbështetës për të dëshmuar se fondet janë shfrytëzuar ose shfrytëzohen në përputhje me Marrëveshjen për huanë dhe me Planin e prokurimit⁹³. Ashtu siç është cekur në paragrafin 1.2 të Udhëzimeve, Huamarrësi është ligjërisht përgjegjës për prokurim. Ai fton, pranon dhe vlerëson ofertat, dhe jep kontratën. Kontrata bëhet ndërmjet Huamarrësit dhe furnitorit apo kontraktuesit. Banka nuk është palë në kontratë.

Roli i Bankës

3. Siç thuhet në paragrafin 1.13 të Udhëzimeve, Banka rishikon procedurat e prokurimit, dokumentet, vlerësimet e ofertës, rekomandimet për dhënie, dhe vetë kontratën për t'u siguruar se procesi po kryhet në përputhje me procedurat e dakorduara, siç kërkohet në Marrëveshjen e Huasë. Në rastin e kontratave të mëdha, dokumentet shqyrtohen paraprakisht nga Banka para lëshimit të tyre, siç përshkruhet në Aneksin 1⁹⁴. Gjithashtu, në qoftë se, në çdo kohë gjatë procesit të prokurimit (edhe pas dhënies së kontratës), Banka arrin në përfundimin se procedurat e pranuar nuk janë ndjekur në çdo aspekt material, Banka mund të deklarojë keq-prokurim, siç përshkruhet në paragrafin 1.14. Megjithatë, nëse një Huamarrës ka dhënë një kontratë pas marrjes së "mos kundërshtimit" nga Banka, Banka shpall keq-prokurim vetëm në qoftë se mos kundërshtimi është lëshuar në bazë të informatave jo të plota, të pasakta ose mashtruese të siguruar nga Huamarrësi. Për më tepër, nëse banka konstaton se janë

93

94

përdorur praktika korruptuese ose mashtruese nga përfaqësuesit e Huamarrësit ose ofertuesit, Banka mund të imponojë sanksione të zbatueshme të përcaktuara në paragrafin 1.16 të Udhëzimeve.

4. Banka ka lëshuar *Dokumentet standard të ofertimit (SBD)* për lloje të ndryshme të ofertimit. Ashtu siç është thënë në paragrafët 2.10 dhe 2.12 të Udhëzimeve, është e obligueshme që Huamarrësi t'i shfrytëzojë këto dokumente, me ndryshime minimale për të shtjelluar çështje që janë specifike për shtetin apo projektin. Dokumentet për para-kualifikim dhe për ofertim finalizohen dhe lëshohen nga Ofertuesi.

Informatat mbi ofertimin

5. Informacion mbi mundësitë e ofertimit nën ICB mund të merret nga Njoftimi i përgjithshëm për prokurim dhe Njoftimeve specifike të prokurimit, siç përshkruhen në paragrafët 2.7 dhe 2.8 të Udhëzimeve. Udhëzimet e përgjithshme për pjesëmarrjen, si dhe informatat paraprake mbi mundësitë e biznesit në projektet e ardhshme, mund të merren nga ueb faqja e Bankës Botërore⁹⁵ si dhe nga Infoshop⁹⁶. PAD janë gjithashtu në dispozicion nga Infoshop-i dhe në faqen e internetit të Bankës pas miratimit të kredisë.

Roli i ofertuesit

6. Pasi një ofertues pranon dokumentin e parakualifikimit ose ofertimit, ofertuesi duhet të studiojnë me kujdes dokumentet për të vendosur nëse ai mund të plotësojë kushtet teknike, komerciale, dhe kontraktuale, dhe nëse është kështu, të vazhdojë të përgatisë ofertën e tij. Ofertuesi duhet pastaj të shqyrtojë dokumentet në mënyrë kritike për të parë nëse ka ndonjë paqartësi, mosveprim, ose kontradiktë të brendshme, ose ndonjë tipar të specifikacioneve ose kushteve të tjera të cilat janë të paqarta ose duken diskriminuese ose kufizuese; nëse është kështu, ai duhet të kërkojë sqarime nga Huamarrësi, me shkrim, brenda periudhës kohore të specifikuar në dokumentet e tenderit për të kërkuar sqarime.
7. Kriteret dhe metodologjia për përzgjedhjen e ofertuesit të suksesshëm janë të përshkruara në dokumentet e tenderit, zakonisht në Udhëzimet për ofertuesit dhe specifikacionet. Nëse këto nuk janë të qarta, sqarimi duhet kërkuar në mënyrë të ngjashme nga Huamarrësi.
8. Në lidhje me këtë duhet theksuar se dokumentet specifike të kualifikimit të lëshuara nga Huamarrësi qeverisin çdo proces të prokurimit, siç thuhet në paragrafin 1.1 të Udhëzimeve. Nëse një ofertues mendon se ndonjë nga dispozitat në dokumente janë në kundërshtim me Udhëzimet, ai duhet gjithashtu ta ngris këtë çështje me Huamarrësin.
9. Është përgjegjësi e ofertuesit të parashtrojë çfarëdo paqartësi, kundërshtim, lëshim, etj, para dorëzimit të ofertës së tij, për të siguruar dorëzimin e ofertës e cila është plotësisht e përgjegjshëm dhe e përputhshme, duke përfshirë të gjitha dokumentet mbështetëse të kërkuara në dokumentet e tenderit . Mos përputhja me kërkesat kritike

⁹⁵ <http://www.worldbank.org>

⁹⁶ Adresa e Infoshop-it është adresa e Bankës Botërore, në 1818 H Street, N. W., Washington, D. C., 20433, U.S.A. Baza e të dhënave të projektit mund të gjendet në: <http://www.worldbank.org/projects/>.

(teknike dhe komerciale), do të rezultojë në refuzimin e ofertës. Nëse një ofertues dëshiron të propozojë devijimet në një kusht jo-kritik, ose të propozojë një zgjidhje alternative, ai duhet të ndjek rreptësisht udhëzimet mbi këto aspekte të caktuara në dokumentet e ofertimit të Huamarrësit, në veçanti dispozitat që kanë të bëjnë me devijimet. Zgjidhjet alternative duhet të ofrohen vetëm kur autorizohen në dokumentet e ofertimit. Përveç nëse dokumentet e ofertimit identifikojnë qartë kushtet e obligueshme dhe jo të obligueshme teknike dhe komerciale, ofertuesi merr përsipër përgjegjësinë e plotë për çfarëdo devijimi ose kushti në ofertën e tij i cili mund të konsiderohet material dhe të ketë si rezultat refuzimin e ofertës së tij. Sapo ofertat të jenë pranuar dhe hapur publikisht, nuk kërkohet apo lejohet ndryshimi i çmimit apo përmbajtjes së ofertës.

10. Ashtu siç është cekur në paragrafin 2.47 të Udhëzimeve, procesi i vlerësimit të ofertave është konfidencial deri në publikimin e njoftimit për dhënie të kontratës. Kjo është me rëndësi thelbësore për t'i mundësuar Huamarrësit dhe Bankës për të shmangur qoftë realitetin apo dukjen e ndikimit të paqenë. Nëse, në këtë fazë, ofertuesi dëshiron t'i bëjë me dije Huamarrësit informata shtesë ose Bankës, ose të dyve, e bën këtë me shkrim.

Veprimet e Bankës

11. Ofertuesit mund t'i dërgojnë Bankës kopje të komunikimeve të tyre për çështjet dhe pyetjet me Huamarrësin ose t'i shkruajnë Bankës drejtpërsëdrejti, kur Huamarrësit nuk përgjigjen me kohë, ose kur komunikimi është në fakt ankesa kundër Huamarrësit. Të gjitha komunikimet e tilla duhet t'i adresohen Udhëheqësit të Ekipit të dërgatës për projektin, me kopje Drejtorit të shtetit për shtetin huamarrës dhe Menaxherit regional për prokurim. Emrat e Udhëheqësve të ekipit të dërgatës gjenden në PAD.
12. Komunikimet e pranuar nga Banka nga ofertuesit e mundshëm, para datës së mbylljes për parashtrimin e ofertave, sipas rastit, iu referohen Huamarrësit me komente dhe këshilla nga Banka, për veprim apo përgjigje.
13. Komunikimi, përfshirë ankesat, e pranuar nga ofertuesit pas hapjes së ofertave, trajtohen si në vijim. Në rast të kontratave të cilat nuk iu nënshtrohen rishqyrtimit paraprak nga Banka, komunikimi apo ekstraktet relevante, sipas nevojës, iu dërgohen Ofertuesit për shqyrtim dhe veprim të duhur. Huamarrësi i ofron Bankës të gjithë dokumentacionin relevant për shqyrtim dhe komente nga Banka. Në rastet e kontratave që i nënshtrohen shqyrtimit paraprak, komunikimi shqyrtohet nga Banka, në konsultim me Huamarrësin. Nëse kërkohen të dhëna shtesë për të kryer këtë proces, këto sigurohen nga Huamarrësi. Nëse kërkohen informata apo qartësime shtesë nga Ofertuesi, Banka i kërkon Huamarrësit t'i sigurojë dhe të komentojë dhe t'i inkorporojë, sipas nevojës, në raportin e vlerësimit. Shqyrtimi i Bankës nuk kryhet deri sa komunikimi të ekzaminohet dhe të shqyrtohet në tërësi. Komunikimet e pranuar nga ofertuesit që kanë të bëjnë me akuza për mashtrim apo korrupsion⁹⁷

⁹⁷ Raportimi për mashtrimi apo korrupsionin e dyshuar mund të bëhet drejtpërsëdrejti Nënkryesisë së Bankës për Integritet (INT) me email: investigations_hotline@worldbank.org, përmes ueb faqes së Bankës Botërore; apo linjës 24 orëshe të cilën e operojnë palët e treta; numrin pa pagesë +1-800-831-0463, në regjistrimin e thirrjeve +1-704-556-7046 (interpretet janë në dispozicion, thirrjet anonime pranohen); ose kontaktoni INT në Selinë e Bankës në Uashington D. C.: +1-202-458-7677

mund të kenë nevojë për trajtim të llojit tjetër, për shkaqe konfidencialiteti. Në rastet e tilla, Banka ushtron kujdes dhe diskrecion teksa ndan informata me Huamarrësin të cilat i konsideron si të qëlluara.

14. Përveç për të konfirmuar pranimin, Banka nuk bën diskutime apo mban korrespondencë me ndonjë ofertues gjatë procesit të vlerësimit dhe shqyrtimit të prokurimit, deri në publikimin e njoftimit për dhënie të kontratës.

Biseda pasuese me Bankën

15. Ashtu siç është thënë në paragrafin 2.65, nëse, pas njoftimit për dhënie të kontratës, ofertuesi dëshiron t'i vërtetojë arsyet se pse oferta e tij nuk është përzgjedhur, ai duhet t'i drejtojë kërkesën Huamarrësit. Nëse ofertuesi nuk është i kënaqur me shpjegimin me shkrim dhe kërkon takim me Bankën, ai mund ta bëjë këtë duke iu drejtuar Menaxherit regjional të prokurimit për shtetin huamarrës, i cili do të arranzhojë një takim në nivel të duhur dhe me stafin relevant. Qëllimi i një takimi të tillë është vetëm të bisedohet oferta e ofertuesit, dhe as të ndryshohet qëndrimi i Bankës i cili i është përcjellur Huamarrësit dhe as të diskutohen ofertat e konkurruesve.

KLASIFIKIMI: PUBLIK

UDHËZIMET
PËRZGJEDHJA DHE PUNËSIMI
I KONSULENTËVE
NË KUADËR TË HUAVE TË IBRD-SË DHE KREDIVE DHE GRANTEVE TË IDA-SË
NGA HUAMARRËSIT E BANKËS BOTËRORE

Janar 2011

Tabela e përmbajtjes

I.	HYRJE	5
	Qëllimi	5
	Çështje të përgjithshme	6
	Vlefshmëria e udhëzimeve	6
	Konflikti i interesit	7
	Përparësia jo e drejtë konkurruese	8
II.	PËRZGJEDHJA E BAZUAR NË CILËSI DHE KOSTO (QCBS).....	17
	Procesi i përzgjedhjes	17
	Termet e referencës (TOR)	17
	Qartësimi apo ndryshimi i propozimeve	22
	Vlerësimi i propozimeve: shqyrtimi i cilësisë dhe kostos	22
	Vlerësimi i cilësisë	22
	Hapja e propozimeve financiare dhe vlerësimi i kostos	24
III.	METODAT TJERA TË PËRZGJEDHJES	28
	Të përgjithshmet	28
IV.	LLOJET E KONTRATAVE DHE DISPOZITAT E RËNDËSISHME	35
V.	PËRZGJEDHJA E KONSULENTËVE INDIVIDUAL	39
	ANEKSI 1: SHQYRTIMI I PËRZGJEDHJES SË KONSULENTËVE NGA BANKA DHE PUBLIKIMI I DHËNIES SË KONTRATËS	41
	ANEKSI 2: UDHËZIME KONSULENTËVE DHE TABELA E TË DHËNAVE (ITC) E KPP-së ...	47
	ANEKSI 3: UDHËZIME KONSULENTËVE	50
	Qëllimi	50
	Përgjegjësia për përzgjedhjen e konsulentëve	50
	Informatat mbi shërbimet e konsulencës	50

Roli i konsulentëve	51
Konfidencialiteti	52
Veprimi nga Banka	52

Shkurtesat

CDD	Zhvillimi i shtyrë nga komuniteti (Community Driven Development)
CQS	Përzgjedhja bazuar në kualifikimet e konsulentëve (Selection Based on Consultants' Qualifications)
EOI	Shprehja e interesimit (Expression of Interest)
FBS	Përzgjedhja me buxhet fikse (Selection under a Fixed Budget)
IBRD	Banka ndërkombëtare për rindërtim dhe zhvillim (International Bank for Reconstruction and Development)
IDA	Asociacioni ndërkombëtar për zhvillim (International Development Association)
IDC	Kontrata me liferim të pakufizuar (Indefinite Delivery Contract)
IFC	Korporata ndërkombëtare për financim (International Finance Corporation)
ITC	Udhëzime konsulentëve (Instructions to Consultants)
LCS	Përzgjedhja me kosto më të ulët (Least-Cost Selection)
LOI	Letra e ftesës (Letter of Invitation)
MDTF	Trust Fondi Shumë Donatorësh (Multi Donor Trust Fund)
MIGA	Agjencioni për garancionin e investimeve shumëpalëshe (Multilateral Investment Guarantee Agency)
NGO	Organizatë joqeveritare (Nongovernmental Organization)
PAD	Dokumenti për vlerësim të dokumentit (Project Appraisal Document)
PPA	Avansi për përgatitje të projektit (Project Preparation Advance)
PPR	Shqyrtimi pas prokurimit (Procurement Post Review)
PID	Dokumenti me informata mbi projektin (Project Information Document)
QBS	Përzgjedhja e bazuar në cilësi (Quality-Based Selection)
QCBS	Përzgjedhja e bazuar në cilësi dhe kosto (Quality and Cost-Based Selection)
REOI	Kërkesa për shprehje të interesimit (Request for expressions of interest)
RFP	Kërkesat për propozime (Requests for proposal)
SSS	Përzgjedhja një burimore (Single Source Selection)
SWAp	Qasja mbarë-sektoriale (Sector Wide Approach)
TOR	Termet e referencës (Terms of Reference)
UCS	Shfrytëzimi i sistemeve të shtetit (Use of Country Systems)
UN	Kombet e Bashkuara (United Nations)
UNDB	Zhvillimi i biznesit i Kombeve të Bashkuara (United Nations Development Business)

I. HYRJE

Qëllimi

- 1.1 Qëllimi i këtyre udhëzimeve është të definohen politikat dhe procedurat e Bankës për përzgjedhje, kontraktim dhe monitorim të konsulentëve që kërkohen për projektet të cilat financohen pjesërisht apo tërësisht nga huaja e Bankës ndërkombëtare për rindërtim dhe zhvillim (IBRD), kredia apo granti i Asociacionit ndërkombëtar për zhvillim (IDA)¹, për avansin për përgatitjen e projektit (PPA), grantin nga Banka, apo një fond trusti² të administruar nga Banka dhe e ekzekutuar nga Pranuesi.
- 1.2 Marrëveshja e huasë qeverisë marrëdhëniet ligjore ndërmjet Huamarrësit dhe Bankës, dhe këto Udhëzime vlejné për përzgjedhjen dhe punësimin e konsulentëve për projektin, ashtu siç parashihet me Marrëveshjen e huasë. Të drejtat dhe obligimet e Huamarrësit³ dhe të konsulentit qeverisen nga Kërkesat specifike për Propozime (RFP)⁴, të lëshuar nga Huamarrësi dhe me kontratën e nënshkruar nga Huamarrësi me konsulentin, dhe jo nga këto Udhëzime apo nga Marrëveshja e huasë. Asnjë palë tjetër, përveç palëve të Marrëveshje të huasë, nuk kanë të drejtë të tjera sipas asaj marrëveshje apo mund të kërkojnë mjete nga huaja.
- 1.3 Për qëllime të këtyre Udhëzimeve, shprehja *konsulentët* përfshin një gamë të gjerë të subjekteve private dhe publike, përfshirë firma konsulentë, firma inxhinierike, menaxherë të ndërtimit, firma menaxhuese, agjentë të prokurimit, ofrues të shërbimeve inspektuese, auditorë, agjencione të Kombeve të Bashkuara (OKB) dhe organizata të tjera shumë nacionale, bankë tregtare dhe për investime, universitete, institucione kërkimore, agjencione qeveritare, organizata joqeveritare (OJQ), dhe individë⁵. Huamarrësit e Bankës i shfrytëzojnë këto subjekte si *konsulentë* për t'u ndihmuar në një gamë të gjerë të aktiviteteve, siç janë këshilla për politikë; reforma institucionale; menaxhment; shërbime të inxhinierisë; mbikëqyrje të ndërtimit; shërbimet financiare; shërbimet e prokurimit; studimet shoqërore dhe ambiente; dhe identifikimi, përgatitja dhe implementimi i projekteve për të plotësuar kapacitetet e Huamarrësit në këto lëmi.

¹Kushtet e IBRD-së dhe IDA-së janë identike. Referencat *Bankës* në këto Udhëzime përfshijnë *IBRD-në* dhe *IDA-në*, ndërsa përmendja e "huave" përfshinë huatë e IBRD-së, si dhe kreditë dhe grantet e IDA-së, grantet e Bankës, fondet e trusteve të administruar nga Banka dhe të ekzekutuar nga pranuesi, dhe avanset për përgatitje të projekteve (PPA).

Përmendja e "*Marrëveshjes së huasë*" nënkupton marrëveshjet ligjore ndërmjet Bankës dhe Huamarrësit, dhe mund të përfshijnë marrëveshjet e projektit ndërmjet Bankës dhe subjektit për implementim të projektit.

Përmendja e "*Huamarrësit*" përfshin pranuesit e huave, kredive, granteve dhe të PPA-së të cilët ekzekutojnë projekte të tilla, dhe mund të përfshijnë edhe nën-huamarrës apo subjekte për implementim të projektit.

² Përderisa marrëveshja për administrimin e fondeve të tilla të trustit apo të granteve nga Banka nuk është në kundërshtim me këto dispozita si përjashtime, përfshirë edhe Marrëveshjen e Kombeve të Bashkuara mbi Parimet e Besueshme (FPA) apo Fondin e Trustit Shumë Donatorësh (MDTF) në situatë emegjente.

³ Në disa raste, Huamarrësi vepron vetëm si ndërmjetës, dhe projekti kryhet nga ndonjë agjencion apo subjekt tjetër. Përmendja e Huamarrësit në këto Udhëzime përfshin agjencione dhe subjekte, si dhe nën-huamarrës në kuadër të "arranzhmaneve për huadhënie të mëtejme".

⁴ Shih Shtojcën 2.

⁵ Shih paragrafët 3.15 – 3.21 për lloje të caktuara të konsulentëve, dhe Seksionin V për konsulentë individual.

Çështje të përgjithshme

- 1.4 Huamarrësi është përgjegjës për përgatitjen dhe implementimin e projektit, dhe prandaj edhe përzgjedhjen e konsulentit, si dhe dhënien dhe administrimin e kontratës. Banka, nga ana e saj, obligohet me Nenet e Marrëveshjes (Nenet e Marrëveshjes së Bankës, Neni II, Pjesa 5(b)); dhe Nenet e IDA-së së Marrëveshjes, Neni V, Seksioni 1(g)) për “t’u siguruar që mjetet e ndonjë huaje përdorin vetëm për qëllime për të cilët është dhënë granti, duke i kushtuar kujdes racionalitetit dhe efikasitetit dhe pavarësisht ndikimeve apo çështjeve politike apo çështjeve të tjera jo-ekonomike” dhe të ketë përcaktuar procedura të detajshme për këtë qëllim. Edhe pse rregullat dhe procedurat specifike që duhet të pasohen për punësimin e konsulentëve varen nga rrethanat e rastit të caktuar, pesë çështje kryesore udhëheqin politikën e Bankës gjatë procesit të përzgjedhjes:
- (a) Nevoja për shërbime të cilësisë së lartë,
 - (b) Nevoja për ekonomi dhe efikasitet,
 - (c) Nevoja për t’u dhënë të gjithë konsulentëve të cilët kanë të drejtë mundësinë për të garuar në ofrimin e shërbimeve të financuara nga Banka,
 - (d) Interesi i Bankës që të inkurajojë zhvillimin dhe shfrytëzimin e konsulentëve kombëtarë në shtetet e saja anëtare në zhvillim, dhe
 - (e) Nevojën për transparencë gjatë procesit të përzgjedhjes.
- 1.5 Banka konsideron që, në shumicën e rasteve, këto konsiderata mund të shtjellohen më së miri përmes konkurrencës nga firmat e kualifikuara të listës së ngushtë ku përzgjedhja bazohet në cilësinë e propozimit dhe, sipas rastit, edhe në koston e shërbimeve që ofrohen. Seksionet II dhe II të këtyre Udhëzimeve përshkruajnë metodat e ndryshme të përzgjedhjes së konsulentëve të pranueshme nga Banka dhe rrethanat në të cilat këto mund të jenë të qëlluara. Duke qenë se Përzgjedhja e bazuar në cilësi dhe kosto (QCBS është metoda më e rekomanduar, Seksioni II i këtyre Udhëzimeve përshkruan në detaje procedurat për QBCS. Mirëpo, QBCS nuk është metoda më e qëlluar e përzgjedhjes për të gjitha rastet; prandaj, Seksioni III përshkruan metodat tjera të përzgjedhjes dhe rrethanat në të cilat këto mund të jenë më të qëlluara.
- 1.6 Metodot e caktuara të cilat mund të ndiqen për përzgjedhjen e konsulentëve në një projekt të dhënë janë dhënë në Marrëveshjen për hua. Kontratat specifike të cilat duhet të financohen me projekt, dhe metodat e tyre të përzgjedhjes, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje për hua, përcaktohen në Planin e prokurimit, ashtu siç parashihet në paragrafin 1.25 të këtyre Udhëzimeve.

Vlefshmëria e udhëzimeve

- 1.7 Shërbimet konsulente për të cilat vlejné këto Udhëzime janë të një natyre intelektuale dhe këshilluese. Këto Udhëzime nuk vlejné për lloje tjera të shërbimeve për të cilat predominojné aspektet fizike të aktivitetit, ofertoehen dhe kontraktohen në bazë të performancës të një outputi të matshëm fizik, dhe për të cilin standardet e performancës mund të identifikohen qartazi dhe të aplikohen në mënyrë konsistente, siç janë shpimi, fotografitë ajrore, imazhet satelitore, përgatitja e hartave, dhe operacionet e ngjashme,

si dhe ndërtimi i punëve, prodhimi i mallrave, dhe puna dhe mirëmbajtja e stabilimenteve apo impianteve⁶.

- 1.8 Parimet, rregullat dhe procedurat e cekura në këto Udhëzime vlejné për të gjitha kontratat për shërbimet konsulente të financuara tërësisht apo pjesërisht nga huatë e Bankës⁷. Dispozitat e përshkruara në Seksionin I vlejné për të gjitha seksionet e këtyre Udhëzimeve. Gjatë prokurimit të shërbimeve të konsulencës të cilat nuk financohen nga burimet e tilla por janë përfshirë në fushëveprimin e projektit të marrëveshjes për hua, Huamarrësi mund të përvetësojë rregulla dhe procedura të tjera. Në rastet të tilla, Banka duhet të kënaqet që: (a) procedurat që do të aplikohen përmbushin obligimet e Huamarrësit që ta zbatojë projektin me zell dhe efikasitet, dhe se ato do të rezultojnë në përzgjedhjen e konsulentëve të cilët i posedojnë kualifikimet e duhura; (b) konsulenti i përzgjedhur kryen detyrën në përputhje me orarin e dakorduar, dhe (c) fushëveprimi i shërbimeve është në përputhje me nevojat e projektit.

Konflikti i interesit

- 1.9 Politika e Bankës kërkon që konsulentët të ofrojnë këshilla profesionale, objektive dhe të paanshme dhe gjatë gjithë kohës t'u japin rëndësi më të madhe interesave të klientit, pa ndonjë konsideratë për punën e ardhshme dhe se gjatë dhënies së këshillave, iu shmangen konflikteve me detyrat tjera dhe me interesat e tyre korporatave. Konsulentët nuk angazhohen për detyra të cilat do të ishin në kundërshtim me obligimet e tyre paraprake apo aktuale ndaj klientëve të tjerë, ose të cilat do t'i vendosin në pozitë ku do ta kishin të pamundur t'i përmbushin detyrat në interesin më të mirë të Huamarrësit. Pa kufizuar natyrën e përgjithshme të dispozitave më lartë, konsulentët nuk angazhohen në rrethanat vijuese:

- (a) Konflikti ndërmjet aktiviteteve të konsulencës dhe prokurimit të mallrave, punëve apo shërbimeve të jo-konsulente (gjegjësisht, shërbimeve të tjera përveç këtyre të parapara me këto Udhëzime⁸): firma e cila ka qenë e angazhuar nga Huamarrësi për të ofruar mallra, punë apo shërbime jo-konsulente për një projekt, apo një vartës i cili në mënyrë direkte apo indirekte kontrollon, apo kontrollohet nga, apo është nën kontrollin e përbashkët me atë firmë, diskualifikohet nga ofrimi i shërbimeve të konsulencës të cilat rezultojnë nga ose janë në lidhje direkte me ato mallra, punë apo shërbime jo-konsulente. Gjithashtu, firma e angazhuar për të ofruar shërbime konsulente për përgatitjen (para hyrjes në fuqi të Huasë) apo implementimin e projektit, apo ndonjë vartës i cili në mënyrë direkte apo indirekte kontrollon, apo kontrollohet nga, apo është nën kontrollin e përbashkët të asaj firme, diskualifikohet nga ofrimi i mallrave, punëve apo shërbimeve (të tjera përveç shërbimeve të konsulencës të parapara me këto Udhëzime) e të cilat

⁶Këto shërbime të fundit ofertoehen dhe kontraktohen në bazë të performancës së outputeve fizike, të cilat janë të matshme me Udhëzimet: Prokurimi i mallrave, punëve dhe shërbimeve jo-konsulente në kuadër të Huave të IBRD-së dhe Kredive dhe Granteve të IDA-së, këtu të cekura si Udhëzimet për prokurim.

⁷Këtu përfshihet përzgjedhja e konsulentëve nga një agjent prokurimi apo menaxher ndërtimi i punësuar nga Huamarrësi sipa paragrafit 3.17 të këtyre Udhëzimeve.

Banka mund të pajtohet që të shfrytëzojë sistemin e prokurimit publik të shtetit të Huamarrësit – i cili quhet Shfrytëzimi i Sistemit të shtetit (UCS) – për përzgjedhjen e konsulentëve (përfshirë individëve) sipas paragrafit 3.12 të këtyre Udhëzimeve. Në rastet e tilla, Marrëveshja për huanë ndërmjet Huamarrësit dhe Bankës përshkruajnë procedurat e Huamarrësit të vlefshme për përzgjedhje, si dhe aplikimin e plotë të Seksionit I dhe çfarëdo pjese tjetër të këtyre Udhëzimeve, të cilat duken relevante nga Banka.

⁸Shih paragrafin 1.7 të këtyre Udhëzimeve.

rezultojnë nga ose janë drejtpërsëdrejti të lidhura me shërbimet e konsulencës për përgatitje apo implementim të tillë. Kjo dispozitë nuk vlen për firmat e ndryshme (konsulentë, kontraktues apo furnitorë) të cilat së bashku kryejnë obligimet e kontraktuesit sipas parimit çelës në dorë apo kontrata për projektim dhe ndërtim.

- (b) Konflikti ndërmjet detyrave të konsulencës: as konsulentët (përfshirë personelin dhe nën-konsulentët e tyre) dhe as ndonjë vartës i cili në mënyrë direkte apo indirekte kontrollon, kontrollohet apo është nën kontrollin e përbashkët me atë firmë, nuk mund të angazhohen për ndonjë detyrë e cila, sipas natyrës, mund të jetë në konflikt me një detyrë tjetër të konsulentëve. Për shembull, konsulentët që i ndihmojnë një klienti në privatizimin e aseteve publike as nuk blejnë, dhe as këshillojnë, blerësit e aseteve të tilla. Ngjashëm, konsulentët që janë angazhuar për të përgatitur Termat e referencës (ToR) për një detyrë nuk angazhohen për atë detyrë.
- (c) Marrëdhëniet me stafin e Huamarrësit: Konsulentët (përfshirë edhe ekspertët e tyre dhe personelin tjetër, nën-konsulentët) të cilët kanë një marrëdhënie të afërt afariste apo familjare me stafin profesional të Huamarrësit (apo të agjencionit për implementim të projektit, apo të pranuesit të një pjese të huasë) të cilët në mënyrë direkte apo indirekte janë të përfshirë në ndonjë pjesë të: (i) përgatitjes së TOR për detyrën, (ii) procesin e përzgjedhjes për kontratën, ose (iii) mbikëqyrjes së kontratës së tillë nuk mund t'i jepet kontratë, përveç nëse konflikti i cili rrjedh nga ky raport është zgjidhur në një mënyrë e cila është e pranueshme për Bankën gjatë procesit të përzgjedhjes dhe ekzekutimit të kontratës,
- (d) Konsulenti parashtron vetëm një propozim, qoftë në mënyrë individuale apo si një partner i një nisme të përbashkët në propozim tjetër. Nëse konsulenti, përfshirë partnerin e nismës së përbashkët, parashtron apo merr pjesë në më shumë se një propozim, të gjitha propozimet e tilla diskualifikohen. Kjo megjithatë nuk përjashton një firmë konsulentë që të merr pjesë si nën-konsulentë, apo një individ që të merr pjesë si pjesëtar i ekipit, në më shumë se një propozim kur rrethanat e arsyetojnë këtë dhe nëse lejohet me RFP (kërkesë për propozime).

Përparësia jo e drejtë konkurruese

1.10 Drejtësia dhe transparenca gjatë procesit të përzgjedhjes kërkojnë që konsulentët apo vartësit e tyre të cilët konkurrojnë për një detyrë specifike të mos kenë përparësi të padrejtë për shkak se kanë dhënë shërbime të konsulencës në lidhje me detyrën në fjalë. Për këtë qëllim, Huamarrësi vë në dispozicion të gjithë konsulentëve, krahas kërkesës për propozime, të gjitha informatat të cilat në këtë aspekt do t'i jepnin një konsulenti të vetëm një përparësi konkurruese.

Zotësia juridike

1.11 Për të nxitur konkurrencën, Banka u lejon konsulentëve (firmave dhe individëve) të të gjitha shteteve që të ofrojnë shërbime konsulente për projektet e financuara nga Banka⁹.

⁹Banka lejon firmat dhe individët nga Taiuani, Kinë, për ofrim të shërbimeve konsulente për projektet e financuara nga Banka.

Të gjitha kushtet për pjesëmarrje kufizohen vetëm ato të cilat janë thelbësore për të siguruar aftësinë e firmës për të përmbushur kontratën në fjalë.

1.12 Në lidhjen me ndonjë kontratë të financuar tërësisht apo pjesërisht nga një hua e Bankës, Banka nuk i lejon një Huamarrësi ta mohojë pjesëmarrjen në një proces të hartimit të listës së ngushtë apo të përzgjedhjes apo të mohojë dhënien e kontratës një konsulenti për arsye të cilat nuk janë të ndërlidhura me: (i) aftësinë dhe resurset për ta përmbushur kontratën me sukses; ose (ii) situatat e konfliktit të interesit të parapara me paragrafin 1.9 më lartë.

1.13 Përjashtimet nga paragrafët 1.11 dhe 1.12 janë si në vijim:

- (a) Konsulentët mund të përjashtohen nëse: (i) nga aspekti ligjor apo rregulloreve zyrtare, shteti i Huamarrësit ndalon raporte komerciale me shtetin e konsulentit, me kusht që Banka është e kënaqur se përjashtimi i tillë nuk përjashton konkurrencën efektive për prokurim të shërbimeve të kërkuara konsulente, dhe (ii) me aktin e përputhshmërisë me një vendim të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, të sjellë në kuadër të Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, shteti i Huamarrësit i ndalon pagesat ndonjë shteti, personi, apo subjekti. Në rastet kur shteti i Huamarrësit i ndalon pagesat një firme të caktuar ose për mallra të caktuara me aktin e tillë të përputhshmërisë, ajo firmë mund të përjashtohet.
- (b) Ndërmarrjet apo institucionet në pronësi shtetërore në shtetin e Huamarrësit mund të marrin pjesë në shtetin e Huamarrësit vetëm nëse mund të vërtetojnë se (i) janë të pavarur nga aspekti juridik dhe financiar, (ii) punojnë sipas ligjit komercial, dhe (iii) nuk janë agjencione vartëse të Huamarrësit apo Nën-huamarrësit¹⁰.
- (c) Si përjashtim pikës (b), kur shërbimet e universiteteve ose qendrave hulumtuese apo institucioneve tjera shtetërore në shtetin e Huamarrësit janë të natyrës unike dhe të jashtëzakonshme, edhe për shkak të mungesës së alternativave gjegjëse të sektorit privat, dhe pjesëmarrja e tyre është me rëndësi thelbësore për implementimin e projektit, Banka mund të dakordohet për angazhimin e këtyre institucioneve për çdo rast individualisht. Mbi të njëjtën bazë, profesorët e universitetit apo shkencëtarët e instituteve kërkimore mund të kontraktohen individualisht me financim të Bankës.
- (d) zyrtarëtqeveritarëdhe nëpunësit civilëtë vendittë Huamarrësitmundvetëmtë punësohensipas kontratave tëkonsulencës nëvendin eHuamarrësit, qoftë si individëose sianëtarë tëëkipit të ekspertëvetë propozuar nganjë firmëkonsulenteme kusht qëmarrja në punëe tillë nuk është në konfliktmendonjë

¹⁰ Për të poseduar zotësi juridike, ndërmarrja apo instituti në pronësi shtetërore dëshmon, në masën e kënaqshme për Bankën, perms të gjitha dokumenteve relevante, përfshirë Statutin dhe informatat tjera bankare të cilat mund t'i kërkojë Banka, se: (i) është një subjekt juridik i ndarë nga Qeveria; (ii) nuk merr ndonjë subvencion apo mbështetje buxhetore aktualisht, (iii) operon si çdo organizatë tjetër komerciale, dhe ndër të tjera, nuk është e obliguar që t'i kalojë tepricën Qeverisë, mund të krijojë të drejta dhe obligime, të huazojë fonde dhe të jetë përgjegjës për kthimin e detyrimeve, dhe mund të shpallet i bankrotuar, dhe (iv) nuk oferton për dhënie të kontratës nga ndonjë departament apo agjencion qeveritar i cili, sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi, është autoriteti raportues apo mbikëqyrës i ndërmarrjes dhe ka mundësinë që të ushtrojë ndikim apo kontroll mbi ndërmarrjen apo institucionin.

punësimapo ligjeve oserregullorevetë tjeraapo politikave tëvendittë Huamarrësitdhenëse ata(i) janë në pushim pa pagesë, osekanë dhënë dorëheqjenapo janë pensionuar, (ii) nuk punësohennga agjenciapër të cilën ishin duke punuar para se të shkontenë pushimpa pagesë, dorëheqjeosepensionim¹¹; dhe (iii) marrja në punëe tyre nukdo të krijojë njëkonflikt të interesit(shih paragrafin 1.9).

- (e) Një firmëosenjë individ i sanksionuarnga Banka nëpajtim menën-paragrafin (d) të paragrafit1.23tëkëtyre Udhëzimeveose në përputhje me politikat e Grupit të Bankës Botërorekundër korrupsionitdhe procedurat e sanksionimit¹²nuk posedojnë zotësi juridike përtë pranuar kontratë tëfinancuar nga Banka, apopër të përfituar nganjë kontratëe financuar nga Banka, financiarishtose në ndonjë mënyrëjtjetër, gjatënjë periudhe të tillëkohore, të cilën e përcakton Banka.

Kontraktimi në avans dhe financimi retroaktiv

1.14 Në rrethana të caktuara, siç janë ato për të përshpejtuar zbatimin e projektit, Huamarrësi mund, pa kundërshtimin e Bankës, të vazhdojë me zgjedhjen e konsulentëve para se Marrëveshja e lidhur për Kredi të jetë nënshkruar. Ky proces quhet kontraktimi paraprak apo në avans. Në raste të tilla, procedurat e përzgjedhjes, duke përfshirë shpalljen, duhet të jenë në përputhje me këto udhëzime, dhe Banka shqyrton procesin e përdorur nga Huamarrësi. Huamarrësi merr përsipër kontraktimin e tillë në avans në rrezik të vet, dhe çfarëdo miratimi të lëshuar nga Banka në lidhje me procedurat, dokumentacionin, ose propozimin për dhënien nuk obligon Bankën për të bërë një kredi për projektin në fjalë. Nëse kontrata nënshkruhet, rimbursimi nga Banka për pagesat e bëra nga Huamarrësi sipas kontratës para nënshkrimit të kredisë quhen financim retroaktiv dhe lejohet vetëm brenda limiteve të përcaktuara në Marrëveshjen e Huasë.

Asociimet ndërmjet konsulentëve

1.15 Konsulentët mund të bashkohen me njëri-tjetrin në formën e një sipërmarrje të përbashkët ose një marrëveshje nën-konsulente për të plotësuar fushat e tyre përkatëse të ekspertizës, për fuqizimin e anës teknike të propozimeve të tyre dhe për të vënë në dispozicion grupe të mëdha të ekspertëve, të sigurojnë qasje dhe metodologji më të mira, dhe, në disa raste, të ofrojnë çmime më të ulëta. Një bashkim i tillë mund të jetë për një afat të gjatë (të pavarur nga çdo detyrë e veçantë) ose për një detyrë të veçantë. Nëse Huamarrësi punëson një grupim në formën e një sipërmarrjeje të përbashkët, shoqata emëron një apo më shumë firma që të përfaqësojnë shoqatën; gjithë anëtarët e ndërmarrjes së përbashkët, ose përfaqësuesit e tyre me autorizim për përfaqësim, nënshkruajnë kontratën. Të gjithë anëtarët e ndërmarrjes së përbashkët do të jenë

¹¹Në rastin edorëheqjesose tëdaljes në pension,për një periudhëprej së paku gjashtëmuajsh,ose periudhën epërcaktuar ngadispozitat ligjoreqë zbatohen përnëpunësit civilënë vendine Huamarrësit, cilado qëështë më e gjatë. Profesorëtapo stafidheekspertënëfusha të specializuaranga universitetet, institucionet arsimore,dhe institutet kërkimoremundtë kontraktohennë mënyrë individualeme orar jo të plotë, me kusht që ata kanë qenëtë punësuar me orar të plotëne institucionete tyreper një vitapo më shumëpara se tëkontraktohendhepunësimii tillëjustifikohetpër shërbimete kërkua.

¹²Për qëllime të këtijnën-paragrafi, politikat më relevante të Grupit të Bankës Botërorekundër korrupsionitjanë të përcaktuaranë Udhëzimetpër parandalimin dheluftën kundër mashtrimitdhe korrupsionit nëprojektet e financuaranga Huatë e IBRD-s dhe Kreditë dhe Grantet e IDA-sëdhe Grantet, dhe Udhëzimeve kundër korrupsion për IFC, MIGA dhe për Garancat e Transaksioneve të Bankës Botërore.Proceduratsanksionuese të Bankësjanë shpalosurpublikishtnë faqen e internetittë jashtëm tëBankës.

bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për detyrën në tërësi. Pasi lista e ngushtë të jetë finalizuar, dhe Kërkesat për Propozime (KP), të jenë lëshuar, çdo shoqatë në formën e ndërmarrjes së përbashkët ose nën-konsulente në mesin e firmave në listë të ngushtë do të jenë të lejueshme vetëm me miratimin e Huamarrësit. Huamarrësi nuk u kërkon konsulentëve të formojnë shoqata me ndonjë firmë të caktuar ose grup të firmave apo të përfshijnë ndonjë individ të caktuar në propozimet e tyre, por mund të nxisin krijimin e një shoqate me firma të kualifikuar kombëtare.

Shqyrtimi, ndihma dhe monitorimi nga Banka

- 1.16 Banka rishikon punësimin konsulentëve të Huamarrësit për t'u kënaqur procesin e përzgjedhjes së kryerë përputhje me dispozitat e Udhëzimeve. Procedurat për shqyrtim janë përshkruar në Aneksin 1.
- 1.17 Në rrethanat jashtëzakonshme, kur Huamarrësinuk është në gjendje të përgatisë një listë të ngushtë apo listë të gjatë dhe në përgjigje të kërkesës së sajme shkrim, Banka mund të ndihmojë Huamarrësin në hartimin e listës së ngushtë¹³ ose listës së gjatë¹⁴ të firmave të cilat Banka pret që të jenë të afta të ndërmarrin detyrën. Ofrimi i një liste të tillë nuk përfaqëson një miratim të konsulentëve. Huamarrësi mban përgjegjësinë që të verifikojë përshkrimet dhe kualifikimet e firmave të listuara, dhe mund të fshijë ndonjë emër ose të shtojë emra të tjerë sipas dëshirës, megjithatë, lista përfundimtare e ngushtë i dorëzohet Bankës për miratim parase Huamarrësi të lëshojë RFP-në.
- 1.18 Huamarrësi është përgjegjës për mbikëqyrjen e performancës së konsulentëve dhe për t'u siguruar që ata të kryejnë detyrën përputhje me kontratën. Pavarësisht përgjegjësisë së Huamarrësit ose konsulentëve, stafi i Bankës monitoron cilësinë e punës së konsulentëve sipas nevojës për t'u kënaqur ajo është duke u realizuar sipas standardeve të duhur dhe është e bazuar në të dhënat e besueshme. Sipas rastit, Banka mund të marrë pjesë në diskutimet midis Huamarrësit dhe konsulentëve dhe, nëse është e nevojshme, mund të ndihmojë Huamarrësin në adresimin e çështjeve që lidhen me detyrën. Nëse një pjesë e rëndësishme e detyrës është duke u kryer në selinë e konsulentëve, Banka mund, me marrëveshjetë Huamarrësit, të vizitojë këto zyra për të shqyrtuar punën e konsulentëve.

Keqprokurimi

- 1.19 Banka nuk financon shpenzimet në një kontratë për shërbime konsulente, nëse Banka konstaton se një kontratë tilla: (a) nuk është dhënë përputhje me dispozitat e miratuara në Marrëveshjen e Huasëdhjetë shtjelluar më tej në Planin e Prokurimit¹⁵, për të cilat Banka ka dhënë miratim; (b) nuk mund të jepet konsulentit i cili përndryshe është shpallur fitues për shkak të sjelljes së qëllimshme vonuese apo veprimeve të tjeratë Huamarrësit që rezultojnë në vonesë të pajustificueshme, ose mos disponueshmërinë e një propozimi të suksesshëm, ose refuzim të gabuar të ndonjë propozimiose (c) përfshin përfshirjen e ndonjërit nga përfaqësuesi i Huamarrësit, ose një pranuesi të ndonjë pjesë të të ardhurave të Huasë, në mashtrim dhe korrupsion sipas paragrafit 1.23(c). Në rastet tilla, qoftë nën shqyrtim paraprak apo pasues, Banka shpall keq prokurim, dhe është politika e Bankës që të anulohet atë pjesë e huasë së alokuar

¹³ Lista e ngushtë: shih paragrafin 2.6, 2.7 dhe 2.8

¹⁴ Lista e gjatë: një listë preliminare e firmave potenciale nga të cilat mund të hartohet lista e ngushtë

¹⁵ Shih paragrafin 1.25.

pershërbimet që kanë qenë keq prokuruar. Përveç kësaj, Banka mund të ushtrojë tjetër parashikuar në Marrëveshjen e Huasë. Edhe pas kontratës së miratimit nga Banka, Banka mund të deklarojë keq prokurim dhe të aplikojë në tërësi politikë të saj dhe mjetet juridike pavarësisht nëse kredia është mbyllur apo jo, nëse konstaton semiratimi është lëshuar në bazë të informatave jo të plota, të pasakta ose mashtruesetë siguruar nga Huamarrësit dhe kushtet kontratës janë ndryshuar modifikuar ndjeshëm pa asnjë miratim të Bankës.

Referencat Bankës

- 1.20 Huamarrësi përdor tekstin vijues¹⁶ kur iu referohet Bankës në RFP (kërkesën për propozime) dhe në dokumentet e kontratës:

“[Emri i Huamarrësit] ka pranuar [ose, ka parashtruar kërkesë për] një [hua] nga [Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim] (Banka) në shumën e cila është barazi me US\$ _____, për të financuar koston e [emri i projektit] dhe synon ta përdor një pjesë të mjeteve të kësaj [huaje] për pagesat e pranueshme sipas kësaj Kontrate. Pagesat nga Banka bëhen me kërkesë të [emërtimi i Huamarrësit apo i personit të emëruar] dhe me aprovim të Bankës dhe në të gjitha aspektet, iu nënshtrohen termave dhe kushteve të Marrëveshjes së [huasë]. Marrëveshja e [huasë] ndalon tërheqjen nga Llogaria e [huasë] me qëllim të pagesës për pagesa të personave apo subjekteve, apo për import të mallrave, nëse pagesa apo importi i tillë, me sa është Banka në dijeni, është e ndaluar me vendim të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, të marrë në kuadër të Kapitullit të VII-të të Kartës së Kombeve të Bashkuara. Asnjë palë tjetër, përveç [emri i Huamarrësit] ka të drejta sipas Marrëveshjes së [huasë] apo ndonjë kërkesë mbi mjetet e [huasë].”

Trajnimi apo transferi i dijes

- 1.21 Nëse detyra përfshinë një komponentë të rëndësishme për trajnimin apo bartjen e dijes stafit të Huamarrësit apo konsulentëve vendorë, termat e referencës duhet të cekin pikësynimet, natyrën, fushëveprimin dhe qëllimet e programit të trajnimit, përfshirë detajet mbi trajnerët dhe vijuesit, shkathtësitë të cilat duhet të barten, kornizën kohore, si dhe marrëveshjet për monitorim dhe vlerësim. Kostoja për programin e trajnimit përfshihet në kontratën e konsulentit dhe në buxhetin e detyrës.

Gjuha

- 1.22 RFP dhe Propozimet epërgatituranë jëren nga gjuhët e mëposhtme, të përzgjedhura nga Huamarrësi: anglisht, frëngjisht, ose spanjisht. Përveçnjë nga gjuhët emësimet, Huamarrësika mundësi të nxjerrë versionet e përkthyer të këtyre dokumenteve në një gjuhë tjetër cilaose duhet të jetë: (i) e gjuhë kombëtare të Huamarrësit; ose (ii) gjuha e përdorur gjerësisht në vendin e Huamarrësit për transaksionet komerciale, në tekstin e mëtejshëm, çdo gjuhë e tillë quhet gjuhë kombëtare¹⁷. Kurlista e ngushtë përfshin vetëm shtetasit sipas paragrafit 2.7, Banka mund

¹⁶Të ndryshohet rrjedhimisht në rast të kredisë nga IDA ose granti, ose fondi i trustit.

¹⁷Banka duhet të kënaqet me gjuhën që do të përdoret. Huamarrësi merr përgjegjësi të plotë për përkthim korrekt të dokumenteve në gjuhën kombëtare. Në rast të ndonjë mospërputhjeje me dokumentet në gjuhën angleze, frënge apo spanjolle, teksti këtyre të fundit është meritor. Nëse Huamarrësika më shumë se një gjuhë kombëtare dhe një ligj kombëtar kërkon akte zyrtare që do të lëshohen në

të bie dakord që Huamarrësi ta lëshojë RFP-në vetëm në gjuhën kombëtare. Nëse RFP-ja është lëshuar në dy gjuhë, konsulentët do të kenë mundësinë të paraqesin propozimet, nënjerin prej dy gjuhëve në të cilat është lëshuar RFP-ja. Kontrata e nënshkruar me konsulentin fitues gjithmonë është në gjuhën në të cilën është paraqitur propozimi i tij, që do të jetë gjuhë që rregullon marrëdhëniet kontraktuale ndërmjet Huamarrësit dhe konsulentit. Nëse kontrata është nënshkruar në gjuhën kombëtare, Huamarrësi i siguron Bankës përkthim të saktë të kontratës në anglisht, frëngjisht ose spanjisht, kur dorëzon kontratën origjinale sipas Aneksit I. Konsulentët as nuk obligohet dhe as lejohet të nënshkruajnë kontrata në më shumë se një gjuhë.

Mashtrimi dhe korrupsioni

1.23 Është politika e Bankës që të kërkojë që huamarrësit (përfshirë përfituesit e kredive bankare), këshilltarët, dhe agjentët e tyre (qoftë të deklaruar apo jo), nënkontraktuesit, nën-konsulentët, ofruesit e shërbimeve apo furnizuesit, dhe personeli i tij, të respektojnë standard të lartë të etikës gjatë përzgjedhjes dhe ekzekutimit të kontratave të financuara nga Banka¹⁸. Në zbatim të kësaj politike, Banka:

- (a) Definojnë, për qëllime të kësaj dispozite, termet e paraparë si në vijim:
 - (i) "Praktika e korruptuar" është ofrimi, dhënia, marrja apo kërkimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i ndonjë gjëje me vlerë për të ndikuar në mënyrë të paligjshme në veprimet e një pale tjetër¹⁹;
 - (ii) "praktikë mashtruese" është çdo veprim apo mosveprim, përfshirë shtrembërim që mashtron me dashje ose nga pakujdesia, ose tenton të mashtrtojë një palë për të marrë përfitim financiar ose tjetër, ose për të shmangur një obligim²⁰;
 - (iii) "Praktikat e marrëveshjes së fshehtë" është një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë palëve për të arritur një qëllim të pahijshëm, duke përfshirë për të ndikuar në mënyrë të paligjshme veprimet e një pale tjetër²¹;

të gjithë gjuhët kombëtare, Huamarrësi përdornë gjuhën kombëtare në RFP (KPP) dhe mund të nxjerrë versionet e përkthyer në gjuhë të tjera.

¹⁸Në këtë kontekst, çdo veprim i ndërmarrë nga një konsulent apo ndonjëri prej personelit të tij, ose agjentit të tij, aponga nën-konsulentët, nënkontraktuesit, furnizuesit, ofruesit e shërbimeve dhe / ose punonjësit e tij, për të ndikuar në procesin e përzgjedhjes ose ekzekutimit të kontratës përkrijimin e një avantazhi jo të duhur konsiderohet i pahijshëm.

¹⁹Për qëllime të këtij nën-paragrafi, "palë" i referohet një zyrtari publik i cili vepron në lidhje me procesin e përzgjedhjes ose ekzekutimit të kontratës. Në këtë kontekst "zyrtar publik" nënkupton stafin e Bankës Botërore dhe të punonjësve të organizatave të tjeratë cilët marrin ose rishikojnë vendimet e përzgjedhjes.

²⁰Për qëllime të këtij nën-paragrafi, "pala" i referohet një zyrtari publik; termet "përfitim" dhe "detyrim" lidhen me procesin e përzgjedhjes ose ekzekutimit të kontratës; dhe "veprim ose mosveprim" ka për qëllim që të ndikojë në procesin e përzgjedhjes ose ekzekutimit të kontratës.

²¹Për qëllime të këtij nën-paragrafi, "palët" iu referohen pjesëmarrësve në procesin e prokurimitose të përzgjedhjes (përfshirë zyrtarët publikë) të cilët tentojnë qoftë vetë, ose nëpërmjet një personi apo subjekti tjetër i cili nuk merr pjesë në procesin e prokurimitose të përzgjedhjes, për të simuluar konkurrencën apo për të fiksuar çmimet e kontratave në nivele artificiale, jo-konkurrese, ose kanë dijeni mbi çmimet ofertuese të njëri-tjetritose të kushteve të tjera.

- (iv) "praktika detyruese", është cenimi ose dëmtimi, apo kërcënimi për të cenuar ose dëmtuar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, çdo palë ose pronë të palës për të ndikuar në mënyrë të paligjshme në veprimet e një pale tjetër²²;
- (v) "praktika penguese"
 - (aa) shkatërrim, falsifikim, ndryshim ose fshehje e qëllimshme e provave që janë materiale për hetimin ose dhënia e deklaratave të rreme hetuesve në mënyrë që të pengojnë materialisht një hetim të Bankës rreth akuzave për praktika korruptive, mashtruese, detyruese, apo të fshehta, dhe / ose kërcënimi, ngacmimi, ose frikësimi i ndonjëpale për ta parandaluar atë nga shpalosja e njohuriverreth çështjeve relevante për hetimin apo për kryerjen e hetimeve, ose
 - (bb) aktet që synojnë që materialisht të pengojnë ushtrimin e inspektimit të Bankës dhe të drejtat e auditimit të paraparë me paragrafin 1.23(e) në vijim:
- (b) refuzonjë propozimpër dhënien nëse konstaton sekonsulentii rekomanduar për dhënie, apondonjë prejpersonelit, agjentëve,ose nën-konsulentëve të saj, nën-kontraktuesit, furnizuesit, ofruesit e shërbimevedhe / osepunonjësit e tyre, në mënyrë të drejtpërdrejt ose tërthorazi, janë përfshirë praktika korruptuese, mashtruese, të marrëveshjes së fshehtë, praktika shtrëngueseapopenguese për të konkurruar për kontratë në fjalë;
- (c) shpall keq prokurim dhe anulon pjesën e Huasë të alokuar një kontrate nëse konstaton në cilën do kohë se përfaqësuesit e Huasë apo të pranuesit të ndonjë pjese të mjeteve të Huasë janë përfshirë në praktikat korruptive, mashtruese, të fshehta, detyruese apo penguese gjatë procesit të përzgjedhjes apo gjatë implementimit të kontratës në fjalë, ndërsa Huamarrësi nuk ka ndërmarrë masa të duhura dhe me kohë, të kënaqshme për Bankën, për të shtjelluar praktikat e tilla kur ato paraqiten, përfshirë mos informimin e Bankës me kohë, dhe atë në momentin kur vihen në dijeni për praktikat e tilla;
- (d) sanksionon një firmë ose një individ, në çdo kohë, në përputhje me procedurat e Bankës mbi Sanksionet²³, përfshirë shpalljen e një firme apo individi të tillë si të papërshtatshëm, qoftë për një periudhë të pacaktuar ose për një periudhë të caktuar kohore: (i) për dhënien e kontrate të financuar nga Banka, dhe (ii) për

²²Për qëllime të këtijën-paragrafi, "partia" i referohet një pjesëmarrës në procesin e përzgjedhjes ose ekzekutimin e kontratës.

²³Një firmë apo individ mund të jetë shpallur i papërshtatshëm për të marrë një kontratë të financuar nga Banka pas:
(i) përfundimit të procedurave sanksionuese të Bankës të cilat kryhen sipas procedurave të saj për sanksione, duke përfshirë, ndër të tjera, edhe ndër-përrjashtimin e dakorduar me Institucionet e tjerë financiare ndërkombëtare, përfshirë Bankat shumëpalëshe zhvillimore, dhe përmes aplikimit të procedurave të Grupit të Bankës Botërore për aplikim të dënimeve për mashtrim dhe korrupsion; dhe (ii) si pasojë e pezullimit të përkohshëm ose pezullimit të hershëm të përkohshëm në lidhje me një procedurë të sanksionimit në zhvillim e sipër. Shih fusnotën 12 dhe paragrafin 8 të Aneksit 1 të këtyre Udhëzimeve.

t'u emëruar²⁴ si nën-konsulent, furnizues apo ofrues i shërbimeve të një firme tjetër të privilegjuar të cilës i është dhënë një kontratë e financuar nga Banka;

- (e) kërkon që të përfshihet ndonjë klauzolë në KPP dhe në kontratat e financuara nga një kredi e Bankës me të cilën konsulentit, agentit, personelit, nën-konsulentëve, apo nën-kontraktorëve, ofruesve të shërbimeve apo furnizuesve të lejojnë Bankën të inspektojë të gjitha Llogaritë, regjistrat dhe dokumentet e tjera që lidhen me dorëzimin e propozimeve dhe performancën e kontratës, dhe që ato të auditohen nga auditorë të emëruar nga Banka; dhe
- (f) kërkon që, kur një Huamarrësi përzgjedh një agjencion të Kombeve të Bashkuara (OKB) për të ofruar shërbime të asistencës teknike në përputhje me paragrafin 3.15 e në bazë të një marrëveshjeje të nënshkruar midis Huamarrësit dhe agjencisë së OKB-së, dispozitat e mësipërme të këtij paragrafi 1.23 lidhur me sanksionet për mashtrim ose korrupsion zbatohen në tërësi për konsulentët dhe nën-konsulentët, furnizuesit, ofruesit e shërbimeve, kontraktorët, nënkontraktorët, dhe punonjësit e tyre, të cilët nënshkruan kontrata me agjencinë e OKB-së. Si një përjashtim nga e mësipërmja, nën-paragrafët 1.23 (d) dhe (e) nuk vlejnë për agjencinë e OKB-së dhe punonjësit e saj, ndërsa nën-paragrafi 1.23 (d) nuk vlen për kontratat në mes të agjencisë të OKB-së dhe furnizuesit dhe ofruesit e saj të shërbimeve. Në raste të tilla, agjencitë e OKB-së aplikojnë rregullat dhe rregulloret e tyre për hetimin e pohimeve për mashtrim ose korrupsion në bazë të termave dhe kushteve për të cilat Banka dhe agjencia e OKB-së mund të bien dakord, duke përfshirë edhe një detyrim që periodikisht të informojnë Bankën mbi vendimet dhe veprimeve të marra. Banka mban të drejtën të kërkojë nga huamarrësi që të aplikojë mjete të tilla siç janë pezullimi ose ndërprerja e kontratës. Agjencitë e OKB-së konsultojnë listën e Bankës mbi firmat dhe individëte pezulluar ose të përjashtuar. Në rast se një agjenci e OKB-së nënshkruan një kontratë ose urdhër blerje me një firmë ose një individ të pezulluarose të ndaluar nga Banka, Banka nuk financon shpenzimet e ndërlidhura dhe aplikon mjete të tjera juridike, sipas nevojës.

1.24 Mepëlqim të veçantët të Bankës, një Huamarrës mund të vendos, në KPP-tëpërkontratat e financuar nga Banka, një kërkesë që konsulentit të përfshijë në propozim një zotim të konsulentit për të vëzhguar, gjatë konkurrencës dhe ekzekutimit të kontratës, ligjet e shtetit kundër mashtrimit dhe korrupsionit (duke përfshirë atyre kundër mitos), të cilat cekën në KPP²⁵. Banka pranon futjen e një kërkesë të tillë me kërkesëtë vendit Huamarrës, me kusht që arranzhmanet të cilat rregullojnë një sipërmarrje të tillë të jenë të kënaqshme për Bankën.

Plani i prokurimit

²⁴Njën nën-konsulent, furnizues, ose ofrues i emëruar i shërbimit është ai i cili: (i) ose është përfshirë nga konsulentin e propozimit etij, sepse sjell përvojë të veçantë dhe kritik dhedije të cilat jepen në vlerësimin teknik të propozimit të konsulentit për shërbime të veçanta, ose (ii) është emëruar nga Huamarrësi.

²⁵Si një shembull, një zotim i tillë mund të formulohet si vijon: "Ne zotohemi se, gjatë konkurrencës për (dhe, në qoftë se na jepet kontrata, gjatë ekzekutimit të) kontratës së mësipërme, ne do të respektojmë ligjin në fuqi kundër mashtrimit dhe korrupsionit në vendin e Klientit, të cilat janë cekur nga klienti në KPP-në për këtë kontratë."

1.25 Përgatitja e një plani realist të prokurimit²⁶ për një projekt është me rëndësi kritike për monitorimin dhe zbatimin e tij të suksesshëm. Si pjesë e përgatitjes së projektit, Huamarrësi përgatit një plan paraprak të prokurimit, sado tentativë të jetë, për tërë fushëveprimin projektit. Si minimum, Huamarrësi përgatit një plan të detajuar dhe gjithëpërfshirës të prokurimit duke përfshirë të gjitha kontratat për të cilat bëhet përzgjedhja e firmave dhe individëve bëhet për 18 (tetëmbëdhjetë) muajt e parë të zbatimit të projektit. Marrëveshja me Bankën arrihet më së largu gjatë negociatave për huanë. Huamarrësi azhurnon planin e prokurimit gjatë tërë kohëzgjatjes së projektit të paktën çdo vit, duke përfshirë kontratat e dhëna më parë dhe ato që do të prokurohen në 12 (dymbëdhjetë) muajt pasuese. Të gjitha planet e prokurimit, përditësimet apo modifikimet e tyre iu nënshtrohen shqyrtimit²⁷ paraprak të Bankës dhe miratimit para zbatimit. Banka organizon negociata kredisë publikimi në faqen e internetit të jashtëm të Bankës së planit të rënë dakord prokurimit fillestar dhe të gjitha përditësimet e mëpasshme pasi ajo ka dhënë miratimin.

²⁶Plani i prokurimit, duke përfshirë përditësimet e tyre përcaktojnë së paku: (i) një përshkrim të shkurtër të shërbimeve të konsulencës të kërkuara për projektin për të cilin ftesa përpropozimet do të lëshohet gjatë periudhës në fjalë; (ii) metodat e propozuara të përzgjedhjes të cilat lejohen sipas marrëveshjes së kredisë; (iii) kushtet e Bankës për shqyrtim dhe pragjet (iv) orari kohor për aktivitetet kyçe të përzgjedhjes, dhe çdo informacion tjetër që Banka mund të kërkojë me arsye. Për projektet, ose komponentet e tyre, që janë tënxitur nga kërkesa siç janë Projektet e nxitura nga komuniteti (CDD), qasjet ndër-sektorale (SWA), etj, ku kontratat specifike, apo orare të tyre, nuk mund të identifikohen paraprakisht, dakordohet një shabllon i përshtatshëm i Planit të Prokurimit me Bankën për monitorimin dhe zbatimin e përzgjedhjes së konsulentëve. Nëse Projektet përfshijn prokurimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve jo-konsulente, Plani i prokurimit përfshin gjithashtu metodat për prokurimin e tyre në përputhje me *Udhëzimet: Prokurimi i Mallrave, Punët dhe Shërbimet jo-konsulente për huatë e IBRD dhe Grantet dhe kreditë e IDAs-së nga Huamarrësit e Bankës Botërore*.

²⁷Shih Aneksin I.

II. PËRZGJEDHJA E BAZUAR NË CILËSI DHE KOSTO (QCBS)

Procesi i përzgjedhjes

- 2.1 QCBS aplikon një proces konkurrues në mesin e firmave të listës së ngushtë e cila merr parasysh cilësinë e propozimit dhe koston e shërbimeve në përzgjedhjen e firmave të suksesshme. Kostoja si faktor i përzgjedhjes aplikohet me maturi. Pësia relative që do t'i jepet cilësisë dhe koston përcaktohen për çdo rast varësisht prej natyrës së detyrës.
- 2.2 Procesi i përzgjedhjes përfshin hapat vijues:
- (A) Përgatitjen e Termave të Referencës;
 - (B) Përgatitjen e vlerësimit të koston dhe buxhetit, dhe kriterëve për listë të ngushtë,
 - (C) Shpallja;
 - (D) Përgatitja e listës së ngushtë për konsulentët;
 - (E) Përgatitja dhe lëshimi i KPP-së [ku përfshihet: Letra e ftesës (LOI); Udhëzimet konsulentëve (ITC); TOR dhe drafti i propozuar i kontratës];
 - (F) Pranimi i propozimeve;
 - (G) Vlerësimi i propozimeve teknike; shqyrtimi i cilësisë;
 - (H) Hapja publike e propozimeve financiare,
 - (I) Vlerësimi i propozimit financiar;
 - (J) Vlerësimi përfundimtar i cilësisë dhe koston; dhe
 - (K) Negociatat dhe dhënia e kontratës për firmën e përzgjedhur.

Termat e referencës (TOR)

- 2.3 Huamarrësi është përgjegjës për përgatitjen e ToR përdetyrës. TOR-jaduhet të përgatitet nga personi(a) ose një firmë e specializuar në fushën e detyrës. Fushëveprimi i shërbimeve të përshkruara në TOR është në përputhje me buxhetin në dispozicion. TOR-jaduhet të përcaktojë qartë objektivat, qëllimet, dhe qëllimin e detyrës dhe të ofrojë informata (duke përfshirë një listë të studimeve ekzistuese relevante dhe të dhënave themelore) për t'u lehtësuar konsulentëve përgatitjen e propozimeve të tyre. Nëse synimi është transferimi i njohurive ose trajnimit, duhet të ceket në mënyrë specifike bashku me detajet e numrit të personelit të trajnuar, dhe kështu me radhë, për të mundësuar konsulentët që të vlerësojnë burimet e nevojshme. TOR-jaduhet të ceket shërbimet dhe ekspertizën e nevojshme për të kryer detyrën dhe rezultatet e pritshme (për shembull, raportet, të dhënat si hartat, anketat). Megjithatë, TOR nuk duhet të jetë shumë i detajuar dhe jo fleksibil, në mënyrë që konsulentët konkurrues të mund të

propozojë metodologjinë dhe personelin e tyre. Firmat duhet të inkurajohen që të komentojnë mbi TOR në propozimet e tyre. Përgjegjësitë përkatëse të Huamarrësit dhe të konsulentëve duhet të definojnë qartë në TOR.

Vlerësimi i kostos (buxheti)

2.4 Përgatitja e një vlerësimi mirë-menduar të kostos është thelbësore në qoftë se synohet rezervimi i burimeve realiste buxhetore. Vlerësimi i kostos bazohet në vlerësimin e burimeve që nevojiten për kryerjen e detyrës nga Huamarrësi: kohën e ekspertëve, përkrahjen logjistike dhe inputet fizike (për shembull, automjetet, pajisjet laboratorike). Kostot duhet të ndahen në dy kategori të gjera: (a) honorarët apo kompensimet (sipas llojit të kontratës të aplikuar) dhe (b) artikuj të rimbursueshëm, të cilët ndahen më tej në kosto të huaja dhe vendore. Kostoja e inputeve të kohës së ekspertëve vlerësohet bazuar në një vlerësim realist të ekspertizës së duhur ndërkombëtare dhe kombëtare. KPP tregon nivelin e parashikuar të kohës së ekspertëve ose kostos së vlerësuar totale të kontratës, por jo vlerësimet hollësisht janë honorarët.

Shpallja

2.5 Për të gjitha projektet, Huamarrësi është i detyruar të përgatisë dhe t'i paraqesë Bankës një Njoftim të Përgjithshëm të Prokurimit. Banka organizon publikimin e saj në *UN Development Business online* (UNDB online) dhe në ueb faqen e jashtme të Bankës²⁸. Për të marrë shprehje të interesit (EOI), Huamarrësi përfshin një listë të detyrave të pritura të konsulentëve në Njoftimin e përgjithshëm të prokurimit, dhe shpall kërkesë për shprehje të interesit (REOI) për firmat konsulente për çdo kontratë në gazetë kombëtare, me kusht që ajo është e qarkullimit të gjerë, apo të paktën në një gazetë apo revistë, teknike apo financiare, të qarkullimit kombëtar në vendin e Huamarrësit, ose në një portalesh elektronik kombëtar me përdorim të gjerë, me qasje të lirë vendore dhe ndërkombëtare në anglisht, frëngjisht apo spanjisht²⁹. Përveç kësaj, detyrat që pritet të kushtojnë më shumë se US \$ 300,000 reklamohen në *UNDB online*³⁰. Huamarrësi mund të ndërtojë një listë të tillatë reklamoj në REOI në një gazetë ndërkombëtare ose një revistë teknike apo financiare. Informacioni i kërkuar duhet të jetë minimumi i nevojshëm për të marrë një gjykim bërës për të përcaktuar nëse firmat duhet të mos jetë aq komplekse sa të dekurajojë konsulentët nga shprehja e interesit. REOI-të duhet të paktën përfshijnë informata të mëposhtme që vlejshme për detyrën: Kualifikimet e kërkuara dhe përvojat e firmës, por jo edhe të dhënat individuale të ekspertëve; kriteret për hartim të listës së ngushtë; dhe dispozitat e konfliktit të interesit. Lejohet jo më pak se 14 ditë ngadërrimi të postimit në *UNDB online* për përgjigjet, para përgatitjes së listës së shkurtër. Përgjigja e vonshme e përgjigjes në REOI nuk është shkak për refuzim përveç nëse Huamarrësi tashmë ka përgatitur listën e ngushtë, bazuar në EOI-të e pranuar, të cilat i plotësojnë kushtet e parapara me paragrafin 2.6.

²⁸UNDB është një publikim i Kombeve të Bashkuara. Informatat mbi parapagim gjenden nga: Development Business, United Nations, GCPO Box 5850, New York, NY 10163-5850, USA (ueb faqja: www.devbusiness.com; email: dsubscribe@un.org).

Ueb faqja e jashtme e Bankës Botërore: <http://www.worldbank.org>

²⁹Përveç kësaj, me vendimin e Huamarrësit, në gjuhën kombëtare, ashtu siç definohet në paragrafin 1.22.

³⁰Përjashtimisht, kur Banka të jetë pajtuar për një listë të ngushtë e cila përbëhet vetëm nga konsulentë vendor, Banka mund të pajtohet që Huamarrësi të mos publikojë kontratat mbi \$300,000 në *UNDB online*. Pragjet në dollarë amerikanë të dhënë në këto Udhëzime përfshijnë të gjitha tatimet dhe detyrimet, nëse vlejshme.

Banka organizon publikimin simultan të të gjitha REOI (kërkesave për shprehje të interesimit) të përgatitura dhe të parashtruara nga Huamarrësi në ueb faqen e jashtme të Bankës.

Lista e ngushtë e konsulentëve

- 2.6 Huamarrësi është përgjegjës për përgatitjen e listës së ngushtë. Huamarrësi së pari shqyrton firma të cilat kanë shprehur interesimin e që posedojnë kualifikime relevante. Listat e ngushtë përbëhet nga gjashtë firma me një përhapje të gjerë gjeografike, me (i) jo më shumë se dy firma nga ndonjë vend nëse nuk ka firma të tjera të identifikuar të kualifikuara për të përmbushur këtë kusht³¹; dhe (ii) të paktën një firmë nga një vend në zhvillim, përveç nëse ka mundur të identifikohen firma të kualifikuara nga vendet në zhvillim. Kur ndonjë nga kërkesat e mësipërme nuk mund të plotësohen në bazë të EOI-ve të marra, Huamarrësi mund të kërkojë drejtpërdrejt interesim nga firmat e kualifikuara bazuar në njohuritë e veta, ose t'i kërkojë ndihmë Bankës në përputhje me paragrafin 1.1 7. Përjashtimisht, Banka mund të bie dakord për listën e ngushtë që përbëhet nga një numër më i vogël i firmave, kur nuk ka firma të mjaftueshme të kualifikuara që kanë shprehur interes për ndonjë detyrë të veçantë, kur firma të mjaftueshme të kualifikuara nuk mund të identifikohen, ose kur madhësia e kontratës apo natyra e detyrës nuk e justifikon konkurrencën më të gjerë. Sapo Banka të ketë lëshuar miratimin për listë e ngushtë, Huamarrësi nuk e modifikon atë pa miratimin e Bankës. Firmave që kanë shprehur interes, si dhe çfarëdo firmave ose subjekteve tjeratë cilat në mënyrë specifike kërkojnë, iu sigurohet lista përfundimtare e ngushtë e firmave nga Huamarrësi.
- 2.7 Lista e shkurtër mund të përbëhet tërësisht nga konsulentët kombëtar (firma të regjistruara ose të inkuorpuara në vend), nëse detyra është nën tavanin (apo tavanet) e përcaktuara me Planin e Prokurimit të miratuar nga Banka³², një numër i mjaftueshëm i firmave të kualifikuara kombëtare është në dispozicion për të pasur një listë të ngushtë të firmave me kosto konkurruese, dhe kur konkurrenca e cila përfshin konsulentë të huaj nga aspekti *prima facie* nuk arsyetohet apo kur konsulentët e huaj nuk kanë shprehur interesim. Këto tavanet e njëjta do të përdoren në operacionet kredituese të Bankës në mbështetje të Qasjeve mbarë-sektoriale (SWAp)³³ (ku fondet e qeverisë dhe/ose të donatorit janë duke u grumbulluar) pasi që pragu nën të cilin do të hartohen listat e ngushta do të përbëhen tërësisht nga firmat kombëtare të përzgjedhura sipas procedurave të dakorduara me Bankën. Mirëpo, nëse firmat e jashtme shprehin interesim, ato duhet të merren parasysh.

³¹Për qëllim të krijimit të njëliste të ngushtë, kombësia e firmave është e vendit në të cilin ajo është e regjistruar apo inkuorpuar, dhe, në rastin e Sipërmarrjeve të Përbashkëta, me kombësinë e partnerit të saj të udhëheqës.

³²Tavanet të shprehura në dollar duhet të përcaktohen në secilin rast, duke marrë parasysh natyrën e projektit, kapacitetin e konsulentëve kombëtar, dhe kompleksitetin e detyrave. Tavanin (apo tavanet) normalisht nuk tejkalojnë shumën e përcaktuar në Raportin e Vlerësimit të Prokurimeve të Vendit (CPAR) për vendin e huamarrësitose vlerësime të tjera të ngjashme të kryera nga Banka. Tavanet në dollarë përcelilin vendtë huamarrjesdo të postohen në ueb faqen e jashtme të Bankës.

Banka mund të bie dakord, në qoftë se kërkohet nga Huamarrësi, që RFP-të përdetyratë tilla të përfshijnë një klauzolë të cilën Banka shpall të papërshtatshme përfinancimin e një firmë të vendit huamarrës e cila është nën një sanksion të përjashtimit nga dhënia e një kontratë nga autoriteti përkatës gjyqësor të vendit të huamarrësit dhe në pajtim me ligjet e tij përkatëse, me kusht që Banka të ketë konstatuar se firma është përfshirë në masat e korrupsionit dhe procesin gjyqësor ka dhënë firmën procesin e edukimit gjyqësor.

³³SWAppërfaqësojnë një qasjen e agjencitë për zhvillim për të mbështetur programet e udhëhequr nga shteti shkalla e të cilëve është më e madhe sa një projekt vetëm. Kjo zakonisht përfshin një sektor të tërë ose pjesë të mëdha të tij.

2.8 Lista e shkurtër duhet normalisht të përbëhet ngakëshilltarët në një të njëjtën kategorime objektivat të ngjashme të biznesit, kapaciteti korporativ, përvojë dhe fushë të ekspertizës, dhe sekanë ndërmarrëdetyratë njënatyre dhe kompleksiteti të ngjashme. Ndërmarrjet ose institucionet shtetërore dhe organizatat jo-fitimprurëse (OJQ-të, Universitetet, Agjencitë OKB-së, etj), normalisht nuk duhet të përfshihen në të njëjtën listë të shkurtër së bashku me firmat e sektorit privat, nëse ato vepronin si subjekte tregtare të cilat përbushin kushtet e paragrafit 1.13(b) të këtyre Udhëzimeve. Nëse është palikuar përzierja, zgjedhja duhet normalisht të bëhet duke përdorur Përzgjedhjen e bazuar në cilësinë (QBS) ose Përzgjedhjen e bazuar në kualifikimet e konsulentëve (CQS) (për detyra të vogla)³⁴. Lista e shkurtër nuk do të përfshijë konsulentë individualë. Së fundi, në qoftë se firma e njëjtë është konsideruar për përfshirje në listat e ngushta për detyra të ngjashme, Huamarrësit duhet të konsiderojnë kapacitetin e përgjithshëm të firmës për të kryer kontratatë shumtapa se ta përfshijë edhe atë në më shumë se një listë të ngushtë.

Përgatitja dhe lëshimi i kërkesës për propozime (KPP)

2.9 Kërkesa për propozime (KPP) përfshin (a) Letrën e thirrjes, (b) Udhëzime konsulentëve dhe Tabelën e të dhënave, (c) TOR, dhe (d) llojin e propozuar të kontratës. Huamarrësit aplikojnë KPP-të standarde të lëshuara nga Banka me pagesa standarde, të pranueshme për Bankën, sipas nevojës, për të shtjelluar kushtet specifike të projektit. Të gjitha ngarkesat e tilla parashihen vetëm përmes tabelës së të dhënave të KPP-së. Huamarrësit listojnë të gjitha dokumentet e përfshira në KPP. Huamarrësi mund të përdorë ndonjë sistem elektronik për të shpërndarë KPP-në, me kusht që Banka është e kënaqur se sistemi i tillë është adekuat. Nëse KPP-ja shpërndahet në mënyrë elektronike, sistemi elektronik duhet të jetë i sigurt për t'iu shmangur ndryshimeve në KPP dhe nuk kufizon qasjen e konsulentëve të listës së ngushtë në KPP.

Letra e thirrjes (LOI)

2.10 LOI deklaron synimin e Huamarrësit për të lidhur kontratë për ofrimin e shërbimeve të konsulencës, burimin e fondeve, detajet për klientin dhe datën, kohë dhe adresën për parashtrim të propozimeve.

Udhëzimet konsulentëve dhe tabela e të dhënave (ITC)

2.11 ITC përmban të gjitha informatat e nevojshme të cilat do t'iu ndihmojnë konsulentëve që të përgatisin propozime të përgjegjshme, dhe sjellin sa më shumë transparencë që të jetë e mundur përkitazi me procedurën e përzgjedhjes, duke ofruar informata mbi procesin e vlerësimit dhe duke cekur kriteret dhe faktorët e vlerësimit si dhe peshën e tyre përkatëse, së bashku me poenat minimale kualifikuese të cilësisë. ITC cek ose vlerësim të inputeve nga ekspertët kyç (në person për muaj) që kërkohen nga konsulentët ose vlerësimin e buxhetit, por jo edhe të dyja. Mirëpo, konsulentët, janë të lirë të përgatisin vlerësimin e tyre të kohës së nevojshme për ekspertin që të kryejë detyrën dhe të ofrojnë kosto gjegjëse në propozimet e tyre. Kur, në kontratat e bazuara

³⁴ Pragjet në dollarë, të cilat definojnë "të voglin" duhet të përcaktohen në secilin rast, duke marrë parasysh natyrën dhe kompleksitetin e detyrës, por nuk tejkalojnë US\$300,000 përveç në rastet e jashtëzakonshme siç janë ato emergjente të shpallura nga Huamarrësi dhe të pranuar nga Banka.

në kohë, shërbimet janë të natyrës rutinore ose nuk kërkojnë ndonjë qasje inovative, Huamarrësi mund, me kusht që Banka nuk ka kundërshtim, t'u kërkojë konsulentëve që të përfshijnë në propozimin e tyre të njëjtin nivel të kohës së ekspertit, si ajo e cekur në KPP, dhe në rast se kjo nuk bëhet, propozimi financiar ndryshohet me qëllim të krahasimit të propozimeve dhe marrjes së vendimit për dhënie. ITC-ja cakton periudhën e vlefshmërisë së propozimeve, e cila duhet të jetë adekuate për vlerësim të propozimeve, marrjen e vendimit për dhënie të kontratës, shqyrtimin nga Banka, dhe finalizimin e negociatave për kontratë. Lista e hollësishme e informatave përfshihet në ITC, ashtu siç parashihet në Aneksin 2.

Kontrata

2.12 Seksioni IV i këtyre Udhëzimeve shkurtimisht përshkruan llojet më të zakonshme të kontratave. Huamarrësit duhet të përdorin formularin gjegjës standard të kontratës të lëshuar nga Banka, me ndryshime minimale të pranueshme për Bankën, të cilat mund të jenë të nevojshme për të adresuar çështje specifike të vendit dhe të projektit. Çdo ndryshim i tillë futet vetëm përmes Tabelave të të dhënave të kontratësore në Kushtet e Veçanta të Kontratës dhe jo duke futur ndryshimet në formulimin e Kushteve të Përgjithshme të Kontratës, të përfshira në formularin standard të Bankës. Këto forma të kontratës mbulojnë shumicën e shërbimeve të konsulencës. Kur këto forma nuk janë të përshtatshme (për shembull, për inspektim para-dërgesë, shërbime të prokurimit, trajnimin e studentëve në universitete, aktivitetet reklamuese në privatizim, apo binjakëzim) Huamarrësit përdorin forma të tjera të kontratave të pranueshme për Bankën.

Pranimi dhe hapja e propozimeve

2.13 Huamarrësi lejon kohë të mjaftueshme që konsulentët të përgatisin propozimet e tyre. Koha e lejuar është në varësi të detyrës, por normalisht nuk do të jetë më pak se katër javë ose më shumë setremuaj (për shembull, përdetyra që kërkojnë themelimin e një metodologjietë sofistikuar, përgatitjen e një masterplan multidisiplinar). Gjatë kësaj intervale, firmat mund të kërkojnë sqarime lidhur me informatat e dhënë në KPP. Huamarrësi ofron këto sqarime shkrim dheua dërgon të gjithë firmave listën e shkurtër (që kanë ndërmend të paraqesin propozime). Nëse është e nevojshme, Huamarrësi zgjat afatin kohor të përdorimit të propozimeve. Propozimet teknike dhe financiare duhet të dorëzohen në të njëjtën kohë. Asnjë ndryshim në propozimin teknik apo financiar nuk pranohet pas afatit, megjithatë propozimet ndryshuar mund të dorëzohen para afatit të tillë. Për të mbrojtur integritetin e procesit, propozimet teknike dhe financiare duhet të dorëzohen në zafte të veçanta të vulosura. Një komiteti zyrtarëve i formuar nga departamentet përkatëse të Huamarrësit (teknike, financiare, ligjore, sipas nevojës), hapin të gjitha propozimet teknike të pranuar deri në afatin për dorëzimin e propozimeve në vendin e caktuar, të përcaktuar në KPP, pavarësisht nga numri i propozimeve të pranuar deri në afat të tillë. Në hapjen e propozimeve teknike, në praninë e këshilltarëve të cilët dëshirojnë të marrin pjesë, Huamarrësi as nuk refuzon dhe as diskuton meritat e ndonjë propozimi.

Të gjitha propozimet pranuar pas afatit të fundit deklarohen të vonuar dhe refuzohen dhe u kthen menjëherë të papajtura. Komiteti duhet të lexojë me zë të lartë emrat e këshilltarëve të cilët kanë parashtruar propozimet, praninë ose mungesën e zafave të mbyllura financiare, si dhe çdo informacion tjetër që konsiderohet i duhur. Propozimet financiare mbeten të mbyllura dhe dorëzohen tek një auditor publik me

reputacionose tek ndonjë autoritet i pavarur³⁵ deri sa të hapenë përputhje me paragrafin 2.23. Huamarrësit mund të përdorin sistemet elektronike që u lejojnë konsulentëve të dorëzojnë propozime me mjete elektronike, me kusht që Bankatë jetë e kënaqur mepërshtatshmërinë e sistemit, duke përfshirë, ndër të tjera, sistemet është isigurt, ruankonfidencialitetin, integritetin dhe origjinalitetin e propozimeve të paraqitura, dhe përdorin një sistem elektronik në shkëmbim të ngjashëm në mënyrë që konsulentët të mbesin të obliguar ndaj propozimeve të tyre.

Qartësimi apo ndryshimi i propozimeve

2.14 Përveç kur parashikohet ndryshe në paragrafët 2.27 – 2.29 e Seksionit II dhe paragrafit (p) të Aneksit 2 të këtyre Udhëzimeve, konsulentëve as do t'u kërkohet dhe as t'u lejohet të ndryshojnë propozimet e tyre në asnjë mënyrë pas afatit të fundit për dorëzimin e propozimeve. Ndërsa vlerësimin e propozimeve, Huamarrësi e kryen vlerësimin vetëm mbi bazën e propozimeve të paraqitura teknike dhe financiare, dhe nuk kërkon sqarime nga konsulentët, përveç për pyetje sipërfaqësore dhe atë pa kundërshtimin paraprak të Bankës.

Vlerësimi i propozimeve: shqyrtimi i cilësisë dhe kostos

2.15 Vlerësimi i propozimeve kryhet në dy faza: së pari cilësia, dhe pastaj kostoja. Vlerësimi i propozimeve teknike nuk duhet të kenëqasjenë propozime financiare deri sa vlerësimi teknik, duke përfshirë të gjitha rishikimet Bankare dhe miratimet e saj, të ketë përfunduar. Propozimet financiare hapen vetëm pas kësaj. Vlerësimi kryhet në përputhje të plotë me dispozitat e KPP-së.

Vlerësimi i cilësisë

2.16 Duke pasur parasysh nevojën për shërbimet e cilësisë së lartë, cilësia e vlerësimit të propozimeve teknike është e rëndësishme më të lartë. Huamarrësi vlerëson çdo propozim teknik duke përdorur një komision vlerësues prej të paktën tre, dhe zakonisht jo më shumë seshtatë anëtarë të përfshirë specialistë të kualifikuar në sektorin detyrës në konsideratë. Çdo anëtar i komisionit nuk duhet të jetë në situatë të konfliktit të interesit sipas paragrafit 1.9(c), dheta vërtetojë këtë para pjesëmarrjes në vlerësim. Kur Banka konstaton se vlerësimi teknik është në kundërshtim me KPP-në apo nuk vlerëson si duhet pikat e forta apo të dobëta të propozimeve, dhe komisioni dështon të jelojë situatën në kohën e duhur, Banka mund të kërkojë nga huamarrësi që të formojë një komision të ri vlerësimi, duke përfshirë ekspertë ndërkombëtarë në sektorin e detyrës, nëse është e nevojshme.

2.17 Vlerësimi teknik merr parasysh kriteret e cekura në paragrafin 2.18 dhe nën-kriteret e përshkruar në paragrafët 2.20 dhe 2.19, të pasqyruar në KPP. KPP përshkruan çdo kriter dhe nën-kriter të tillë së bashku rezultatat maksimale relative të tyre dhe të zbulojë rezultatin minimal të përgjithshëm teknik nën të cilin një propozim do të refuzohet sipas i përgjegjshëm. Vargu i ndikativit për pikat e përgjithshme minimale teknike fillon me 70 deri në 85 (70 deri në 85) në shkallën prej 1 deri në 100 (një deri në njëqind). Rezultat maksimal për çdo kriter pyetësor dhe pikat e

³⁵Një subjekt i pavarur nuk guxon të ketë interesa direkte apo indirekte apo përfshirje me detyrën në fjalë.

përgjithshmeteknike,
kompleksitetittdetyrëspecifike.

përcaktohennëbazëtënatyrës dhe

- 2.18 Kriteret përfshijnë: (a) përvojën relevante të konsulentitpërdetyrën, (b) cilësinë emetodologjisë sëpropozuar,(c) kualifikimet eekspertëve kryesorëtë propozuar, (d) transferimin e njohurive, nëse kërkohet nga TOR, dhe (d) shkallae pjesëmarrjes sështetasvenë mesin eekspertëve kryesorënë kryerjen edetyrës.Këto duhet të jenë brenda gamës indikative tërezultatevetë specifikuaramë poshtë,përveçnëse Banka miraton ndryshe. Rezultati maksimal për "Pjesëmarrjen nga ekspertëtkombëtar", siç tregohet më poshtë, nukduhet të tejkalojnë10(dhjetë).

Përvoja specifike e konsulentit:	0 deri 10
Metodologjia:	20 deri 50
Transferi i djes ³⁶	30 deri 60
Pjesëmarrja e ekspertëve kombëtar ³⁷ :	0 deri 10
Gjithsej:	100

- 2.19 Huamarrësi normalishtndajnëkëto kriterënë nën-kritere. Çdo kriterpastaj dotë vlerësohetmbi bazënë peshavetë caktuara nënën-kritere përkatëse. Për shembull, nën-kriteret sipas metodologjisëmundtë jenë risidhe niveli i detajeve. Megjithatë, numri inën-kritereve duhet të mbetet tek ata thelbësor.Banka rekomandonkundër përdorimit tëlistavejashtëzakonisht tëdetajuara tënën-kritereveqë mund tabëjnëvlerësimin njëpunë mekanikemë shumë senjë vlerësimiprofesional tëpropozimeve.Pesha e dhënëpërvojës mund të jetë relativishtmodeste, pasi ky kriterdashmëështë marrë parasysh gjatë hartimit të listësë ngushtë të konsulentëve. Më shumë peshëduhet t'i jepetmetodologjisënë rast të detyravemë të ndërlikuara(për shembull,fizibiliteti shumëdisiplinar ose studimet e menaxhimit).

- 2.20 Vlerësohet vetëm ekspertët kyç. Pasi që ata në fund të fundit përcaktojnë cilësinë e punës, më shumë peshë duhet t'i jepet këtij kriteri nëse detyra e propozuar është komplekse. Pranuesi shqyrton kualifikimet dhe përvojën e ekspertëve kyç të propozuar në rezimënë e tyre, të cilat duhet të jenë të sakta, complete dhe të nënshkruara nga zyrtar i autorizuar i firmës konsulentë dhe individit të propozuar. Individët duhet të vlerësohen në tre nën-kritere vijuese, të cilat janë relevante për detyrën:

- (a) kualifikimet e përgjithshme: arsimi i përgjithshëm dhe trajnimi, kohëzgjatja e përvojës, pozitat paraprake, detyrat e mëparshme si ekspert i ekipit, përvoja në vendet në zhvillim, dhe kështu me radhë;

³⁶Transferi idijesmund të jetëobjektivikryesor idisadetyrave: në raste të tilla, kjo ceket nëTORdhe, vetëm me miratimin e Bankës mund të jepet njëpeshëmë e lartëpër të reflektuarrëndësinë e saj.

³⁷Siç pasqyrohet me pjesëmarrjen eshtetasvenë mesin eekspertëve kryesorë(të përfaqësuar qoftë nga firmat ehuaja apokombëtare), dhellogaritetsi raporti kohës së ekspertëvekyç kombëtar(në person-muaj) me numrin e përgjithshëm të kohës së ekspertëve kryesorë(në person -muaj) në propozim.

- (b) përshtatshmëria për detyrë: arsimimi, trajnimi dhe përvoja në sektorin, fushën, subjektin specifik dhe kështu me radhë, të rëndësishme për detyrë veçantë; dhe
 - (c) përvoja në rajon: njohuri të gjuhës, kulturës, sistemit administrativ lokal, organizimin qeveritar, dhe kështu me radhë.
- 2.21 Huamarrësit vlerësojnë çdo propozim mbi bazën e përgjegjshmërisë kundrejt TOR. Propozimi konsiderohet papërshtatshëm dhe refuzohet në këtë fazë nëse nuk është në përputhje me aspekte të rëndësishme të përshkruara në KPP. Propozimet teknike të cilat përmbajnë ndonjë informacion material financiar shpallen jo-të përgjegjshme.
- 2.22 Anëtarët e komisionit vlerësues vlerësojnë propozimet, në përputhje me kriteret e vlerësimit të përcaktuara në KPP, të pavarur nga njëri-tjetri, dhe pa ndonjë ndikim të jashtëm nga çfarëdo personi apo entiteti. Propozimi refuzohet nëse dështon të arrijë rezultatin e përgjithshëm minimal teknik të specifikuar në KPP. Në fund të procesit të vlerësimit, Huamarrësi përgatit një raport teknik të Vlerësimit duke përdorur formën standarde të Bankës për raportin e vlerësimit ose me ndonjë tjetër raport të pranueshëm për Bankën. Raporti mbështet rezultatet e vlerësimit dhe arsyeton pikat totale teknike të caktuar për secilin propozim duke përshkruar anët e forta dhe dobësitë relative të propozimeve. Dallimet mëdha në rezultate individuale të dhënë një propozim për të njëjtin kriter apo nën-kriter nga anëtarë të ndryshëm duhet të adresohen dhe një arsytim të jepet në raportin e vlerësimit teknik. Në rastin e kontratave që i nënshtrohen rishikimit paraprak, raporti i vlerësimit teknik, duke përfshirë edhe tabelat e detajuara të vlerësimit të secilit anëtar të komisionit, i dorëzohen Bankës për rishikim dhe miratim. Të gjitha të dhënat që lidhen me vlerësimin, siç janë tabela individuale të pikave, mbahen në përputhje me paragrafët 2 (k) dhe 5 të Aneksit 1.

Hapja e propozimeve financiare dhe vlerësimi i kostos

- 2.23 Pas përfundimit të vlerësimit të Raporti Teknik (dhe për kontratat me shqyrtim paraprak, pasi Banka të ketë lëshuar miratimin e saj), Huamarrësi informon konsulentët propozimet e të cilëve nuk e përmbushin minimumin kualifikues të rezultatit teknik ose të cilat konsiderohen si të papërgjegjshme KPP dhe TOR se propozimet e tyre financiare do të kthehen të pahapura pas nënshkrimit të kontratës. Përveç kësaj, Huamarrësi njofton secilin nga konsulentët e mësipërmbi rezultatet e tyre të përgjithshme teknike, si dhe rezultatet e fituara për çdo kriter dhe nën-kriter nëse ka të tilla. Huamarrësi njofton njëkohësisht konsulentët që kanë siguruar rezultatin minimal të përgjithshëm teknike mbi datën, kohën, dhe vendin e caktuar për hapjen e propozimeve financiare. Data e hapjes përcaktohet ashtu që të lejojë kohë të mjaftueshme që konsulentët të bëjnë përgatitje dhe të marrin pjesë në hapjen e propozimeve financiare. Propozimet financiare hapen në prani të përfaqësuesve të konsulentëve të cilët dëshirojnë të marrin pjesë (personalisht apo online). Emri i konsulentit, pikët teknike, duke përfshirë edhe zërthimin sipas kriterëve, si dhe çmimi i përgjithshëm i ofruar total lexohen me zë të lartë (dhe postohen në internet në rastet kur dorëzimi elektronik i propozimeve është përdorur) dhe regjistrohen kur propozimet financiare të hapen. Huamarrësi përgatit proces verbaline hapjes dhe një kopje e këtij raporti i dërgohet menjëherë Bankës dhe të gjithë këshilltarëve që kanë dorëzuar propozime.

2.24 Huamarrësi pastaj vlerëson dhe krahason propozimet financiare në përputhje me procedurat e mëposhtme. Çmimet konvertohen në një monedhë të vetme të zgjedhur nga Huamarrësi (monedhë vendase ose në valutë të huaj plotësisht të konvertueshme), ashtu siç ceket në KPP. Huamarrësi bën këtë konvertim duke përdorur norma (të shitjes) të shkëmbimit për valutat e cituara nganjë burim zyrtar (siç është Banka Qendrore), ose nga një bankë komerciale ose nga një gazetë me qarkullim ndërkombëtar për transaksionet engjashme. KPP specifikon burimin ekursit të këmbimit të përdorur dhe datën atij kursi të këmbimit, me kusht që data të mos jetë më herët se katër javë para afatit të fundit për dorëzimin e propozimeve, dhe as më vonë se data origjinale e skadimit të periudhës së vlefshmërisë së propozimit. Për kontratën të bazuar në kohë³⁸, çdo gabim aritmetik korrigjohet, dhe çmimet rregullohen, nëse ata nuk pasqyrojnë të gjitha inputet që janë të përfshirë në propozimet përkatëse të teknike. Për një kontratë pa ushull, konsulentit konsiderohet të ketë përfshirë të gjitha çmimet në propozimin e tij financiar, kështu që nuk bëhen askorrigjime aritmetike dhe as rregullimet e çmimeve, ndërsa çmimi i përgjithshëm, neto e tatimeve e parë në kuptim të paragrafit 2.25 më poshtë, të përfshira në propozimin financiar, konsiderohen siç mimi i ofruar.

2.25 Përqëllime të vlerësimit, çmimet e ofruar për jashtë tatimet lokale indirekte të identifikueshme³⁹ për kontratën dhe tatimin mbi të ardhurat që i paguhen vendit të Huamarrësit mbipagesën për shërbimet e kryera në vendin e Huamarrësit nga ekspertët jo-rezidentë dhe personeli tjetër i konsulentit. Në rrethana të jashtëzakonshme, kur taksat indirekte nuk mund të identifikohen plotësisht nga Huamarrësi gjatë vlerësimit të ofertave financiare, Banka mund të pajtohet se çmimet, vetëm për qëllime të vlerësimit, përfshijnë të gjitha taksat e pagueshme në vendin e Huamarrësit. Çmimi i ofruar i përgjithshëm përfshin të gjitha pagesat e konsulentëve dhe shpenzimet e tjera siç janë udhëtimet, përkthimin, printimin e raportit, ose shpenzimet e sekretarisë. Propozimeve me çmimin më të ulët total të ofruar mund t'u jepet vlerësimi financiar prej 100 pikëve, ndërsa propozimeve të tjera jepet vlerësimi financiar që janë në përpjesëtim me çmimet e tyre. Përndryshe, metodologjia e proporcioneve direkte apo ndonjë metodologji tjetër mund të përdoret për alokimin e pikave për propozimin financiar. Metodologjia e cila do të aplikohet përshkruhet në KPP.

Cilësia e kombinuar dhe vlerësimi i kostos

2.26 Rezultati i përgjithshëm fitohet duke peshuar rezultatin për cilësi dhe kosto dhe duke i mbledhur këto. Pësha për "koston" zgjidhet, duke marrë parasysh kompleksitetin e detyrës dhe rëndësinë relative të cilësisë. Përveç për llojin e shërbimeve të përcaktuara në Seksionin III, pesha për kosto normalisht duhet të jetë 20 pikë nga rezultati total prej 100. Peshat e propozuara për cilësinë dhe koston specifikohen në KPP. Firma e cila fiton rezultatin më të lartë total fitohet për negociatën.

Negociatat dhe dhënia e kontratës

2.27 Negociatat përfshijnë diskutimet mbi TOR, metodologjinë, inputet e Huamarrësit, dhe kushtet e veçanta të kontratës. Këto diskutime nuk ndryshojnë thelbësisht

³⁸ Shih Seksionin IV për formularët e kontratave.

³⁹ Të gjitha tatimet indirekte që vilen për faturat e kontratave, në nivel kombëtar, shteti (apo krahi) dhe atë komunal, siç janë tatimet në shitje, TVSH, akciza, dhe tatimet apo ngarkesat e ngjashme.

fushëveprimin fillestar të shërbimeve sipas TOR apo termave të kontratës, për t'u siguruar se cilësia e produktit final, çmimi, dhe rëndësia e vlerësimit fillestar të mos preken. Reduktime të mëdha në inputet e punës nuk duhet të bëhen vetëm për të plotësuar koston e vlerësuar ose buxhetin në dispozicion. TOR përfundimtare dhe metodologjia e dakorduar përfshihen në "Përshkrimet Shërbimeve", të cilët do të jenë pjesë e kontratës.

- 2.28 Firmësshë zgjedhur nuk duhet t'i lejojë të zëvendësojë ekspertët kyçe, përveç nëse të dyja palët bien dakord që vonesa të panevojshme në procesin e përzgjedhjes e bëjnë zëvendësimin e tillë të pashmangshëm ose se ndryshimet e tilla janë kritike për të përmbushur objektivat e detyrës⁴⁰. Nëse kjo nuk ndodh dhe në qoftë se konstatohet se ekspertët kryesorë janë përfshirë në propozim pa konfirmuar disponueshmërinë e tyre, firma mund të diskualifikohet dhe procesi vazhdon me firmën tjetër në rend. Ekspertët kryesorë të propozuar për zëvendësim duhet të kenë kualifikime të barabarta ose më të mira se ekspertët kryesorë të propozuar fillimisht⁴¹.
- 2.29 Negociatat financiare duhet të përfshijnë të qartësime mbi detyrimet tatimore të konsulentëve në vendin e Huamarrësit (nëse ka) dhe si ky detyrim tatimor është pasqyruar ose do të pasqyrohet në kontratë. Pagesat sipas kontratave paushallbazohen në dhënien e rezultateve (ose produkte), prandaj çmimi i ofruar përfshin të gjitha shpenzimet (koha e ekspertëve, shpenzimet e stafit, udhëtimi, hoteli, etj.) Rrjedhimisht, në qoftë se metoda e përzgjedhjes për një kontratë paushall përfshin koston si faktor të vlerësimit, çmimi i ofruar nuk negociohet. Në rastin e kontratave të bazuara në kohë, pagesa është e bazuar në inputet (koha e ekspertëve dhe shpenzimet e rimbursimit) ndërsa çmimi i ofruar përfshin normat e ekspertëve dhe një vlerësim të shumës së rimbursueshme. Kur metoda e përzgjedhjes përfshin koston si një faktor të vlerësimit, negocijimi i normave të ekspertëve nuk bëhet, përveç në rrethana të veçanta, si për shembull, normat e ekspertëve të ofruara janë shumë më të larta se normat e të cilat zakonisht kërkohen nga konsulentët për kontrata të ngjashme. Rrjedhimisht, ndalimi i negociimit nuk përjashtonte drejtën e klientit për të kërkuar shpërblime, dhe, në qoftë se honorarët janë shumë të larta, të kërkojnë ndryshimin e tyre, paskonsultimit të duhur me Bankën. Shpenzimet e rimbursueshme paguhen mbi shpenzimet reale të shkaktuara pas paraqitjes së faturave dhe për këtë arsye nuk iu nënshtrohen negociatave. Megjithatë, nëse klienti dëshiron të përcaktojë tavanet për çmimet për njësi për disa shpenzime të rimbursueshme (si shpenzimet e udhëtimit ose normat e hotelit), ata duhet të tregojnë nivelet maksimale të këtyre normave në KPP apo të definojnë mëditjet në KPP.
- 2.30 Në rast se negociatat me konsulentin e lartë përmendur dështojnë, Huamarrësi do të informojë konsulentin përkatës me shkrim mbi të gjitha çështjet dhe mosmarrëveshjet e pazgjidhura, dhe t'u sigurojë atyre një mundësi të fundit për t'u përgjigjur me shkrim. Negociatat e kontratës nuk ndërpriten vetëm për shkak të konsideratave buxhetore. Nëse mosmarrëveshje nuk zgjidhen, Huamarrësi informon konsulentin me shkrim mbi synimin e tij për të përfunduar negociatat. Negociatat atëherë mund të ndërpriten pas marrjes së miratimit të Bankës, dhe konsulentii radhës ftohet për negociatën. Huamarrësi i paraqet Bankës në shqyrtim procesverbalet e negociatave dhe të gjitha komunikimet përkatëse, si dhe arsyet për ndërprerjen e tillë. Pasi negociatat

⁴⁰ Definimi i periudhave realiste të vlefshmërisë së propozimit në KPP dhe kryerja e një vlerësimi efikas minimizon këtë rrezik.

⁴¹ Shih Aneksin 2, paragrafin 1 (p) për më shumë detaje.

me firmën e ardhshëm të renditur të kenë filluar, Huamarrësi nuk rihap negociatat e mëhershme. Pasi negociatat të kenë përfunduar me sukses dhe Banka të ketë lëshuar miratimin e saj për kontratën e negociuar e cila përmban inicialet e palëve, Huamarrësi njofton menjëherë firmat tjera në listën e shkurtër se ata ishin të pasuksesshme.

Publikimi i dhënies së kontratës

2.31 Procedura për publikimin e dhënies së kontratës përcaktohet në paragrafin 7 të Aneksit 1.

Pas-informimi nga Huamarrësi

2.32 Në publikimin e dhënies së kontratës referuar në paragrafin 2.31, Huamarrësi do të specifikojë se çdokonsulenti cili dëshiron të vërtetojë arsyet se propozimi i tij nuk është përzgjedhur, duhet të kërkojë një shpjegim nga Huamarrësi. Huamarrësi siguron menjëherë me shkrim një shpjegim se pse një propozim i tillë nuk është zgjedhur. Nëse një konsulent kërkon një takim informues, ai duhet të gjithë shpenzimet e tyre të pjesëmarrjes në një takim të tillë sqarues.

Refuzimi i të gjitha propozimeve dhe ri-thirrja

2.33 Huamarrësi arsyetohet me refuzimin e të gjithë propozimeve vetëm nëse: (i) të gjitha propozimet janë të papërgjegjshme sepse nuk iu përgjigjen aspekteve të rëndësishme të TOR ose paraqesin mangësi madhore kundrejt TOR në përputhje me paragrafin 2.21; ose (ii) asnjë propozim nuk arrin rezultatin minimal teknik të përcaktuar në KPP; ose (iii) nëse çmimi i ofruar i propozimit të suksesshëm është dukshëm më i lartë se buxheti në dispozicion apo vlerësimi i azhurnuar i kostos. Në rastin e fundit, si një alternativë e ri-thirrjes, mundësia e rritjes së buxhetit, apo e zvogëlimit të fushëveprimit të shërbimeve duhet të hulumtohet me firmën në konsultim me Bankën. Mirëpo, në përputhje me paragrafin 2.27, çfarëdo zvogëlimi thelbësor i fushëveprimit të shërbimeve nuk është i pranueshëm dhe kërkon ri-thirrje. Nëse kostoja është faktor i vlerësimit për kontratën e bazuar në kohë, numri i person-muajve të propozuar nga konsulenti mund të negociohet, me kusht që nuk rrezikon cilësinë apo të ndikojë në mënyrë negative tek detyra. Edhe në raste të tilla, normat e ekspertëve nuk negociohen në mënyrë normale, sipas paragrafit 2.29.

2.34 Para se të gjitha propozimet të hidhen poshtë dhe propozimet e reja të ftohen, Huamarrësi njofton Bankën, duke treguar arsyet për refuzimin e gjithë propozimeve, dhe merr miratimin e Bankës para se të procedojë me refuzim dhe proces të ri. Prosesi i rimund të përfshijë rishikimin e KPP-së, duke përfshirë TOR, listën e ngushtë dhe buxhetin. Këto rishikime dakordohen me Bankën.

Konfidencialiteti

2.35 Informatat në lidhje me vlerësimin e propozimeve dhe rekomandimeve lidhur me dhënien e kontratës nuk iu zbulohet konsulentëve të cilët kanë parashtruar propozimet ose personave të tjerë jozyrtarisht të interesuar me procesin, deri në publikimin e dhënies së kontratës, përveç nëse parashihet ndryshe me paragrafët 2.23 dhe 2.30.

III.METODAT TJERA TË PËRZGJEDHJES

Të përgjithshmet

- 3.1 Kyseksionpërshkruanmetodattjera të përzgjedhjes përveçQCBS, dhe rrethanat nëtë cilatatojanëtë pranueshme. Të gjitha dispozitat eSeksionitII (QCBS) vlejné për metoda të tjeratë përzgjedhjessipas SeksionitIII, përveçnëse njëdispozitëe ndryshmeështë identifikuar në mënyrë specifike nëSeksionin III, me ç'rast, vlen kjo e fundit⁴². Huamarrësitzbatojnë standardin në fuqi tëKPP të lëshuarnga Banka, mendryshime minimaletë pranueshempër Bankën, sipas nevojës, për të adresuar kushtetspecifike të projektit, përveçnëse parashihet ndryshenë paragrafët3.8, 3.12, dhe 3.13, 3.14dhe3.15të këtij neni Seksioni.

Përzgjedhja e bazuar në cilësi (QBS)

- 3.2 QBS është e qëlluar për lloje vijuese të detyrave:
- (a) Detyra komplekse apo shumë të specializuara për të cilat është e vështirë të definohen me precizitet TOR dhe inputi i konsulentëve, dhe për të cilat klienti pret që konsulentët të tregojnë inovacion në propozimet e tyre (për shembull, studimet ekonomike apo të sektorit, studimet shumë-sektorale të fizibilitetit, projektimi i impianteve për rregullimin e mbeturinave të rrezikshme apo master planin urban, reformat e sektorit financiar);
 - (b) Detyratqë kanë njëndikim të lartënë nivele më të ulëtadhenë të cilat pikësynimi është që të ketëekspertët më të mirë(për shembull, projektimi i fizibilitetit dhedizajnitstrukturor të projekteve të mëdha të infrastrukturësiç janë digate mëdha, studime e politikave tërëndësisëkombëtare, studimet e menaxhimit tëagjencive të mëdhaqeveritare);dhe
 - (c) detyratqë mund tëkryhennë mënyrathelbësisht të ndryshme, ashtu qëpropozimet nuk mund të jenë të krahasueshme(për shembull, këshillimpër menaxhim,dhe studime tëpolitikave dhe të sektorit në të cilatvlera e shërbimevevaret nga cilësiae analizës).
- 3.3 NëQBS, KPPmund të kërkojë vetëm dorëzimin epropozimit teknik(pa propozimin financiar), ose të kërkojë paraqitjen e propozimeve teknikedhe financiare në të njëjtën kohë, por në zarfe të ndara(sistemi me dy zarfe). RFP-ja ofron ose buxhettë vlerësuar apokohën e parashikuar tëekspertëve kryesorë, duke specifikuar se ky informacionjepet vetëm si indikacion dhe sekëshilltarëtjanë të lirë tëpropozojnëvlerësimete tyre.
- 3.4 Nëse janë kërkuar vetëm propozimet teknike, pas vlerësimit të propozimeve teknike duke përdorur metodologjinë e njëjtë si në QCBS, Huamarrësi i kërkon konsulentit me propozimin më të lartë të renditur teknik, të paraqesë një propozim të detajuar

⁴²PërshembullnjëHuamarrës: (i) të përdorë procedurë me një zarfdhe jo procedurën me dy zarfesipasmetodësQBS; (ii) nuk tregojnëKPP numrine përfaqësimin e individit-muajsh me metodën FBS, (iii) nuk përdorinnjëEOI sipasmetodësSSS apo nuk reklamon EOI nëUNDBsipas metodësCQS; (iv) nuk përdoren standardet e KPP-së të bankës dheforma e kontratës për kontratat me vlerashumë të vogla (shih fusnotën46) sipas metodave të tilla siCQS; (v) kryerjen e negociatave për çmimesiç lejohen me metodën QBS, CQS oseSSS,ose sipas praktikavetregtare;(vi) zgjedhjen e një konsulentime Programin provues të Përdorimit tëSistemeve të Venditnë pajtimme paragrafin3.12; (vii) përdorimi i një faktori çmimi më të lartë se20% gjatë angazhimit të njëagjent të prokurimit, një agjentinspektimi, një bankë investimesh, ose njëAuditor; (viii) nuk ndiqen procedurat QCBSnë kuadër të praktikavekomerciale; etj

financiar. Huamarrësi dhe konsulenti pastaj do të negociojnë propozimin financiar⁴³ dhe kontratën. Të gjitha aspektet e tjera të procesit të përzgjedhjes do të jenë identike me ato të QCBS, duke përfshirë publikimin e Dhënies së Kontratës siç përshkruhet në paragrafin 2.31 dhe paragrafin 7 të Aneksit 1, përveç se publikohet vetëm çmimi i kontratës i firmës fituese. Nëse konsulentëve i është kërkuar që të japin propozimet financiare fillimisht së bashku me propozimet teknike, sendërtohen masa mbrojtëse si në QCBS për të siguruar se propozimi financiar vetëm e firmës së përzgjedhur hapet dhe pjesa tjetër kthehen të pahapura, pasi negociatat kanë përfunduar me sukses.

Përzgjedhja me buxhet fiks (FBS)

3.5 Kjo metodë është e përshtatshme vetëm kur detyra është e thjeshtë dhe mund të definohet saktësisht dhe kur buxheti është fiks. KPP-të duhet të tregojë buxhetin në dispozicion dhe t'u kërkojë konsulentëve të japin propozime të tyre me miratime teknike dhe financiare në zëra të veçanta, brenda buxhetit. TOR duhet të jetë veçanërisht mirë i përgatitur për t'u siguruar që buxheti është i mjaftueshëm për konsulentët për të kryer detyrat e pritura. RFP duhet të tregojë qartë nëse buxheti përfshin tatimet apo ngarkesa të pagueshme në vendin e huamarrësit dhe çmimi i çdo inputi të parashikuar nga klienti. Vlerësimi i të gjitha propozimeve teknike kryhet së pari në metodën QCBS. Pastaj propozimet financiare hapin siç përcaktohet në paragrafin 2.23. Propozimet që e tejkalojnë buxhetin e kurrë refuzohen. Konsulenti i cili kadorëzuar propozimin më të lartë të renditur teknik përzgjidhet dhe ftohet për të negociuar kontratën. Çmimi i kontratës duhet të publikohet, siç përshkruhet në paragrafin 7 të Aneksit 1.

Përzgjedhja me kosto më të ulët (LCS)

3.6 Kjo metodë është përgjithësisht e përshtatshme për zgjedhjen e konsulentëve për detyrat e një natyre standard apo rutine (auditimet, projektimi i punëve jo komplekse, dhe kështu me radhë), ku ekzistojnë praktikat dhe standardet e pranuar. Sipas kësaj metode, përcaktohet një "minimum" i notës kualifikuese për "cilësinë". Propozimet, të cilat paraqiten në dy zëra, ftohen në një listë ngushtë. Propozimet teknike ftohen dhe vlerësohen së pari. Ato që sigurojnë më pak se notën minimale kualifikuese⁴⁴, hidhen poshtë, ndërsa propozimet financiare të tjerëve hapin siç përcaktohet në paragrafin 2.23. Firma më e ulët pastaj zgjidhet. Sipas kësaj metode, përcaktohet nota minimale kualifikuese, duke kuptuar setë të gjitha propozimet mbi minimumin konkurrojnë vetëm në bazë të "kostos". Nota minimale kualifikuese duhet të deklarohet në KPP. Dhënia e kontratës publikohet sipas paragrafit 7 të Aneksit 1.

Përzgjedhja bazuar në kualifikimet e konsulentëve (CQS)

3.7 Kjo metodë mund të përdoret për detyra të vogla⁴⁵ ose situatat emergjente të deklaruar nga huamarrësi dhe të pranuar nga Banka për të cilat nevoja për lëshimin

⁴³ Negociatat financiare sipas QBS përfshijnë negociatat të të gjitha pagesat e konsulentëve dhe shpenzimet tjera.

⁴⁴ Kjo metodë nuk përdoret si zëvendësim për QCBS dhe përdoret vetëm në raste specifike të natyrës shumë standard dhe rutine teknike ku komponenta intelektuale është më pak e rëndësishme. Për këtë metodë, nota minimale kualifikuese është 70 pika apo më shumë.

⁴⁵ Pragjet në dollarë, të cilat definojnë të "vogla" përcakton në secilin rast, duke marrë parasysh natyrën dhe kompleksitetin e detyrës, por nuk tejkalojnë US\$300,000, përveç në rastet e jashtëzakonshme.

enjëKPP-je apo për përgatitjen dhevlerësimin e propozimevekonkurruesenuk arsyetohet. Në raste të tilla, Huamarrësi përgatisënjë TOR dhe siguron shprehjet einteresimit ku përfshihen informata përpërvojën dhe kualifikimet e tyre, eventualisht edhe përmes njëREOInëse është e nevojshme, nga sa mëshumë firmatë jetë e mundur, dhe të paktën nga trefirmatë kualifikuara,me përvojërelevante.Firmatqë kanë përvojën e nevojshmedhe kompetencërelevante përdetyrën vlerësohen dhekrahahohen, dhepërzgjidhet firmamë e mirë e kualifikuardhe më me përvojë. Vetëmfirmëssë përzgjedhuri kërkohet që tëparaqesë një propozimtë kombinuar teknik dhe financiar dhe, në qoftë se një propozim i tillë është ipërgjegjshëm dhe i pranueshëm, ftohet për të negociuar një kontratë. Të dy aspektet teknik dhe financiar të propozimit mund të negociohen. Në negociatat me firmë përzgjedhur dëshojnë, aplikohen dispozitatë paragrafit 2.30. Procesverbalin negociatave përgatitet dhe nënshkruhet nga të dyja palët. Dhënia e Kontratave publikohet sipas paragrafit 7 të Aneksit 1.

Përzgjedhja një-burimore (SSS)

- 3.8 Përzgjedhja një-burimore ekonsulentëve nuk ofron dobitë e konkurrencës në lidhje me cilësinë dhe koston, mungon transparencanë përzgjedhje, dhe mund të inkurajojë praktikën të papranueshme. Prandaj, përzgjedhja një-burimore përdoret vetëm në raste të jashtëzakonshme. Justifikimi për përzgjedhjen një-burimore shqyrtohet në kontekstin e interesave të përgjithshme të klientit dhe projektit, dhe përgjegjësisë së Bankës për të siguruar ekonomizim dhe efikasitetin dhe mundësinë të barabartë për të gjithë konsulentët e kualifikuar.
- 3.9 Përzgjedhja një-burimore mund të jetë e përshtatshme në rastet e mëposhtme, dhe vetëm nëse paraqet një avantazh të qartë mbi konkurrencën: (a) për detyrat që përfaqësojnë një vazhdimësi natyrisht epunës së mëparshme të kryer nga firma (shih paragrafin tjetër), (b) në raste të veçanta, siç janë, por që nuk kufizohen vetëm në, përgjigjenidajfatkeqësive natyrore dhe situatave emergjente, të dyja këto të shpallura nga Huamarrësi dhe të pranuar nga Banka, (c) për detyra shumë të vogla⁴⁶, ose (d) kur vetëm një firmë është e kualifikuar ose ka përvojë me vlerë të jashtëzakonshme për detyrën. Në të gjitha këto raste, Huamarrësi nuk është i detyruar të lëshojë një KPP dhe i dorëzon Bankës përrishikim dhe miratim TOR për detyrën, një arsyetim të hollësishëm, duke përfshirë edhe arsyetimin për përzgjedhjen një-burimore në vend të një procesi konkurrues të përzgjedhjes, dhe bazën për rekomandimin e një firme të caktuar, me përjashtim të kontratave nën kufirin e përcaktuar në bazën e rreziqeve dhe fushëveprimit të projektit, dhe të përcaktuar në Planin e Prokurimit.
- 3.10 Kur vazhdimësia për punën në nivele më të ulëta janë thelbësore, KPP-ja fillestare e përshkruan këtë perspektivë, dhe, nëse është e mundur, faktorët që përdoren për përzgjedhjen e konsulentit marrin parasysh gjatë vazhdimin. Vazhdimësia në qasjen teknike, përvoja e fituar, dhe përgjegjësia e vazhdueshme profesionale e konsulentit të njëjtë mund ta bëjë vazhdimin me konsulentin fillestar të preferueshëm ndaj një subjekti të ri konkurrues për ecurinë e kënaqshme të detyrës fillestare. Për detyra të tilla që prekin nivele më të ulëta, Huamarrësi kërkon që konsulenti i zgjedhur fillimisht të

⁴⁶Pragjet në dollarë të cilat definojnë “shumë të vogël” përcaktohen në secilin rast, duke marrë parasysh natyrën dhe kompleksitetin e detyrës, por nuk tejkalojnë US\$100,000, përveç në rastet e jashtëzakonshme.

përgatis propozimet teknike dhe financiare mbi bazën e TOR të siguruar nga Huamarrësi, të cilët pastaj negociohen.

- 3.11 Nëse detyra fillestare nuk u dha mbi baza konkurruese ose u dha nën financimin e lidhur ose nëse detyra në nivele më të ulëta thelbësisht më e madhe në vlerë, ndiqet një proces konkurrues i pranueshëm për Bankën, në të cilën konsulenti i cili kryenpunën fillestare nuk përjashtohet nga konsiderata nëse shpreh interes. Banka merr parasysh përjashtimin nga ky rregull vetëm nën rrethana të veçanta dhe vetëm kur një proces i ri konkurrues nuk është i mundshëm. Dhënia e Kontratës publikohet sipas paragrafit 7 të Aneksit 1.

Përdorimi i sistemeve të vendit

- 3.12 Përdorimi i Sistemeve të Vëndit (UCS) i referohet metodave për përzgjedhjen e konsulentëve (përfshirë individëve) të parashikuara në sistemin e prokurimit publik në vëndin e Huamarrësit, e të cilat konstatohen si të pranueshme për Bankën, në përputhje me Programin provues të Bankës për Përdorimin e sistemeve të shtetit⁴⁷. Ato mund të përdoren nga Huamarrësit në pilotprojekte, të cilat kanë qenë të miratuara nga Banka në bazë të Programit të tillë të Pilotimit.

Përzgjedhja e konsulentëve për Huatë Institucioneve dhe subjekteve ndërmjetëse financiare

- 3.13 Kur krediasiguron fonde përnjë institucion ose subjekt financiar ndërmjetës (ose agjencinë e caktuar të saj) e cila huazohet më tej përfituesve siç janë individë, ndërmarrjet e sektorit privat, ndërmarrjet e vogël dhe të mesme, ose ndërmarrjet autonome të tregtarëve të sektorit publik, përfinancim të pjesshëm të nënprojekteve, përzgjedhja e konsulentëve zakonisht ndërmerret nga përfituesit përkatës, në përputhje me metodave e standardizuara të prokurimit të sektorit privat ose praktikave tregtare që janë të pranueshme për Bankën⁴⁸. Kur fondet e kredisë huazohen më tej për përfituesit e sektorit publik ose përdetyratë mëdha dhe komplekse, merret parasysh aplikimi i metodave konkurruese të përcaktuara në këto Udhëzime.

Përzgjedhja e konsulentëve në kuadër të Huave të garantuara nga Banka

- 3.14 Nëse Banka garanton shlyerjen e një kredie të bërë nga një huadhënës, shërbimet e konsulentëve të financuara nga kredia në fjalë do të prokurohen me vëmendje dhe duhur ndaj parimeve dhe procedurave që përmbushin kërkesat e paragrafit 1.8. Banka mund të kryejë një rishikim të transaksioneve të prokurimit sipas huasë pas mbylljes së saj.

Përzgjedhja e llojeve të caktuara të konsulentëve

⁴⁷Programi i Pilotimit është përshkruar në letër Bordit të datës 3 mars dhe 25 mars 2008 me titull "Përdorimi i sistemeve të vëndit në operacionet mbështetura nga Banka: Programi i propozuar i Pilotimit" (R2008-0036 dhe 0036 dhe 0036/1), të miratuar nga Bordi i Drejtorëve Ekzekutivë të Bankës më 24 prill, 2008.

⁴⁸Për detaje të tjera, shih paragrafin 3.13 (Prokurimi me Kredie për institucione dhe subjekte financiare ndërmjetëse) të Udhëzimeve: *prokurimi i mallit, punëve dhe shërbimeve jo-konsulente për Huatë e IBRD-së dhe Kreditë dhe Grantet e IDA-së nga Huamarrësit e Bankës Botërore.*

- 3.15 *Përzgjedhja e Agjencive të OKB-së.* Agjencitë Kombeve të Bashkuara (OKB)⁴⁹ mund t'i jepet vetëm një burimi nga Huamarrësit kur ata janë të vetmit ose jashtëzakonisht të kualifikuar për të ofruar ndihmë teknike dhe këshilla në fushën e tyre të ekspertizës. Banka mund të bien dakord që agjencitë OKB-së të ndjekin procedurat e tyre për: (a) seleksionimin e nën-konsulentëve ekspertë individualë, dhe furnizimi i mallrave minimale të nevojshme për kryerjen e kontratës; (b) detyratë vëllimore të vogla siç përcaktohen në fusnotën 45 të paragrafit 3.7 të këtyre Udhëzimeve; dhe (c) nën rrethana të caktuara, në përgjigje ndaj fatkeqësive natyrore dhe për situata emergjente të deklaruara nga Huamarrësi dhe të njohura nga Banka. Huamarrësi përdorë formularin standard të Bankës për Marrëveshjetë mes të një Huamarrësi dhe një agjencitë OKB-së për ofrimin e asistencës teknike dakorduar nga Banka. Huamarrësi i paraqet Bankës për miratim një arsyetim të plotë dhe draft formën e marrëveshjes me agjencinë e OKB-së para nënshkrimit.
- Agjencitë e OKB-së nuk marrin ndonjë trajtim preferencial, kur marrin pjesë në procesin e përzgjedhjes konkurruese, përveç se, Huamarrësit mund të pranojnë privilegjet dhe imunitetet e dhëna për agjencitë e OKB-së dhe stafin e tyre sipas konventave ekzistuese ndërkombëtare dhe mund të bien dakord me agjencitë e OKB-së për bashkëpunim të pagesave të veçanta, të parapara me Kartën e Agjencisë, me kusht që këto janë të pranueshme për Bankën. Për të neutralizuar privilegjet e Agjencive të OKB-së, si dhe avantazhet e tjera siç janë lirimi nga tatimet dhe stabilizimet, dhe dispozitave veçanta të pagesave, aplikohet metoda QBS ose metoda CQS për detyratë vëllimore (shih shënimin 45).
- 3.16 *Angazhimi i organizatave joqeveritare (OJQ).* OJQ-të janë organizatat jo-profitabile të cilat mund të kenë kualifikime unike për të ndihmuar në përgatitjen, menaxhimin dhe implementimin e projekteve, në thelb për shkak të përfshirjes dhe dijeve të tyre mbi çështjet lokale, nevojave të komunitetit dhe/ose qasjeve pjesëmarrëse. OJQ-të mund të përfshihen në listën e ngushtë nëse shprehin interesim dhe me kusht që Huamarrësi dhe Banka janë të kënaqur me kualifikimet e tyre. Për detyratë të cilat theksojnë pjesëmarrje dhe dije të theksuar lokale, lista e ngushtë mund të përbëhet tërësisht nga OJQ-të. Nëse është ashtu, atëherë ndiqet një metodë gjegjëse e përzgjedhjes (QCBS, FBS, LCS, ose CQS), bazuar në natyrën, kompleksitetin dhe madhësinë e detyrës, ndërsa kriteret e vlerësimit pasqyrojnë kualifikimet unike të OJQ-ve, siç janë dija lokale, shkalla e operacionit, dhe përvoja paraprake relevante. Huamarrësit mund të përzgjedhin OJQ-të me përzgjedhje një burimore, me kusht që respektohen kriteret e cekura në paragrafin 3.9 të këtyre Udhëzimeve.
- 3.17 *Agjentët e Prokurimit dhe Menaxherët e ndërtimit.* Kur një huamarrësi i mungon organizimi, burimet, ose përvoja e nevojshme, mund të jetë efikase dhe efektive për atë që të punësojë, si agjent të tij, një firmë që është e specializuar në trajtimin e prokurimit. Kur Agjentët e prokurimit përdoren në mënyrë specifike si "agjentë" që merren me prokurimin e sendeve të veçanta dhe përgjithësisht punojnë nga zyrat e tyre, ata zakonisht paguhen një përqindje të vlerës së furnizimeve të trajtuara, apo një kombinim siç është një përqindje dhe një tarifë fikse. Në raste të tilla, Agjentët e Prokurimit zgjidhen duke aplikuar procedurat QCBS ku koston i jepet një peshë prej

⁴⁹Një agjencie Kombeve të Bashkuara, iu referohet departamenteve të Kombeve të Bashkuara, agjencive të specializuara dhe zyrave të tyre rajonale, siç janë Organizata Shëndetësore Pan-Amerikane (PAW), fondet dhe programet.
Huamarrësi do t'i paraqesë Bankës për miratim një arsyetim të plotë dhe formën e draftit të marrëveshjes me agjencinë e OKB-së.

50 për qind. Megjithatë, kur agjentët e Prokurimit ofrojnë vetëm shërbime këshillimore për prokurimin ose veprojë si “agjentë” për një projekt të tërë në një zyrë të veçantë, për projekt të tillë, ata zakonisht paguhen në baza kohore, dhe në raste të tilla, ata duhet të zgjidhen duke ndjekur procedurat e duhura për detyra të tjera të konsulencës duke aplikuar procedurat QCBS dhe kontratën e bazuar në kohë, të përcaktuar me këto Udhëzime. Agjenti ndjekë të gjitha procedurat e prokurimit të përcaktuara në Marrëveshjen e Huasë dhe në Planin e Prokurimit të miratuar nga Banka në emër të Huamarrësit, duke përfshirë përdorimin e Kërkesë Standarde për Propozime të Bankës, procedurat e shqyrtimit dhe dokumentacionit. Dispozitat e mësipërme vlejné edhe për menaxherët e ndërtimit.

- 3.18 *Shërbimet e inspektimit.* Huamarrësit mund të dëshirojnë të punësojnë ofruesit e shërbimeve të inspektimit për të inspektuar dhe certifikuar mallra para dërgimit ose arritjes në vendin e Huamarrësit. Inspektimi zakonisht mbulon cilësinë dhe sasinë e mallrave në fjalë dhe arsyeshmërinë e çmimit. Ofruesit e shërbimeve të inspektimit zgjidhen duke aplikuar procedurat QCBS ku koston i jepet një peshë deri në 50 për qind dhe ku përdoret një format kontrate me pagesat bazuar në përqindje të vlerës së mallrave të inspektuara dhe të certifikuara.
- 3.19 *Bankat.* Bankat investuese dhe komerciale, firmat financiare, dhe menaxherët e fondeve të punësuar nga Huamarrësit për shitjen e aseteve, lëshimin e instrumenteve financiare, dhe transaksionet e tjera financiare korporative, sidomos në kontekstin e operacioneve të privatizimit, përzgjidhen në bazë të QCBS. KPP duhet të përcaktojë kriteret e përzgjedhjes të cilat janë relevante për aktivitetin - për shembull, përvoja në detyra të ngjashme ose rrjeti i blerësve potencial - dhe kostoja e shërbimeve. Përveç pagesës konvencionale (e quajtur "tarifa e shërbimit"), kompensimi përfshin një "tarifë të suksesit"; kjo tarifë mund të jetë fikse, por zakonisht shprehet si përqindje e vlerës së aseteve ose instrumenteve të tjera financiare që duhet të shiten. KPP duhet të tregojë kostoja e vlerësimit do të merr parasysh tarifën e suksesit, ose në kombinim me tarifën e shërbimit ose vetëm. Nëse vetëm, norma standarde e shërbimit caktohet për të gjithë konsulentët në listë të ngushtë dhe ceket në KPP, ndërsa rezultatet financiare duhet të bazohen në honorarin e suksesit. Për vlerësimin e kombinuar (veçanërisht për kontratat e mëdha), koston mund t'i akordohet një peshë më e madhe se ajo e rekomanduar në paragrafin 2.26. KPP specifikon në mënyrë të qartë si paraqiten dhe si krahasohen propozimet.
- 3.20 *Auditorët.* Auditorët zakonisht kryejné detyrat e auditimit të brendshëm sipas TOR të përcaktuara mirë dhe standardeve profesionale. Ata zgjidhen në bazë të QCBS, me koston si një faktor thelbësor të përzgjedhjes (40-50 pikë) ose “Përzgjedhjen me koston më të ulët” të përvijuar në paragrafin 3.6. Për detyra të vogla⁵⁰, mund të përdoret metoda CQS.
- 3.21 *Kontraktuesit e ofrimittë shërbimeve.* Projektet mund të përfshijnë punësimin e një numri të madh të individëve të cilët ofrojnë shërbime në bazë të kontratës. Përzgjedhja e tyre, si konsulentë individualë ose nëpërmjet një firme, kryhet në përputhje me Seksionin V të këtyre Udhëzimeve. Përskrimet e punës, kualifikimet minimale, kushtet e punës, metodat e përzgjedhjes në rastet kur bëhet përmes kontratës me një firmë, si dhe përmasat e shqyrtimit të Bankës së këtij dokumentacioni dhe metodat, do

⁵⁰Shih fusnotën 45.

përshkruhen në dokumentacionin e projektit.Kontrata përfshihet në Planin e Prokurimit për t'u rishikuar nga Banka.

IV.LLOJET E KONTRATAVE DHE DISPOZITAT E RËNDËSISHME

Llojet e kontratave

- 4.1 *Kontrata me shumë paushallë*⁵¹. Ky lloj i kontratës përdoret kryesisht për detyra në të cilat qëllimi dhe kohëzgjatja e shërbimeve dhe e prodhimit të kërkuar të konsulentëve janë të përcaktuara qartë. Ajo përdoret gjerësisht për planifikimin e thjeshtë dhe studime fizibiliteti, studime mjedisore, dizajn të detajuara të strukturave ose standarde të thjeshta, përgatitja e sistemeve të përpunimeve të të dhënave, dhe kështu me radhë. Pagesat janë të lidhura me outpute (produkte) të siç janë raportet, vizatimet, paramasat dhe parallogaritë, dokumentet e ofertimit, dhe programet softuerike. Kontrata përfshin një çmim fiks për aktivitetet që do të kryhen nga konsulenti dhe nuk iu nënshtrohen ndonjë rregullimi të çmimeve, përveç siç parashihet në paragrafin 4.7 të këtyre Udhëzimeve. Kontratat paushall janë të lehta për t'u administruar, sepse ata veprojnë mbi parimin e çmimit fiks për një qëllim të caktuar, ndërsa bëhen për pagesë mbi bazë të rezultateve dhe piketave të përcaktuara në mënyrë të qartë.
- 4.2 *Kontratat e bazuara në kohë*⁵². Ky lloji i kontratës është i përshtatshëm kur është e vështirë të definohet apo të përcaktohet qëllimi dhe kohëzgjatja e shërbimeve, ose për shkak se ato janë të lidhura me aktivitetet kryeranga të tjerë për të cilën periudha e përfundimit mund të ndryshojë, ose për shkak se inputi i konsulentëve i nevojshëm për arritjen e objektivave të detyrës është vështirë të vlerësohet. Ajo është përdorur gjerësisht për studime komplekse, mbikëqyrjen e ndërtimit, shërbimet këshilluese, dhe për shumicën e detyrave të trajnimit. Pagesat janë të bazuara në normat e orës, ditore, javore, apo mujore (për ekspertët të cilët zakonisht emërtohen në kontratë) dhe mbi sendet erimbursueshëm përdoren shpenzimet reale dhe /ose çmimet e dakorduara për njësi. Normat për ekspertët përfshijnë pagesat, kostot shoqërore, shpenzimet e përgjithshme, fitimin, dhe, sipas rastit, shtesat e veçanta. Kontrata përfshin shumën e kufizueshme të totalit të pagesave që bëhen për konsulentët. Kjo shumë e tavanit duhet të përfshijë njëndihmë emergjente për shërbimet dhe kohëzgjatjen e paparashikuar, dhe një dispozitë për rregullim të çmimit për inflacion, ashtu siç parashihet me paragrafin 4.7 të këtyre Udhëzimeve. Kontratat të bazuara në kohë duhet të monitorohen nga afër dhe të administrohen nga klienti për të siguruar që detyra po ecën në mënyrë të kënaqshme dhe se pagesat e kërkuara nga konsulentët janë të përshtatshme.
- 4.3 *Kontrata për shërbime dhe/ose kontrata me honorarë rezervë (të suksesit)*. Kontratat për shërbime dhe/ose kontrata me honorarë rezervë (të suksesit) përdoren kur konsulentët (bankat apo firmat financiare) janë duke i përgatitur kompanitë për shitje apo për bashkim të firmave, veçanërisht në operacione privatizimit. Pagesa e konsulentit përfshin një tarifë të shërbimit dhe një tarifë të suksesit, ky i fundit shprehur normalisht si një përqindje e çmimit të shitjes së pasurisë.
- 4.4 *Kontrata me përqindje*. Këto kontrata përdoren zakonisht për ofruesit e shërbimeve të prokurimit dhe inspektimit. Kontratat me përqindje drejt përsëdrejti ndërlidhin tarifën e paguar për konsulentin me kostot vlerësuar reale të ndërtimit të projektit, apo kostos së mallrave të prokuruar dhe inspektuar. Kontratat negociohen në bazë të normave të tregut për shërbime dhe/ose kosto në person/muaj për shërbime, ose ofertohen në mënyrë konkurruese. Duhet të mbahet në mend se në rast të

⁵¹Formulari standard i *Kontratës për shërbime konsulente (Pagesa me shumë të parajgykuar – paushall)*.

⁵²Forma standard e *Kontratave për shërbimet e konsulentëve (detyrat komplekse të bazuar në kohë)*. Këto dokumente gjenden në ueb faqen e Bankës në <http://www.worldbank.org/procure>.

shërbimeve arkitekturnale apo inxhinierike, kontratat me përqindje nuk përmbajnë stimuj për dizajn ekonomik dhe prandaj edhe dekurajohen. Prandaj, aplikimi i një kontrate të tillë për shërbime arkitekturnale rekomandohet vetëm nëse bazohet në një kosto fikse cak dhe mbulon shërbimet e definuara në mënyrë precize (por jo për shembull për mbikëqyrje të punëve).

- 4.5 *Kontrata me dorëzim/liferim të pacaktuar (IDC) ose Marrëveshja mbi çmimin.* IDC-të përdoren kur Huamarrësit duhet të sigurojnë qasje të shpejtë dhe të vazhdueshme shërbimeve të specializuara “me thirrje” për ndonjë aktivitet të caktuar, përmasa dhe koha e të cilëve nuk mund të definohet më herët. IDC-të zakonisht përdoren për të angazhuar “këshilltarë”, gjykues ekspertë, anëtarë të panelit, ose ekspertë për të marrë pjesë në hartiminose zbatimin enënprojekteveapo detyravekomplekseगततं ekzekutimittë projekteve tëfinancuara nga Banka(për shembull, paneli i digës, bordeve tëzgjidhjes së mosmarrëveshjeve, reformat institucionale, këshilla të prokurimit, zgjidhja e problemeve teknike, vlerësimi i çështjevembrojtëse, e kështu me radhë), zakonishtpër një periudhë prejsë paku një viti. Shërbimetofrohen ngafirmat ekualifikuarapërmes një listetë ekspertëve tëpropozuaratë cilat firma zotohet t’i vë në dispozicion nëletrën esynimitnë përgjigje të REOI ku përcaktohen kriteret E përzgjedhjestë cilat fokusohen në kualifikimetpërkatëse dheekspertizën eekspertëvetë kërkuar. Huamarrësitpastaj krijojë njëlistë të gjatë tëekspertëve të kualifikuar. Huamarrësi dhe firmatbien dakordpër normat e para-caktuara që iu paguhen ekspertëvedhepër kushtestandardet tëkontratës, ndërsa pagesat bëhen mbi bazën ekohës së shpenzuar në të vërtetë.Ekspertëtzgjidhennga lista e gjatëmbi bazën e kërkesës për "thirrje" me TORspecifikpër detyrën, bazuar në vlerësimincilësor /krahasimin ebiografive tëekspertëvetë propozuarapo nga niveli i honorarit, ndërsa për çdo detyrë nënshkruhet kontratëe veçantë.

Dispozitat me rëndësi

- 4.6 *Valuta.* KPP-të deklarojnë qartë sefirmat mund tëshprehinçmimin përshërbimet e tyre në çdo lloj valuteplotësisht tëkonvertueshme.Nësekonsulentët dëshirojnë tëshprehinçmiminsi shuma esasivenë valuta tëndryshme të huaja, ato mundta bëjnë këtë, me kusht që propozimipërfshinjo më shumë setrevaluta të huaja. Huamarrësi mund t’u kërkojëkonsulentëvetë deklarojnëpjesën eçmimit të cilat përfaqësojnëshpenzimet lokale në monedhëne vendittë Huamarrësit. Pagesatsipaskontratës bëhënnëvalutëosevaluta në tëcilat kërkohet pagesa nëpropozim.
- 4.7 *Rregullimi i çmimeve.* Për të rregulluarnormat epagesësnë një kontratë të bazuar në kohë për të reflektuar inflacionine huajdhe /ose lokal, në kontratë përfshihet një dispozitë për rregullimçmimi, nëse kohëzgjatja e saj pritët të tejkalojë18(tetëmbëdhjetë) muaj. Kontratat e bazuara në kohë, të një kohëzgjatje më të shkurtëmund të përfshijnënjë dispozitë për rregullimittë çmimeve, kur inflacionivendorapo i huajpritettë jetë i lartëdhe i paparashikueshëm. Kontratat paushall në përgjithësi nuk iu nënshtrohet rregullimitautomatik tëçmimeve, kur kohëzgjatja e tyrepritët tëjetë më pak se18(tetëmbëdhjetë) muaj, me përjashtim të kontratave të voglame shumë-vjeçare (për shembull me auditorët). Çmimi i kontratës me shumë fikse përjashtimit mund të ndryshojë kur fushëveprimi i shërbimeve zgjerohet përtej asaj që është paraparë në përshkrimin fillestar të detyrave dhe përgjegjësi (TOR) dhe me kontratë.

- 4.8 *Dispozitat e pagesës.* Dispozitat e pagesës, duke përfshirë shumat për pagesë, orari i pagesave, si dhe procedurat e pagesës, dakordohen gjatë negociatave të kontratës. Pagesat mund të bëhen në intervale të rregullta (si në kontratat e bazuara në kohë) ose për rezultatet të pajtuara (si në bazë të kontratave paushall). Pagesat për të gjitha avanset (për shembull, për kostot e mobilizimit) sigurohen nga sigurimi i pagesës me paradhënie ose nga garancioni, përveç në rastin e kontratave me vlerë të vogël, siç përcaktohet në fusnotën 34. Nëse shuma avansit është dhjetë për qind e shumës së kontratës ose më pak, Huamarrësi mund të vendosë të mos kërkojë një siguri ose garancë të tillë, me ç'rast kjo duhet të ceket në draftin e kontratës të përfshirë në KPP.
- 4.9 Pagesat bëhen menjëherë në përputhje me dispozitat e kontratës. Për këtë qëllim,
- (a) konsulentët mund të paguhet direkt nga Banka me kërkesë të Huamarrësit ose përjashtimisht nëpërmjet Letrës së kreditit;
 - (b) vetëm shumat e kontestuara nuk paguhet, ndërsa pjesa tjetër e faturës paguhet në përputhje me kontratën; dhe
 - (c) kontrata parasheh pagesën e ngarkesave financiare nëse pagesa vonohet për shkak të gabimit të klientit përtej kohës së lejuar në kontratë; norma e ngarkesave specifikohet në kontratë.
- 4.10 *Sigurimi i Propozimit dhe i Performancës, dhe Dëmet e likuiduara.* Siguria e propozimit dhe e performancës nuk rekomandohen për shërbimet e konsulentëve, por, nëse kërkohet, duhet të jenë në një sasi të arsyeshme. Zbatimi i tyre është shpesh subjekt i vendimeve të bazuara në gjykim të lirë, mund të abuzohen lehtë, dhe kanë tendencë të rrisin koston për industrinë e konsulencës pa përfitime të dukshme, të cilat qartazi i barten Huamarrësit. Përveç kësaj, për shkak se ofrimi me kohë i shërbimeve të një natyre intelektuale dhe këshilluese varet në shumë mënyra pas veprimeve nga veprimet e klientit, duke e bërë kështu të vështirë përcaktimin e përgjegjësisë së vetme të konsulentit, në rast të vonesave, aplikimi i dëmeve të likuiduara nuk është rekomandohet për shërbime konsulente.
- 4.11 *Kontributi i Huamarrësit.* Huamarrësi mund të caktojë anëtarë të stafit të vet profesional në detyra në cilësi të ndryshme. Kontrata ndërmjet Huamarrësit dhe Konsulentit parasheh detajet që qeverisin staf të tillë, të njohur si staf homolog, si dhe stabilimentet që ofrohen nga Huamarrësi, siç janë strehimi, hapësira për zyre, mbështetje sekretarie, shërbimet, materialet, dhe automjetet. Kontrata vë në pah masat të cilat mund t'i ndërmerr konsulenti në qoftë se ndonjëri nga nenet nuk mund të ofrohet ose duhet të tërhiqet gjatë detyrës, si dhe kompensimi të cilin konsulenti do të merr në një rast të tillë.
- 4.12 *Konflikti i interesit.* Konsulenti nuk merr pagesë në lidhje me ndonjë detyrë tjetër përveç atyre të paraparë me kontratë. Konsulenti dhe vartësit e tij nuk përfshihen në konsultime për aktivitete të tjera të cilat janë në konflikt me interesat e klientit sipas kontratës. Kontrata përfshin dispozitat me të cilat kufizohet angazhimi i ardhshëm i konsulentit për shërbime të tjera të cilat rrjedhin nga ose janë drejtpërsëdrejti të

ndërlidhura me shërbimet konsulentë të firmës në përputhje me dispozitat e paragrafëve 1.9 dhe 1.10 të Udhëzimeve.

- 4.13 *Përgjegjësia profesionale.* Konsulenti pritet të kryejë detyrën e vet me kujdesin e duhur dhe në përputhje me standardet mbizotëruese të profesionit. Duke qenë se përgjegjësia e Konsulentit ndaj Huamarrësit qeveriset nga ligji në fuqi, kontratanë ka nevojë të merret me këtë çështje, përveç nëse palët dëshirojnë ta kufizojnë këtë detyrim. Nëse ata e bëjnë këtë, ata duhet të sigurojnë që (a) nuk duhet të ketë asnjë kufizim të asnjë lloji; (b) detyrimi i konsulentit ndaj Huamarrësit në asnjë rast nuk mund të kufizohet në mënyrë pakse një koeficient të vlerës së përgjithshme të kontratës i cili tregohet në KPP dhe në kushtet e veçantat të kontratës (shuma e kufizimit të tillë varet nga çdorast specifik);⁵³ dhe (c) çdo kufizim i tillë mund të merret vetëm me detyrimin e konsulentit drejt klientit dhe jo me detyrimin e konsulentit ndaj palëve të treta.
- 4.14 *Zëvendësimi i Ekspertëve.* Gjatë një detyre, nëse zëvendësimi është i nevojshëm (për shembull, për shkak të shëndetit të sëmurë, ose sepse një ekspert dëshmon të jetë ipapërshtatshëm ose humbet zotësinë juridike në ndonjë mënyrë tjetër), konsulentin propozon ekspertë të tjerë të njëjtë nivel të kualifikimit për miratim nga ana e Huamarrësit.
- 4.15 *Ligji i zbatueshëm dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve.* Kontrata përfshin dispozita që kanë të bëjnë me ligjin e zbatueshëm dhe forumin për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Kontratat e konsulentëve përfshijnë një klauzolë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Arbitrazhi ndërkombëtar komercial në një vend neutral ka avantazhe praktikë me metodat tjera për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Për këtë arsye, Banka kërkon që Huamarrësit ta përdorin këtë lloj të arbitrazhit në kontratat për konsulentët e huaj nëse Banka ka rënë dakord në mënyrë specifike që të heqë dorë nga kjo kërkesë për shkak të justifikuarasiq janë rregulloret ekuivalente kombëtare dhe procedurat e arbitrazhit. Banka nuk emërohet arbitër dhe as nuk i kërkohet të emërojë arbitër.⁵⁴

V. PËRZGJEDHJA E KONSULENTËVE INDIVIDUAL

⁵³Huamarrësi i kurajohet të organizojë sigurimin për rreziqet e mundshme të mësipërme mbi këto limiteve. Koeficienti duhet të jetë më shumë se një. Aty ku mund të mos ketë nevojë për kushtet e përgjegjësive profesionale, Huamarrësi shpjegon arsyet për kërkimin e miratimit të KPP-së nga Banka.

⁵⁴Është e kuptueshme, megjithatë, që zyrtarët e Qendrës Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve në Investime (ICSID) mbetet i lirë të emërojë arbitranë cilësinë e tyre si zyrtarë të ICSID.

- 5.1 Konsulentët individualë⁵⁵ punësohen në detyra për të cilat (a) një ekip i ekspertëve nuk është i nevojshëm, (b) kërkohet një mbështetje shitesë e jashtme (jashtë zyrës së vendit), dhe (c) eksperiencia dhe kualifikimet e individit janë të rëndësishme më të lartë. Kur koordinimi, administrimi, apo përgjegjësia kolektive mund të bëhen të vështira për shkak të numrit të individëve, është e këshillueshme të punësohet një firmë. Kur konsulentë të kualifikuar individualë nuk janë në dispozicion ose nuk mund të nënshkruajnë një kontratë të drejtpërdrejtë me një huamarrës për shkak të ndonjë marrëveshje paraprake me ndonjë firmë, Huamarrësi mund të ftojë firma të ofrojnë konsulentë të kualifikuar individualë për detyrë.
- 5.2 Inkurajohet të bëhen shpalljet për të kërkuar shprehje të interesit (EOI), veçanërisht kur Huamarrësi nuk ka njohuri rreth individëve me përvojë dhe të kualifikuar ose rreth disponueshmërisë së tyre, apo kur shërbimet janë komplekse, ose kur përfitimet e mundshme nga shpallja e tij është më e gjerë, ose në qoftë se kërkohet sipas ligjit kombëtar. Megjithatë, kjo nuk mund të kërkohet në të gjitha rastet, dhe nuk duhet të bëhet për kontrata me vlerë të vogël⁵⁶. Të gjitha ftesat për EOI duhet të përcaktojnë kritere të përzgjedhjes që bazohen vetëm në përvojën dhe kualifikimet. Kur firmat ftohen të propozojë konsulentë individualë, EOI sqaron se vetëm përvoja dhe kualifikimet e individëve përdoren në procesin e përzgjedhjes, dhe se përvoja e tyre korporatave nuk merret parasysh, dhe specifikon nëse kontrata do të nënshkruhet me firmën apo me individë të propozuar.
- 5.3 Konsulentët individualë zgjidhen në bazë të përvojës së tyre përkatëse, kualifikimeve, dhe aftësisë për të kryer detyrën. Ata nuk kanë nevojë të paraqesin propozime ndërsa do të shqyrtohet nëse i plotësojnë kërkesat minimale përkatëse të cilat do të përcaktohen nga Huamarrësi varësisht prej natyrës dhe kompleksitetit të detyrës, dhe vlerësohen në bazë të sfondit akademik dhe përvojës relevante të caktuar, dhe, sipas nevojës, edhe për nga njohja e kushteve lokale siç janë gjuha, kultura kombëtare, sistemet administrative dhe organizimin e qeverisë. Përzgjedhja kryhet nëpërmjet krahasimit të kapacitetit përkatës të përgjithshëm të së paku tre kandidatëve të kualifikuar në mesin e atyre që kanë shprehur interes, drejtpërdrejt ose nëpërmjet një firme, në detyrën ose janë kontaktuar drejtpërdrejt nga Huamarrësi. Individët e përzgjedhur për angazhim nga Huamarrësi duhet të jenë më me përvojë dhe më me kualifikim, dhe të jenë plotësisht të aftë për të kryer detyrën. Huamarrësi nuk negocion një kontratë me konsulentin ose firmën e përzgjedhur individuale, si mund të jetë rasti, pas arritjes së marrëveshjes mbi termat dhe kushtet e kënaqshme të kontratës, përfshirë honorarë dhe shpenzime të tjera të arsyeshme.
- 5.4 Përzgjedhja e konsulentëve individualë normalisht nuk është subjekt i shqyrtimit paraprak. Huamarrësi, megjithatë, marrin miratimin e Bankës: (a) në rastet kur nuk ka mundur të krahasojë të paktën tre kandidatë të kualifikuar para angazhimit, me ç'rast

⁵⁵Konsulentët individualë shërbimet e të cilëve janë të nevojshme në kuadër të programit pilotimit të Bankës UCS përzgjidhen përputhje me metodologjinë e cekur në paragrafin 3.12, dhe me kusht që detyra bie nënkuftirin e përcaktuar nga Banka.

⁵⁶Reklamim për EOI nuk bëhet normalisht për kontratat individualë nën US\$ 50,000. Pragu i tillë, megjithatë, përcaktohet në çdo rast, duke marrë parasysh natyrën, kompleksitetin dhe rreziqet e detyrës. Banka mund të bie dakord, në qoftë se kërkohet nga Huamarrësi, që detyrat të shpallen si të papërshtatshme për financim nga Bankatë individëve nga vendi i Huamarrësit të cilët janë nën sanksionet përjashtimit ngadhënia e kontratës nga autoriteti përkatës gjyqësori vendit dhe Huamarrësit në pajtim me ligjet e saj përkatëse, me kusht që Bankatë të konstatojnë se individët e përfshirë në masat e korrupsionit dhe se procesi gjyqësor i ka dhënë individit proces adekuat të duhur.

ofron arsytet; (b) para se të fton firmat për të ofruar Shërbimet e konsulentëve individualë sipas paragrafit 5.1 të këtyre udhëzimeve; (c) në rast se negociatat me individin e përzgjedhur dështojnë përpara se të negociojë me individin tjetër më të mirë apo me firmën, varësisht prej rastit, dhe (d) Në rast përzgjedhjes një-burimore sipas paragrafit 5.6 të këtyre Udhëzimeve. Banka gjithashtu kërkon shqyrtim paraprak të zgjedhjes së kategorive të caktuara të konsulentëve individual⁵⁷.

- 5.5 Kur një kontratë nënshkruhet me një firmë konsulente për të ofruar konsulentë individualë. ose staf të saj të përhershëm ose bashkëpunëtorët apo ekspertë të tjerë të cilët mund t'i rekrutojë, dispozitat e konfliktit të interesit të përshkruara në këto Udhëzime vlejné për firmës amë. Nuk lejohet zëvendësimi i asnjë individi i cili fillimisht u propozua dhe u lejua, dhe në një rast të tillë, nënshkruhet kontrata me konsulentin e ardhshëm të radhës.
- 5.6 Konsulentët individualë mund të zgjidhet me përzgjedhje një-burimore vetëm me arsyetimin e duhur dhe atë në raste të veçanta siç janë: (a) detyrattë cilat janë vazhdim i punëvetë mëparshme të cilat konsulenti i ka kryer dhe për të cilat konsulenti është përzgjedhur në mënyrë konkurruese; (b) detyra me kohëzgjatje totale prej më pak se gjashtë muajve; (c) rastet urgjente, dhe (d) kur individi është konsulent i vetëm i kualifikuar për atë detyrë. Huamarrësi i paraqet Bankës në rishikim dhe miratim përshkrimi e detyrave dhe përgjegjësi, një arsyetim të detajuar, duke përfshirë arsyetimin për përzgjedhjen një-burimore në vend të një procesi konkurrues të përzgjedhjes dhe baza për të rekomanduar konsulentin e caktuar në të gjitha rastet e tilla, me përjashtim të kontratave nën kufirin e përcaktuar në bazë të rreziqeve dhe fushëveprimt të projektit, dhe të cekura në Planin e Prokurimit.

ANEKSI 1: SHQYRTIMI I PËRZGJEDHJES SË KONSULENTËVE NGA BANKA DHE PUBLIKIMI I DHËNIES SË KONTRATËS

⁵⁷Ataqë punësohen për ndihmë teknike ose shërbime këshilluese afatgjate për kohëzgjatje projektit (mbi pragun paraprak të shqyrtimit të përcaktuar në Marrëveshjen e Huasëose me planin e prokurimit), dhe (pavarësisht pragut paraprak të rishqyrtimit), ataqë punësohen për punë juridike ose aktivitetet e prokurimit të ndërlidhura me projektin. Shqyrtim paraprak i TOR-të konsulentëve individualë nga Banka është i obligueshëm, përveç nëse përcaktohet ndryshe nga menaxherët Rajonaletë Prokurimit të Bankës, përdetyra të kufizuara, të thjeshta dhe me vlerë të vogël.

Orari i procesit të përzgjedhjes

1. Banka shqyrton⁵⁸ Planet e prokurimit dhe azhurnimet e tyre të përgatitura nga Huamarrësit në përputhje me dispozitat e paragrafit 1.25. Ato duhet të jenë në përputhje me Planin e implementimit të projektit, Marrëveshjen e huasë dhe me këto Udhëzime.

Shqyrtimi paraprak

2. Në lidhje me të gjitha kontratat⁵⁹ të cilat iu nënshtrohen rishqyrtimit paraprak të Bankës:
 - (a) Para se të thirren propozimet, Huamarrësi i paraqet Bankës për rishikim dhe miratim, vlerësimin e propozuar të kostos dhe KPP-në (duke përfshirë listën e ngushtë). Huamarrësi bën modifikime në listën e ngushtë dhe në dokumentet e cilat Banka i kërkon me arsye. Çdo modifikim i mëtejshëm kërkon miratimin e Bankës para se KPP t'u jetë lëshuar konsulentëve të listës së ngushtë⁶⁰.
 - (b) Pas propozimit teknik të jenë vlerësuar, Huamarrësi i paraqet Bankës, me kohë të mjaftueshme për shqyrtimin e saj, një raport të vlerësimit teknik (përgatitur, nëse Banka e kërkojë këtë, nga ekspertë pranueshëm nga Banka në pajtim me paragrafin 2.16) dhe një kopje të propozimeve, nëse kërkohet nga Banka. Nëse banka konstaton se vlerësimi teknik është kundërshtim me dispozitat e KPP-së, ajo informon menjëherë Huamarrësin dhe cek arsyet për konstatimin e saj; në të kundërtën, Banka lëshon miratimin për vlerësimin teknik. Huamarrësi gjithashtu kërkon miratimin e Bankës, nëse raporti i vlerësimit rekomandon refuzimin e të gjitha propozimeve.
 - (c) Huamarrësimi mund të vazhdojë hapjen e propozimeve financiare vetëm pas marrjes së miratimit të Bankës mbi vlerësimin teknik. Kur kostoja është një faktor në zgjedhjen e konsulentit, Huamarrësi mund të vazhdojë me vlerësimin financiar në përputhje me dispozitat e KPP-së. Huamarrësi i paraqet Bankës raportin përfundimtar të vlerësimit të bashkë rekomandimit të tij mbi konsulentin suksesshëm. Huamarrësi njofton firmën që ka marrë rezultatin më të lartë total në vlerësimin përfundimtar lidhur me synimin e saj që të jep kontratën për firmën dhe firmën për negociatën. Nëse Banka vëren ndonjë mospërputhje në vlerësimin financiar në përputhje me shqyrtimin vet os sipas ndonjë ankese, ajo duhet të njoftojë Huamarrësin pa vonesë, i cili i shtjellon menjëherë të gjitha çështjet e ngritura në masën e kënaqshme për Bankën para se të vazhdojë negociatat me konsulentin e suksesshëm apo të suspendojë negociatat nëse tashmë i ka filluar. Në raste të tilla, veprimet tjera nuk ndërmerren deri sa Banka të ketë dhënë miratimin e saj për rekomandimin e Huamarrësit.

⁵⁸Paragrafët 11 deri 15 të Aneksit III përcaktojnë veprimet që i merr Banka nëpërgjigje të komunikimeve nga ofertuesit, duke përfshirë ankesat e Ofertuesve, dhe kërkesave të ofertuesve për pas-informim.

⁵⁹Vlera totale e kontratës duke përfshirë të gjitha taksat dhe taksat do të jetë bazuar për të përcaktuar nëse një kontratë nënshtrohet shqyrtimit paraprak apo pasues nga Banka.

⁶⁰Në rastin e kontratave që jep sipas paragrafit 3.11, ku një proces i rikonkurrës nuk është i mundur, Huamarrësi nuk iniciuon negociatat pa dhënë së pari Bankës në shqyrtim arsyetimin e duhur dhe pa marrë miratimin e Bankës, dhe përndryshe jekërkesat e këtij paragrafi 2, në të gjitha aspektet relevante.

- (d) Nëse Huamarrësi kërkon një zgjatje të vlefshmërisë së propozimeve për të përfunduar vlerësimin, të marrë aprovimet e nevojshme të brendshme apo bankë asnjë kundërshtim, ose të bëjë çmimin, ai duhet të kërkojë kundërshtimin paraprak të Bankës asnjë për kërkesën e parë të zgjerimit në qoftë se të tilla është për një periudhë më të gjatë se katër javë, dhe për të gjitha kërkesat pasuese për zgjerimin, pavarësisht kohëzgjatjes së periudhës.
- (e) Nëse Huamarrësi merr ankesa nga konsulentët, ajo menjëherë i dërgon parashtruesit të ankesës një vërtetim pranimi, ndërsa Bankës për rishikim dhe komente një kopje të ankesës, komentet e Huamarrësi për çdo çështje të ngritur në ankesë, dhe një kopje të përgjigjes së propozuar ankuesit.
- (f) Nëse si rezultat i analizës së një ankese, apo për ndonjë arsye tjetër. Huamarrësi ndryshon rekomandimin e vet për dhënien e kontratës, arsyet për një vendim të tillë dhe një raport të rishikuar të vlerësimit i dorëzohet Bankës për miratim. Huamarrësi siguron një ribotim të dhënies së kontratës në formatin e paragrafit 7 të këtij Aneksi. Nëse negociatat me konsulentin e suksesshëm dështojnë, Huamarrësi i paraqet Bankës në shqyrtim procesverbalet e negociatave dhe arsyet për dështimin. Pas përfundimit të procedurës së përshkruar në paragrafin 2.30 të këtyre Udhëzimeve, dhe marrjen e miratimit nga Banka, negociatat mund të ndërpriten dhe firma tjetër e radhës ftohet për negociata.
- (g) Pas përfundimit të negociatave, ose në rastin e përzgjedhjes nga një burim i vetëm, Huamarrësi i paraqet Bankës, në kohë të mjaftueshme për shqyrtim, një kopje të kontratës së negociuar të propozuar për nënshkrim nga Huamarrësi, e cila përmban inicialet e konsulentit të suksesshëm. Nëse kontrata e negociuar rezulton në zëvendësimin e ekspertëve kyç ose në çfarëdo ndryshimi në TOR dhe në kontratën fillestare të propozuar, Huamarrësi nxjerrë në pah ndryshimet dhe siguron një shpjegim se përse këto ndryshime janë të nevojshme dhe të pranueshme për Huamarrësin.
- (h) Nëse banka përcakton se raporti përfundimtar i vlerësimit, rekomandimi për dhënien e kontratës, dhe / ose kontrata e negociuar janë në kundërshtim me dispozitat e KPP-së, ajo informon menjëherë Huamarrësin dhe tregon arsyet për vendimin e saj. Përndryshe, Banka jep miratimin e saj përfundimtar për dhënie të kontratës. Huamarrësi konfirmon çmimin dhe nënshkruan kontratën vetëm pas marrjes së miratimit nga Banka.
- (i) Një kopje e konformuar e kontratës i dorëzohet Bankës pa vonesë pas nënshkrimit dhe para dorëzimit të kërkesës së parë tek Banka për tërheqje të fondeve nga Llogaria e huasë në raport me kontratën e tillë. Kur pagesat për kontratë duhet të bëhen nga një Llogari e veçantë (SA), kopja e kontratës i dorëzohet Bankës para se të bëhet pagesa e parë nga SA në lidhje me kontratën e tillë.
- (j) Përshkrimidhe shumae kontratës, së bashku me emrindhe adresën ekonsulentit, përveç nëse është një individ, iu nënshtrihen deklaramit publiknga Banka

nëpajtimme nën-paragrafin(i) më lartë pas marrjes së kopjes së nënshkruar të kontratës nga Huamarrësi.

- (k) Huamarrësi ruan të gjithë dokumentacionin në lidhje me çdo kontratë gjatë implementimit të Projektit deri në dy vjet pas datës mbyllëse të Marrëveshjes së huasë. Ky dokumentacion do të përfshinte, por të mos ishte i kufizuar në: (i) origjinalin e nënshkruar të çdo kontrate dhe të gjitha ndryshimet dhe plotësimet pasuese; (ii) propozimet origjinale, të gjitha dokumentet dhe korrespondenca e ndërlidhur me përzgjedhjen dhe implementimin e kontratës, përfshirë ato në mbështetje të vlerësimit të propozimeve (përfshirë edhe tabela të poenave), si dhe rekomandimin për dhënie të kontratës të bërë Bankës; dhe (iii) faturat dhe dëftesat e pagesës. Për kontratat e dhënë sipas metodës SSS, dokumentacionin përfshin arsyetimin për aplikimin e metodës, kualifikimet dhe përvojën e konsulentit të zgjedhur; dhe origjinalin e nënshkruar të kontratës. Huamarrësi i ofron këto dokumente Bankës pas kërkesës për ekzaminim nga Banka ose nga konsulentët/auditorët e saj.
3. *Modifikimi i kontratës së nënshkruar.* Në rastin e kontratave që i nënshtrohen rishikimit paraprak, para se të dakordohen për: (a) një zgjatje të kohës së përcaktuar për kryerjen e kontratës, (b) ndryshimet thelbësore në fushëveprimin e shërbimeve, zëvendësimet ekspertëve kyç, apo për ndryshime të tjerat të rëndësishme të termat dhe kushtet të kontratës; ose (c) ndërprerjen e propozuar të kontratës, Huamarrësi kërkon miratimin e Bankës. Nëse Banka konstaton se modifikimet propozuar do të jenë në kundërshtim me dispozitat e Marrëveshjes së Huasë dhe / ose planin e prokurimit, ajo informon menjëherë Huamarrësin dhe tregon arsyetimet për vendimin e saj. Një kopje e të gjitha amendamenteve të kontratës i dorëzohet Bankës për dosjet e saj.
4. *Përkthimet.* Në qoftë se një kontratë i nënshtrohet shqyrtimit paraprak dhe është shkruar në Gjuhën Kombëtare⁶¹, Huamarrësi ka përgjegjësinë që t'i paraqesë Bankës një përkthim të sakt të raporteve të vlerësimit teknik dhe kontratën e dakorduar të negociuar me iniciale, në gjuhën e përdorur ndërkombëtarisht të specifikuar në KPP (anglisht, frëngjisht apo spanjisht). Përkthimi i saktë gjithashtu jepet Bankës për çdëndryshim të mëvonshëm të këtyre kontratave.

Shqyrtimi pasues

5. Shqyrtimi pasues i prokurimit (PPR) kryhet normalisht nga Banka. Huamarrësi ruan të gjithë dokumentacionin në lidhje me çdo kontratë që nuk rregullohet nga paragrafi dykëtëj Aneksi gjatë zbatimit të projektit dhe deri në dy vjet pas datës së mbylljes së Marrëveshjes mbi huasë. Ky dokumentacion përfshin, por nuk kufizohet vetëm në, origjinalin e nënshkruar të kontratës dhe të gjitha ndryshimet ose shtesat e mëvonshme, propozimet origjinale, raportin e vlerësimit teknik dhe raportin kombinuar të vlerësimit, rekomandimin për dhënie të kontratës, dhe faturat ose dëftesat e pagesës për shqyrtim nga Banka ose nga konsulentët / auditorët e saj. Për kontratat e dhënë mbi bazën e përzgjedhjes së burimeve, përfshihet shënimi i arsyetimit, kualifikimet dhe përvoja e konsulentëve, dhe origjinali i nënshkruar i kontratës. Huamarrësi siguron dokumentacion të tillë për Bankën sipas kërkesës. Banka mund të

⁶¹ Shih paragrafin 1.22

deklarojëkeq prokurim për ndonjë ngaarsyet e parashikuaranë paragrafin1.19të këtyre Udhëzimeve,edhenëse konstaton sekontrata nukishte dhënë në përputhje meprocedurat e rëna dakorddhe metodat epasqyruara nëMarrëveshjen e Huasëdhe të përpunuara më tej në planin e prokurimevepër të cilën Banka dha miratimin e saj, apo që vetë kontratanukështë në përputhje me proceduratdhe metodatetilla. Banka informon menjëherëHuamarrësinpër arsyet enjë vendimi të tillë. Banka gjithashtu mund, në varësi të rreziqeve dhefushëveprimit tëprojektit (p.sh., projekte që përfshijnë vlerashumë të vogla dhe kontrata të thjeshta), të pajtohetme Huamarrësinqëata të emërojnësubjekte të pavarurapër të kryerPPR-në, në përputhje me termat. kushtet dheprocedurat e raportimittë pranueshëmepër Bankën.Në raste të tilla, Bankashqyrtonraportet e paraqituranga Huamarrësi, dhe ruantë drejtën e saj për të kryerdrejtëpërdrejt shqyrtimetpasuese gjatë zbatimit të projektit, sipas nevojës.

6. Kontrata, vlerësimi i kostos i së cilës është nën pragun e shqyrtimit paraprak të Bankës të cekur në Planin e Prokurimit bienën shqyrtimin paraprak dhe jo shqyrtimin pasues nëse oferta financiare e firmës së përzgjedhur e tejkalon pragun e tillë. Të gjitha dokumentet përkatëse të prokurimitashmë të përpunuara, duke përfshirë raportin e vlerësimit dhe rekomandimi përdhënien e kontratës, duhet t'i dorëzohen Bankës për shqyrtim paraprak dhe për miratim para dhënies së kontratës. Kur, në të kundërtën, oferta financiare e firmës së përzgjedhur bienën pragun e shqyrtimit paraprak, procesi i shqyrtimit paraprak vazhdon. Në rrethana të caktuara, Banka mund të kërkojë nga huamarrësi që të ndjeknjë proces të rishikimit paraprak për një kontratë nën pragun e shqyrtimit paraprak të përcaktuar në Planin e Prokurimit, për shembull në rastin enjë ankesë të cilën Banka e konsideron të jetë natyrës serioze. Gjithashtu, kur metoda e përzgjedhjes duhet të ndryshojë për shkak të vlerësimeve më të larta ose më të ulëta së sakostoja e vlerësuar më parë, plani i prokurimit do të modifikohet nga Huamarrësi dhe i dorëzohet Bankës për shqyrtim dhe miratim.

Publikimi i dhënies së kontratës

7. Huamarrësi publikon informatat në *UNDB online* për të gjitha kontratat kur lista e ngushtë përfshin ndonjë firmë të huaj dhe të gjitha kontratat një-burimore i janë dhënë firmave të huaja, si dhe në shtypin kombëtar⁶² publikohen të gjitha kontratat ku lista e ngushtë përfshin firma vendore dhe të gjitha kontratat një-burimore të dhënë firmave kombëtare. Publikimi i tillë bëhet në afat prej dy javëve pas pranimit të miratimit të Bankës lidhur me dhënien e kontratës sipas paragrafëve 2(h) dhe 2(j) të këtij Aneksi për kontrata që iu nënshtrohen shqyrtimit paraprak të Bankës, dhe në afat prej dy javëve pas negociimit të suksesshëm me firmën e përzgjedhur për kontratat që iu nënshtrohet shqyrtimit pasues të Bankës. Publikimet përfshijnë informata vijuese, të cilat vlejné dhe zbatohen për çdo metodë: (a) emrat e të gjithë konsulentëve në listën e shkurtër, duke specifikuar ato që dorëzuan propozimet; (b) pikët e caktuara për secilin kriter dhe nën-kriter të secilit konsulent; (c) çmimet e ofruara nga secilin konsulent siç janë lexuar dhe sipas vlerësuar; (d) rezultatet përfundimtare të kombinuara dhe rangut përfundimtar të konsulentëve; (d) Emri i konsulentit të suksesshëm dhe çmimi i përgjithshëm, kohëzgjatja, dhe përmbledhja e fushëveprimit të kontratës. I njëjti informacion dot'u dërgohet të gjithë këshilltarëve të cilët kanë paraqitur propozimet.

⁶²Një gazetë kombëtare me tirazh të madh dhe /ose në gazetën zyrtare kusht që ajo është e qarkullimit të gjerë, ose në një faqe interneti të përdorur gjerësisht ose portali elektronik meqasjetë lirë kombëtare dhe dërkombëtare, në gjuhën kombëtare, siç përcaktohet sipas paragrafit 2.15.

Banka organizon publikimin edhënies sëkontrataveme shqyrtimparaprak në ueb faqen e saj të jashtme pas pranimit të njëkopje të konformuar të kontratës nga Huamarrësi, të nënshkruar në përputhje me nën-paragrafin 2 (i) më lartë.

Hulumtimi paraprak në lidhje me politikën dhe procedurat e Bankës

8. Kur kryen vlerësimin e propozimeve, Huamarrësi kontrollon përshtatshmërinë e konsulentëve nga listat e firmave dhe individëve që janë të ndaluar dhe të pezulluar, në përputhje me paragrafin 1.23 (d) të këtyre Udhëzimeve dhe / ose paragrafit 1.16 (d) të Udhëzimeve të Prokurimit, nga Banka të cilat janë postuar në faqen e internetit të jashtëm të Bankës. Huamarrësi tregon kujdes të shtuar duke mbikëqyrur për së afërmi ndonjë kontratë në vazhdim e sipër (qoftë me shqyrtim paraprak apo pasues) të nënshkruar nga ndonjë firmë ose individ i cili ka qenë i sanksionuar nga Banka, pasi kontrata e tillë është nënshkruar. Huamarrësi nuk duhet as të nënshkruajë ndonjë kontratë të re dhe as të nënshkruajë ndonjë amendament, duke përfshirë edhe ndonjë zgjatje të kohës për përmbushjen, në një kontratë në vazhdim e sipër me një firmë apo individ të pezulluar ose të përjashtuar pas hyrjes në fuqi të pezullimit ose përjashtimit pa shqyrtimin paraprak të Bankës dhe miratimit të saj. Banka financon shpenzimet shtesë në qoftë se ata ishin bërë para datës së përfundimit të kontratës origjinale ose datës së përfundimit të rishikuar: (i) për kontratat me shqyrtim paraprak, në një amendament për të cilin Banka nuk ka dhënë miratimin e saj, dhe (ii) për kontratat me shqyrtim pasues, në një amendament të nënshkruar para datës së hyrjes në fuqi të pezullimit ose përjashtimit. Banka nuk financon ndonjë kontratë të re, ose ndonjë ndryshim ose plotësim me të cilin futet një ndryshim material në ndonjë kontratë ekzistuese që është nënshkruar me një firmë apo individ të pezulluar apo të përjashtuar më ose pas datës efektive të pezullimit ose përjashtimit.

ANEKSI 2: UDHËZIME KONSULENTËVE DHE TABELA E TË DHËNAVE (ITC) E KPP-së⁶³

1. Huamarrësi përdorë KPP-të standardetë lëshuara nga Banka, të cilat përfshijnë ITC, që mbulojnë udhëzimet përkatëse që vlejné për shumicën e metodave të përzgjedhjes. Nëse në rrethana të jashtëzakonshme, Huamarrësi duhet të ndryshojë ITC-në standarde, atëherë duhet ta bëjë këtë përmes fletës së dhënave teknike dhe jo mendryshimin e tekstit kryesor. ITC-japërfshin informata të mjaftueshme mbi aspektet e mëposhtme të detyrës:
 - (a) një përshkrim shumë të shkurtër të detyrës;
 - (b) formatet standarde për propozimet teknike dhe financiare;
 - (c) emrat dhe informatat kontaktuese të zyrtarëve të cilët duhet t'i adresohen sqarime dhe me të cilët takohet përfaqësuesi i konsulentëve, nëse është e nevojshme;
 - (d) detajet e procedurës së përzgjedhjes që duhet ndjekur, përfshirë (i) një përshkrim të procesit të fazës, nëse aplikohet, dhe (ii) një listë të kriterëve të vlerësimit teknik dhe peshave dhënë për secilin kriter, (iii) detajet e vlerësimit financiar; (iv) peshat relative për cilësinë dhe kostonnë rastin e QCBS; (v) pikët minimale kalimtare për cilësinë, dhe (vi) detajet mbi hapjen e propozimeve financiare;
 - (e) një vlerësim të nivelit të inputeve të ekspertëve kryesorë (në person-muaj) të nevojshëm nga konsulentët ose nga buxheti i përgjithshëm, por jo edhe për të dyja;
 - (f) indikacion të përvojës minimale, arritje akademike, dhe kështu me radhë, që priten nga ekspertët kyç;
 - (g) detajet dhe statusi i çdo financimi të jashtëm;
 - (h) informatat mbi negociatat; dhe informatat financiare dhe të tjera që dotë kërkohet nga firma e përzgjedhur gjatë negociatës së kontratës;
 - (i) afat për paraqitjen e propozimeve;
 - (j) Valuta(t), në të cilën duhet të shprehen, të krahasohen dhe të paguhet kostot e shërbimeve,;
 - (k) referencë ligjeve të vendit të Huamarrësit që mund të jenë veçanërisht të rëndësishme për kontratën e propozuar të konsulentëve;
 - (l) deklaratë që firma dhe vartësit e saj do të diskualifikohen nga ofrimi i mallrave, punëve apo shërbimeve në nivele më të ulëta sipas projektit nëse,

⁶³Ky Seksion nuk vlen në rast të kontratave të cilat jepen sipas Programit provues UCS, të përshkruar në paragrafin 3.12.

sipas mendimit të Bankës, aktivitetet e tilla përbëjnë një konflikt interesi me shërbimet që ofrohen në kuadër të detyrës;

- (m) metodat sipas të cilës parashtrihen propozimet, përfshirë kushtin që propozimet teknike dhe propozimet financiare të mbyllen dhe të parashtrihen ndaras në mënyrën e cila siguron që vlerësimi teknik nuk ndikohet nga çmimi;
- (n) një kërkesë që firma e ftuar (i) ta pranojë pranimin e KPP-së (ii) njofton Huamarrësin nëse do të parashtrojë një propozim apo jo;
- (o) lista e shkurtër e konsulentëve që ftohen të parashtrojnë propozimet dhe nëse janë të pranueshme shoqatat midis konsulentëve nga lista e ngushtë;
- (p) Periudha për të cilën propozimet e konsulencës do të konsiderohen të vlefshme dhe gjatë të cilëve konsulentët zotohen të mbajnë, pa ndryshuar, ekspertët e propozuar kyç, dhe mbesin pranë normave të propozuara dhe çmimit total; në rast të zgjerimit të periudhës së vlefshmërisë së propozimit, të drejtën e konsulentëve të mos mbajnë të pandryshuar propozimin e tyre. Nëse konsulentët bien dakord për zgjatjen e vlefshmërisë së propozimit të tyre, ata do të bëjnë këtë pa ndonjë ndryshim në propozimet e tyre origjinale dhe gjithashtu konfirmojnë disponueshmërinë e të gjithë ekspertëve kyç, siç është propozuar fillimisht, përveç nëse parashihet ndryshe në vijim. Nëse ndonjë prej ekspertëve kryesorë nuk është në dispozicion në këtë kohë dhe konsulentët, kur kërkojnë zgjatjen e vlefshmërisë së propozimit të tyre, kërkojnë të zëvendësojnë ekspertin e tillë me një tjetër, ata ofrojnë arsye të adekuata dhe dëshmi për kënaqësinë e Huamarrësit. Propozimi refuzohet nëse konstatohet se eksperti i padisponueshëm u propozua pa konfirmimin e tij / saj, në qoftë se arsyet e parashikuara për zëvendësimin apo justifikim janë të papranueshme, ose kualifikimet dhe përvoja e ekspertit zëvendësues nuk janë të barabarta ose më të mira me ato të ekspertit të propozuar fillimisht. Nëse janë të pranueshme, nuk lejohen ndryshime të tjera në propozimin teknik apo financiar. Pikët e vlerësimit teknik bazuar në ekspertët kryesorë, propozimet financiare dhe detajet tjera të propozimit origjinal mbeten të pa-ndryshuara.
- (q) datën e parashikuar në të cilën konsulenti i përzgjedhur pritet të fillojë detyrën;
- (r) një deklaratë që tregon (i) nëse kontratat e konsulentëve dhe e personelit do të jenë me taksa apo jo; nëse jo, (ii) cila do të jetë barra tatimore e mundur ose ku mund të merret kjo informatë në kohën e duhur, së bashku me një deklaratë që kërkon që konsulenti të përfshijë në propozimin e tij financiar një shumë të veçantë financiare, për të mbuluar tatimet;
- (s) nëse nuk janë përfshirë në TOR ose në draftin e kontratës, detajet e shërbimeve, pajisjeve, dhe personelit që sigurohet nga Huamarrësi;
- (t) ndërprerjen graduale të detyrës, nëse është e përshtatshme, dhe gjasat për detyrat pasuese;
- (u) procedura për të trajtuar sqarime për informata të dhënë në KPP; dhe
- (v) kushteve për nën-kontraktimin e pjesëve të detyrës.

ANEKSI 3: UDHËZIME KONSULENTËVE

Qëllimi

1. Ky aneks ofron udhëzime konsulentëve të cilët synojnë të marrin pjesë në shërbime të konsulencës të financuar nga Banka.

Përgjegjësia për përzgjedhjen e konsulentëve

2. Përgjegjësia për zbatimin e projektit, dhe së këndejmi edhe për pagesën e shërbimeve këshilluese në kuadër të projektit, është vetëm e Huamarrësit. Banka, nga ana e saj, obligohet nga Nenet e Marrëveshjes të sigurojë që fondet të jenë paguar nga një kredi e Bankës vetëm pasi shpenzimet të jenë shkaktuar. Disbursimet e të ardhurave të një kredie ose dhënia bëhen vetëm me kërkesë të Huamarrësit. Huamarrësi i dorëzon kërkesat për tërheqje Bankës së bashku me dokumentacionin e kërkuar mbështetës për të dëshmuar se fondet kanë qenë ose janë duke u përdorur në përputhje me Marrëveshjen e Huasë dhe me Planin e Prokurimit⁶⁴. Siç theksohet në paragrafin 1.4 të këtyre Udhëzimeve, Huamarrësi është përgjegjës për përzgjedhjen dhe punësimin e konsulentëve. Ai fton, merr, dhe vlerëson propozimet dhe dhënien e kontratës. Kontrata është midis Huamarrësit dhe Konsulentit. Banka nuk është një palë në kontratë.

Roli i bankës

3. Siç thuhet në këto Udhëzime (Aneksi I) Banka rishikon KPP-në, vlerësimin e propozimeve, rekomandimeve për dhënie, dhe kontratën për të siguruar që procesi po kryhet në përputhje me procedurat e dakorduara, siç kërkohet në Marrëveshjen e Huasë dhe elaboruar më tej në Planin e prokurimit. Për të gjitha kontratat që i nënshtrohen rishikimit paraprak të Bankës, Banka rishikon dokumentet para se ata të lëshohen, siç përshkruhet në Aneksin 1. Gjithashtu, në qoftë se në çdo kohë gjatë procesit të përzgjedhjes (edhe pas dhënies së kontratës) Banka arrin në përfundimin se procedurat e pranuar nuk janë ndjekur në ndonjë aspekt thelbësor, Banka mund të deklarojë keq prokurim, siç përshkruhet në paragrafin 1.19. Megjithatë, nëse një huamarrës ka dhënë një kontratë pas marrjes së miratimit të Bankës, Banka shpall keq prokurim vetëm në qoftë se miratimi është lëshuar në bazë të informatave jo të plota, të pasakta ose mashtruese të ofruar nga Huamarrësi. Për më tepër, nëse banka konstaton se praktikat korruptuese ose mashtruese janë zbatuar nga përfaqësuesit e Huamarrësit ose të konsulentit, Banka mund të imponojë sanksione në fuqi sipas paragrafit 1.23 të Udhëzimeve.
4. Banka publikon KPP-të dhe kontratat standarde për lloje të ndryshme të shërbimeve konsulentë. Ashtu siç është cekur në paragrafët 2.9 dhe 2.12 të këtyre Udhëzimeve, Huamarrësi obligohet t'i përdor këto dokumente, me ndryshime minimale të pranueshme për Bankën për të shtjelluar çështje specifike për projektin. Huamarrësi finalizon dhe lëshon këto dokumentet si pjesë të KPP-së.

Informatat mbi shërbimet e konsulencës

5. Informatat mbi shërbimet këshillimore, duke përfshirë një përshkrim të shkurtër të natyrës së shërbimeve, kohën, koston e llogaritur dhe inputet e ekspertëve në kohë, dhe kështu me radhë, përfshihen, në radhë të parë, në Dokumentin e Informatave mbi Projektin (PID), i cili përshkruan projektet në përgatitje e sipër. Në të njëjtën kohë, informata të ngjashme gjithashtu përfshihen në përshkrimin e çdo projekti në Përmbledhje Mujore Operacionale (MOS). Një informatë e tillë përditësohen vazhdimisht. Çdo projekt kërkon publikimin e Njoftimit të Përgjithshëm të Prokurimit në Zhvillimi i Biznesit të Kombeve të Bashkuara (UNDB online)⁶⁵ i cili përfshin një përshkrim më të detajuar të shërbimeve të kërkuara, Agjencionin klient, dhe koston e buxhetuar. Në rastin e kontratave me vlerë të madhe⁶⁶, kjo pasohet nga një njoftimi specifik i cili kërkon "shprehje të interesit" në *UNDB online*. Dokumenti i Vlerësimit të Projektit (PAD) ofron informata më të detajshme.
6. Dokumenti informues mbi projektin (PID) dhe Përmbledhja Mujore Operacionale (MOS) gjenden në internet dhe nga Infoshop⁶⁷ në bankë. PAD është në dispozicion, pas aprovimit të kredisë. UNDB është në dispozicion përmes abonimit online.

Roli i konsulentëve

7. Kur konsulentët të pranojnë KPP-në, dhe nëse ata mund t'i plotësojnë kërkesat e TOR dhe kushteve komerciale dhe kontraktuale, ata duhet t'i bëjnë përgatitjet e nevojshme për të përgatitur një propozim të përgjegjshëm (për shembull, duke vizituar lokacionin e detyrës, duke kërkuar shoqata, mbledhjen e dokumentacionit, ngritjen e Ekipit Përgatitor). Nëse konsulentët gjejnë në dokumentet e KPP-së, sidomos në kriteret e procedurës së përzgjedhjes dhe vlerësimit ndonjë paqartësi, lëshim apo kontradiktë të brendshme, ose ndonjë veçori që është e paqartë ose që duket diskriminuese ose kufizuese, ata duhet të kërkojnë sqarime nga Huamarrësi, me shkrim, brenda periudhës së paraparë në KPP për të kërkuar sqarime.
8. Në lidhje me këtë, duhet theksuar se KPP-ja specifike e lëshuar nga Huamarrësi qeveris çdo përzgjedhje, siç parashihet me paragrafin 1.2 të këtyre Udhëzimeve. Nëse konsulentët mendojnë se ndonjë prej dispozitave në KPP janë në kundërshtim me Udhëzimet, ata duhet gjithashtu të ngrenë këtë çështje me Huamarrësin.
9. Konsulentët duhet të sigurojnë që të dorëzojnë një propozim plotësisht të përgjegjshëm duke përfshirë të gjitha dokumentet mbështetëse të kërkuara në KPP. Është thelbësore që të *curricula vitae* të ekspertëve kryesorë të dorëzuara me propozimet të jenë të sakta. *Curricula vitae* nënshkruhet nga konsulentët dhe individët dhe përmbajnë datën. Pasi propozimet teknike të jenë marrë dhe hapur, konsulentëve nuk u kërkohet dhe as u lejohet të ndryshojnë thelbin, ekspertët kyç, etj. Mos përputhja me kërkesat e rëndësishme do të rezultojë në refuzimin e propozimit. Po ashtu, pas pranimi të propozimit financiar, konsulentëve nuk do t'u kërkohet dhe as

⁶⁵UNDB është një botimi Kombeve të Bashkuara. Informacion abonim është në dispozicion nga: Zhvillimin e Biznesit, Kombet e Bashkuara, GCP0Box5850, New York, NY10163-5850, USA (Website: www.devbusiness.com; e-mail: dbsubscribe@un.org).

⁶⁶Kontratat që pritet të kushtojë më shumë seekuivalenti US \$ 300,000, përveç kurlista e ngushtë përfshin vetëm konsulentë kombëtare (shih paragrafët 2.5 dhe 2.7 të këtyre Udhëzimeve)

⁶⁷Adresa Infoshop është edhe adresa e Bankës Botërore: 1818 H Street, NW, Washington, DC, 20433, USA Baza e të dhënave për Projektet është në dispozicion në: [Http://www4.worldbank.org/sprojects/](http://www4.worldbank.org/sprojects/).

t'u lejohet të ndryshojnë honorarin e cituar, përveç në kohën e negociatave, të zhvilluara në përputhje me dispozitat e KPP-së. Në qoftë se vazhdimi i vlefshmërisë së propozimeve ishte arsyeja që ekspertët kyç nuk ishin në dispozicion për një kompani, ndryshim i ekspertëve kyç me kualifikim ekuivalent ose më të mirë mund të lejohet sipas paragrafit 2.28 dhe Aneksit 2, nën-paragrafit I (p) të këtyre Udhëzimeve.

Konfidencialiteti

10. Siç parashihet me paragrafin 2.35, procesi i vlerësimit të propozimeve do të jetë konfidencial deri në publikimin e dhënies së kontratës, përveç për shpalesjen e pikave teknike të paraparë në paragrafët 2.23 dhe 2.30. Konfidencialiteti mundëson huamarrësit dhe shqyrtuesve të Bankës t'u shmangen ndërhyrjes së pahijshme, qoftë reale apo të perceptuar. Nëse, gjatë procesit të vlerësimit, konsulentët dëshirojnë të sjellin informata shtesë për Huamarrësin, Bankën, ose për të dytë, këtë e bëjnë me shkrim.

Veprimi nga Banka

11. Nëse konsulentët dëshirojnë të ngrenë çështje ose pyetje në lidhje me procesin e përzgjedhjes, ata mund t'i dërgojnë Bankës kopjet e komunikimit të tyre me Huamarrësin, ose mund t'i shkruajnë Bankës direkt kur Huamarrësi nuk iu përgjigjet menjëherë ose kur komunikimi është një ankesë kundër Huamarrësit. Të gjitha këto komunikime duhet të adresohen Udhëheqësin e Ekipit të Dërgatës, me një kopje për Drejtorin Vendor për vendin huamarrës dhe Menaxherin Rajonal të Prokurimit. Emrat e udhëheqësve të ekipeve të dërgatave gjenden në PAD.
12. Komunikimet e pranuar nga Banka nga konsulentët e listës së ngushtë para datës së mbylljes për dorëzimin e propozimit, nëse janë të qëlluara, iu referohen Huamarrësit me komentet dhe këshillat e Bankës, për veprim apo përgjigje.
13. Komunikimet, përfshirë edhe ankesat, Banka i merr nga konsulentët pas hapjes së propozimeve teknike trajtohen si më poshtë. Në rastin e kontratave që nuk iu nënshtrohen rishikimit paraprak nga Banka, çdo komunikim apo ekstrakti përkatës i saj, varësisht prej rastit, i dërgohet Huamarrësin për shqyrtim të duhur dhe masa gjegjëse. Huamarrësi i siguron Bankës të gjithë dokumentacionin përkatës për shqyrtim dhe komente. Në rastin e kontratave që iu nënshtrohen rishikimit paraprak, Banka shqyrton komunikimin, në konsultim me Huamarrësin, dhe në qoftë se ka nevojë për informacion shtesë, i kërkon nga Huamarrësi, nëse nevojiten informatat apo qartësime shtesë nga konsulent, Banka i kërkon Huamarrësit që t'i sigurojë këto dhe të komentojë dhe t'i inkorporojë, sipas rastit, në raportin e vlerësimit. Shqyrtimi i Bankës nuk përfundon deri në shqyrtimin dhe ekzaminimin e plotë të komunikimit. Komunikimet e pranuar nga konsulentët të cilët kanë të bëjnë me akuza të mashtrimit dhe korrupsionit⁶⁸ mund të kërkojnë një trajtim të ndryshëm për arsye të

⁶⁸Raportimi imashtrimidhe korrupsionit të dyshuar mund të bëhetdrejtpërsëdrejti Nënkrësisë për Integritet(INT) me email: Hetimet hotline@worldbank.org; përmes faqes së internetit të Bankës Botërore, ose linja telefonike 24 orëshe që operohet nga pala e tretë: pa pagesë +1- 800-831-0463, Mledhja e thirrjeve+1-704-556-7046(përkthyesit janë në dispozicion, telefonata anonimepranohet); ose kontaktoniINTnë zyrën eselisë së Bankës nëUashington DC:+1-202-458-7677

konfidencialitetit. Në raste të tilla, Banka ushtron kujdes dhe diskrecion në ndarjen e informatave relevante me Huamarrësin.

14. Përveç vërtetimit të pranimit të komunikimit, Banka nuk zhvillon diskutim apo korrespondencë me ndonjë konsulent gjatë procesit të përzgjedhjes dhe shqyrtimit, deri në publikimin e dhënies së kontratës.

Diskutimi pasues me Bankën

15. Në qoftë se pas dhënies së kontratës, një konsulent dëshiron të vërtetojë arsye se pse propozimi i tij nuk u zgjodh, ai duhet t'i adresojë kërkesën e tij Huamarrësit, siç parashihet në paragrafin 2.32. Nëse konsulentinuk është i kënaqur me shpjegimin me shkrim të dhënë dhe / ose informimin nga ana e Huamarrësit, dëshiron të kërkojë një takim me Bankën, ai mund t'i drejtohet menjëherë rajonalitë prokurimit përvendin huamarrës, i cili do të organizojë një takim në nivelin e duhur dhe mestafin përkatës. Qëllimi i këtij takimi është vetëm për të diskutuar mbipropozimin e Konsulentit, dhe jo për të ndryshuar qëndrimin e Bankësi cili i është përcjellur për Huamarrësit dhe as për të diskutuar propozimet e konkurrentëve.

UDHËZIMET

Për parandalimin dhe luftimin e mashtrimit dhe korrupsionit në Projektet e financuara nga Huatë e IBRD-së dhe Kreditë dhe Grantet e IDA-së

Data 15 tetor, 2006, ndryshuar në janar, 2011

Qëllimi dhe parimet e përgjithshme

1. Këto Udhëzimesynojnë parandalojnë dheluftojnë mashtrimin dhe korrupsioninqë mund të ndodhë lidhje mepërdorimin e të ardhuravetë financimitnga BankaNërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) ose Asociacioni Nërkombëtar për Zhvillim(IDA) gjatë përgatitjes dhe / ose zbatimit projekteve të investimit të financuara nga IBRD/ IDA. Atopërcaktojnë parimet epërgjithshme, kërkesatdhe sanksionetqë vlejné përpersonatdhe subjektet të cilat marrin, janë përgjegjëse përdepozitimose transferimin e mjeteve, ose të cilët marrin vendime ose ndikojnë në marrjen e vendimevelidhur me përdorimin e produkteve të tilla.
2. Të gjithë personatdhe subjektete përmendura në paragrafin1 më sipërduhet të respektojnëstandardinmë të lartë tëetikës.Në veçanti, të gjithë personat dhe subjektete tilladuhet tëmarrin të gjithamasat e duhurapër të parandaluar dheluftuar mashtrimin dhe korrupsionin, dhe të përmbahen nga përfshirjanë mashtrim dhe korrupsionnë lidhje mepërdorimin etë ardhurave ngaIBRD-jaose nga financimi i IDA-së.

Çështjet ligjore

3. Marrëveshja e Huasë⁶⁹ e cila siguron Huanë⁷⁰ qeverisë raportet juridike ndërmjet Huamarrësit⁷¹ dhe Bankës⁷² përkritazi me ndonjë raport të caktuar për të cilin jepet Huaja.Përgjegjësia për implementimin e projektit⁷³ sipas Marrëveshjes për huanë, dhe për shfrytëzimin e mjeteve nga Huaja, bie mbi Huamarrësin. Banka, nga ana e saj, ka detyrë të besuar sipas këtyre neneve të Marrëveshjes që “të organizohet për t’u

⁶⁹Referencat në këto udhëzime "Marrëveshjes së huasë" përfshijn çfarëdo Marrëveshje të garancionit për ndonjë garancion të ofruar nga Shteti anëtar lidhur me një Hua të IBRD-së, Marrëveshjen e financimit e cila parashikon kredi të IDA-së ose Grant të IDA-së, një marrëveshje që parashikon avans për përgatitje të projektit apo Grant të Fondit për Zhvillimin Institucional (IDF), Granti për Fondin e Trustit ose Marrëveshja e huasë e cila parasheh grantin e fondit të trustit të ekzekutuar nga Pranuesi apo hua në rastet kur këto udhëzime vlejné për një marrëveshje të tillë, Marrëveshje të Projektit me një Subjekt implementues të Projektit në lidhje me ndonjërin nga pikat më lartë.

⁷⁰Referimet "huasë" ose "huave" përfshijnë huatë e IBRD-së, si dhe kreditë dhe grantet e IDA-së, paradhëniet për përgatitjen e projektit, grantet e IDF-së dhe grantet e fondeve të trustit të hua të ekzekutuara nga pranuesi për të cilat kur këto udhëzime aplikohen sipas Marrëveshjes që parashikon grant dhe / ose huatë të tillë, por përjashton huadhënie për politikat zhvillimore, përveç nëse Banka bie dakord me Huamarrësin për qëllime të caktuara, për të cilat mund të përdoren mjetet e kredisë.

⁷¹Referencat në këto udhëzime për të "Huamarrësit" përfshijnë marrësit e një kredie të IDA-së ose granti apo një grant nga trusti i fondit ose hua. Në disa raste, huaja e IBRD-së mund t'i bëhet një subjekti tjetër përveç vndi anëtar. Në raste të tilla, referencat në këto udhëzime "Huamarrësit" përfshijnë edhe vend anëtar si garantuese të Huasë, përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe. Në disa raste, projekti, ose një pjesë e projektit, kryhet nga një subjekt zbatimi i projektit me të cilin Banka ka hyrë në një marrëveshje të Projektit. Në raste të tilla, referencat në këto udhëzime "Huamarrësit" përfshijnë Subjektin Implementues të Projektit, siç përcaktohet në Marrëveshjen e Huasë.

⁷²Referencat në këto Udhëzime "Bankës" përfshijnë si IBRD-në ashtu edhe IDA-në.

⁷³Referencat në këto udhëzime "projektin" nënkupton Projektin siç është definuar në Marrëveshjen e Huasë.

kujdesur që mjetet e huasë përdoren vetëm për qëllime për të cilat është dhënë huaja, duke i kushtuar kujdes çështjes së ekonomisë dhe efikasitetit, pavarësisht ndikimeve apo çështjeve politike apo jo-ekonomike.”⁷⁴ Këto Udhëzime përbëjnë një element të rëndësishëm të atij organizimi dhe vlejën për përgatitjen dhe implementimin e projekteve, ashtu siç parashihet me Marrëveshjen mbi huanë.

Fushëveprimi i zbatimit

4. Dispozitatvijuose tëkëtyre Udhëzimevembulojnëmashttrimin dhekorruptionin që mund të paraqitet në lidhje mepërdorimin e të mjeteve të Huasëgjatë përgatitjesdhe implementimit tënjë projekti të financuar, tërësisht ose pjesërisht, nga ana e Bankës. Këto Udhëzimembulojnëmashttrimindhe korruptionin nëdiversiontë drejtpërdrejtëtë të ardhuravetë Huasëpër shpenzimet të papranueshme,si dhe përfshirjen në mashttrim dhe korruptionme qëllim që të ndikohet nëndonjë vendimnë lidhje me përdorimine mjeteve të Huasë. Të gjithamashttrimetdhe korruptionete tillakonsiderohet, për qëllimetë këtyreUdhëzimeve,të kenë ndodhur "nëlidhje mepërdorimin e mjeteve të Huasë".
5. Këto Udhëzimevlejnëpër Huamarrësin dhe të gjithë personatapo subjektet tjeratë cilat osemarrintë ardhurate huasë përpërdorimin e tyre(p.sh., "përdoruesit e skajshëm"), personat ose subjektet siç janë agjentë fiskal të cilët janëpërgjegjës përdepozitiminose transferimine mjeteve të Huasë(pavarësisht nëse janë apojo përfitues tëkëtyre të ardhurave), dhe personat ose subjektet të cilët marrin vendime ose ndikojnë në vendimet në lidhje mepërdorimin e mjeteve të huasë.Të gjithë personatdhe subjektete tillanë këto Udhëzimequhen "pranues të mjeteve të Huasë", pavarësisht nëse janë apo jo në posedim fizik të mjeteve të tilla⁷⁵.
6. Kërkesatspecifiketë politikës së Bankëspërmashtrim dhe korruptionnë lidhje meprokurimin ose ekzekutimine kontratavepër mallrat, punimetose shërbimet e financuaranga mjetet e një kredietë bankës,mbulohen me Udhëzimet e Prokurimit⁷⁶dheUdhëzimet mbi konsulentë⁷⁷, pasi që Udhëzimetë tilla të prokurimitdhepër konsulentë vlejën për hua të caktuara.

⁷⁴ Nenet e Marrëveshjes të IBRD-së, Neni III, Pjesa 5(b); Nenet e Marrëveshjes të IDA-së, Neni V, Seksioni I(g).

⁷⁵ Disa persona apo subjekte mund të jenë pjesë e më shumë se një kategorie të identifikuar në paragrafin 5. Ndërmetësi financiar, për shembull, mund të pranojë pagesa për shërbime, transferon mjete shfrytëzuesve të skajshëm dhe merr ose ndikon në vendime lidhur me shfrytëzimin e mjeteve të huasë.

⁷⁶ Udhëzimet; Prokurimi me huatë e IBRD-së dhe Kreditë e IDA-së, maj 2004, të ndryshuar në tetor të vitit 2006 dhe maj 2010, dhe Udhëzimet: prokurimi i mallrave, punëve dhe shërbimeve jo konsulente me huatë e IBRD-së dhe kredietë dhe grantet e IDA-së nga Huamarrësit të Bankës Botërore të dates janar 2011, me ndryshimet periodike të Udhëzimeve për prokurim.

⁷⁷ Udhëzimet. Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga Huamarrësit e Bankës Botërore, maj 2004, të ndryshuar më tetor 2006 dhe maj 2010, dhe Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve sipas Huave të IBRD-së dhe Kredive dhe Granteve të IDA-së nga Huamarrësit e Bankës Botërore të dates janar 2011, me ndryshimet periodike të Udhëzimeve për konsulentë.

Përkufizimi i praktikave të cilat përbëjnë mashtrim dhe korrupsion

7. Këto Udhëzimeshtjellojnëpraktikate mëposhtme të përcaktuaranë të cilat përfshihen pranuesit emjeteve të Huasënë lidhjeme përdorimine këtyre mjeteve⁷⁸:
- a) Një"praktikë e korruptuar" është ofrimi, dhënia, marrjaapo kërkimi, në mënyrë të drejtpërdrejtose tërthorazi, indonjë gjëje me vlerëpër të ndikuar nëmënyrë të paligjshmeveprimet enjë pale tjetër.⁷⁹
 - b) Një"praktike mashtruese" është çdo veprim apo mosveprim,duke përfshirë edhejështrembërim,i cili vetëdijeapo nga pakujdesia⁸⁰vë në lajthitje, apo tentontë vë në lajthitje,një palë për të marrë njëpërfitim financiarose tjetër, ose për të shmangurnjë detyrim.
 - c) Praktikëe marrëveshjes së fshehtë"është njëmarrëveshje ndërmjet dy osemë shumë palëvepër të arriturnjë qëllimtë pahijshëm, duke përfshirë ndikimin nëmënyrë të paligjshmenë veprimet enjë pale tjetër.
 - d) "Praktikëdetyruese", është cënimi ose dëmtimi,osekërcënimi për të cënuarose dëmtuar,drejtpërdrejt ose tërthorazi, çdo palëosepronë të palëspër të ndikuar nëmënyrë të paligjshmenë veprimet enjë pale.
 - e) Një"praktikëobstruktive" është (i) shkatërrimi,falsifikimi, ndryshimi osefshehja eqëllimishme eprovavematerialepër hetiminose dhënia e deklaratavehetuesvenë mënyrë që tëpengojnëmaterialishtnjë hetim tëBankës lidhur me akuzatpër ndonjë praktikë të korruptuar, mashtruese, detyruese apo tëfshehtë; dhe / osekërcënimi, ngacmimiapo frikësimi indonjëpale për të parandaluaratë ngazbulimii njohurivetë tijrreth çështjeve relevantepër hetiminose ngakryerja e hetimit, ose (ii) veprime që synojnë materialishttë pengojnë ushtrimine të drejtavekontraktualetë Bankësnë auditimaponë qasje në informata.⁸¹
8. Praktikate e mësipërme, të definuara si më lartë, ndonjëherë kolektivisht referohen në këto Udhëzime, si "mashtrim dhe korrupsion".

⁷⁸Përveç nëse parashihet ndryshenë Marrëveshjen e Huasë, kurdo qëkëto termajanë përdorurnë Marrëveshjen e Huasë, përfshirë Kushtet ePërgjithshmenë fuqi, ato kanëkuptimete përcaktuara nëparagrafin 7 tëkëtyre Udhëzimeve.

⁷⁹shembujtipikëtë praktikavekorruptivepërfshijnëryshfetin dhe"ndaljen e përqindjes".

⁸⁰Për të vepruar"me dashje ose nga pakujdesia", vepruesi mashtruesose duhet tëdijë seinformatat apopërshtypjaqë përcjell është e rremë,ose të jetëpakujdesishtindiferentnëseajoështë e vërtetëapo e rreme. Vetëm pasaktësiainëinformacion apopërshtypje të tillë, e kryernga pakujdesiathjeshtënuk mjafton mjaftueshëmepër t'u konsideruar si praktikëmashtruese.

⁸¹Këto të drejtapërfshijnëato që parashikohen, ndër të tjera, në paragrafin9 (d) më poshtë.

Veprimet e Huamarrësit për të parandaluar dhe luftuar mashtrimin dhe korrupsionin në lidhje me shfrytëzimin e mjeteve nga huaja

9. Në mbështetje të qëllimitë mësipërm dhe parimevetë përgjithshme, Huamarrësi:
- (a) merr të gjitha masat e duhura për të parandaluar praktikatat korruptive, mashtruese, të marrëveshjes së fshehtë, detyruese dhe penguese në lidhje me përdorimin e të mjeteve të Huasë, duke përfshirë (por duke mos u kufizuar në):
 - (i) miratime praktikavetë duhura administrative dhe të besueshmerisë dhe aranzhimet institucionale për të siguruar që të ardhurat e huasë përdoren vetëm për qëllimet për të cilat Kredia është dhënë, dhe (ii) të sigurojë që të gjithë përfaqësuesit⁸² e saj të përfshirë në projekt dhe të gjithë pranuesve të të ardhurave të Huasë me të cilën ai lidh një marrëveshje që lidhet me projektin, të merr një kopje të këtyre Udhëzimeve dhe të jenë njoftuar mbi përmbajtjen e saj;
 - (b) menjëherë i raporton Bankës çfarëdo akuza të mashtrimit dhe korrupsionit në lidhje me përdorimin e të ardhurave të Huasë të cilat i bëhen me dije;
 - (c) nëse Banka konstaton se ndonjë person ose entit i përmendur në (a) më lartë është përfshirë në praktika korruptuese, mashtruese, të marrëveshjes së fshehtë, shtrënguese apo penguese në lidhje me përdorimin e mjeteve të Huasë, merr masa të përshtatshme dhe me kohë, të kënaqshme për Bankën, për të adresuar praktikatat e tilla kur ato ndodhin;
 - (d) të përfshijë dispozitat në marrëveshjet e saj me çdo përfitues të të ardhurave të Huasë të cilat Banka mund t'i kërkojë për t'i dhënë efekt të plotë këtyre Udhëzimeve, përfshirë (por duke mos u kufizuar vetëm në) dispozitat (i) të cilat kërkojnë që pranuesit e tillë të veprojnë në përputhje me paragrafin 10 të këtyre Udhëzimeve, (ii) që obligojnë pranuesit e tillë që të lejojnë Bankën të inspektojë të gjitha llogaritë e tyre dhe regjistrimet dhe dokumentet e tjera që lidhen me projektin të cilat duhet të mbahen në përputhje me Marrëveshjen e Huasë dhe që ato të auditohen nga, ose në emër të, Bankës, (iii) parashohin përfundimin e hershëm apo pezullimin e marrëveshjes nga ana e Huamarrësit, nëse përfituesi i tillë është deklaruar i papërshtatshëm nga Banka sipas paragrafit II poshtë; dhe (iv) mundësojnë kërkimkthimin e çfarëdo shumetë kredisë në lidhje me të cilat ka ndodhur mashtrimi dhe korrupsioni;
 - (e) të bashkëpunojë plotësisht me përfaqësuesit e Bankës në çdo hetim lidhur me dyshimet për mashtrim dhe korrupsion në lidhje me përdorimin e mjeteve të kredisë; dhe
 - (f) në rast se Banka deklaron ndonjë pranues të të ardhurave të Huasë të papërshtatshëm siç përshkruhet në paragrafin 11 më poshtë, të merr të gjitha masat e nevojshme dhe të përshtatshme për t'i dhënë efekt të plotë të një deklaratë të tillë nga, ndër të tjera, (i) të ushtrojnë të drejtën e Huamarrësit për

⁸²Referencat “përfaqësuesve” e një subjekti në këto Udhëzime gjithashtu përfshijnë zyrtarët, nëpunësit dhe agjentët e atij subjekti.

të ndërprerë herët ose të pezullojnë marrëveshjen ndërmjet Huamarrësit dhe pranuesit të tillë dhe / ose (ii) të kërkojnë kthim.

Pranuesit e tjerë të mjeteve të huasë

10. Në mbështetje të qëllimit e mësipërm dhe parimet e përgjithshme, çdo përfituesi i të ardhurave të Huasë që hyn në një marrëveshje me të Huamarrësit (ose me një tjetër pranuesit e të ardhurave të Huasë) në lidhje me Projektin do të:
 - (a) kryen aktivitetet e ndërlidhura me projektin në përputhje me parimet e sipërpërmendura të përgjithshme dhe dispozitat e marrëveshjes së tij me Huamarrësin të përmendur në paragrafin 9 (d) më sipër; dhe përfshin dispozita të ngjashme në çdo marrëveshje të ndërlidhur me Projektin në të cilin ai lidhur me pranuesit e tjerë të mjeteve të Huasë;
 - (b) menjëherë i raporton Bankës ndonjë akuzë për mashtrim dhe korrupsion në lidhje me përdorimin e mjeteve të kredisë të cilat i bëhen me dije,
 - (c) bashkëpunojë plotësisht me përfaqësuesit e Bankës në çdo hetim rreth dyshimeve për mashtrim dhe korrupsion në lidhje me përdorimin e të ardhurave të kredisë;
 - (d) Merr të gjitha masat e duhura për të parandaluar praktikat korruptive, mashtruese, të marrëveshjes së fshehtë, detyruese dhe penguese nga përfaqësuesit e saj (nëse ka të tillë) në lidhje me përdorimin e mjeteve të kredisë, duke përfshirë (por duke mos u kufizuar vetëm në): (i) përvetësimin e praktikave të duhura administrative dhe të besuara si dhe rregullime institucionale për të siguruar që të ardhurat e huasë përdoren vetëm për qëllimet për të cilat është dhënë huaja, dhe (ii) kujdeset që të gjithë përfaqësuesit e saj të marrin një kopje të këtyre Udhëzimeve dhe njoftohen mbi mbi përmbajtjen e tyre;
 - (e) në rast se ndonjë përfaqësues i pranuesit të tillë është deklaruar i papërshtatshëm, siç përshkruhet në paragrafin 11 më poshtë, merr të gjitha masat e nevojshme dhe të përshtatshme për t'i dhënë efekt të plotë një deklaratë të tillë duke, ndër të tjera, hequr përfaqësuesin e tillë nga të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë në lidhje me projektin ose, kur kërkohet nga Banka ose shihet përndryshe si e nevojshme, ndërpre marrëdhëniet e tij kontraktuale me përfaqësuesin e tillë; dhe
 - (f) në rast se ka hyrë në një marrëveshje të ndërlidhur me projektin me një person apo entitet tjetër i cili është deklaruar i papërshtatshëm, siç përshkruhet në paragrafin 11 më poshtë, merr të gjitha masat e nevojshme dhe të përshtatshme për t'i dhënë efekt të plotë një deklaratë të tillë duke, ndër të tjera, (i) ushtruar të drejtën e tij për të ndërprerë herët ose për të pezulluar marrëveshjen e tillë dhe / ose (ii) të kërkojë kthim.

Sanksionet dhe veprimet e ndërlidhura nga Banka në rast të mashtrimit dhe korrupsionit

11. Nëmbështetje të qëllimittë mësipërmdhe parimevetë përgjithshme, Banka gëzon të drejtë për të sanksionuar në përputhje me politikat dhe procedurat e Bankës, çdo individ apo subjekt⁸³ përveç Vendit Anëtar⁸⁴, duke përfshirë (por duke mos u kufizuar në), shpalljen e individitose entitetitë tillësi publikisht të papërshtatshëm, qoftë për një kohë të pacaktuarose për një periudhë të caktuarose: (i) të merr kontrata të financuara nga Banka, (ii) të përfitojë nga një kontratë e financuar nga Banka, në mënyrë financiare apo tjetër, për shembull, si një nën-kontraktor; dhe (iii) të merr pjesë në përgatitjenose zbatimin e projektit ose donjë projekt tjetër të financuar, tërësishtose pjesërisht, nga Banka,
- (a) në qoftë se në çdo kohë Banka konstaton⁸⁵ ai individose entitetishtë përfshirë në praktika korruptuese, mashtruese, marrëveshjes së fshehtë, shtrënguese apo penguesenë lidhje me përdorimin e mjeteve të kredisë;⁸⁶
 - (b) nëse një financier me të cilat Banka ka hyrë në një marrëveshje për zbatimin reciprok të vendimevetë përjashtimit ka shpallur individose subjektin e tillëtë papërshtatshëm për të pranuar shumat e financimevetë bëra nga financieri tillëose për të marrë pjesë në përgatitjenose zbatimin e çdo projektit të financuar tërësishtose pjesërisht nga financieri tillësi rezultat i konstatimit nga financieri i tillë se individ apo subjekti është përfshirë në praktika mashtruese, korruptive, detyruese ose të fshehtë lidhje me përdorimin e mjeteve nga një financier i tillësi bërë nga financieri; ose
 - (c) nëse Departamenti për shërbimet e përgjithshme të Bankës ka konstatuar se individ apo subjekti është jo i përgjegjshëm në bazë të mashtrimit dhe korrupsionit në lidhje me prokurimin korporativ të Grupit të Bankës Botërore.

Të ndryshme

⁸³ Ashtu si në rastin e ofertuesit në kontekstin e prokurimit, Banka gjithashtu mund të sanksionojë individët dhe subjektet që cilët përfshihen në praktika të mashtrimit apo korrupsionit gjatë aplikimit për t'u bërë përfituesi të ardhurave të Huasë (p.sh. një bankë e cilasigurondokumentacione falsifikuar në mënyrë që të kualifikohet si njëndërmjetës financiar në një projekt të financuar nga banka) pavarësisht nëse janë të suksesshëm.

⁸⁴ Për qëllimet e këtyre Udhëzimeve, "Shtet anëtar" përfshin zyrtarët dhe punonjësit e qeverisë kombëtare apo të donjë prej nëndarjeve politike ose administrative qeveritare dhe tërësisht të pronësive të agjencitë, të cilët nuk kanë të drejtë të: (i) ofertojnë sipas paragrafit 1.8(b) të Udhëzimeve: Prokurimi për Huatë e IBRD-së dhe kreditë e IDA-së, maj 2004, të rishikuar në tetor 2006 dhe maj 2010, dhe paragrafit 1.10(0) të Udhëzimeve: Prokurimi imallrave, punëve dhe shërbimeve jo-konsulentë sipas huatëve të IBRD-së dhe kredive dhe granteve të IDA-së nga Huamarrësit e Bankës Botërore, datë janar 2011; ose (ii) të marrin pjesë sipas paragrafit 1.11(b) të Udhëzimeve: Përzgjedhja dhe Punësimi i Konsulentëve nga Huamarrësit e Bankës Botërore, Maj 2004, rishikuar në tetor 2006 dhe maj 2010, dhe paragrafit 1.13(b) të Udhëzimeve: Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve sipas huatëve të IBRD-së dhe Kredive dhe granteve të IDA-së nga Huamarrësit e Bankës Botërore, data janar 2011.

⁸⁵ Banka ka themeluar një Bord të sanksioneve, dhe procedurat e ndërlidhura, me qëllim që të konstatime të tilla. Procedurat e Bordit të Sanksioneve përcaktojnë tërësinë e plotë të sanksioneve në dispozicion të Bankës.

⁸⁶ Sanksionim mund, pa kufizim, të përfshijë gjithashtu çdoktim të shumës së kredisë në lidhje me të cilat është kryerja sjellja e sanksioneve. Banka mund të publikojë identitetin e çdo individit apo entitetit të shpallur si të papërshtatshëm sipas paragrafit 1.

12. Dispozitat e Udhëzimeve nuk kufizojnë të drejtat, mjetet tjera juridike⁸⁷ apo obligimet e Bankës apo Huamarrësit në kuadër të Marrëveshjes së huasë apo ndonjë dokumenti tjetër në të cilin Banka dhe Huamarrësi janë palë.

⁸⁷Marrëveshja e huasë i ofron Bankës disa të drejta dhe mjete juridike të cilat mund t'i ushtrojë në lidhje me huanë në rast të mashtrimit apo korrupsioni në lidhje me shfrytëzimin e mjeteve të Huasë, në rrethanat e përshkuara në të.

NUMRI I KREDISË 5240-XX

Marrëveshja e projektit

(Projektin e pastrimit dhe rikthimit të tokës në Sektorin e Energjetikës)

ndërmjet

ASOCIACIONIT NDËRKOMBËTAR PËR ZHVILLIM

dhe

KORPORATËS ENERGETIKE TË KOSOVËS

Datë 15 maj 2013

MARRËVESILJA E PROJEKTIT

Marrëveshja e datës 15 maj, 2013, e lidhur ndërmjet ASOCIACIONIT NDËRKOMBËTAR PËR ZHVILLIM ("Asociacioni") dhe KORPORATËS ENERGJETIKE TË KOSOVËS me ("Subjekti i implementimit të Projektit") ("Marrëveshja e Projektit") në lidhje me Marrëveshjen e Dytë e Financimit Shtesë ("Marrëveshja e Financimit") të së njëjtës datë ndërmjet Republikës së Kosovës ("Pranuesi") dhe Asociacionit. Asociacioni dhe Subjekti i Implementimit të Projektit pajtohen si në vijim:

NENI I – KUSHTET E PËRGJITHSHME; PËRKUFIZIMET

- 1.01. Kushtet e përgjithshme (ashtu siç definoohen në Aneksin e kësaj Marrëveshjeje të Financimit) janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.
- 1.02. Përveç nëse kërkohet ndryshe nga konteksti, shprehjet me shkronja të shtypura, të përdorura në këtë Marrëveshje kanë kuptimet të cilat janë paraparë në Marrëveshjen e Financimit ose me Kushtet e përgjithshme.

NENI II - PROJEKTI

- 2.01. Njësia për implementim të projektit deklaron përkushtimin e tij ndaj pikësnyimeve të Projektit. Për këtë qëllim, Subjekti i implementimit të projektit zbaton Pjesët C dhe E të Projektit, si dhe Pjesën D së bashku me MMPH-në, në përputhje me dispozitat e Nenit IV të Kushteve të përgjithshme. Njësia për implementim të projektit ofron pa vonesë, sipas nevojës, fonde, stabilimente, shërbime dhe burime të tjera të nevojshme për Pjesët gjegjëse të Projektit.
- 2.02. Pa kufizuar dispozitat e Seksionit 2.01 të kësaj Marrëveshjeje, dhe përveç nëse pajtohen ndryshe Asociacioni dhe Subjekti për implementim të projektit, Subjekti për implementim të projektit zbaton pjesët gjegjëse të Projektit në përputhje me dispozitat e Shtojcës së kësaj Marrëveshjeje.

NENI III – NDËRPRERJA

- 3.01. Për qëllime të Seksionit 8.05(c) të Kushteve të përgjithshme, data në të cilën ndërpriten dispozitat e kësaj Marrëveshjeje është njëzet vjet pas datës së Marrëveshjes.

NENI IV – PËRFAQËSUESI; ADRESA

- 4.01. Përfaqësuesi i Subjektit për implementim të Projektit është Koordinatori i Njesisë për menaxhim të projektit.
- 4.02. Adresa e Asociacionit është:

International Development Association
1818 H Street, N. W.

Washington, D. C. 20433
United States of America

Kabllogram:	Telex:	Facsimile:
INDEVAS Washington, D.C.	248423 (MCT)	1-202-477-6391

4.03. Adresa e Subjektit për implementim të projektit është:
Rruga Nëna Terezë
10000, Prishtinë
Republika e Kosovës

Faksi:
+381 385017011296

Lidhur në Prishtinë, Republika e Kosovës, në ditën dhe datën e shkruar më lartë.

ASOCIACIONI NDËRKOMBËTAR PËR ZHVILLIM

Nga

Përfaqësuesi i Autorizuar

Emri: _____

Titulli: _____

KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS

Nga

Përfaqësuesi i Autorizuar

Emri: _____

Titulli: _____

SHTOJCA 1

Ekzekutimi i projektit

Seksioni I. Përgatitjet për implementim

A. Përgatitjet institucionale

1. Subjekti i implementimit të projektit lidh një Marrëveshje të vartësisë me Pranuesin për qëllime të pranimit të fondeve të nevojshme për zbatimin e Projektit.
2. Subjekti i implementimit të projektit përbush me zell të gjitha obligimet sipas Marrëveshjes së vartësisë. Përveç nëse Asociacioni pajtohet ndryshe, Subjekti për implementimi të projektit nuk ndërmerr dhe as mbështet ndonjë veprim i cili do të kishte për pasojë ndryshimin, abrogimin, hartjen e obligimeve apo shfuqizimin e Marrëveshjes së vartësisë apo ndonjë dispozite të saj.
3. Subjekti i implementimit të projektit njofton pa vonësë Asociacionin lidhur me ndonjë kusht i cili ndërhyt apo kërcënon të ndërhyjë në përparimin e Projektit apo përbushjen e obligimeve të Subjektit të implementimit të projektit sipas kësaj Marrëveshjeje apo sipas Marrëveshjes së vartësisë.
4. Subjekti për implementim të projektit është përgjegjës për aktivitetet të menaxhimit të projektit për Pjesët C dhe E sipas Pjesës D të Projektit. Subjekti i implementimit të projektit gjithashtu është përgjegjës për implementimin e Pjesëve C dhe E të Projektit.
5. Njësia për implementim të projektit kujdeset që Bordi i drejtorëve takohet të paktën një herë gjatë tremujorit kalendarik gjatë implementimit të Projektit, apo më shpesh, sipas nevojës:
 - (a) Për të shqyrtuar përparimin në zbatimin e Projektit;
 - (b) Për të shqyrtuar raportet tremujore të progresit të NJPM-së së KEK-ut; dhe
 - (c) Për të ofruar NJPM-së së KEK-ut çfarëdo këshille apo rekomandimi të cilën e konsideron të qëlluar apo të domosdoshme në këto rrethana.
6. Njësia për implementim të projektit kujdeset që NJPM e KEK-ut:
 - (a) Gjatë tërë kohëzgjatjes së zbatimit të projektit, të furnizohet me fonde adekuate, stabilimente, shërbime dhe burime të tjera, dhe me staf të kualifikuar si duhet dhe atë në numra të mjaftueshëm;

- (b) Raporton Bordit të drejtorëve të KEK-ut, përmes Shërbimeve korporative të KEK-ut, në mënyrë të plotë, të rregullt, dhe me kohë, duke përfshirë, pa kufizim, edhe përmes ofrimit të raporteve tremujore të progresit të Projektit;
- (c) Është përgjegjës për implementimin e përditshëm dhe menaxhimin e Pjesës E, si dhe për aktivitete të menaxhimit të projektit për Pjesët C dhe E, të kryer sipas Pjesës D, përfshirë, pa kufizim, menaxhimin e mbrojtësve mjedisor dhe shoqëror, menaxhim financiar, prokurim dhe monitorim dhe vlerësim si dhe për raportim të progresit dhe raportim financiar, harton temat e referencës (përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi) për detyrat e konsulentëve të financuara me Projekt dhe shqyrton raportet e konsulentëve dhe monitoron performancën e tyre, si dhe organizon konsultimet publike, sipas nevojës;
- (d) Përgatit raportet tremujore të Progresit për Bordin e drejtorëve të KEK-ut, dhe
- (e) Kryen funksione të tjera dhe merr përgjegjësi të tjera të cilat mund t'i caktohen me Doracakun e operacioneve kohë pas kohe.

B. Udhëzuesi kundër korrupsionit

Subjekti i implementimit të Projektit kujdeset që Projekti të kryhet në përputhje me dispozitat e Udhëzuesve kundër korrupsionit.

C. Masat mbrojtëse

1. Subjekti i implementimit të Projektit kujdeset që Projekti zbatohet në përputhje me Planin e menaxhimit të mjedisit dhe me Doracakun e Operacioneve e në përputhje me kushtet e tyre përkatëse, si dhe aplikon dhe zbaton, varësisht prej rastit, politikat procedurat dhe marrëveshjet e parapara në to.
 2. Subjekti i implementimit të Projektit ndryshon, suspendon, anulon, ndërpresë apo zhvlefëson Planin për menaxhim mjedisor apo Doracakun e operacioneve pa miratimin paraprak me shkrim të Asociacionit.
 3. Pa pëlqimin paraprak të Asociacionit në konsultim me Pranuesin, Subjekti për implementim të projektit:
 - (a) Nuk merr ndonjë vendim përfundimtar në lidhje me tokën e rikthyer në përputhje me Pjesën C të Projektit; ose
 - (b) Nuk shet, transferon, jep me qira apo tjetëron tërësisht apo pjesërisht tokën e tillë.
- përveç nëse dhe deri në hartimin e një plani për shfrytëzim të tokës, të kënaqshëm për Asociacionin, në përputhje me legjislacionin për planifikim hapësinor në Kosovë dhe në mënyrë pjesëmarrëse të pranueshme për Asociacionin.

Seksioni II. Monitorimi, raportimi dhe vlerësimi i projektit

A. Raportet e projektit

1. Subjekti për implementim të Projektit monitoron dhe vlerëson progresin e Projektit dhe harton Raportet e Projektit në përputhje me dispozitat e Nenit 4.08 të Kushteve të përgjithshme dhe mbi bazë të troguesve të dakorduar me Asociacionin. Çdo Raport i tillë i Projektit mbulon periudhën e një tremujori kalendarik dhe i dorëzohet Pranuesit jo më vonë se njëzet e një (21) ditë pas përfundimit të periudhës së mbuluar nga ky raport për t'u inkorporuar dhe ceduar nga Pranuesi tek Asociacioni në Raportin e përgjithshëm të Projektit.
2. Jo më vonë se njëqind e njëzet ditë (12) ditë pas Datës së mbylljes, Subjekti për implementim të Projektit i ofron Pranuesit, për inkorporim në raportin e cekur në Seksionin 4.08(c) të Kushteve të Përgjithshme, të gjitha informatat të cilat i kërkon me arsye Pranuesi dhe Asociacioni për qëllime të një raporti të tillë.

B. Menaxhimi financiar, raportet dhe auditet financiare

1. Subjekti për implementim të projektit mirëmban një sistem të menaxhimit financiar dhe përgatit Deklaratat financiare në përputhje me standardet e vlefshme kontabiliste në fuqi e që janë të pranueshme për Asociacionin, të dyja këto në mënyrën e cila është e adekuate për të pasqyruar operacionet, resurset dhe shpenzimet e ndërlidhura me Projektin. Subjekti për implementim të Projektit është përgjegjëse për deklaratat e konsoliduara financiare të projektit deri sa aktivitetet e ndërlidhura me largimin e kimikateve të rrezikshme nga lokacioni i gazifikacionit të kenë përfunduar dhe të jenë raportuar, pas së cilës gjë parashtrihen deklaratat e konsoliduara financiare nga Pranuesi.
2. Subjekti për implementim të Projektit lejon auditimin e Deklaratave financiare të lartpërmendura nga auditorë të pavarur të pranueshëm për Asociacionin, në përputhje me standardet e auditimit në fuqi e të pranueshmë për Asociacionin. Çdo auditim i këtyre Deklaratave Financiare mbulon periudhën prej një viti fiskal të Subjektit për implementim të projektit.

Seksioni III. Prokurimi

Të gjitha mallrat, punë dhe shërbimet e nevojshme për Pjesët gjegjëse të Projektit të Subjektit për implementim të Projektit dhe të cilat duhet të financohen nga mjetet e Financimit prokurohen në përputhje me dispozitat e Seksionit III të Shtojcës 2 të Marrëveshjes së financimit.